PËR MËSIMDHËNËSIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Sejdi Bellanica, Arbëreshë Sahiti-Yvejsi, Gëzime Azemi-Salihi, Jehona Kumnova-Dula, Liridonë Mehmeti, Naze Bellanica, Vixhilent Kurti, Vjollca Pllana-Kastrati, Vjollca Veliu

6

# GJUHA SHQIPE

Për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët

# PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes ....... 8
Hyrje ....... 10
Planifikimi vjetor ....... 19
Plani dymujor: shtator—tetor ....... 20
Plani dymujor: nëntor—dhjetor ....... 24
Plani tremujor: janar—shkurt—mars ....... 28
Plani tremujor: prill—maj—qershor ....... 32
Mësimi 1: Shoqëria dikur dhe sot ....... 36
Mësimi 2: Shoqëria dikur dhe sot. ....... 38
Mësimi 3: Shqipja standarde dhe dialektet ....... 40
Mësimi 4: Shqipja standarde dhe dialektet ....... 42
Mësimi 5: Shqipja standarde dhe dialektet ....... 44
Mësimi 6: Shqipja standarde dhe dialektet ....... 46
Mësimi 7: Fonetika: tingujt e të folurit ....... 48
Mësimi 8: Tingujt e të folurit ....... 50
Mësimi 9: Tingujt e të folurit ....... 52
Mësimi 10: Tingujt e të folurit ....... 54
Mësimi 11: Vajzat dhe djemtë ....... 56
Mësimi 12: Vajzat dhe djemtë (ora e dytë) ....... 58
Mësimi 13: Vajzat dhe djemtë (ora e tretë) ....... 60
Mësimi 14: Vajzat dhe djemtë (ora e katërt) ....... 62
Mësimi 15: Rrokja ....... 64
Mësimi 16: Rrokja ....... 66
Mësimi 17: Rrokja ....... 68
Mësimi 18: Lajmet ....... 70
Mësimi 19: Elementet e lajmit ....... 72
Mësimi 20: Përsëritje ....... 74
Mësimi 21: Interneti ....... 76
Mësimi 22: Rëndësia e internetit ....... 78
Mësimi 23: Theksi (Ora I) ....... 80
Mësimi 24: Theksi (Ora II) ....... 82
Mësimi 25: Theksi i fjalisë (Ora I) ....... 84
Mësimi 26: Theksi i fjalisë (Ora II) ....... 86
Mësimi 27: Përmbledhja (Ora I) ....... 88
Mësimi 28: Përmbledhja (Ora II) ....... 90
Mësimi 29: Si të përmbledhim? (Ora III) ....... 92
Mësimi 30: Përmbledhja (Ora IV) ....... 94
Mësimi 31: Intonacioni ....... 96
Mësimi 32: Intonacioni ....... 98
Mësimi 33: Intonacioni ....... 100
Mësimi 34: Fjala dhe kuptimet e saj ....... 102
Mësimi 35: Fjala dhe kuptimet e saj ....... 104
Mësimi 36: Fjala dhe kuptimet e saj ....... 106

Mësimi 37: Fjala dhe kuptimet e saj ....................108
Mësimi 38: Si të shkruajmë mesazhe? ....................110
Mësimi 39: Si të shkruajmë mesazhe - ushtrime ....................112
Mësimi 40: Si të shkruajmë mesazhe - kërkesa ....................114
Mësimi 41: Si të shkruajmë mesazhe - njoftimet ....................116
Mësimi 42: Emri (Ora I) ....................118
Mësimi 43: Emri (Ora II) ....................120
Mësimi 44: Emri (Ora III) ....................122
Mësimi 45: Emri (Ora IV) ....................124
Mësimi 46: Emri (Ora V) ....................126
Mësimi 47: Emri (Ora VI) ....................128
Mësimi 48: "Don Kishoti lufton me gjigantët" ....................130
Mësimi 49: ”Don Kishoti lufton me gjigantët” (ora e dytë) ....................132
Mësimi 50: Mbiemri ....................134
Mësimi 51: Mbiemri ....................136
Mësimi 52: Mbiemri ....................138
Mësimi 53: Mbiemri ....................140
Mësimi 54: Mbiemri ....................142
Mësimi 55: Don Kishoti lufton me gjigantët ....................144
Mësimi 56: Don Kishoti ....................146
Mësimi 57: Rrëfimi për Kilian Mbapenë ....................148
Mësimi 58: Rrëfime për Kilian Mbapenë - ushtrime ....................150
Mësimi 59: Përemri ....................152
Mësimi 60: Përemri vetor (ora II) ....................154
Mësimi 61: Përemri vetor dhe dëftor ....................156
Mësimi 62: Përemrat pronorë dhe pyetës ....................158
Mësimi 63: Përemri lidhor dhe përemri i pacaktuar ....................160
Mësimi 64: Përemri (ora VI) ....................162
Mësimi 65: Autobiografia (ora I) ....................164
Mësimi 66: Autobiografia (ora II) ....................166
Mësimi 67: Numrat ....................168
Mësimi 68: Numrat ....................170
Mësimi 69: Numrat ....................172
Mësimi 70: Ese ....................174
Mësimi 71: Si të shkruajmë nje ese? ....................176
Mësimi 72: Ese argumentuese ....................178
Mësimi 73: Ese treguese ....................180
Mësimi 74: Folja - kuptimi i përgjithshëm ....................182
Mësimi 75: Folja - Llojet e foljes ....................184
Mësimi 76: Folja - Kategoritë gramatikore të foljes ....................186
Mësimi 77: Folja - Zgjedhimet dhe format e foljes ....................188
Mësimi 78: Folja - Mënyra dëftore dhe mënyra lidhore ....................190
Mësimi 79: Mbaresat e foljes ....................192
Mësimi 80: Mënyrat e foljes - ushtrime ....................194
Mësimi 81: Mbaresat e foljeve - ushtrime ....................196

Mësimi 82: Përshkrimi dhe rrëfimi 198
Mësimi 83: Përshkrimi dhe rrëfimi 200
Mësimi 84: Përshkrimi dhe rrëfimi 202
Mësimi 85: Përshkrimi dhe rrëfimi 204
Mësimi 86: Përshkrimi dhe rrëfimi 206
Mësimi 87: Ndajfolja 208
Mësimi 88: Ndajfolja 210
Mësimi 89: Ndajfolja 212
Mësimi 90: Pjesëzat 214
Mësimi 91: Pjesëzat 216
Mësimi 92: Pjesëzat 218
Mësimi 93: Parafjala 220
Mësimi 94: Rasat e parafjalëve 222
Mësimi 95: Drejtshkrimi i parafjalëve 224
Mësimi 96: Përsëritje për parafjalët 226
Mësimi 97: Zhanret dhe kategoritë letrare: Poezi, prozë, tekst dramatik (ora I) 228
Mësimi 98: ''Peshkaqeni'' Tajar Hatipi 230
Mësimi 99: ''Në munç'' Rejard Kipling 232
Mësimi 100: ''Trimi i mirë me shokë shumë'' Sylejman Pitarka 234
Mësimi 101: Zhanret dhe kategoritë letrare (ora II) 236
Mësimi 102: Lidhëzat (ora I) 238
Mësimi 103: Lidhëzat (ora II) 240
Mësimi 104: Lidhëzat (ora III) 242
Mësimi 105: Përbërësit e fjalës 244
Mësimi 106: Përbërësit e fjalës 246
Mësimi 107: Përbërësit e fjalës 248
Mësimi 108: Subjekti dhe tema 250
Mësimi 109: Subjekti dhe tema 252
Mësimi 110: Struktura e tekstit 254
Mësimi 111: Subjekti dhe tema 256
Mësimi 112: Struktura e tekstit - ushtrime 258
Mësimi 113: Kryefjala 260
Mësimi 114: Kryefjala - vendi i saj në fjali 262
Mësimi 115: Kryefjala - shprehja e saj me pjesë të ligjëratës 264
Mësimi 116: Kallëzuesori i kryefjalës 266
Mësimi 117: Kryefjala - ushtrime 268
Mësimi 118: Poezia (ora I) 270
Mësimi 119: Poezia (ora II) 272
Mësimi 120: Poezia (ora III) 274
Mësimi 121: Poezia (ora IV) 276
Mësimi 122: Kallëzuesi 278
Mësimi 123: Kallëzuesi (ora II) 280
Mësimi 124: Kallëzuesi (ora e tretë) 282
Mësimi 125: Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike 284
Mësimi 126: Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike 286

Mësimi 127: Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike ....................288
Mësimi 128: Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike ....................290
Mësimi 129: Kundrinori i drejtë ....................292
Mësimi 130: Kundrinori i drejtë ....................294
Mësimi 131: Kundrinori i zhdrejtë ....................296
Mësimi 132: Kundrinori i zhdrejtë ....................298
Mësimi 133: Lektyrë shkollore ''Luli i vocërr'' nga Migjeni (ora I) ....................300
Mësimi 134: Lektyra ''Luli i vocërr'' (ora II) ....................302
Mësimi 135: Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora I) ....................304
Mësimi 136: Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora II) ....................306
Mësimi 137: Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora III) ....................308
Mësimi 138: Përcaktori ....................310
Mësimi 139: Përcaktori ....................312
Mësimi 140: Fjalia ....................314
Mësimi 141: Fjalia - ushtrime ....................316
Mësimi 142: Fjalia e thjeshtë dhe llojet e saj ....................318
Mësimi 143: Fjalia e thjeshtë – ushtrime ....................320
Mësimi 144: Fjalia e përbërë ....................322
Mësimi 145: Fjalia e përbërë - ushtrime ....................324
Mësimi 146: Shenjat e pikësimit: Pika dhe pikëpyetja ....................326
Mësimi 147: Shenjat e pikësimit: Presja dhe pikëçuditja ....................328
Mësimi 148: Shenjat e pikësimit ....................330
Mësimi 149: Prmbledhje - Shenjat e pikësimit ....................332
Mësimi 150: Apostrofi ....................334
Mësimi 151: Apostrofi (ora II) ....................336
Mësimi 152: Ndjenjat ....................338
Mësimi 153: Ndjenjat ....................340
Mësimi 154: Ndjenjat ....................342
Mësimi 155: Ndjenjat ....................344
Mësimi 156: Ndjenjat ....................346
Mësimi 157: Përdorimi i shkronjës së madhe ....................348
Mësimi 158: Përdorimi i shkronjës së madhe ....................350
Mësimi 159: Përmbledhje ....................352
Mësimi 160: Drejtshrimi i shkronjës ë (ora I) ....................354
Mësimi 161: Drejtshrimi i shkronjës ë (ora II) ....................356

Të dashur mësimdhënës dhe mësimdhënëse,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësimdhënësve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për të formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

# UDHËRRËFYES
**për konceptimin e mësimeve model**

## Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënit.

Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin/en gjatë përgatitjes.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes.

Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënit.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.

## Faqja në të djathtë

Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik i tij.

Përforcimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe i shprehjeve si dhe zbatimi i tyre.

## Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

**Rezultatet e të nxënit të temës** janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës.** Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.
Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës.** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënit.** Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit** janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat** e zhvillimit të mësimit. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënit, sipas proceseve njohëse.

***Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimit?***

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



**Parashikimi: Përgatitja për të nxënët**
Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënit. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimit, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



**Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes**
Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënit dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përftimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit**
Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxë-nësit konsolidojnë të nxënët e ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

# HYRJE

**Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësimdhënësin/en**

**GJUHË SHQIPE 6**

*Kurrikula Bërthamë* për këtë nivel edukativ (klasat 6-9) u mundëson nxënës(e)ve t'i zhvillojnë aftësitë komunikative, përmes: përdorimit pragmatik dhe efikas të gjuhës, pasurimit të leksikut, zhvillimit të shkathtësive gjuhësore, të kuptuarit përmes dëgjimit, të folurit në funksion të dhënies dhe marrjes së informacionit, lexim-kuptimin, të shkruarit sipas modeleve të dhëna, dallimin e elementeve të veçanta letrare e joletrare, njohjen dhe zgjerimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë), zhvillimin e shkathtësive të të shprehurit nëpërmjet mjeteve të ndryshme audio-vizuale; përdorimin e TIK-ut, formimin e përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor.

*Fusha Gjuhët dhe komunikimi* në nivelin e dytë (klasa 6-9), bazuar në *Kornizën Kurrikulare*, përmban edhe lëndën gjuhë amtare (shqipe). Kjo fushë i përgatit nxënësit për komunikim efektiv, të qartë dhe përmbajtësor.

Nëpërmjet lëndëve të kësaj fushe, nxënësve u mundësohet t'i zhvillojnë dhe t'i kultivojnë shkathtësitë kryesore të gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit, me qëllim të zhvillimit të kompetencave të cilat i përdor në jetën e përditshme.

Qëllimi i kësaj fushe është avancimi i shkathtësive gjuhësore dhe të komunikimit në funksion të formësimit gjuhësor e të menduarit kritik e krijues, të lexuarit dhe të kuptuarit e zhanreve të ndryshme, të shkruarit funksional dhe komunikimit me shkrim dhe me gojë në situata të ndryshme jetësore.

Suksese!

## Udhëzime metodologjike

Procesi i mësimdhënies për fushën *Gjuhët dhe komunikimi* duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve, në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetitit të tyre. Nxënësit duhet t'i arrijnë kompetencat e tyre nëpërmjet mësimit dhe qasjes së integruar. Arritja e suksesshme e tyre bëhet nëpërmjet rezultateve të fushës. Metodat, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe nxënies, janë çelës kryesor për arritjen e këtyre kompetencave. Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare; si: edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe diasporë, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, formën dhe strategjinë e duhur. Në këtë nivel komunikimi efektiv arrihet nga nxënësit me metodën e bashkëbisedimit, por nuk duhet lënë anash as metodat e tjera, gjithmonë duke pasur parasysh njohuritë paraprake, interesat dhe nevojat e nxënësve. Organizimi i mësimit duhet të jetë atraktiv dhe interesant në mënyrë që nxënësit të jenë në bashkëveprim gjatë gjithë kohës për të marrë njohuri të reja.

## Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës" (botim i rishikuar, 2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.* Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Ky trekëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies të të nxënit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.




Burimi: *Metodologji e mësimdhënies*, *(faqe 102)*, B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE

***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
*Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.

***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
*Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.*




Burimi: *Psikologji edukimi,* (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

***Zgjeroni dhe thelloni dijet***
*Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 32-36.*

## Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore të shkallës 3

| Nr. | Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore |
|---|---|
| **I** | **Kompetenca në komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv** |
| 1. | Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. |
| 2. | Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. |
| 3. | Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim. |
| 4. | Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. |
| 5. | Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke i respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor. |
| 6. | Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke e përdorur gjuhën dhe fjalorin e saktë adekuat. |
| 7. | Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore. |

| II | Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik |
|---|---|
| 1. | Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie. |
| 3. | Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke i përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). |
| 4. | Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe e arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. |
| 5. | Përzgjedh dhe demonstron ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke e dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë. |
| 6. | Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. |
| 7. | Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. |
| 8. | Përdor krahasimin dhe kontrastin për t'i gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike. |

| III | Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm |
|---|---|
| 1. | Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/ detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. |
| 2. | Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit. |
| 3. | Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. |
| 4. | Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar. |
| 5. | Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. |

| IV | Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv |
|---|---|
| 1. | Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses. |
| 2. | Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe i propozon masat që duhen të ndërmerren për evitimin e tyre. |
| 4. | Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (psh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. |
| 5. | Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës. |

| V | Kompetenca personale - Individ i shëndoshë |
|---|---|
| 1. | Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm. |
| 2. | Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative, të paktën të tri llojeve të ushqimeve, të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë. |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut. |
| 5. | Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe ua shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale. |

| | |
|---|---|
| 6. | Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke i ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit. |
| 7. | Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme, në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor |
| 8. | Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit. |
| 9. | Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës. |

| VI | Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm |
|---|---|
| 1. | Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë. |
| 2. | Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe e arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre. |
| 3. | Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/ klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre. |
| 4. | Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme, nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më. |
| 5. | Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interest. |
| 6. | Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit. |
| 7. | Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre. |
| 8. | Merr pjesë në aktivitetet që e promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë. |

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë duhet t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) nga temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Temat kanë dalë nga konceptet dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) dhe, Gjuhët dhe komunikimi për shkallën e tretë të Kurrikulës (Shk3), të cilat mund t'i shihni në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

| Konceptet | Temat | Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL) |
|---|---|---|
| Tekstet letrare dhe joletrare | Poezia<br><br>Proza<br><br>Biografia dhe autobiografia<br><br>Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë, përshtypje, shqetësime dhe dëshira, preferencat<br><br>Ese<br><br>Përshkrimi, rrëfimi<br><br>Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti | • Identifikon tipare të prozës dhe të poezisë;<br>• Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik;<br>• Lexon dhe krahason artikuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me aktualitete nga shkenca, shëndetësia; barazia gjinore, të drejtat e njeriut;<br>• Shkruan sipas modeleve të teksteve joletrare urime, informata, lutje, kërkesë etj.;<br>• Shkruan ese të ndryshme letrare e joletrare;<br>• Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar;<br>• Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet;<br>• Përshkruan jetën në Kosovë dhe në mërgatë;<br>• Identifikon shkaktarët e rreziqeve nga natyra dhe njeriu; |
| Gjuha figurative dhe jofigurative | Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike (kuptimi i parë dhe i figurshëm<br><br>Tropet: figurat kryesore letrare/ teksti letrar dhe joletrar | • Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ (kuptimin e parë dhe atë të figurshëm);<br>• Dallon dhe përdor figurat kryesore stilistike në të folur dhe në të shkruar;<br>• Identifikon tipare letrare dhe joletrare. |
| Kritika, teoria, historia | Zhanret dhe kategoritë letrare: poezi, prozë, tekst dramatik<br><br>Subjekti, kompozicioni, tema, komentimi i teksteve<br>Lexim-kuptimi | • Dallon zhanret kryesore letrare;<br>• Kupton tiparet e subjektit, kompozicionit dhe temës;<br>• Zhvillon strategjinë e lexim-kuptimit dhe komentimit të teksteve. |
| Sistemi gjuhësor | Gjuha standarde dhe dialektore<br><br>Fonetikë/fonologji | • Dallon format e gjuhës standarde nga ato dialektore;<br>• Dallon, tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin;<br>• Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit;<br>• Përcakton theksin e fjalës në fjali. |

| | | |
|---|---|---|
| | Leksikologji<br><br><br><br>Sintaksë<br>Rrethanori<br>Morfologji<br>Emri, kategoritë e tij gramatikore<br><br>Mbiemri dhe kategoritë e tij<br><br><br><br>Përemrat<br><br><br>Numërorët<br><br>Folja, kategoritë e saj gramatikore<br><br><br><br>Ndajfoljet dhe llojet saj<br><br><br>Parafjala<br>Lidhëzat<br><br>Fjalëformimi | • Pasuron fjalorin dhe njeh kuptimin e fjalës;<br>• Dallon dhe përdor fjalë me kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm;<br>• Dallon dhe përdor fjalët me shumë kuptime;<br>• Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë;<br>• Dallon rrethanorin e vendit, të kohës, të shkakut si dhe përcaktorin e ndajshtimin;<br>• Dallon emrin dhe kategoritë e tij (gjininë, numrin, rasën, lakimin);<br>• Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm;<br>• Dallon dhe i përdor drejt parafjalët sipas rasave;<br>• Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasën, lakimin, shkallën).<br>• Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë dhe të pacaktuar.<br>• Dallon numërorët themelorë dhe numërorët rreshtorë.<br>• Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës;<br>• Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj;<br>• Dallon zgjedhimin e foljes;<br>• Dallon dhe kupton foljen, mënyrat vepro-re dhe joveprore të saj;<br>• Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore;<br>• Dallon llojet e ndajfoljes, si ndajfolje mënyre, sasie, kohe, vendi dhe i përdor ato drejt në të folur e të shkruar.<br>• I përdor drejt parafjalët: me, për, në, nga, te, gjer, prej, ndaj, pranë, larg dhe i dallon nga ndajfoljet.<br>• Dallon lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.<br>• Dallon fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë; |
| | Drejtshkrimi | • Dallon llojet kryesore të fjalive (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore), format e tyre (pohore, mohore);<br>• Dallon fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura;<br>• Dallon përbërësit e fjalës: rrënjën, temën, parashtesat, prapashtesat, mbaresat;<br>• Dallon fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura;<br>• Në të shkruar përdor drejt shenjat e pikë-simit, pikën, presjen dhe pikëçuditjen;<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe dhe të vogël;<br>• Shkruan drejt apostrofin në fjalë. |

## Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi, Klasa VI

| Lënda | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës |
|---|---|---|---|---|---|
| | Gjysmëvjetori I | | Gjysmëvjetori II | | |
| | Shtator—tetor | Nëntor—dhjetor | Janar—shkurt—mars | Prill—maj—qershor | |
| GJUHË SHQIPE | Shoqëria dikur dhe sot<br><br>Gjuha standarde dhe dialektore<br>Projekt<br>Fonetikë/ fonologji<br>Zhanret dhe kategoritë letrare: poezi, prozë, tekst dramatik<br>Fonetikë/ fonologji<br>Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti<br>Ese<br>Leksikologji | Përshkrimi, rrëfimi<br>Projekt<br>Emri, kategoritë e tij gramatikore<br>Mbiemri dhe kategoritë e tij<br>Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë<br>Përemrat<br>Numërorët<br>Biografia dhe autobiografia<br>Folja, kategoritë e saj gramatikore<br>Ndajfoljet dhe llojet saj | Morfologji<br>Projekt<br>Ese<br>Lidhëzat<br>Përshkrimi, rrëfimi<br>Fjalëformim<br>Sintaksë<br>Zhanret dhe kategoritë letrare: poezi, prozë, tekst dramatik | Sintaksë<br><br>Projekt<br><br>Subjekti, kompozicioni, tema, komentimi i teksteve<br><br>Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike (kuptimi i parë dhe i figurshëm)<br><br>Drejtshkrim<br><br>Ese<br><br>Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë, përshtypje, shqetësime dhe dëshira, preferencat | I. Komunikues efektiv: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7<br><br>II. Mendimtar kreativ: 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8<br><br>III. Nxënës i suksesshëm: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8<br><br>IV. Kontribues produktiv: 1, 2, 3, 4, 5<br><br>V. Individ i shëndoshë: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9<br><br>VI. Qytetar i ndërgjegjshëm: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 |
| | Gjithsej 42 orë | Gjithsej 47 orë | Gjithsej 43 orë | Gjithsej 53 orë | 185 |

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

**Lënda mësimore: Gjuhë shqipe**

**Fusha e kurrikulës:** Gjuhët dhe komunikimi **Klasa:** VI

**Temat mësimore:** Shoqëria dikur dhe sot; Gjuha standarde dhe dialektore; Projekt; Fonetikë/ fonologji; Zhanret dhe kategoritë letrare: poezi, prozë, tekst dramatik; Fonetikë/ fonologji; Mediet (televizioni, radio), shoqëria, internet; Ese; Leksikologji.

| Nr. | Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: |
|---|---|
| I | Kompetenca në komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv |
| 1. | Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. |
| 2. | Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. |
| 3. | Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/ detyre me shkrim. |
| 4. | Shpreh mendimin/ gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. |
| 5. | Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke i respektuar rregullat e organizimit/ strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor. |
| 6. | Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke e përdorur gjuhën dhe fjalorin e saktë adekuat. |
| 7. | Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore. |

| II | Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik |
|---|---|
| 1. | Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie. |
| 3. | Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/ detyre duke i përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). |
| 4. | Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe e arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. |
| 5. | Përzgjedh dhe demonstron ecuri/ strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke e dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë. |
| 6. | Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. |
| 7. | Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/ dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. |
| 8. | Përdor krahasimin dhe kontrastin për t'i gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike. |

| III | Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm |
|---|---|
| 1. | Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/ detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. |
| 2. | Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit. |
| 3. | Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. |
| 4. | Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar. |
| 5. | Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. |
| 6. | Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/ punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes. |
| 7. | I parashtron pyetje vetes (pse?, çka?, si?, kur?) dhe i organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe e vlerëson përparimin e vet, derisa ta gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. |
| 8. | Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti, vepre arti (në klasë/ shkollë apo gjetiu). |

| IV | Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv |
|---|---|
| 1. | Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses. |
| 2. | Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe i propozon masat që duhen të ndërmerren për evitimin e tyre. |
| 4. | Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (psh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. |
| 5. | Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës. |

| V | Kompetenca personale - Individ i shëndoshë |
|---|---|
| 1. | Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm. |
| 2. | Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative, të paktën të tri llojeve të ushqimeve, të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë. |
| 3. | Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut. |
| 5. | Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe ua shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale. |
| 6. | Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke i ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit. |

| | |
|---|---|
| 7. | Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme, në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor. |
| 8. | Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit. |
| 9. | Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës. |

| VI | Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm |
|---|---|
| 1. | Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë. |
| 2. | Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe e arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre. |
| 3. | Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/ klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre. |
| 4. | Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme, nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më. |
| 5. | Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interest. |
| 6. | Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit. |
| 7. | Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre. |
| 8. | Merr pjesë në aktivitetet që e promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I:1,2; II: 2,4; III:2.



*Lexoni me kujdes tri tekstet e dhëna.*

A

Bimët janë organizma të gjallë që përfshijnë pemët, perimet, shkurret, barishtet, vreshtat dhe algat jeshile. Ato janë të shumëllojshme: artificiale, mjekuese, natyrore. Bimët janë gjithashtu shumë të dobishme për njerëzit. Ato janë gjallesa që e sigurojnë vetë ushqimin me anë të procesit të fotosintezës. Bimët janë shumëqelizore dhe kanë qeliza eukariote. Ato ndahen në lloje e në forma të ndryshme.

B

Djali, tuj pa se s'ish aty tjetërkush përveç plakës, e thirri edhe t'shoqen. Plaka u bani zjarm t'mirë për me u nxe, por me vete mendojke me jau ba naj t'zezë. Muer e i bani magji djalit edhe e ven n'gjum t'randë. Mandej del e i thirr të shtatë djemt e vet si ishin tuj nejtë n'ni odë tjetër. Kta dojshin me e ba robneshë t'Bukurën e Dheut. Edhe hanë e pinë e bajnë darsëm për gzim qi ju erdh në dorë kjo farë nuse. Mirpo e Bukura e Dheut nuk u tut dhe nisi me keshë e me folë me ta deri sa i bani me u pi...

C

U martua një djalë. Edhe tri javë ndënji me të shoqen dhe shkoi ay. Bëri luftë Turqia me greknë. Edhe u doq ajo kasabaja, ku punonte ky djali. Edhe vete gjetkë. Edhe ay fshati qe ish, u doq edhe ay. Edhe ndënji kaqe kohë e punon tutje tëhu. Edhe e dinte të vdekur gruan. Vinin të shtunave çupëria mbushnin ujë me shoqet në çezmë. Na vinin qiraxhinjtë nga Stambolli edhe na i zinte nata atje. Prej Sarande vinin edhe i thonë njëra-tjetrës: “Mos na vinë burrat nga Stambolli?" Ajo zuri e qante. Edhe i thonë shoqet: “Pse qan ti?” U thotë: “Mua më ka humbur burri, ju i prisni burrat.”



*Në këtë rast, në gjuhën e të rinjve, fjala "i smutë" përdoret me kuptimin "i jashtëzakonshëm".*

11

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shqipja standarde dhe dialektet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon gjuhën standarde nga ajo dialektore;
- Krahason tekstet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** harta, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*

Lexohen disa shembuj nga dialektet e gjuhës shqipe të shkruara nga nxënësit.

| Toskërisht | Gegërisht |
|---|---|
| *Hyra* | *Hyna* |
| *Gjuri* | *Guni* |
| *Syri* | *Syni* |



*Lexoni me kujdes tri tekstet e dhëna.*

A

Bimët janë organizma të gjallë që përfshijnë pemët, perimet, shkurret, barishtet, vreshtat dhe algat jeshile. Ato janë të shumëllojshme: artificiale, mjekuese, natyrore. Bimët janë gjithashtu shumë të dobishme për njerëzit. Ato janë gjallesa që e sigurojnë vetë ushqimin me anë të procesit të fotosintezës. Bimët janë shumëqelizore dhe kanë qeliza eukariote. Ato ndahen në lloje e në forma të ndryshme.

B

Djali, tuj pa se s'ish aty tjetërkush përveç plakës, e thirri edhe t'shoqen. Plaka u bani zjarm t'mirë për me u nxe, por me vete mendojke me jau ba naj t'zezë. Muer e i bani magji djalit edhe e ven n'gjum t'randë. Mandej del e i thirr të shtatë djemt e vet si ishin tuj nejtë n'ni odë tjetër. Kta dojshin me e ba robneshë t'Bukurën e Dheut. Edhe hanë e pinë e bajnë darsëm për gzim qi ju erdh në dorë kjo farë nuse. Mirpo e Bukura e Dheut nuk u tut dhe nisi me keshë e me folë me ta deri sa i bani me u pi...

C

U martua një djalë. Edhe tri javë ndënji me të shoqen dhe shkoi ay. Bëri luftë Turqia me greknë. Edhe u doq ajo kasabaja, ku punonte ky djali. Edhe vete gjetkë. Edhe ay fshati qe ish, u doq edhe ay. Edhe ndënji kaqe kohë e punon tutje tëhu. Edhe e dinte të vdekur gruan. Vinin të shtunave çupëria mbushnin ujë me shoqet në çezmë. Na vinin qiraxhinjtë nga Stambolli edhe na i zinte nata atje. Prej Sarande vinin edhe i thonë njëra-tjetrës: "Mos na vinë burrat nga Stambolli?" Ajo zuri e qante. Edhe i thonë shoqet: "Pse qan ti?" U thotë: "Mua më ka humbur burri, ju i prisni burrat."



*Në këtë rast, në gjuhën e të rinjve, fjala "i smutë" përdoret me kuptimin "i jashtëzakonshëm".*

11

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim me tërë klasën*

Në këtë fazë të orës do të lexohen tri tekstet e dhëna nën A, B dhe C.

Në këto tri tekste janë paraqitur dialektet e shqipes dhe gjuha standarde. Nxënësit duhet ta gjejnë se cili tekst është në gjuhën standarde, cili në dialektin gegë dhe cili në dialektin toskë.

Disa nga përgjigjet mund të jenë:

Nën A – është gjuha standarde.
Nën B – është dialekti gegë.
Nën C – është dialekti toskë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Zhvillimi dhe civilizimi i shoqërisë e sjell nevojën për një komunikim në rrafsh më të gjerë. Variant i ndërtuar duke u bazuar në këto nevoja, përdoret në rrafshin publik, ka një gramatikë më të rreptë se variantet e tjera gjuhësore dhe njihet me emra të ndryshëm, si gjuhë standarde, gjuhë e njësuar, gjuhë e përbashkët etj.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të dialekteve dhe të gjuhës standarde dhe gjen elemente dalluese dialektore në tekste.

**Detyrë:**
(Nxënësit do ta plotësojnë detyrën në librin *Fletore pune,* faqe 5)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 5

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 2
SHQIPJA STANDARDE DHE DIALEKTET

◇ *1. Këto fragmente nga tekstet B dhe C të Librit të klasës VI, ktheni në gjuhën standarde.*

*Mirpo e Bukura e Dheut nuk u tut dhe nisi me keshë e me folë me ta deri sa i bani me u pi...*

*U martua një djalë. Edhe tri javë ndënji me të shoqen dhe shkoi ay. Bëri luftë Turqia me greknë.*

◇ *2. Shkruani në fletore një rrëfim të shkurtër, jo më të gjatë se një faqe, në dialektin që e flitni. Lexojeni në klasë.*

◇ *3. Vendosni ✓ te fjalët e shqipes standarde dhe ✗ te format dialektore.*

| | | | |
|---|---|---|---|
| ☐ *libër* | ☐ *këqyr* | ☐ *kerr* | ☐ *nanë* |
| ☐ *vo* | ☐ *punu* | ☐ *me bërë* | ☐ *ftue* |
| ☐ *për të lexuar* | ☐ *dimën* | ☐ *çelës* | ☐ *i lexuar* |

◇ *4. Dëgjoni një emision televiziv dhe hetoni përdorimin e gjuhës.*

◇ *5. Shikoni hartën e dhënë. Sipas vendosjes në hartë, shënoni se cili dialekt flitet në këto qytete. Shënoni* ***gegërishte*** *apo* ***toskërishte*** *sipas nevojës, në hapësirën pranë secilit qytet të shënuar.*

| | | |
|---|---|---|
| **Fier** ____ | **Shkup** ____ | **Pogradec** ____ |
| **Prishtinë** ____ | **Gjirokastër** ____ | **Tetovë** ____ |
| **Shkodër** ____ | **Dibër** ____ | **Preshevë** ____ |
| **Tiranë** ____ | **Pejë** ____ | **Sarandë** ____ |
| **Durrës** ____ | **Elbasan** ____ | **Vlorë** ____ |
| **Korçë** ____ | **Ulqin** ____ | **Janinë** ____ |

***Detyrë***

◇ *6. Bashkë me arsimtarin/arsimtaren, shkoni të shihni një shfaqje teatrale në teatrin e qytetit. Analizoni gjuhën që përdorin aktorët/aktoret. Diskutoni pastaj në klasë.*

5

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shqipja standarde dhe dialektet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon format e gjuhës standarde nga ato dialektore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2. 3, II: 2. 3. 4, III: 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I:1,2; II: 2,4; III:2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shqipja standarde dhe dialektet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon gjuhën standarde nga ajo dialektore;
- Analizon veçoritë gjuhësore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** harta, projektori

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Gjeografi

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit do t'i lexojnë detyrat e punuara në librin *Fletore pune,* faqe 5.
Fragmentet nga tekstet B dhe C të librit të klasës VI, ktheni në gjuhën standarde:

*b. Mirpo e Bukura e Dheut nuk u tut dhe nisi me keshë e me folë me ta deri sa i bani me u pi…*
*c. U martua një djalë. Edhe tri javë ndënji me të shoqen dhe shkoi ay. Bëri luftë Turqia me greknë…*

Për mësimdhënësin/en



njësia 2

SHQIPJA STANDARDE DHE DIALEKTET

◇ 1. Këto fragmente nga tekstet B dhe C të Librit të klasës VI, ktheni në gjuhën standarde.

*Mirpo e Bukura e Dheut nuk u tut dhe nisi me keshë e me folë me ta deri sa i bani me u pi...*

*U martua një djalë. Edhe tri javë ndënji me të shoqen dhe shkoi ay. Bëri luftë Turqia me greknë.*

◇ 2. Shkruani në fletore një rrëfim të shkurtër, jo më të gjatë se një faqe, në dialektin që e flitni. Lexojeni në klasë.

◇ 3. Vendosni ✓ te fjalët e shqipes standarde dhe ✗ te format dialektore.

| | | | |
|---|---|---|---|
| ☐ libër | ☐ këqyr | ☐ kerr | ☐ nanë |
| ☐ vo | ☐ punu | ☐ me bërë | ☐ ftue |
| ☐ për të lexuar | ☐ dimën | ☐ çelës | ☐ i lexuar |

◇ 4. Dëgjoni një emision televiziv dhe hetoni përdorimin e gjuhës.

◇ 5. Shikoni hartën e dhënë. Sipas vendosjes në hartë, shënoni se cili dialekt flitet në këto qytete. Shënoni **gegërishte** apo **toskërishte** sipas nevojës, në hapësirën pranë secilit qytet të shënuar.

| | | |
|---|---|---|
| **Fier** ______ | **Shkup** ______ | **Pogradec** ______ |
| **Prishtinë** ______ | **Gjirokastër** ______ | **Tetovë** ______ |
| **Shkodër** ______ | **Dibër** ______ | **Preshevë** ______ |
| **Tiranë** ______ | **Pejë** ______ | **Sarandë** ______ |
| **Durrës** ______ | **Elbasan** ______ | **Vlorë** ______ |
| **Korçë** ______ | **Ulqin** ______ | **Janinë** ______ |

**Detyrë**

◇ 6. Bashkë me arsimtarin/arsimtaren, shkoni të shihni një shfaqje teatrale në teatrin e qytetit. Analizoni gjuhën që përdorin aktorët/aktoret. Diskutoni pastaj në klasë.

5

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Në pjesën e dytë do të shpjegohet për variantet e gjuhës shqipe.

Dialektet janë variante gjeografike të një gjuhe. Ato dallojnë nga njëra-tjetra, por vetëm deri në masën sa folësit e dy dialekteve arrijnë të kuptohen ndërmjet vete. Dallimet kryesore vërehen më së shumti në fonetikë, në mënyrën se si shqiptohen tingujt e caktuar dhe nga vlera që kanë ata tinguj. Po ashtu dallohen edhe në morfologji, në leksik e në sintaksë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Gjuha shqipe përbëhet nga shumë dialekte të ndara në dy grupe kryesore, gegërisht dhe toskërisht. Lumi Shkumbin është përafërsisht vija ndarëse gjeografike, me gegërishten e folur në veri të Shkumbinit dhe toskërishten në jug.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të dialekteve dhe të gjuhës standarde dhe veçorive dalluese në mes dy dialekteve.

**Detyrë:**
(Shkruani në fletore një tekst në gjuhën që e përdorni çdo ditë në shtëpi)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______

______

# Mësimi 6


**Detyrë**

*Shkruani në fletore një tekst në gjuhën që e përdorni çdo ditë në shtëpi. Të njëjtin pastaj kthejeni në shqipen standarde dhe diskutoni për ndryshimet.*

**Bashkëbisedojmë:**

*Nëse i krahasojmë tri tekstet A, B, C, vërejmë se mes tyre ka disa dallime. Disa nga dallimet kryesore janë:*

| | Shqipja standarde | Toskërishtja | Gegërishtja |
|---|---|---|---|
| 1 | vetëm zanore gojore: *pesë, reja* | vetëm zanore gojore: *pesë, reja* | veç zanoreve gojore, në disa të fol me ka edhe zanore hundore: pësë, rëja (Luteni mësuesen / mësuesin t'ju tregojë per zanoret hundore) |
| 2 | ë e theksuar: *bëj, nëna, zë* | ë e theksuar: *bëj, nëna, zë* | a e theksuar: *bãj, nãna, zã* |
| 3 | Rotacizmi (shndërrimi në r i një n-je që gjendet mes dy zanoreve): *zëri, bëra, syri* | Rotacizmi, bashkëtingëllorja r, mes dy zanoreve: *zëri, bëra, syri* | ruajtja e n-së: *zani, bana, syni* |
| 4 | togu zanor ua: *grua, duar, shkruaj, punuar* | togu zanor ua: *grua, duar, shkruaj, punuar* | togu zanor ue (ose shkurtimi në u): *grue, duer, shkruej, punue ose gru, du:r, shkru:j, punu* |
| 5 | pjesorja me mbaresa (-ur, -rë, -r, -në): (kam) *lidhur, hapur, bërë, punuar, lënë, rënë* | pjesorja me mbaresa: (kam) *lidhur, hapur, bërë, punuar, lënë, rënë* | pjesorja pa mbaresa: (kam) *li:dh, ha:p, ba:, punu(e), la:n, ra:(n)* |
| 6 | paskajorja e tipit *për të punuar* | paskajorja e tipit *për të punuar* | paskajorja e tipit *me punue (me punu)* |

13

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shqipja standarde dhe dialektet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon format e gjuhës standarde nga ato dialektore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2. 3, II: 2. 3. 4, III: 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I:1,2; II: 2,4; III:2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shqipja standarde dhe dialektet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon gjuhën standarde nga ajo dialektore;
- Krahason tekstet;
- Analizon veçoritë gjuhësore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi, harta.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit do t'i lexojnë tekstet e shkruara në gjuhën që ata e flasin në shtëpi.

Një nga tekstet mund të jetë:

*Unë qohna herët n'mjes dhe bana gati për shkoll. Me veti marr edhe buken. Rrugës e takoj shoqen tem Artën. Ajo o ni vit ma e madhe se unë. Na dyja lujna gjith bashk.*



**Bashkëbisedojmë:**

*Dallime ka edhe në përdorimin e fjalëve.*
*Krahaso:*

| | Shqipja standarde | Toskërishtja | Gegërishtja |
|---|---|---|---|
| 1 | hap; çel | hap | çel |
| 2 | mbyll | mbyll | mbyll/mshel |
| 3 | kokë; krye | kokë | krye |
| 4 | shaka | shaka | hajgare/shaka |
| 5 | gënjej; rrej | gënjej | rrej |
| 6 | qumësht | qumësht | tamël |

**Hulumtojmë dhe bashkëbisedojmë:**

*Shikoni një emision lajmesh nga një televizion i Kosovës dhe një tjetër nga një televizion i Shqipërisë. Mbani shënime për: intonacionin, fjalët e përdorura etj. Diskutoni në klasë.*

**Projekt:**

*Kërkoni nga gjyshërit a familjarët tuaj t'ju rrëfejnë ndonjë ngjarje interesante a përrallë. Regjistrojeni rrëfimin dhe pastaj dalloni deri në dhjetë fjalë të veçanta e të rralla dhe shkruani në fletore.*
*Prezantojini në klasë. Me ndihmën e arsimtarit/es, për fjalët që keni listuar, gjeni sinonime të tyre. Diskutoni për kuptimet e tyre dhe për dallimet dialektore.*

Shih fletoren e punës

14

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di – Dua të di – Mësova më shumë*

Nxënësit do të ndahen në grupe, varësisht sa nxënës janë në klasë aq grupe do të formohen. Ata do të shpalosin të gjitha ato që dinin dhe ato që i mësuan gjatë zhvillimit, me teknikën
*Di-Dua të di-Mësova më shumë.*

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Gjuha shqipe për-bëhet nga shumë dialekte të ndara në dy grupe krye-sore, gegërisht dhe toskërisht. | Si ndahen dialek-tet në aspektin gjeografik? | Lumi Shkumbin është vija ndarëse gjeografike me gegërishten e folur në veri të Shkumbinit dhe toskërishten në jug. |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

| Shqipja standare | Toskërishtja | Gegërishtja |
|---|---|---|
| hap/ çel<br>mbyll<br>kokë/ krye | hap<br>mbyll<br>kokë | çel<br>mbyll/mshel<br>krye |

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të dialekteve dhe të gjuhës standarde dhe veçorive dalluese në mes dy dialekteve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 7

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Fonetikë/ Fonologji

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon, tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.
Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 3. 2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fonetika: Tingujt e të folurit


njësia 10

FONETIKA:
TINGUJT E TË FOLURIT

Matematika e tingujve:

Tingulli ***m*** + tingulli ***a*** + tingulli ***l*** = fjala ***mal***
Tingulli ***y*** + tingulli ***ll*** = fjala ***yll***
Tingulli ***t*** + tingulli i = fjala ***ti***
Tingulli ***sh*** + tingulli ***k*** + tingulli ***o*** + tingulli ***ll*** + tingulli ***a*** = fjala ______

Njerëzit janë të vetmet qenie të gjalla në planet që komunikojnë me anë të gjuhës së folur. Pra, njerëzit kanë aftësi që përmes një mekanizmi të shqiptimit të tingujve të prodhojnë gjuhë të folur. Formimi i tingujve bëhet në organet e aparatit të të folurit, që janë: *buzët, dhëmbët, gjuha, qiellza, uvula, laringu, tejzat e zërit, mushkëritë etj.*

*1. Buzët; 2. Dhëmbët; 3. Alveolat (mishi i dhëmbëve); 4. Qiellza e fortë (palatumi); 5. Qiellza e butë (velumi); 6. Uvula (njërithi); 7. Maja e gjuhës; 8. Pjesa e përparme e gjuhës; 9. Pjesa e prapme e gjuhës; 10. Rrënja e gjuhës; 11. Epiglota; 12. Faringu (fyti); 13. Laringu; 14. Ezofagu; 15. Trakeja.*


*Fig. 1. Skicë e aparatit të të folurit.*

Ne i quajmë organe të aparatit të të folurit, edhe pse ato kanë edhe funksione të tjera. P.sh., mushkëritë dhe hunda shërbejnë për frymëmarrje, gjuha për të shijuar dhe për të lëvizur ushqimin, dhëmbët për të copëtuar ushqimin etj.
Pra, për t'u prodhuar tingujt e të folurit vihet në funksion një tërësi organesh.Truri, nëpërmjet sistemit nervor, kontrollon të folurit. Prodhimi i tingujve fillon si një rrymë ajri nga mushkëritë, kalon nëpër kanalin e frymëmarrjes dhe në laring dridh tejzat e zërit, që prodhojnë zë.
Ky zë, më tej, përmes faringut arrin në hapësirën e gojës, ku varësisht nga forma dhe pozita e organeve në këtë hapësirë prodhohen tinguj të ndryshëm - tinguj zanorë dhe tinguj bashkëtingëllorë.

37

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon tingujt e gjuhës shqipe;
- Përdor tingujt e gjuhës shqipe.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, fletë me ngjyra, projektor.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arti muzikor, Biologjia, Fizika.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësve u shtrohen disa pyetje në formë diskutimi.
Si formohen tingujt e gjuhës shqipe?
Cilat organe të aparatit të të folurit ndihmojnë në formimin e tingujve?
A keni vështirësi kur flisni gjatë nyjëtimit të ndonjë tingulli?
A mund ta germëzoni emrin tuaj?



— Zanoret dallohen nga bashkëtingëlloret për nga mënyra e nyjëtimit. Kur shqiptoj më zanoret, ajri del lirisht nga goja pa hasur pengesa në organet e aparatit të të folurit. Kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, ajri has pengesa në organet e aparatit të të folurit (buzë, gjuhë, dhëmbë, qiellzë etj.).

— Provo të shqiptosh tingullin a. Ajri del lirshëm, nuk ka asnjë pengesë.
Provo të shqiptosh tingullin b. Mbyllen buzët në një moment, pra krijohet pengesë.
A-ja është zanore dhe b-ja është bashkëtingëllore.

— Kur një pjesë e ajrit kalon nëpër hundë, tingulli është hundor *(m, n, nj)*. Kur kalon vetëm nëpër gojë, tingulli është johundor (gojor). Nëse mbyllim hundën dhe themi *n, m,* ose *nj*, del një timbër i çuditshëm që e quajmë hundor. Por, kur i shqiptojmë bashkëtingëlloret e tjera, nuk del timbri i tillë.

— Me procesin e prodhimit të tingujve të të folurit merret **fonetika**.

— Gjuha krijohet përmes tingujve të të folurit. Kur një tingull mund të bëhet bashkë me tinguj të tjerë dhe të krijojë fjalë, ai tingull quhet fonemë. Fonemat në shqipen i shënojmë me nga një shkronjë.

— Mirëpo, nuk është gjithnjë njësoj shkronja me tingullin.

***Krahaso:***
*aeroplan, Agim, plakë, mal, - do të shihni se shkronja* **a** *nuk shqiptohet njësoj te këto fjalë.*

— ***Fonologjia*** studion fonemat, si njësi themelore të gjuhës. Fonemat vetë nuk kanë kuptim, por bashkohen mes tyre për të ndërtuar dhe për të dalluar njësi të kuptimshme të gjuhës, siç janë fjalët. P.sh., l + u + l + e = lule.

— Shqipja standarde ka 7 fonema zanore: a, e, ë, i, o, u, y dhe 29 fonema bashkëtingëllore: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

— Disa të folme toske dhe gege kanë më pak ose më shumë fonema sesa shqipja standarde.

— Disa të folme nuk bëjnë dallimin ndërmjet r dhe rr, disa mes q dhe ç e gj dhe xh. Te disa të folme mungon fonema y. Për shembull, në Gjirokastër e në Çamëri në vend të saj del fonema i: di (dy), ill (yll), si (sy). Në gegërishten, në kundërvënie me zanoret e shkurtra, del edhe seria e zanoreve të gjata: dy (djem) - dyy (vajza), plak - plaak(ë).

38

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di – Dua të di – Mësova më shumë*

Fillimisht, nxënësit marrin shpjegime nga mësimdhënësi/ ja dhe vazhdojnë nëpërmjet tekstit t`i klasifikojnë njohuritë në tri kolona, duke u bazuar në dijet paraprake, pyetjet e mundshme dhe njohuritë e fituara.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Zanoret<br>Bashkëtingëlloret | Ç`është fonetika?<br>Ç`është fonolog-jia? | |

Nxënësit i lexojnë pyetjet e shkruara te kolona *Dua të di* dhe i marrin përgjigjet e sqarimet nga mësimdhënësi/ ja, si dhe e plotësojnë kolonën e tretë *Mësova më shumë.* Gjithashtu, udhëzohen të marrin nga një fletë me ngjyrë, në të cilën duhet të shkruajnë nga dy fonema, një zanore dhe një bashkëtingëllore; më pas t`i shkëmbejnë me shokun ose shoqen e bankës nëpërmjet veshit, për t`i perceptuar dhe nyjëtuar ato.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Imagjinata e drejtuar*

Me anë të projektorit dëgjojnë një këngë të zgjedhur për moshën e nxënësve, duke i shkruar tingujt ashtu si i dëgjojnë; t`i analizojnë cilët tinguj janë përsëritur më shumë e cilët nuk janë përdorur pothuajse fare.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësisë e njohurive të tyre, për tingujt e shqipes dhe përdorimin e drejtë të tyre gjatë të folurit, por edhe në të shkruar.

**Detyrë:**
(Të plotësohet fletore pune në faqe 21-23)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 8

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.
Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 6, III: 1. 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3. 5


— Zanoret dallohen nga bashkëtingëlloret për nga mënyra e nyjëtimit. Kur shqiptoj më zanoret, ajri del lirisht nga goja pa hasur pengesa në organet e aparatit të të folurit. Kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, ajri has pengesa në organet e aparatit të të folurit (buzë, gjuhë, dhëmbë, qiellzë etj.).

— Provo të shqiptosh tingullin a. Ajri del lirshëm, nuk ka asnjë pengesë.
Provo të shqiptosh tingullin b. Mbyllen buzët në një moment, pra krijohet pengesë.
A-ja është zanore dhe b-ja është bashkëtingëllore.

— Kur një pjesë e ajrit kalon nëpër hundë, tingulli është hundor *(m, n, nj)*. Kur kalon vetëm nëpër gojë, tingulli është johundor (gojor). Nëse mbyllim hundën dhe themi *n, m,* ose *nj*, del një timbër i çuditshëm që e quajmë hundor. Por, kur i shqiptojmë bashkëtingëlloret e tjera, nuk del timbri i tillë.

— Me procesin e prodhimit të tingujve të të folurit merret **fonetika**.

— Gjuha krijohet përmes tingujve të të folurit. Kur një tingull mund të bëhet bashkë me tinguj të tjerë dhe të krijojë fjalë, ai tingull quhet fonemë. Fonemat në shqipen i shënojmë me nga një shkronjë.

— Mirëpo, nuk është gjithnjë njësoj shkronja me tingullin.

***Krahaso:***
*aeroplan, Agim, plakë, mal, - do të shihni se shkronja* **a** *nuk shqiptohet njësoj te këto fjalë.*

— ***Fonologjia*** studion fonemat, si njësi themelore të gjuhës. Fonemat vetë nuk kanë kuptim, por bashkohen mes tyre për të ndërtuar dhe për të dalluar njësi të kuptimshme të gjuhës, siç janë fjalët. P.sh., l + u + l + e = lule.

— Shqipja standarde ka 7 fonema zanore: a, e, ë, i, o, u, y dhe 29 fonema bashkëtingëllore: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

— Disa të folme toske dhe gege kanë më pak ose më shumë fonema sesa shqipja standarde.

— Disa të folme nuk bëjnë dallimin ndërmjet r dhe rr, disa mes q dhe ç e gj dhe xh. Te disa të folme mungon fonema y. Për shembull, në Gjirokastër e në Çamëri në vend të saj del fonema i: di (dy), ill (yll), si (sy). Në gegërishten, në kundërvënie me zanoret e shkurtra, del edhe seria e zanoreve të gjata: dy (djem) - dyy (vajza), plak - plaak(ë).

38

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon me intonacionin e duhur;
- Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shpjegimi i përparuar*

Në fillim të orës nxënësit do ta lexojnë njësinë në libër, faqe 38.
Gjatë leximit ata do ta vërejnë dallimin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve për nga mënyra e nyjëtimit.



— Zanoret dallohen nga bashkëtingëlloret për nga mënyra e nyjëtimit. Kur shqiptoj më zanoret, ajri del lirisht nga goja pa hasur pengesa në organet e aparatit të të folurit. Kur shqiptojmë bashkëtingëlloret, ajri has pengesa në organet e aparatit të të folurit (buzë, gjuhë, dhëmbë, qiellzë etj.).

— Provo të shqiptosh tingullin a. Ajri del lirshëm, nuk ka asnjë pengesë.
Provo të shqiptosh tingullin b. Mbyllen buzët në një moment, pra krijohet pengesë.
A-ja është zanore dhe b-ja është bashkëtingëllore.

— Kur një pjesë e ajrit kalon nëpër hundë, tingulli është hundor *(m, n, nj)*. Kur kalon vetëm nëpër gojë, tingulli është johundor (gojor). Nëse mbyllim hundën dhe themi *n, m,* ose *nj*, del një timbër i çuditshëm që e quajmë hundor. Por, kur i shqiptojmë bashkëtingëlloret e tjera, nuk del timbri i tillë.

— Me procesin e prodhimit të tingujve të të folurit merret **fonetika**.

— Gjuha krijohet përmes tingujve të të folurit. Kur një tingull mund të bëhet bashkë me tinguj të tjerë dhe të krijojë fjalë, ai tingull quhet fonemë. Fonemat në shqipen i shënojmë me nga një shkronjë.

— Mirëpo, nuk është gjithnjë njësoj shkronja me tingullin.

***Krahaso:***
*aeroplan, Agim, plakë, mal, - do të shihni se shkronja* **a** *nuk shqiptohet njësoj te këto fjalë.*

— ***Fonologjia*** studion fonemat, si njësi themelore të gjuhës. Fonemat vetë nuk kanë kuptim, por bashkohen mes tyre për të ndërtuar dhe për të dalluar njësi të kuptimshme të gjuhës, siç janë fjalët. P.sh., l + u + l + e = lule.

— Shqipja standarde ka 7 fonema zanore: a, e, ë, i, o, u, y dhe 29 fonema bashkëtingëllore: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

— Disa të folme toske dhe gege kanë më pak ose më shumë fonema sesa shqipja standarde.

— Disa të folme nuk bëjnë dallimin ndërmjet r dhe rr, disa mes q dhe ç e gj dhe xh. Te disa të folme mungon fonema y. Për shembull, në Gjirokastër e në Çamëri në vend të saj del fonema i: di (dy), ill (yll), si (sy). Në gegërishten, në kundërvënie me zanoret e shkurtra, del edhe seria e zanoreve të gjata: dy (djem) - dyy (vajza), plak - plaak(ë).

38



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Demonstrim në grup*

Nxënësit bashkë me mësimdhënësin do ta provojnë shqiptimin e tingujve, për të parë se si gjuha merr formë gjatë shqiptimit dhe ku mbështetet ajo për të formuar një tingull.



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim për njohuritë e mëparshme*

Nxënësit do të pyeten për njohuritë e mësuara edhe më herët.
*Sa zanore ka gjuha shqipe?*
*Gjuha shqipe ka 7 zanore.*
*Sa bashkëtingëllore ka gjuha shqipe?*
*Gjuha shqipe ka 29 bashkëtingëllore.*

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tingujve si dhe shqiptimin e tyre të drejtë.

**Detyrë:**
(Në librin bazë të bëhen detyrat në faqe 39)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 9

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.
Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 6, III: 1. 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3. 5



**O** dhe **Ö** dallojnë shumë mes vete, por nuk qenkan fonema të ndryshme.
Ato janë variante të së njëjtës fonemë.

***Pyetje:***

- *Çka studion fonetika?*
- *Po fonologjia, çfarë studion?*
- *A është shkronja gjithmonë e barabartë me një fonemë?*
- *Cilat janë organet e aparatit të të folurit?*
- *Sa zanore ka shqipja standarde?*
- *Sa bashkëtingëllore ka shqipja standarde?*
- *Në qytetin tënd, sa zanore dhe sa bashkëtingëllore ka shqipja?*

***Detyrë:***

- *Fonema shërben:*

*a) Për të krijuar fjalë dhe për të ndryshuar kuptimet e fjalëve.*
*b) Për të ndërtuar këngë.*

39

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Demonstron prodhimin e tingujve;
- Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetja sjell pyetjen*

Kërkohet nga nxënësit t'i lexojnë detyrat e bëra në shtëpi.
Disa nga pyetjet dhe përgjigjet do të ishin:
*1. Çka studion fonetika?*
*- Fonetika studion tingujt.*
*2. Po fonologjia çfarë studion?*
*- Fonologjia është një degë e gjuhësisë që e studion organizimin sistematik të tingujve në gjuhë.*




**O** dhe **Ö** dallojnë shumë mes vete, por nuk qenkan fonema të ndryshme.
Ato janë variante të së njëjtës fonemë.

***Pyetje:***

— *Çka studion fonetika?*
— *Po fonologjia, çfarë studion?*
— *A është shkronja gjithmonë e barabartë me një fonemë?*
— *Cilat janë organet e aparatit të të folurit?*
— *Sa zanore ka shqipja standarde?*
— *Sa bashkëtingëllore ka shqipja standarde?*
— *Në qytetin tënd, sa zanore dhe sa bashkëtingëllore ka shqipja?*

***Detyrë:***

— *Fonema shërben:*

*a) Për të krijuar fjalë dhe për të ndryshuar kuptimet e fjalëve.*
*b) Për të ndërtuar këngë.*

39

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit do të provojnë të lexojnë me intonacionin e duhur një tekst të siguruar nga mësimdhënësi.
Gjatë leximit nxënësit do të kenë shumë kujdes te tingujt, duke analizuar se si gjuha gjatë formimit të tingujve i prek dhëmbët, buzët etj.

Nxënësit e bëjnë me radhë leximin e tekstit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Nxënësit e lexojnë stripin e dhënë në libër faqe 39, për ta dalluar variantin e fonemës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tingujve si dhe shqiptimin e tyre të drejtë.
**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 10

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.
Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret sipas shqiptimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 6, III: 1. 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3. 5


**Bashkëbisedojmë:**
*Si shqiptohen q dhe ç?*

Kur nyjëtojmë bashkëtingëlloret **q** dhe **gj**, pjesa e mesme e gjuhës prek qiellzën e fortë.
Kur shqiptojmë **ç** dhe **xh**, pjesa e përparme e gjuhës prek alveolat.

Bashkëtingëlloret [ç], [xh]

Bashkëtingëlloret [q], [gj]

***Detyrë:***

***Lexo:***

- *Gjini qëndroi deri në fund të betejës.*
- *Qëndresa ngjyros ngadalë.*
- *Gjashtë shkurtabiqët po e shikonin të shtatin.*
- *Sa shumë qeshnin në lagjen time!*
- *Ti qenke skuqur shumë.*
- *Çka tha gjyshja?*
- *Ne duam paqe, por çfarë doni ju?*
- *Xhaxhai i Çlirimit quhet Qamil.*
- *Për asnjë çast, ai nuk qeshi.*
- *Gjykatësi e çoi dorën.*

Shih fletoren e punës

***Detyrë:***

- *Provoni të shqiptoni* **q** *dhe* **gj** *sipas vizatimit.*
- *Lute shoqen ose shokun e bankës për ta thënë alfabetin. Shiko sa fonema po përmend ai. Kujdes a i shqipton mirë dallimet mes* **r** *dhe* **rr**, **q** *dhe* **ç**, **gj** *dhe* **xh** *apo* **ll** *dhe* **dh**.

40

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Tingujt e të folurit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret;
- Shqipton drejt tinguj të caktuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim i përbashkët*

Ora do të fillojë me një bashkëbisedim për njësinë. Nxënësit do të bëjnë një përsëritje të asaj që mësuan deri më tani për tingujt e të folurit.

Pasi të bëhet një përsëritje e shkurtër, nxënësit do ta thonë alfabetin e gjuhës shqipe, do të shihet nëse ata po i shqiptojnë mirë tingujt.


***Bashkëbisedojmë:***
*Si shqiptohen q dhe ç?*

Kur nyjëtojmë bashkëtingëlloret **q** dhe **gj**, pjesa e mesme e gjuhës prek qiellzën e fortë.
Kur shqiptojmë **ç** dhe **xh**, pjesa e përparme e gjuhës prek alveolat.



***Detyrë:***

***Lexo:***

- *Gjini qëndroi deri në fund të betejës.*
- *Qëndresa ngjyros ngadalë.*
- *Gjashtë shkurtabiqët po e shikonin të shtatin.*
- *Sa shumë qeshnin në lagjen time!*
- *Ti qenke skuqur shumë.*
- *Çka tha gjyshja?*
- *Ne duam paqe, por çfarë doni ju?*
- *Xhaxhai i Çlirimit quhet Qamil.*
- *Për asnjë çast, ai nuk qeshi.*
- *Gjykatësi e çoi dorën.*

Shih fletoren e punës

***Detyrë:***

- *Provoni të shqiptoni* ***q*** *dhe* ***gj*** *sipas vizatimit.*
- *Lute shoqen ose shokun e bankës për ta thënë alfabetin. Shiko sa fonema po përmend ai. Kujdes a i shqipton mirë dallimet mes* ***r*** *dhe* ***rr***, ***q*** *dhe* ***ç***, ***gj*** *dhe* ***xh*** *apo* ***ll*** *dhe* ***dh***.

40

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**

*Shpjegimi i përparuar*

Në këtë pjesë do t'i kushtohet rëndësi tinguve *q* dhe *gj*, *ç* dhe *xh*.

Kërkohet nga nxënësit të shqiptojnë *q* dhe *gj*.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Veprimtari zbatuese*

Në fund të orës nxënësit do t'i shqiptojnë *r* dhe *rr*, *q* dhe *ç*, *gj* dhe *xh*, *ll* dhe *dh*.
Ata do t'i vërejnë dallimet që kanë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tingujve si dhe shqiptimin e tyre të drejtë.

**Detyrë:**
(Në librin bazë të bëhen detyrat në faqe 39)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 11

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jo-letrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2; V. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 3; 2. 1; 3. 3



njësia 3
VAJZAT DHE DJEMTË

Nga romani "Pipi Çorapegjata" i shkrimtares Astrid Lindgren

**PIPI ÇORAPEGJATA**

Pipi Çorapegjata dhe dy shokët e saj, Tomi e Anika, ishin duke kërkuar gjësende, kur e panë një djalë që po vraponte i frikësuar. Pesë djem po e ndiqnin. E zunë menjëherë, e mbështetën për një gardh dhe që të pestët filluan ta godisnin. Ai po qante dhe po e mbronte fytyrën me duar.
"Mëshojini!"- thoshte më i forti nga djemtë. "Kurrë më të mos kujtohet të dalë në këtë mëhallë".
"Po e rrahin Uillin", tha Anika. "Sa të këqij që janë!" "Qenka Bengti i keq. Ai gjithnjë bën sherre", tha Tomi. "Janë bërë pesë kundër njërit - qyqarët".
Pipi u afrua te djemtë dhe e preku me gisht në shpinë Bengtin.
"Mirëdita" tha ajo. "Ç'keni kështu ju pesë kundër Uillit të vogël?"
Bengti u kthye dhe e pa një vajzë të vogël që nuk ia kishte zënë syri asnjëherë më përpara dhe që po guxonte ta prekte në shpinë. U ndal dhe po e shikonte me habi. Pastaj iu ngërdhesh. "Djema", tha ai. "Lëreni Uillin, shikojeni këtë vajzën!" E goditi gjurin e vet me shuplakë dhe nisi të zgërdhihej, ndërsa djemtë e tjerë u mblodhën përreth, përveç Uillit, i cili duke i fshirë lotët u afrua afër Tomit.
"Shikojani flokët! Të kuq si flaka! Pale këpucët!" thoshte Bengti. "A ma fal njërën këpucë, se do ta përdor si barkë?" E preku njërin nga bishtalecat e Pipit dhe bëri thuajse iu dogj dora. Të pestë djemtë u mblodhën rreth Pipit dhe nisën ta tallnin: "Flo-kë-ku-qe! Flo-kë-ku-qe!" Pipi po buzëqeshte miqësisht mes tyre. Bengti kishte kujtuar se ajo do t'ia niste vajit, ose, të paktën, do të trembej. Kur pa se nuk po ndodhte gjë, e shtyu me duar.
"Aaa, kështu nuk bën të sillesh me një zonjushë", tha Pipi. Sakaq, e kapi Bengtin me duart e saj të forta dhe e ngriti peshë, e çoi te druri i afërt dhe e vari për jake në një degë. Pastaj e kapi një tjetër dhe e vari edhe atë për jake në degë. Të tretin e çoi mbi shtyllën e portës së gardhit, të katërtin e kapi dhe e hodhi matanë gardhit e drejt e në lehe, ndërsa të pestin mbi një qerre lodër që ishte lënë skaj rruge. Pipi, Tomi, Anika dhe Uilli i shikuan të pestë djemtë për disa çaste. Pesë djemtë kishin mbetur pa fjalë dhe me frikë.
"Ju jeni qyqarë", u tha Pipi. "Pesë kundër njërit. Ky është qyqarllëk. Veç kësaj, e shtyni një vajzë të vogël. Sa të këqij!"
Pastaj u kthye nga Bengti dhe e pyeti nëse kishte ende për të thënë diçka për flokët ose këpucët e saj. Mirëpo, Bengti s'kishte çfarë të thoshte më.

15

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vajzat dhe djemtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon përmbajtjen dhe tematikën e tekstit;
- Përcakton llojin e tekstit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, tabela, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare, Shkathtësi për jetë

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Shënohet në tabelë titulli, shënohen vajzat në anën e djathtë dhe djemtë në anën e majtë. Nxënësit individualisht duhet të shkruajnë në fletoret e tyre nga pesë karakteristika të personalitetit për vajzat dhe pesë karakteristika për djemtë, pastaj disa prej tyre i shkruajnë edhe në tabelë.



**Detyrë:**

*Teksti i mësipërm është prozë, pjesë e një romani. Shkruani për këtë tekst, duke iu përgjigjur pyetjeve:*

- *Për çfarë bën fjalë ky tekst?*
- *Cilët janë personazhet kryesore?*
- *Si lindi sherri mes Pipit dhe pesë djemve?*
- *Çfarë bëri Pipi më pas?*
- *Çfarë u tha ajo djemve në fund?*

**Djemtë apo vajzat**

— Andi e Rona po bisedonin. Andi e kishte dëgjuar dikë duke thënë se djemtë janë më të mençur, më të fortë, më të guximshëm, më të mirë se vajzat. Një tjetër kishte thënë se vajzat e kanë vendin në kuzhinë dhe se gjithë ditën mendojnë vetëm për fustane e rregullim të flokëve.
Andi ishte shqetësuar. Rona qeshi. Ajo tha se të jesh djalë nuk është më mirë se të jesh vajzë. Asnjë nuk është më i rëndësishëm se tjetri për shkak të gjinisë. Pastaj, ata nisën t'u përgjigjeshin dy burrave:
— Kuzhina është për gratë! - tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi. Mua më pëlqen të gatuaj. Kuzhinieri më i mirë në botë është Rene Rexhepi. Ai është burrë.
— Vajzat nuk dinë të ngasin veturën! - tha burri i dytë. E pasaktë, tha Rona. Mami im është shofere më e mirë se babi. Pastaj, Danica Patrik është kampione e botës në automobilizëm.
— Burrat janë më të vendosur, janë prijës më të mirë, tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi Ne kemi pasur një presidente grua në Kosovë.
Gratë udhëheqin shtete të mëdha në botë. Pastaj, mbretëreshë Teuta i komandonte burrat, Laskarina Bubulina ishte kapitene e burrave në anije dhe komandante në luftë.
— Vajzat mendojnë vetëm për fustane, tha burri i dytë.
E pasaktë, tha Rona. Veshja tradicionale e burrave shqiptarë është fustanella. Fundja, veshjet që më pëlqejnë më shumë i krijon Versaçi e ai nuk është grua.
— Burrat janë më të mençur. Ka më shumë profesorë, shkencëtarë e shkrimtarë burra, tha i pari.
E pasaktë, krejt krejt e pasaktë, tha Andi. Mund të ketë pasur dikur më shumë shkencëtarë e shkrimtarë burra, sepse shoqëria i ka shtypur gratë. Mirëpo, edhe atëherë ka pasur shkencëtare të shquara si

16

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar - DRTA*

Pas njohtimit me tekstin në libër, nxënësit udhëzohen ta lexojnë tekstin me paragrafë. Pas leximit të paragrafit të parë duhen ta mbyllin librin dhe u shtrohen disa pyetje rreth tekstit, si:
- Për çfarë bën fjalë ky tekst?
- Cilët janë personazhet kryesore?
- Cili ishte ishte qëllimi i bisedës së Andit me Ronën?
- Si do të vazhdojë ky tekst më tutje?

Vazhdohet me leximin edhe të paragrafëve të tjerë, duke shtruar pyetje dhe diskutime për tematikën që trajtohet në kuadër të tekstit.
- Përse nuk jepen emrat e të gjithë personazheve në këtë tekst?
- Çfarë thonë Andi e Rona?
- Cilat janë gratë më të suksesshme që i përmendin Andi e Rona?
- Përmendni ju disa burra dhe gra të sukesshme për të cilat keni dëgjuar!
- Çfarë mendoni ju lidhur me këtë temë që trajtohet në tekst?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Në tabelë ose projektor shkruhet një pyetje e ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit që lexuan gjatë zhvillimit të orës mësimore, me mundësi të përgjigjes me Po ose Jo. Shembull: A janë më të suksesshme vajzat, sesa djemtë? Nxënësit mund t'i shkëmbejnë mendimet në çifte ashtu si janë ulur, duke i argumentuar përgjigjet e tyre pse janë për po dhe pse janë për jo. Pastaj, mund të grupohen ata që janë për po dhe ata që janë për jo, duke zhvilluar një debat lidhur me qëndrimet e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë dhe kreativitetin e përgjigjeve të dhëna; analizën përmbajtësore e tematike të tekstit, si dhe përcaktimin e llojit të tekstit.

**Detyrë:**
(Të hulumtojnë dhe të shkruajnë një tekst të shkurtër për një hero ose heroinë shqiptare)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 12

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Identifikon tipare të prozës dhe të poezisë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II, 1, 2
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 1, 3; II.1, 2, 3



**Detyrë:**

*Teksti i mësipërm është prozë, pjesë e një romani. Shkruani për këtë tekst, duke iu përgjigjur pyetjeve:*

— *Për çfarë bën fjalë ky tekst?*
— *Cilët janë personazhet kryesore?*
— *Si lindi sherri mes Pipit dhe pesë djemve?*
— *Çfarë bëri Pipi më pas?*
— *Çfarë u tha ajo djemve në fund?*

**Djemtë apo vajzat**

— Andi e Rona po bisedonin. Andi e kishte dëgjuar dikë duke thënë se djemtë janë më të mençur, më të fortë, më të guximshëm, më të mirë se vajzat. Një tjetër kishte thënë se vajzat e kanë vendin në kuzhinë dhe se gjithë ditën mendojnë vetëm për fustane e rregullim të flokëve.
Andi ishte shqetësuar. Rona qeshi. Ajo tha se të jesh djalë nuk është më mirë se të jesh vajzë. Asnjë nuk është më i rëndësishëm se tjetri për shkak të gjinisë. Pastaj, ata nisën t'u përgjigjeshin dy burrave:
— Kuzhina është për gratë! - tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi. Mua më pëlqen të gatuaj. Kuzhinieri më i mirë në botë është Rene Rexhepi. Ai është burrë.
— Vajzat nuk dinë të ngasin veturën! - tha burri i dytë. E pasaktë, tha Rona. Mami im është shofere më e mirë se babi. Pastaj, Danica Patrik është kampione e botës në automobilizëm.
— Burrat janë më të vendosur, janë prijës më të mirë, tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi Ne kemi pasur një presidente grua në Kosovë.
Gratë udhëheqin shtete të mëdha në botë. Pastaj, mbretëreshë Teuta i komandonte burrat, Laskarina Bubulina ishte kapitene e burrave në anije dhe komandante në luftë.
— Vajzat mendojnë vetëm për fustane, tha burri i dytë.
E pasaktë, tha Rona. Veshja tradicionale e burrave shqiptarë është fustanella. Fundja, veshjet që më pëlqejnë më shumë i krijon Versaçi e ai nuk është grua.
— Burrat janë më të mençur. Ka më shumë profesorë, shkencëtarë e shkrimtarë burra, tha i pari.
E pasaktë, krejt krejt e pasaktë, tha Andi. Mund të ketë pasur dikur më shumë shkencëtarë e shkrimtarë burra, sepse shoqëria i ka shtypur gratë. Mirëpo, edhe atëherë ka pasur shkencëtare të shquara si

16

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vajzat dhe djemtë (ora e dytë)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton rreth detyrës së shtëpisë;
- Lexon duke e zbërthyer kuptimin;
- Shkruan rreth ngjashmërive të teksteve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Edukatë qytetare

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Nxënësve u parashtrohen pyetje rreth detyrës së shtëpisë:
- *Çfarë ju pëlqeu më shumë te filmi?*
- *A dukej ndryshe vajza në film?*
- *Çfarë karakteri kishte Pipi?*



Maria Kiri e shkrimtare të mëdha si Sharlot Bronte e Musine Kokalari. Sot ka po aq shkencëtare e shkrimtare të mëdha, sa ka shkencëtarë e shkrimtarë të mëdhenj.

— Eh, burrat janë më të fortë, thanë dy burrat njëzëri.

Ha-ha-ha, qeshën Andi e Rona. A do të guxoje t'i dilje në mejdan Majlinda Kelmendit, kampione bote në xhudo?

— Gruaja rri në shtëpi, burri punon! - nguli këmbë burri i parë.

Budallallëk, thanë Andi e Rona njëzëri. Gruaja mund t'i bëjë të gjitha punët që i bën edhe burri: gruaja mund të jetë drejtore fabrike, pilote aeroplani, ushtare, inxhiniere, mjeke - gjithçka.

— Pse, pra, njerëzit thonë se burrat janë trima e kur dikush është me karakter më të fortë, ai është burrë? - u përpoq burri i dytë.

Gabim sërish, tha Rona. Njoh shumë djem që janë qyqarë si Bengti e shumë vajza që janë trimëresha si Pipi. Kjo vjen prej shoqërive që e kanë shtypur gruan. Trimëria e forca e karakterit nuk kanë lidhje me çështjen a je djalë a vajzë. E saktë, tha Andi. Fare nuk ka rëndësi a je grua a burrë. Asnjë veprimtari njerëzore nuk është e kufizuar nga gjinia.

Andi e Rona e dinin mirë. Vajzat e djemtë janë të barabartë.

***Pyetje:***

- *Për çfarë bisedojnë Andi e Rona me dy personat, emrat e të cilëve nuk jepen në këtë tekst?*
- *Çfarë thonë ata dy personat?*
- *Çfarë thonë Andi e Rona?*
- *Cili është kuzhinieri që përmendet në këtë tekst?*
- *Cilat janë gratë e suksesshme që i përmendin Andi e Rona?*
- *Përmendni ju disa burra dhe gra të suksesshme për të cilat keni dëgjuar.*
- *Çfarë mendoni ju lidhur me këtë temë që trajtohet në tekst?*

***Fjalë të reja:***
*Zgërdhihet, lehe, veprimtari, shkencëtar, prijës, qyqarllëk, verandë*

***Gjeni fjalë të tjera që kanë kuptim të përafërt me fjalët e dhëna:***

*Skaj (rruge)* Buzë (rruge)*; Vajzë ____________; Djalë ____________;*
*Mëhallë____________; Ia zuri syri ____________.*

17

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim me ndalesa*

Nxënësit e lexojnë tekstin "Djemtë apo vajzat" me ndalesa. Pas çdo ndalese parashtrohen pyetje.

Ndalesa e parë:
- A janë djemtë më të mençur se vajzat?
- A mendoni se vajzat e kanë vendin në kuzhinë?

Ndalesa e dytë:
- Të duken të sakta përgjigjet e Adit?
- Po për burrin e dytë, çka mendoni?

E kështu, vazhdohet edhe me pyetje të tjera, duke e kuptuar më mirë tekstin.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diagrami i Venit*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë për dy tekstet, duke i gjetur ngjashmëritë dhe dallimet



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe për dallimin e ngjashmërive të teksteve.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 13

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Identifikon tipare të prozës dhe të poezisë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II, 1, 2
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 1, 3; II.1, 2, 3



**Detyrë:**

*Teksti i mësipërm është prozë, pjesë e një romani. Shkruani për këtë tekst, duke iu përgjigjur pyetjeve:*

- *Për çfarë bën fjalë ky tekst?*
- *Cilët janë personazhet kryesore?*
- *Si lindi sherri mes Pipit dhe pesë djemve?*
- *Çfarë bëri Pipi më pas?*
- *Çfarë u tha ajo djemve në fund?*

**Djemtë apo vajzat**

— Andi e Rona po bisedonin. Andi e kishte dëgjuar dikë duke thënë se djemtë janë më të mençur, më të fortë, më të guximshëm, më të mirë se vajzat. Një tjetër kishte thënë se vajzat e kanë vendin në kuzhinë dhe se gjithë ditën mendojnë vetëm për fustane e rregullim të flokëve.
Andi ishte shqetësuar. Rona qeshi. Ajo tha se të jesh djalë nuk është më mirë se të jesh vajzë. Asnjë nuk është më i rëndësishëm se tjetri për shkak të gjinisë. Pastaj, ata nisën t'u përgjigjeshin dy burrave:
— Kuzhina është për gratë! - tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi. Mua më pëlqen të gatuaj. Kuzhinieri më i mirë në botë është Rene Rexhepi. Ai është burrë.
— Vajzat nuk dinë të ngasin veturën! - tha burri i dytë. E pasaktë, tha Rona. Mami im është shofere më e mirë se babi. Pastaj, Danica Patrik është kampione e botës në automobilizëm.
— Burrat janë më të vendosur, janë prijës më të mirë, tha burri i parë.
E pasaktë, tha Andi Ne kemi pasur një presidente grua në Kosovë.
Gratë udhëheqin shtete të mëdha në botë. Pastaj, mbretëreshë Teuta i komandonte burrat, Laskarina Bubulina ishte kapitene e burrave në anije dhe komandante në luftë.
— Vajzat mendojnë vetëm për fustane, tha burri i dytë.
E pasaktë, tha Rona. Veshja tradicionale e burrave shqiptarë është fustanella. Fundja, veshjet që më pëlqejnë më shumë i krijon Versaçi e ai nuk është grua.
— Burrat janë më të mençur. Ka më shumë profesorë, shkencëtarë e shkrimtarë burra, tha i pari.
E pasaktë, krejt krejt e pasaktë, tha Andi. Mund të ketë pasur dikur më shumë shkencëtarë e shkrimtarë burra, sepse shoqëria i ka shtypur gratë. Mirëpo, edhe atëherë ka pasur shkencëtare të shquara si

16

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vajzat dhe djemtë (ora e tretë)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton tiparet e djemve dhe të vajzave;
- Shkruan për gratë e suksesshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Edukatë qytetare

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetje-përgjigje*

Nxënësit udhëzohen të përgjigjen në pyetjet e bëra:
- *Si lindi sherri mes Pipit dhe pesë djemve?*
- *Çfarë bëri Pipi më pas?*
- *Çfarë u tha ajo djemve në fund?*
- *Ku është dallimi mes dy teksteve?*



Maria Kiri e shkrimtare të mëdha si Sharlot Bronte e Musine Kokalari. Sot ka po aq shkencëtare e shkrimtare të mëdha, sa ka shkencëtarë e shkrimtarë të mëdhenj.

— Eh, burrat janë më të fortë, thanë dy burrat njëzëri.

Ha-ha-ha, qeshën Andi e Rona. A do të guxoje t'i dilje në mejdan Majlinda Kelmendit, kampione bote në xhudo?

— Gruaja rri në shtëpi, burri punon! - nguli këmbë burri i parë.

Budallallëk, thanë Andi e Rona njëzëri. Gruaja mund t'i bëjë të gjitha punët që i bën edhe burri: gruaja mund të jetë drejtore fabrike, pilote aeroplani, ushtare, inxhiniere, mjeke - gjithçka.

— Pse, pra, njerëzit thonë se burrat janë trima e kur dikush është me karakter më të fortë, ai është burrë? - u përpoq burri i dytë.

Gabim sërish, tha Rona. Njoh shumë djem që janë qyqarë si Bengti e shumë vajza që janë trimëresha si Pipi. Kjo vjen prej shoqërive që e kanë shtypur gruan. Trimëria e forca e karakterit nuk kanë lidhje me çështjen a je djalë a vajzë. E saktë, tha Andi. Fare nuk ka rëndësi a je grua a burrë. Asnjë veprimtari njerëzore nuk është e kufizuar nga gjinia.

Andi e Rona e dinin mirë. Vajzat e djemtë janë të barabartë.

***Pyetje:***

- *Për çfarë bisedojnë Andi e Rona me dy personat, emrat e të cilëve nuk jepen në këtë tekst?*
- *Çfarë thonë ata dy personat?*
- *Çfarë thonë Andi e Rona?*
- *Cili është kuzhinieri që përmendet në këtë tekst?*
- *Cilat janë gratë e suksesshme që i përmendin Andi e Rona?*
- *Përmendni ju disa burra dhe gra të suksesshme për të cilat keni dëgjuar.*
- *Çfarë mendoni ju lidhur me këtë temë që trajtohet në tekst?*

***Fjalë të reja:***

*Zgërdhihet, lehe, veprimtari, shkencëtar, prijës, qyqarllëk, verandë*

***Gjeni fjalë të tjera që kanë kuptim të përafërt me fjalët e dhëna:***

*Skaj (rruge) Buzë (rruge); Vajzë ___________; Djalë ___________;*

*Mëhallë___________; Ia zuri syri ___________.*

17

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Klasifikim-kontrast*

Në bazë të dy teksteve “Pipi çorapegjata” dhe “Djemtë apo vajzat”, nxënësit udhëzohen t'i shkruajnë tiparet e djemve dhe të vajzave.

| Tiparet e djemve | Tiparet e vajzave |
| --- | --- |
| | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i drejtuar*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë për një grua të suksesshme që ata e njohin apo kanë dëgjuar për të.

Më pas, i lexojnë shkrimet e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, përcaktimin e tipareve si dhe për shkrimin e drejtuar.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Për mësimdhënësin/en

# Mësimi 14

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Identifikon tipare të prozës dhe të poezisë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II, 1, 2
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 1, 3; II.1, 2, 3



Maria Kiri e shkrimtare të mëdha si Sharlot Bronte e Musine Kokalari. Sot ka po aq shkencëtare e shkrimtare të mëdha, sa ka shkencëtarë e shkrimtarë të mëdhenj.
— Eh, burrat janë më të fortë, thanë dy burrat njëzëri.
Ha-ha-ha, qeshën Andi e Rona. A do të guxoje t'i dilje në mejdan Majlinda Kelmendit, kampione bote në xhudo?
— Gruaja rri në shtëpi, burri punon! - nguli këmbë burri i parë.
Budallallëk, thanë Andi e Rona njëzëri. Gruaja mund t'i bëjë të gjitha punët që i bën edhe burri: gruaja mund të jetë drejtore fabrike, pilote aeroplani, ushtare, inxhiniere, mjeke - gjithçka.
— Pse, pra, njerëzit thonë se burrat janë trima e kur dikush është me karakter më të fortë, ai është burrë? - u përpoq burri i dytë.
Gabim sërish, tha Rona. Njoh shumë djem që janë qyqarë si Bengti e shumë vajza që janë trimëresha si Pipi. Kjo vjen prej shoqërive që e kanë shtypur gruan. Trimëria e forca e karakterit nuk kanë lidhje me çështjen a je djalë a vajzë. E saktë, tha Andi. Fare nuk ka rëndësi a je grua a burrë. Asnjë veprimtari njerëzore nuk është e kufizuar nga gjinia.
Andi e Rona e dinin mirë. Vajzat e djemtë janë të barabartë.

***Pyetje:***

— *Për çfarë bisedojnë Andi e Rona me dy personat, emrat e të cilëve nuk jepen në këtë tekst?*
— *Çfarë thonë ata dy personat?*
— *Çfarë thonë Andi e Rona?*
— *Cili është kuzhinieri që përmendet në këtë tekst?*
— *Cilat janë gratë e suksesshme që i përmendin Andi e Rona?*
— *Përmendni ju disa burra dhe gra të suksesshme për të cilat keni dëgjuar.*
— *Çfarë mendoni ju lidhur me këtë temë që trajtohet në tekst?*

***Fjalë të reja:***
*Zgërdhihet, lehe, veprimtari, shkencëtar, prijës, qyqarllëk, verandë*
***Gjeni fjalë të tjera që kanë kuptim të përafërt me fjalët e dhëna:***
*Skaj (rruge)* Buzë (rruge)*; Vajzë ____________; Djalë ____________;*
*Mëhallë____________; Ia zuri syri ____________.*

17

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vajzat dhe djemtë (ora e katërt)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përgjigjet rreth pyetjeve;
- Gjen fjalë të tjera të përafërta;
- Shkruan kuptimin e fjalëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6, fjalor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Edukatë qytetare

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetje-përgjigje*

Nxënësve u drejtohen pyetjet:
- *Cili është kuzhinieri që përmendet te teksti i dytë?*
- *Çfarë thonë Andi dhe Rona, po dy të tjerët?*
- *Cilat janë gratë e suksesshme që përmendin Andi dhe Rona?*


**Bashkëbisedojmë: Si ta përdorim fjalorin**

*Fjalët të cilave nuk ua dimë kuptimin, i kërkojmë në fjalor. Gjuha shqipe ka Fjalorin e Gjuhës Shqipe. Si të kërkojmë në një fjalor?*

*Fjalët në fjalor janë të renduara me renditje alfabetike. Në bazë të renditjes do ta gjesh fjalën. Por, fjalët mund t'i kërkoni edhe në fjalorët elektronikë (www.fjalorthi.com), duke e shkruar fjalën e caktuar në rubrikën përkatëse.*

*Fjala e kërkuar është e shënuar me shkronja të mëdha. Anash fjalës janë format në trajtën e shquar, si dhe në shumës trajta e shquar dhe e pashquar.*
*P.sh. Veprimtari, -a, -të (-a tregon trajtën e shquar në njëjës, ndërsa -të në shumës).*
*Në të djathtë pastaj shënohet kuptimi i asaj fjale. Disa fjalë kanë më shumë se një kuptim.*
*P.sh. fjala VEPRIMTARI, - A ka katër kuptime të ndryshme.*
*Ndonjëherë, ndonjë fjalë nuk gjendet në fjalor.*
*Pyeteni mësuesin/mësuesen apo prindërit për kuptimet e atyre fjalëve.*

VEPRIMTARI *f.*

1. Punë e gjallë që kryen dikush në një fushë të caktuar të jetës; pjesëmarrje e gjallë në një punë. *Veprimtari shoqërore (politike, shkencore, letrare, artistike). Veprimtari krijuese (prodhuese). Veprimtari shtetërore (diplomatike). Veprimtari e gjallë (e dendur, e frytshme).*
2. *spec.* Puna e një organi të caktuar të trupit. *Veprimtaria psikike. Veprimtaria e lartë nervore. Veprimtaria e zemrës.*
3. Veprimi i një force të natyrës etj., që sjell rrjedhime a pasoja të ndryshme. *Veprimtaria shkatërruese e ujërave (e erërave...).*
4. Degë prodhimi që kryen punë ose shërbime të caktuara. *Veprimtari ndihmëse.*

Shih edhe: veprimtar | veprim | vepror | veprohet | veproj | vepër | vepruos

shkencëtar | Kuptimi dhe...
https://fjalorthi.com

Fjalor i Gjuhës Shqipe

Fjalori i fundit(**2006**) i publikuar nga ASHSH(Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë) - rreth **48.000** fjalë

shkencëtar

Kerko

Instalo në Chrome

Kuptimi i fjalës **shkencëtar**

**shkencëtar**:
shkencëtár,-i m. sh. -ë(t) ai që merret me kërkime e studime shkencore, dijetar.

Sinonime / Të përafërta:
dijetar

***Detyrë:***

*Provoni të gjeni në fjalor fjalët:* ***emoji, printer, videolojë, selfi.*** *Nëse nuk i gjeni, përpiqumi t'i shkruani vetë kuptimet e tyre.*

Shih fletoren e punës

18

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-analizo-shkruaj*

Nxënësit udhëzohen të gjejnë fjalë që kanë kuptime të përafërta me fjalët e dhëna
Skaj rruge - buzë rruge
Vajzë ____________________
Djalë ____________________
Mëhallë ________________
Ia zuri syri ______________
Mundohen të gjejnë edhe fjalë të tjera në tekstet në libër dhe i diskutojnë bashkërisht.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexo – shkruaj*

Nxënësit udhëzohen t'i shkruajnë kuptimet e fjalëve:
emoji__________________________
printer_________________________
videolojë_______________________
selfi___________________________

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, shkrimin e fjalëve të përafërta si dhe për gjetjen e kuptimeve të fjalëve të dhëna.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 15

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE




**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 6, II: 2. 4, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 4

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon rrokjen;
- Përcakton llojin e rrokjes;
- Dallon njërrokëshin, dyrrokëshin dhe shumërrokëshin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Ora do të fillojë me rubrikën *Di*.
Nxënësit do të ndahen në katër grupe. Fillimisht në rubrikën *Di* do t'i shkruajnë njohuritë e tyre të mëhershme të cilat do t'i shkruajnë edhe në tabelë.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Rrokja është njësia më e vogël e shqiptimit. Njërrokëshe. Dyrrokëshe. | | |

Për mësimdhënësin/en



***Bashkëbisedojmë:***

*Në tekstin e mësipërm, roboti nuk e thotë fjalën të plotë. Ai e ndan fjalën në rrokje. Rrokja është njësia më e vogël e shqiptimit.*
*Për shembull, fjala **robot** ka dy rrokje: **ro** dhe **bot** Një rrokje përbëhet nga bërthama që, në gjuhë si shqipja standarde, është zanorja dhe nga margjinat që janë bashkëtingëlloret. Te rrokja **ro, o**-ja është bërthamë, ndërsa **r**-ja është margjinë.*



Top - fjalë njërrokëshe.

Fjala **robot** ka dy rrokje, por nëse e shënojmë në trajtën e shquar shndërrohet në tri rrokje.

Ro - bot (dy rrokje)
Ro - bo - ti (tri rrokje)

Ka fjalë me një rrokje: mal, mjek, det;
Ka fjalë me dy rrokje: ro-bot, lu-le, ka-tër, nxë-nës;
Ka fjalë me tri rrokje: i-mi-to, pa-su-ri, më-su-es, nxë-në-se;
Ka fjalë me më shumë rrokje: më-su-e-se; pa-ra-shu-tist, ko-stu-mo-gra-fi-a.

Ndarja e fjalëve në rrokje nuk ka të bëjë fare me kuptimin, por vetëm me shqiptimin. Ndarja më e thjeshtë në rrokje në gjuhën standarde shqipe është sipas numrit të zanoreve brenda fjalës. Pra, sa zanore ka një fjalë, ka aq rrokje.

Një rrokje që përfundon me zanore quhet rrokje e hapur. Një rrokje që përfundon me bashkëtingëllore quhet rrokje e mbyllur.

P.sh. Te fjala **robot**, rrokja **ro** është e hapur, **bot** është e mbyllur.
Te fjala **lule**, të dy rrokjet (**lu** dhe **le**) janë të hapura.

dru, ky, a-ra, me-ndi-mi - janë rrokje të hapura;
ul, shend, mal, laps, trim - janë rrokje të mbyllura.

42

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë dhe të mbajnë shënime duke i vendosur të gjitha njohuritë shtesë që duan të dinë te paragrafi *Dua të di.* Një nxënës që e përfaqëson grupin do t'i shkruajë ato në tabelë.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Rrokja është njësia më e vogël e shqiptimit. Njërrokëshe. | Cilat janë fjalët me një rrokje? Cilat janë fjalët me dy rrokje? Cilat janë fjalët me tri rrokje? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova më shumë*

Në këtë fazë të orës do të plotësohen në tabelë të gjitha paragrafët dhe do të merren shembuj ku nxënësit do të gjejnë rrokjet në fjalë.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Rrokja është njësia më e vogël e shqiptimit.<br>Njërrokëshe. | Cilat janë fjalët me një rrokje?<br>Cilat janë fjalët me dy rrokje? Cilat janë fjalët me tri rrokje? | Mal, mjek, det<br>Ro-bot, lu-le, ka-tër<br>I-mi-to, pa-su-ri, më-su-es |

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në përcaktimin e saktë të llojeve të rrokjeve dhe dallimit të tyre.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë fjalë të ndryshme duke i ndarë në rrokje)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 16

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 6, II: 2. 4, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 4


**Bashkëbisedojmë:**

*Ndarja në rrokje gjatë shkrimit është me rëndësi edhe për ndarjen me vizë në fund të rreshtit. Por, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit nuk përputhet gjithmonë me ndarjen në rrokje dhe është ndarje drejtshkrimore që është zgjidhur me marrëveshje. Megjithëkëtë, ndarja e fjalës në fund të rreshtit vlen më shumë përshkrimin me dorë, sepse programet e sotme kompjuterike nuk lejojnë ndarje të tilla.*

**Detyrë:**

- *Bërthama e një rrokjeje është:*
  - *a) Zanorja*
  - *b) Bashkëtingëllorja*
- *Margjina e rrokjes është:*
  - *a) Zanorja*
  - *b) Bashkëtingëllorja*
- *Numri i rrokjeve në një fjalë varet nga:*
  - *a) Numri i zanoreve brenda asaj fjale*
  - *b) Numri i bashkëtingëlloreve brenda asaj fjale*
- *Fjala* **mal** *ka:*
  - *a) Dy rrokje*
  - *b) Një rrokje*
- *Fjala* **mali** *ka:*
  - *a) Dy rrokje*
  - *b) Një rrokje*
- *Emri yt sa rrokje ka?*
- *Luani një lojë me rrokje. Dikush del para klasës dhe thotë një fjalë të gjatë. Ju duhet të përgjigjeni sa më shpejt që mundeni për numrin e rrokjeve që ka. Ose dikush kërkon një fjalë me një numër të caktuar rrokjesh dhe ju duhet ta gjeni, por shpejt.*
- *Gjeni nga pesë fjalë që kanë më shumë se pesë rrokje dhe provoni t'i shqiptoni shpejt ato.*

Shih fletoren e punës

43

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon rrokjen;
- Përcakton llojin e rrokjes;
- Dallon njërrokëshin, dyrrokëshin dhe shumërrokëshin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi ku nxënësit do t'i gjejnë rrokjet.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do t'i lexojnë detyrat me fjalë të ndryshme duke i ndarë në rrokje.
- Në, ne, me, të, ju, ja, pa - Këto janë fjalë me një rrokje
- Dëgjoi - Dë-gjo-i
- Fjalë - Fja-lë
- Zhurmë - Zhur-më
- Zanore - Za-no-re
- Shkronjat - Shkro-njat
- Përjashtime - Për-ja-shti-me



**Bashkëbisedojmë:**

*Ndarja në rrokje gjatë shkrimit është me rëndësi edhe për ndarjen me vizë në fund të rreshtit. Por, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit nuk përputhet gjithmonë me ndarjen në rrokje dhe është ndarje drejtshkrimore që është zgjidhur me marrëveshje. Megjithëkëtë, ndarja e fjalës në fund të rreshtit vlen më shumë përshkrimin me dorë, sepse programet e sotme kompjuterike nuk lejojnë ndarje të tilla.*

**Detyrë:**

- *Bërthama e një rrokjeje është:*
  - *a) Zanorja*
  - *b) Bashkëtingëllorja*
- *Margjina e rrokjes është:*
  - *a) Zanorja*
  - *b) Bashkëtingëllorja*
- *Numri i rrokjeve në një fjalë varet nga:*
  - *a) Numri i zanoreve brenda asaj fjale*
  - *b) Numri i bashkëtingëlloreve brenda asaj fjale*
- *Fjala* **mal** *ka:*
  - *a) Dy rrokje*
  - *b) Një rrokje*
- *Fjala* **mali** *ka:*
  - *a) Dy rrokje*
  - *b) Një rrokje*
- *Emri yt sa rrokje ka?*
- *Luani një lojë me rrokje. Dikush del para klasës dhe thotë një fjalë të gjatë. Ju duhet të përgjigjeni sa më shpejt që mundeni për numrin e rrokjeve që ka. Ose dikush kërkon një fjalë me një numër të caktuar rrokjesh dhe ju duhet ta gjeni, por shpejt.*
- *Gjeni nga pesë fjalë që kanë më shumë se pesë rrokje dhe provoni t'i shqiptoni shpejt ato.*

Shih fletoren e punës

43

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Në këtë fazë të orës do të bëhet një ushtrim në librin bazë me disa pyetje rreth rrokjes.

Bërthama e një rrokjeje është:
a) Zanorja
b) Bashkëtingëllorja

Margjina e rrokjes është:
a) Zanorja
b) Bashkëtingëllorja

Numri i rrokjeve në një fjalë varet nga:
a) Numri i zanoreve brenda asaj fjale
b) Numri i bashkëtingëlloreve brenda asaj fjale

Fjala mal ka:
a) Dy rrokje
b) Një rrokje

Fjala mali ka:
a) Dy rrokje
b) Një rrokje

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pyetja e sjell pyetjen*

Nxënësit parashtrojnë pyetje:

Pse bëhet ndarja e fjalëve në rrokje? — Ndarja e fjalëve në rrokje nuk ka të bëjë me kuptimin, por vetëm me shqiptimin e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në përcaktimin e saktë të llojeve të rrokjeve dhe dallimit të tyre.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë emrat e tyre dhe të familjarëve si dhe t'i gjejnë sa rrokje kanë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 17

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 6, II: 2. 4, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 4


njësia 11
RROKJA

◇ Ndani në rrokje fjalët.

befasi ______ përziej ______ peshku ______
befas ______ trokas ______ tingulli ______
lisi ______ kështu ______ ndërmjet ______
breshka ______ hartoj ______ qumështi ______

◇ Shënoni para fjalëve ✓ ose ✗ varësisht nëse janë ndarë mirë ose jo në rrokje.
Ndani mirë rastet me gabime.

na-ty-ri-sht ___✗___ shpër-fill-je ______ tre-go-jmë ______
për-bër-je ______ shpe-nzi-mi ______ ar-ti-sti ______
baj-ra-ku ______ stilo-gra-fi ______ ba-jra-mi ______
shp-ej-ti-mi ______ a-rki-tek-ti ______ fle-to-rja ______
shte-gti-mi ______ mirë-be-si-mi ______ re-gji-stri ______

24

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrokja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shkruan drejt fjalët;
- Përcakton llojin e rrokjes;
- Dallon rrokjen në fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi ku nxënësit do t'i gjejnë rrokjet.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë ku i kanë shkruar emrat e tyre dhe të familjarëve dhe duhej t'i gjenin sa rrokje kanë.

*Elona – E-lo-na*
*Nora – No-ra*
*Poema – Po-e-ma*



◇ Tregoni sa rrokje kanë fjalët.

| | | |
|---|---|---|
| ai dy rrokje | këta | miqësi |
| barkazi | këneta | rrëfej |
| mandej | libror | lirisht |
| atë | liri | anembanë |
| fundos | librave | gjithandej |
| gërryej | qytetërim | |

◇ Shkruani pesë fjalë:

me rrokje të hapur:

me rrokje të mbyllur:

◇ Duke i ndarë në rrokje, shkruani fjalë:

| | |
|---|---|
| me 1 rrokje: | me 5 rrokje: |
| me 2 rrokje: | me 6 rrokje: |
| me 3 rrokje: | me 7 rrokje: |
| me 4 rrokje: | me 8 rrokje: |

25

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit punojnë në dyshe për t'i rifreskuar njohuritë e fituara për rrokjen.
Fillimisht nxënësi A tregon diçka që mban mend për rrokjen, nxënësi B e dëgjon. Pastaj nxënësi A ndalon dhe vazhdon nxënësi B me gjërat e tjera që i ka mbajtur mend, por jo të njëjtat sikurse nxënësi A.
***Nxënësi A:*** Ndarja e fjalëve në rrokje nuk ka të bëjë me kuptimin, por vetëm me shqiptimin e tyre. Ndarja më e thjeshtë në rrokje në gjuhën standarde shqipe është sipas numrit të zanoreve brenda fjalës.
***Nxënësi B:*** Një rrokje që përfundon me zanore quhet rrokje e hapur, një rrokje që përfundon me bashkëtingëllore quhet rrokje e mbyllur.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit do të lexojnë në libër vjershën "Libri", ku gjatë leximit do t'i dallojnë rrokjet.
*Libri është*
*Dritë e dituri*
*Shumë gjëra*
*Mësova nga ai.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në përcaktimin e saktë të llojeve të rrokjeve si dhe ndarjes së fjalëve në rrokje.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 18

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2. 3. 4; II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2



njësia 4
LAJMET

VULLKANI RREZIKON, BANORËT LARGOHEN NGA VANATUJA

Të gjithë banorët janë detyruar të largohen nga ishulli Ambe, të premten, për shkak të rrezikut nga shpërthimi i një vullkani.
Njëmbëdhjetë mijë banorët e ishullit janë larguar në mënyrë të organizuar me urdhër të Qeverisë së Vanatusë.

Popullata është larguar pas shpërthimit të vullkanit Manaro Vui, hiri i të cilit është ngritur deri në pesë kilometra lartësi, duke i penguar edhe rrezet e diellit.
Ishulli Ambe është pjesë e Republikës së Vanatusë, shtet i përbërë nga disa ishuj në Oqeanin Paqësor.

***Zbërthejmë tekstin sipas pyetjeve të shtruara:***

*Kush vepron në këtë lajm?*
***E tërë popullata.***
*Çfarë veprimi kanë bërë ata?*
***Janë larguar.***
*Ku ndodh veprimi?*
***Në ishullin Ambe.***
*Kur ka ndodhur veprimi?*
***Të premten.***
*Pse ka ndodhur veprimi?*
***Për shkak të shpërthimit të një vullkani.***
*Si ka ndodhur?*
***Në mënyrë të organizuar.***

***Bashkëbisedojmë: Lajmi***

- *Teksti i mësipërm është një lajm.*
- *Lajmi përdoret në medie (televizion, gazeta, radio, portale në internet).*
- *Një lajm është një informadon i freskët për një ngjarje me rëndësi dhe me interes për publikun.*
- *Lajmi i ofron përgjigjet e pyetjeve kush, çka, ku, kur, pse dhe si.*
- *Fjalia e parë e një lajmi përmbledh të gjitha informacionet e nevojshme, zakonisht përgjigjet e pyetjeve: kush, çka, ku dhe kur.*
- *Sa më pak të rëndësishme janë informacionet e tjera, shkojnë më poshtë tekstit.*
- *Gazeta, televizioni, radioja, portalet në internet quhen mjete të informacionit.*
- *Shërben për ta informuar popullin për ngjarjet më të rëndësishme që kanë ngjarë kohët e fundit.*

19

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lajmet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon lajmin nga tekstet e tjera;
- Nxjerr informacionet nga lajmi.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** një gazetë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Mësimdhënësi paraqet para klasës një gazetë dhe diskuton me nxënësit për titujt kryesorë.



EPOKA E RE

KOSOVA SHËNON PËRPARIM NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Mësimdhënësi e shpjegon rëndësinë e lajmit.


njësia 4
LAJMET

**VULLKANI RREZIKON, BANORËT LARGOHEN NGA VANATUJA**

Të gjithë banorët janë detyruar të largohen nga ishulli Ambe, të premten, për shkak të rrezikut nga shpërthimi i një vullkani.
Njëmbëdhjetë mijë banorët e ishullit janë larguar në mënyrë të organizuar me urdhër të Qeverisë së Vanatusë.

Popullata është larguar pas shpërthimit të vullkanit Manaro Vui, hiri i të cilit është ngritur deri në pesë kilometra lartësi, duke i penguar edhe rrezet e diellit.
Ishulli Ambe është pjesë e Republikës së Vanatusë, shtet i përbërë nga disa ishuj në Oqeanin Paqësor.

***Zbërthejmë tekstin sipas pyetjeve të shtruara:***

*Kush vepron në këtë lajm?*
***E tërë popullata.***
*Çfarë veprimi kanë bërë ata?*
***Janë larguar.***
*Ku ndodh veprimi?*
***Në ishullin Ambe.***
*Kur ka ndodhur veprimi?*
***Të premten.***
*Pse ka ndodhur veprimi?*
***Për shkak të shpërthimit të një vullkani.***
*Si ka ndodhur?*
***Në mënyrë të organizuar.***

***Bashkëbisedojmë: Lajmi***

- *Teksti i mësipërm është një lajm.*
- *Lajmi përdoret në medie (televizion, gazeta, radio, portale në internet).*
- *Një lajm është një informadon i freskët për një ngjarje me rëndësi dhe me interes për publikun.*
- *Lajmi i ofron përgjigjet e pyetjeve kush, çka, ku, kur, pse dhe si.*
- *Fjalia e parë e një lajmi përmbledh të gjitha informacionet e nevojshme, zakonisht përgjigjet e pyetjeve: kush, çka, ku dhe kur.*
- *Sa më pak të rëndësishme janë informacionet e tjera, shkojnë më poshtë tekstit.*
- *Gazeta, televizioni, radioja, portalet në internet quhen mjete të informacionit.*
- *Shërben për ta informuar popullin për ngjarjet më të rëndësishme që kanë ngjarë kohët e fundit.*

19

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit të ndarë në dyshe e lexojnë lajmin e dhënë në libër. Pasi të lexojnë ata krijojnë pyetje rreth tekstit për dyshet e tjera.

Pas përfundimit të pyetjeve nxënësit në dyshe i lexojnë pyetjet dhe nxënësit e tjerë përgjigjen.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Veprimtari zbatuese*

Nxënësit shkruajnë informacionet kryesore nga teksti.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të lajmit nga tekstet e tjera si dhe nxjerrjes së saktë të informacioneve kryesore nga lajmi.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë lajme të ndryshme nga portalet)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 19

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2. 3. 4; II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2



*Detyrë:*
*Formo një lajm nga këto elemente.*
- *Kotelja e Zanës kishte mbetur në degë të një druri.*
- *Arti ka hipur në dru dhe e ka shpëtuar kotelen.*
- *Arti e ka bërë këtë se ka dashur t'ia bëjë qejfin Zanës.*
- *Ngjarja ka ndodhur të mërkurën në Prizren.*
- *Arti e ka marrë kotelen nga dega dhe e ka lëshuar me kujdes në tokë.*
- *Nuk dihet si ka mbetur kotelja në degë.*

*Detyrë:*
*Ndahuni në grupe. Hulumtoni në internet, në portale shqiptare dhe përzgjidhni disa lajme për t'i analizuar. Zbërthejini ato përmes gjashtë pyetjeve.*
*Prezantoni punimet në klasë dhe diskutoni për to.*

20

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elementet e lajmit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon elementet e lajmit;
- Krijon lajme;
- Analizon një lajm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor,

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji, Gazetari

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë. Gjatë leximit mësimdhënësi me nxënësit diskuton rreth informacioneve që japin lajmet që kanë lexuar ata.

Mësimdhënësi gjatë diskutimit parashtron pyetjet kryesore të elementeve të një lajmi: kush, çka, ku, kur, si, pse. Ai shpjegon në pika të shkurtra elementet e lajmit.



Përcakto elementet e lajmit sipas pyetjeve:

| | |
|---|---|
| KUSH? | |
| ÇKA? | |
| KUR? | |
| KU? | |
| SI? | |
| PSE? | |

Pjesë nga "Fëmija i elefantit"

GJASHTË SHOKËT BESNIKË

Kam gjashtë shokë besnikë unë
(Më kanë mësuar gjithçka që di)
Ata quhen **Kush** dhe **Kur** dhe **Ku**
Dhe **Çka** dhe **Pse** dhe **Si**

I çoj të kërkojnë në tokë e në det
Përgjatë nga Lindja në Perëndim
Dhe kur përgjigjet të gjitha i gjejnë
Kthehen sërish në gjirin tim

Rudijard Kipling

21

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit e zgjidhin detyrën faqe 20 për formimin e një lajmi, duke përdorur elementet e dhëna nga detyra.

Pasi nxënësit e kanë përfunduar formimin e lajmit ata i shkëmbejnë detyrat me shokun/ shoqen e bankës. Secili nga ta u përgjigjet 6 pyetjeve të elementeve të lajmit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Veprimtari zbatuese*

Nxënësit e lexojnë poezinë "6 shokët besnikë" dhe u përgjigjen pyetjeve në libër.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në përcaktimin e saktë të elementeve të lajmit dhe krijimin e një lajmi.

**Detyrë:**

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

______________________________

# Mësimi 20

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2. 3. 4; II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2



njësia 3
VAJZAT DHE DJEMTË

Detyrë

- Cila është heroina që e preferoni më shumë?

a. Borëbardha
b. Elsa dhe Ana
c. Mulan
d. Ndonjë tjetër

Pse?

Shkruajeni një tekst me, së paku, tri fjali, për të treguar se përse kjo është heroina juaj e preferuar. Lexojeni në klasë.

Detyrë

- Ndahuni në gjashtë grupe dhe secili nga grupet merreni nga një detyrë. Gjeni të dhënat në internet dhe përgatiteni një tekst në gjysmë faqe për njërën nga këto gra të suksesshme. Lexojini në klasë.

a. Nëna Terezë
b. Mbretëresha Teutë
c. Bubulina
d. Shotë Galica
e. Majlinda Kelmendi
f. Dua Lipa

Detyrë

- Bashkë me arsimtarin/arsimtaren tuaj, shkoni të shihni një performancë muzikore. Analizoni pjesëmarrjen gjinore të performuesve/eve në këtë koncert. Pastaj, hulumtoni për personalitete të shquara në fushën e muzikës klasike dhe diskutoni në klasë.

6

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon tekstet letrare dhe joletrare;
- Identifikon lajmet;
- Analizon një lajm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji, Gazetari

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet një poezi, një tekst prozaik. Ai diskuton me nxënësit rreth dallimeve që i shohin në këto tekste.
Ai i shpjegon dallimet mes teksteve prozaike dh teksteve poetike, teksteve letrare dhe joletrare.
Së fundi, i udhëzon nxënësit të lexojnë në libër.


njësia 4
LAJMI

**Detyrë**

◇ *Të shkruajmë lajme:*

- *Është luajtur një ndeshje futbolli.*
- *Ndeshja është luajtur të shtunën, në oborrin e shkollës sonë.*
- *Skuadra e shkollës sonë ka luajtur kundër skuadrës së shkollës fqinje.*
- *Skuadra jonë ka fituar me rezultatin 2:0.*
- *Të dy golat janë shënuar në pjesën e parë.*
- *Golat i kanë shënuar Genci dhe Trimi.*
- *Ndeshja është luajtur për ta shënuar festën e shkollës.*

*(Kush)* ____________ *(Çka)* ____________

*(Kur)* ____________ *(Ku)* ____________.

*Si (kush i ka shënuar golat dhe si janë shënuar golat?)* ____________.

*Pse (pse është luajtur ndeshja?)* ____________.

◇ *Shndërrojmë në lajm Borëbardhën.*

*Princi ka puthur Borëbardhën.*
*Puthja e Princit e ka zgjuar Borëbardhën nga magjia e shtrigës.*
*Ngjarja ka ndodhur afër shtëpisë së shkurtabiqëve.*
*Ngjarja ka ndodhur të hënën.*

*Kush* ____________, *Çka* ____________, *Pse* ____________.

*Ku* ____________, *Kur* ____________.

7

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit plotësojnë fletore pune faqe 6 dhe 7. Mësimdhënësi vëzhgon.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit i lexojnë detyrat dhe korrigjohen gabimet nëse ka.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të lajmit nga një tekst tjetër.

**Detyrë:**

______________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

______________________________

# Mësimi 21

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2. 3. 4; II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2



**Detyrë dhe pyetje:**

- Cilët qenkan gjashtë shokët besnikë të personazhit të vjershës?
- Personazhi i kësaj vjershe duket se bën shumë pyetje. Kjo do të thotë se ai është:
  a) Kureshtar
  b) Hutaq
  c) Budalla
- Kur personazhi thotë se i çon pyetjet në tokë e në det, në Lindje e në Perëndim, ai dëshiron të thotë se:
  a) Është i interesuar të mësojë gjëra të ndryshme
  b) Është i hutuar
  c) Është i gjithdijshëm dhe nuk ka nevojë për të mësuar asgjë më shumë
- Kur autori thotë se gjashtë pyetjet kthehen sërish në gjirin e tij, ai dëshiron të thotë se:
  a) Dëshiron të vazhdojë të mësojë e të interesohet gjithnjë e më shumë
  b) Nuk kupton asgjë
  c) Nuk dëshiron të mësojë

**Bashkëbisedojmë: "Tekste letrare dhe joletrare"**

Teksti me Pipi Çorapegjatën, teksti "Djemtë apo vajzat" dhe lajmi "Vullkani rrezikon, banorët largohen nga Vanatuja" janë tekste në prozë.

Teksti "Gjashtë shokët besnikë" është vjershë dhe shkruhet në vargje.

Teksti me Pipi Çorapegjatën dhe vjersha "Gjashtë shokët besnikë" janë tekste letrare dhe janë krijuar nga fantazia e shkrimtarëve. E shfaqin një botë që është krijuar në kokën e shkrimtarit.

Lajmi është tekst joletrar dhe nuk është pjesë e imagjinatës së shkrimtarit, por bën fjalë për diçka që pritet të jetë e vërtetë.

Tekste joletrare, pos lajmeve, janë: kuriozitetet, recetat e gatimit, udhëzimet e ndryshme, biografitë e autobiografitë, shkrimet studimore e shkollore e kështu me radhë.

**Si ta shkruajmë një ese?**
***Interneti***

*Edhe interneti është një mjet informacioni.*
*Paramendoni që të gjithë kompjuterët e shoqeve dhe të shokëve të shkollës të jenë të lidhur në një rrjet të përbashkët, në mënyrë që secili të mund të vendosë dhe të marrë informacione. Tash, kur edhe rrjete të tjera lidhen me këtë rrjetin e shoqeve dhe të*

22

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Interneti

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon rëndësinë e internetit;
- Dallon anët pozitive dhe negative të internetit;
- Shkruan për rreziqet e internetit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazike

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim i njohurive paraprake*

Mësimdhënësi drejton pyetjet:
Sa orë kaloni në internet?
Për çka e përdorni më së shumti internetin?
Disa nga përgjigjet që mund të marrë mësimdhënësi, janë:
Kalojmë pjesën më të madhe të ditës.
E kemi me orar.
Qëndrojmë në rrjetet sociale.
Varësisht nga përgjigjet edhe mësimdhënësi diskuton me nxënësit dhe u flet për rolin e internetit.


shokëve tuaj, krijohet një rrjet shumë i gjerë informacionesh. Ky rrjet i informacioneve në kompjuterë është interneti.
Interneti është një mjet për bartjen e informacioneve nga një kompjuter te kompjuterët e tjerë kudo në botë, përmes telefonave, satelitëve.
E shfrytëzojmë përmes kompjuterëve në shtëpi dhe telefonave të mençur.

Nxënëset dhe nxënësit e përdorin internetin:

- Për të realizuar projekte të ndryshme,
- Për të luajtur lojëra,
- Për të gjetur informacione lidhur me mësimet në shkollë,
- Për të komunikuar mes vete, me anëtarët e familjes dhe me mësueset/mësuesit (nëpërmjet e-mailit),
- Për të krijuar faqe të vetat në internet,
- Për të krijuar rrjete shoqërore në internet.

**Loni dhe interneti**

Loni është nxënës i klasës së gjashtë. Ai thotë: "Unë kam gjithnjë kujdes, kur e përdor internetin". Loni ka hapur llogarinë e tij të e-mailit. Ai komunikon me shokët, me anëtarët e familjes dhe me mësuesen. Nuk komunikon me persona që nuk i njeh. Bën kujdes që të mos hedhë të dhëna personale në internet.
Mirëpo, një ditë dikush ia kishte dërguar një mesazh që kishte pasur virus. Loni nuk e ka ditur dhe e ka hapur mesazhin. Virusi e kishte dëmtuar kompjuterin dhe ia kishte humbur disa shënime të mamit. Mami ishte inatosur. Motra e madhe e kishte mësuar si t'i bllokonte mesazhet e padëshirueshme.
Motra ia kishte dhënë këto këshilla Lonit:
- Kurrë mos jep në internet informacione të tilla si adresa e shtëpisë, numri i telefonit apo shënime të ngjashme.
- Mos dërgo fotografi që tregojnë ku e ke shkollën apo shtëpinë.
- Nëse ndonjë i panjohur të shkruan, tregomë mua apo mamit e babit.

Arta është shoqe e klasës e Lonit. Ajo i ka shkruar e-mail Lonit për ta pyetur për detyrat e shtëpisë. Arta thotë:
Interneti është shumë i dobishëm, sepse kur nuk jam e sigurt për detyrat e shtëpisë, mund t'i pyes shoqet apo shokët. Është argëtues, sepse luan videolojëra. Mirëpo, nuk është mirë të rrish shumë në internet. Unë kam qejf më shumë të dal në natyrë dhe të luaj me shoqet.
Videoloja më e pëlqyer e Lonit dhe e Artës është loja Majnkraft. Ata e luajnë këtë lojë në rrjet me një grup shokësh.

Shih fletoren e punës

**Pyetje dhe bashkëbisedim:**

- Çfarë është interneti?
- Për çfarë është i dobishëm interneti?
- Cilat janë rreziqet e përdorimit të internetit nga fëmijët?
- Cilat këshilla ia dha motra Lonit lidhur me përdorimin e internetit?
- Po Arta, shoqja e Lonit, për çka e përdor internetin?
- Si e përdorni ju internetin?
- Cila është loja juaj e preferuar? Pse?

23

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në libër faqe 22.

Pas leximit ata i shkruajnë në tabelë anët pozitive dhe negative të përdorimit të internetit.

| Anët pozitive | Anët negative |
|---|---|
| Një botë me shumë informacion.<br>Komunikim i lehtë. | Pasiguria.<br>Dëmtimi i syve.<br>Kalimi i tepërt i kohës. |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në libër. Së bashku me mësimdhënësin diskutojnë rreth internetit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të anëve pozitive dhe negative të internetit dhe shpjegimit të rëndësisë së tij.

**Detyrë:**
(Fletore pune, detyra e fundit, faqe 8)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 22

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mediet (televizioni, radio), shoqëria, interneti

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Komenton dhe shkruan për tekste apo emisione të ndryshme nga mediet

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2. 3. 4; II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rëndësia e interneti

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon pasojat nga interneti;
- Interpreton materiale të marra nga interneti;
- Shkruan për rëndësinë e internetit.


*Detyrë dhe pyetje:*

- *Cilët qenkan gjashtë shokët besnikë të personazhit të vjershës?*
- *Personazhi i kësaj vjershe duket se bën shumë pyetje. Kjo do të thotë se ai është:*
  a) *Kureshtar*
  b) *Hutaq*
  c) *Budalla*
- *Kur personazhi thotë se i çon pyetjet në tokë e në det, në Lindje e në Perëndim, ai dëshiron të thotë se:*
  a) *Është i interesuar të mësojë gjëra të ndryshme*
  b) *Është i hutuar*
  c) *Është i gjithdijshëm dhe nuk ka nevojë për të mësuar asgjë më shumë*
- *Kur autori thotë se gjashtë pyetjet kthehen sërish në gjirin e tij, ai dëshiron të thotë se:*
  a) *Dëshiron të vazhdojë të mësojë e të interesohet gjithnjë e më shumë*
  b) *Nuk kupton asgjë*
  c) *Nuk dëshiron të mësojë*

***Bashkëbisedojmë: "Tekste letrare dhe joletrare"***

*Teksti me Pipi Çorapegjatën, teksti "Djemtë apo vajzat" dhe lajmi "Vullkani rrezikon, banorët largohen nga Vanatuja" janë tekste në prozë.*

*Teksti "Gjashtë shokët besnikë" është vjershë dhe shkruhet në vargje.*

*Teksti me Pipi Çorapegjatën dhe vjersha "Gjashtë shokët besnikë" janë tekste letrare dhe janë krijuar nga fantazia e shkrimtarëve. E shfaqin një botë që është krijuar në kokën e shkrimtarit.*

*Lajmi është tekst joletrar dhe nuk është pjesë e imagjinatës së shkrimtarit, por bën fjalë për diçka që pritet të jetë e vërtetë.*

*Tekste joletrare, pos lajmeve, janë: kuriozitetet, recetat e gatimit, udhëzimet e ndryshme, biografitë e autobiografitë, shkrimet studimore e shkollore e kështu me radhë.*

**Si ta shkruajmë një ese?**
***Interneti***

*Edhe interneti është një mjet informacioni.*
*Paramendoni që të gjithë kompjuterët e shoqeve dhe të shokëve të shkollës të jenë të lidhur në një rrjet të përbashkët, në mënyrë që secili të mund të vendosë dhe të marrë informacione. Tash, kur edhe rrjete të tjera lidhen me këtë rrjetin e shoqeve dhe të*

22

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim i njohurive paraprake*

Nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë dhe së bashku me mësimdhënësin diskutohet për poezitë dhe faqet e internetit ku ata i kanë marrë.

Mësimdhënësi e tregon kuptimin e fjalës internet duke u bazuar në fjalorin e ASHSH-së.

Internet - internét,-i emër i gjinisë mashkullore; i ligjërimit libror; rrjeti kompjuterik ndërkombëtar.



shokëve tuaj, krijohet një rrjet shumë i gjerë informacionesh. Ky rrjet i informacioneve në kompjuterë është interneti.
Interneti është një mjet për bartjen e informacioneve nga një kompjuter te kompjuterët e tjerë kudo në botë, përmes telefonave, satelitëve.
E shfrytëzojmë përmes kompjuterëve në shtëpi dhe telefonave të mençur.

Nxënëset dhe nxënësit e përdorin internetin:

- Për të realizuar projekte të ndryshme,
- Për të luajtur lojëra,
- Për të gjetur informacione lidhur me mësimet në shkollë,
- Për të komunikuar mes vete, me anëtarët e familjes dhe me mësueset/mësuesit (nëpërmjet e-mailit),
- Për të krijuar faqe të vetat në internet,
- Për të krijuar rrjete shoqërore në internet.

**Loni dhe interneti**

Loni është nxënës i klasës së gjashtë. Ai thotë: "Unë kam gjithnjë kujdes, kur e përdor internetin". Loni ka hapur llogarinë e tij të e-mailit. Ai komunikon me shokët, me anëtarët e familjes dhe me mësuesen. Nuk komunikon me persona që nuk i njeh. Bën kujdes që të mos hedhë të dhëna personale në internet.
Mirëpo, një ditë dikush ia kishte dërguar një mesazh që kishte pasur virus. Loni nuk e ka ditur dhe e ka hapur mesazhin. Virusi e kishte dëmtuar kompjuterin dhe ia kishte humbur disa shënime të mamit. Mami ishte inatosur. Motra e madhe e kishte mësuar si t'i bllokonte mesazhet e padëshirueshme.
Motra ia kishte dhënë këto këshilla Lonit:
- Kurrë mos jep në internet informacione të tilla si adresa e shtëpisë, numri i telefonit apo shënime të ngjashme.
- Mos dërgo fotografi që tregojnë ku e ke shkollën apo shtëpinë.
- Nëse ndonjë i panjohur të shkruan, tregomë mua apo mamit e babit.

Arta është shoqe e klasës e Lonit. Ajo i ka shkruar e-mail Lonit për ta pyetur për detyrat e shtëpisë. Arta thotë:
Interneti është shumë i dobishëm, sepse kur nuk jam e sigurt për detyrat e shtëpisë, mund t'i pyes shoqet apo shokët. Është argëtues, sepse luan videolojëra. Mirëpo, nuk është mirë të rrish shumë në internet. Unë kam qejf më shumë të dal në natyrë dhe të luaj me shoqet.
Videoloja më e pëlqyer e Lonit dhe e Artës është loja Majnkraft. Ata e luajnë këtë lojë në rrjet me një grup shokësh.

Shih fletoren e punës

**Pyetje dhe bashkëbisedim:**

- Çfarë është interneti?
- Për çfarë është i dobishëm interneti?
- Cilat janë rreziqet e përdorimit të internetit nga fëmijët?
- Cilat këshilla ia dha motra Lonit lidhur me përdorimin e internetit?
- Po Arta, shoqja e Lonit, për çka e përdor internetin?
- Si e përdorni ju internetin?
- Cila është loja juaj e preferuar? Pse?

23

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari zbatuese*

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të shkruajnë një ese me temën "Një ditë pa internet".

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Veprimtari zbatuese*

Nxënësit i lexojnë punimet e tyre. Mësimdhënësi diskuton me nxënësit rreth mendimeve që kanë dhënë rreth mungesës së internetit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të anëve pozitive dhe negative të internetit dhe shpjegimit të rëndësisë së tij.

**Detyrë:**
(Fletore pune, detyra e fundit, faqe 8)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 23

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Fonetikë/ fonologji

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon theksin. Përcakton theksin e fjalës në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 4; 3. 1, 2


njësia 12
THEKSI

Adelina Mamaqi
**LIBRI**

***Bashkëbisedojmë:***

*Në këtë vjershë janë dalluar me shkronja të bardha disa rrokje. Kur ta lexoni vjershën, do ta vëreni se këto rrokje shqiptohen më shumë se rrokjet që Janë të shënuara me shkronja të zeza.*
*Këto rrokje të fjalës që shqiptohen apo dëgjohen më shumë janë rrokje ku bie theksi i fjalës - janë rrokjet e theksuara.*
*Kjo rrokje e theksuar mund të jetë një zanore e vetme: Po e zëmë, te fjala ai:* **a - i**, **i**-*ja është rrokja e theksuar.*

*Kjo rrokje e theksuar mund të jetë me një a me më shumë bashkëtingëllore:* **shkru-aj** *- rrokja* **shkru** *është e theksuar. Nga këta shembuj vërejmë se rrokja e theksuar është më e zëshme dhe shqiptohet me forcë, me lartësi dhe me gjatësi më të madhe të zërit.*

*Për shembull, te fjala* **lexoj**, *theksi është në rrokjen e fundit. Te fjala* **libër**, *është në rrokjen e parafundit. Në gjuhën shqipe theksi ka disa rregulla të caktuara. Kur fjala merr mbaresa, theksi nuk lëviz.*

**mal** **ma**le
**ma**li **ma**let
**ma**lit **ma**leve
**ma**lin **ma**lesh

Te të gjitha rastet, theksi është te rrokja **ma.**

**Libri është.**
**dritë e dituri,**
**shumë gjëra**
**mësova nga ai.**

**Mësova të shkruaj,**
**mësova të lexoj**
**mësova shumë vjersha**
**unë të recitoj.**

***Pyetje:***
- *Për çfarë bën fjalë kjo vjershë?*
- *Si e cilëson autorja librin?*
- *Çfarë ka mësuar ajo nga libri?*

44

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Theksi (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon theksin e fjalës;
- Vendos theksin në fjalët e dhëna;
- Krahason fjalët - homonime.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjete shkrimi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetja e sjell pyetjen*

Drejtohen pytjet:
- Ç'është fonetika?
- Fonologjia studion?
- Ç'është rrokja?
- A mund të jetë rrokja vetëm me një shkronjë?
- Gjeni fjalë njërrokëshe, dyrrokëshe, tri e më shumë rrokëshe.
- Po fjala bari te grupet e fjalëve: bari i gjelbër dhe bari delesh ku dallon (shkruhet fjala në tabelë).

Nxënësit japin përgjigje rreth pyetjeve.



Kjo do të thotë se gjatë lakimit të emrave dhe zgjedhimit të foljeve ai mbetet në të njëjtën rrokje të temës së fjalës, pavarësisht nga mbaresat që Çala i merr në fund të saj. P.sh.

| *Lakimi i emrit **lis*** | | | *Zgjedhimi i foljes **lexoj*** |
|---|---|---|---|
| *E.* | *lís-**i*** | *I* | *lexó-**j*** |
| *Gj./Dh./Rr.* | *(i,e) lís-**it*** | *II* | *lexó-**n*** |
| *K.* | *lís-**in*** | *III* | *lexó-**n*** |
| *E./K.* | *lís-**at*** | *I* | *lexó-**jmë*** |
| *Gj./Dh./Rr.* | *lís-**ave*** | *II* | *lexó-**ni*** |
| | | *III* | *lexó-**jnë*** |

Mirëpo, kur fjala merr prapashtesa, me ç'rast formohet fjalë e re, theksi zakonisht bie në prapashtesë.

*Punë-a*
*Puno-j*
*Punim-i*
*Punëtor-i*
*Punëtori-a.*

Ka disa përjashtime, si te prapashtesat: -je, -as, -aj, -shëm, -izëm.
P.sh. Drenas, gjilanas, deçanas shqiptohen: ***dre***-nas, de-***ça***-nas, gji-***la***-nas;
Ferizaj, Skënderaj, Bardhaj shqiptohen: Fe-***ri***-zaj, Skë-***nde***-raj, ***Bar***-dhaj.

45

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Leximi bëhet me ndalesa.

Pyetjet e mundshme për ndalesën e parë:

- Ç'është theksi i fjalës?
- Ku bie theksi?
- Kur lëviz theksi?

Pyetjet e mundshme për ndalesën e dytë:

- Ku dallon fjala ar-i nga fjala ari-u?
- Cila fjalë është me theks fundor e cila me theks parafundor?
- Pse mendon se kjo rrokje është e theksuar?
- Vendose theksin në rrokje tjetër!
- A kanë theks fjalët me dy tema?
- A ka fjalë pa theks?
- Merren shembuj me theks tejfundor, si: flutura, kukulla, kumbulla dhe shpjegohet se ai bie në rrokjen e tretë nga fundi. Nxënësit provojnë ta vendosin theksin te rrokjet e tjera.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit në mënyrë individuale e vendosin theksin te fjalët që u jepen (me theks fundor, parafundor e tejfundor), si shembull fjalët: vetull, Kosovë, Shqipëri, ora, letërsi, drejtori.
Nxënësit në dyshe i shkëmbejnë fletoret, i korrigjojnë gabimet dhe diskutojnë për detyrën.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të theksit të fjalës, vendosjes së theksit të fjalës dhe për arsyetimin e mendimit në vendosjen e theksit.

**Detyrë:**
(Vendosin theksin te fjalët dhe formojnë fjali me fjalët, detyra 1 dhe 2 në fletoren e punës, faqe 27)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 24

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Theksi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon theksin. Përcakton theksin e fjalës në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 4; 3. 1, 2


njësia 12
THEKSI

◇ *Vini theksin në fjalët e mëposhtme. Rrumbullakoni zanoren që ka theks.*

*fshat, fshatar, fshatari, fshatarësi, fshatarësinë; vizë, vizatoj, vizatim; fëmijë, fëmijëri, fëmijëror; afër, afroj, afrim, afrueshmëria; muzikë, muzikant, muzikoj; i bukur, bukuri, bukurosh, bukurshkrim; flutura, fluturoj, fluturues, fluturake; pyjet, pyllëzoj, pyllëzim; kaloj, kalimtar, kalimtarësi; krye, kryetar, kryesues, kryesoj, kryeqytet; shkëmb, shkëmbinj; i sigurt, siguria, i siguruar, sigurisht; qytete, qytetarë, kryeqytetet; kukulla; kumbulla; republikë; burrave.*

◇ *Ndërtoni fjali me këto fjalë, duke i përdorur një herë me theks parafundor dhe një herë me theks fundor.*

*Ministri:* ____________________
*Bari:* ____________________
*Drejtori:* ____________________
*Punëtori:* ____________________
*Para:* ____________________

◇ *Lexoni fjalët e poshtëshënuara. Vini re cila rrokje po shqiptohet më shumë.*

*ujë - ujit, i madh - të mëdhenj, i keq - të këqij, mik - miqësi, punë - punëtor, fshat - fshatar, lumë - lumenj, i thjeshtë - thjeshtësi, mirë - mirësi.*

27

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Theksi (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon çfarë din për theksin e fjalës;
- Vendos mbaresën -ë në fund të fjalës me theks fundor sipas rregullave gramatikore;
- Identifikon klasifikimin e fjalëve sipas theksit fundor, parafundor dhe tejfundor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Disa nxënës i lexojnë detyrat e shtëpisë.
Diskutojnë nëse e kanë vendosur saktë theksin e fjalës.
Përmes pyetjeve rikujtohet se çfarë është theksi.



◇ *Nënvizoni fjalët që janë në vendin e gabuar.*

| *me theks fundor* | | *me theks parafundor* | | *me theks tejparafundor* | |
|---|---|---|---|---|---|
| *para* | *përkundrazi* | *fole* | *i përzemërt* | *Trishtueshëm* | |
| *ar* | *tregti* | *art* | *tani* | *grumbull* | *dardhë* |
| *dërgoj* | *kuti* | *rrugor* | *shpejt* | *katërshe* | *miqësi* |
| *histori* | *vetull* | *ujk* | *i përveçëm* | *e lumtura* | *shportë* |
| *rruzull* | *vëlla* | *petull* | *fuqi* | *ndenjëse* | *pleqëri* |
| | | | | *nëndetëse* | *barkazi* |

◇ *Vini mbaresën e saktë, pasi të gjeni theksin: -në, -n, -së, -s.*

*Kallëzore: vëlla ______ , nxënëse ______ , tregti ______ , shkollë ______ , hare ______ .*

*Dhanore: vëlla ______ , nxënëse ______ , tregti ______ , shkollë ______ , hare ______ .*

◇ *Provoni të bashkëbisedoni me shokun/shoqen e bankës, duke ua ndërruar theksin fjalëve. A qenka e mundshme?!*

28

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-Analizo-Plotëso*

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë detyrën "Nënvizo fjalët që janë në vendin e gabuar" në fletore punë dhe t'i identifikojnë gabimet në klasifikimin e fjalëve sipas theksit.

Pas përfundimit i shkëmbejnë librat në dyshe, e kontrollojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.
Pas kësaj, udhëzohen të punojnë në fletore pune detyrën "Vini mbaresën e saktë pasi ta gjeni theksin!"
Kërkohet nga nxënësit të gjejnë se kur duhet të përdoret shkronja -ë.
Nëse nuk arrijnë ta gjejnë shpjegohet se fjalët me theks fundor marrin -ë sipas rasës dhe trajtës. Si shembull: letërsinë, vëllanë (te theksi fundor fjala shkruhet me -ë në fund), kurse nxënëses, lepujt (te theksi jofundor pa -ë në fund).

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diagrami përmbledhës*

Nxënësit do t'i përmbledhin njohuritë e tyre rreth theksit.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të theksit, identifikimin e llojit të theksit, drejtshkrimin e fjalëve me theks fundor e jofundor.

**Detyrë:**
(Shkruajnë një poezi në fletore)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________

______________________________

# Mësimi 25

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Theksi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon theksin. Përcakton theksin e fjalës në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 4; 3. 1, 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Theksi i fjalisë (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon theksin e fjalisë;
- Identifikon theksin e fjalisë, logjik dhe emocional;
- Përdor theksin logjik për interpretim artistik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**


***Bashkëbisedojmë:***

***Theksi i fjalisë, logjik, sintagmatik dhe emocional***

*Theksi mund të bjerë edhe mbi njësi më të mëdha se fjala, siç janë grupet emërore, grupet foljore e fjalia. Për shembull, në fjalinë: Shoqja ime lexon shpejt - fjala që shquhet më shumë është fjala **shpejt**. Ky quhet theks i fjalisë dhe zakonisht bie mbi fjalën e fundit të fjalisë. Kurse theksi logjik bie mbi fjalën që në çastin e caktuar të ligjërimit duam ta veçojmë më fort nga të tjerat për nga ana kuptimore. P.sh. **Librin** duhet të ma kthesh./Librin **duhet** të ma kthesh.*
*Kurse brenda fjalisë së mësipërme fjalët **ime** dhe **shpejt** në kuadër të grupeve **shoqja ime** dhe lexon shpejt janë ato që theksohen më shumë. Ky quhet theks sintagmatik.*
*Kemi edhe theksin emocional, i cili realizohet me zgjatje të zanoreve (Mooos, ashtu!) e të bashkëtingëlloreve (Shkatërrrrraq!) dhe shërben për t'u dhënë fjalëve ngarkesë emocionale.*

***Detyrë:***

***Lexojini këto fjali, duke e theksuar fjalën e shënuar me të zeza dhe tregoni a po vëreni ndonjë ndryshim:***

- ***Djali** erdhi nga shkolla. Djali **erdhi** nga shkolla. Djali erdhi **nga** shkolla. Djali erdhi nga **shkolla.***
- ***Eja** me mua! Eja me **mua**! Eja **me** mua!*
- ***Sot** e pashë Dritën. Sot **e pashë** Dritën. Sot e pashë **Dritën.***

***Përpiquni të aktroni emocione. Shqiptojini në mënyrë emocionale fjalët e shënuara me të zeza:***

- Ai është ***rebel***.
- Të kam thënë ***shtatë*** herë.
- ***Mos***.

*(inat)*

- Sa e ***lehtë***!
- Sa qenush ***i mirë***!

*(butësi)*

Shih fletoren e punës

47

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Disa nga nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë (mund të recitojë edhe mësuesi për të dhënë model se si përjetohet poezia).
Duke e përdorur theksin logjik kërkohet nga nxënësit nëse kanë vërejtur se disa fjalë u shqiptuan më me zë. Pyeten nxënësit se si quhej shqiptimi më me zë i një rrokjeje ose i rrokjeve të tjera në fjali.
Se çfarë është shqiptimi më me zë i një fjale dhe llojeve të tjera të theksit u jepet nxënësve të lexojnë.


*Bashkëbisedojmë:*

*Theksi i fjalisë, logjik, sintagmatik dhe emocional*

*Theksi mund të bjerë edhe mbi njësi më të mëdha se fjala, siç janë grupet emërore, grupet foljore e fjalia. Për shembull, në fjalinë: Shoqja ime lexon shpejt - fjala që shquhet më shumë është fjala **shpejt**. Ky quhet theks i fjalisë dhe zakonisht bie mbi fjalën e fundit të fjalisë. Kurse theksi logjik bie mbi fjalën që në çastin e caktuar të ligjërimit duam ta veçojmë më fort nga të tjerat për nga ana kuptimore. P.sh. **Librin** duhet të ma kthesh./Librin **duhet** të ma kthesh.*
*Kurse brenda fjalisë së mësipërme fjalët **ime** dhe **shpejt** në kuadër të grupeve **shoqja ime** dhe lexon shpejt janë ato që theksohen më shumë. Ky quhet theks sintagmatik.*
*Kemi edhe theksin emocional, i cili realizohet me zgjatje të zanoreve (Mooos, ashtu!) e të bashkëtingëlloreve (Shkatërrrrraq!) dhe shërben për t'u dhënë fjalëve ngarkesë emocionale.*

***Detyrë:***

*Lexojini këto fjali, duke e theksuar fjalën e shënuar me të zeza dhe tregoni a po vëreni ndonjë ndryshim:*

- ***Djali** erdhi nga shkolla. Djali **erdhi** nga shkolla. Djali erdhi **nga** shkolla. Djali erdhi nga **shkolla.***
- ***Eja** me mua! Eja me **mua**! Eja **me** mua!*
- ***Sot** e pashë Dritën. Sot **e pashë** Dritën. Sot e pashë **Dritën.***

*Përpiquni të aktroni emocione. Shqiptojini në mënyrë emocionale fjalët e shënuara me të zeza:*

- Ai është ***rebel***.
- Të kam thënë ***shtatë*** herë. *(inat)*
- ***Mos***.
- Sa e ***lehtë***!
- Sa qenush ***i mirë***! *(butësi)*

Shih fletoren e punës

47

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditari dypjesësh*

Nxënësit e plotësojnë ditarin dypjesësh. Në anën e majtë shënohet citati, në anën e djathtë shpjegohet.

| Citat | Koment |
|---|---|
| Theksi i fjalisë | Bie në fund të fjalës. |
| Theksi logjik | Një fjalë shqiptohet më fort. |
| Theksi emocional | Qëndrimi i folësit. |

Lexohen disa punime të nxënësve.

Lexojnë fjalitë e dhëna në detyrën I në librin bazë, duke e përdorur theksin e fjalisë sipas kërkesës.
**Djali** erdhi nga shkolla (theksi logjik në fjalën djali).
Djali **erdhi** nga shkolla (theksi logjik në fjalën erdhi).

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shqyrtim i përbashkët*

Nxënësit udhëzohen ta dallojnë theksin e fjalisë, theksin logjik në poezinë, të cilën e patën detyrë shtëpi.
Pas përfundimit, shqyrtohet si e kanë vendosur theksin. Për theksin emocional merret shembull meqë në poezi nuk ka, si psh. fjalët: gooool, shuuuumë, jooooo.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit, argumentimin e mendimit lidhur me identifikimin e theksit të fjalisë.

**Detyrë:**
(Pesëvargësh me fjalën “theksi i fjalisë”)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 26

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Theksi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon theksin. Përcakton theksin e fjalës në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 4; 3. 1, 2



*Bashkëbisedojmë:*

*Theksi i fjalisë, logjik, sintagmatik dhe emocional*

*Theksi mund të bjerë edhe mbi njësi më të mëdha se fjala, siç janë grupet emërore, grupet foljore e fjalia. Për shembull, në fjalinë: Shoqja ime lexon shpejt - fjala që shquhet më shumë është fjala* ***shpejt****. Ky quhet theks i fjalisë dhe zakonisht bie mbi fjalën e fundit të fjalisë. Kurse theksi logjik bie mbi fjalën që në çastin e caktuar të ligjërimit duam ta veçojmë më fort nga të tjerat për nga ana kuptimore. P.sh.* ***Librin*** *duhet të ma kthesh. / Librin* ***duhet*** *të ma kthesh.*
*Kurse brenda fjalisë së mësipërme fjalët* ***ime*** *dhe* ***shpejt*** *në kuadër të grupeve* ***shoqja ime*** *dhe lexon shpejt janë ato që theksohen më shumë. Ky quhet theks sintagmatik.*
*Kemi edhe theksin emocional, i cili realizohet me zgjatje të zanoreve (Mooos, ashtu!) e të bashkëtingëlloreve (Shkatërrrrraq!) dhe shërben për t'u dhënë fjalëve ngarkesë emocionale.*

*Detyrë:*

*Lexojini këto fjali, duke e theksuar fjalën e shënuar me të zeza dhe tregoni a po vëreni ndonjë ndryshim:*

- ***Djali*** *erdhi nga shkolla. Djali* ***erdhi*** *nga shkolla. Djali erdhi* ***nga*** *shkolla. Djali erdhi nga* ***shkolla.***
- ***Eja*** *me mua! Eja me* ***mua****! Eja* ***me*** *mua!*
- ***Sot*** *e pashë Dritën. Sot* ***e pashë*** *Dritën. Sot e pashë* ***Dritën.***

*Përpiquni të aktroni emocione. Shqiptojini në mënyrë emocionale fjalët e shënuara me të zeza:*

- Ai është ***rebel***.
- Të kam thënë ***shtatë*** herë. *(inat)*
- ***Mos***.
- Sa e ***lehtë***!
- Sa qenush ***i mirë***! *(butësi)*

Shih fletoren e punës

47

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Theksi i fjalisë (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krahason theksin e fjalës me theksin e fjalisë;
- Përdor theksin e fjalisë për efekt artistik;
- Vendosin theksin e fjalisë në tekst.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Disa nxënës e lexojnë detyrat e shtëpisë. Diskutohet nëse janë përdorur saktë fjalët në pesëvargësh.

Për mësimdhënësin/en



***Bashkëbisedojmë:***

***Theksi i fjalisë, logjik, sintagmatik dhe emocional***

*Theksi mund të bjerë edhe mbi njësi më të mëdha se fjala, siç janë grupet emërore, grupet foljore e fjalia. Për shembull, në fjalinë: Shoqja ime lexon shpejt - fjala që shquhet më shumë është fjala* ***shpejt****. Ky quhet theks i fjalisë dhe zakonisht bie mbi fjalën e fundit të fjalisë. Kurse theksi logjik bie mbi fjalën që në çastin e caktuar të ligjërimit duam ta veçojmë më fort nga të tjerat për nga ana kuptimore. P.sh.* ***Librin*** *duhet të ma kthesh./Librin* ***duhet*** *të ma kthesh.*
*Kurse brenda fjalisë së mësipërme fjalët* ***ime*** *dhe* ***shpejt*** *në kuadër të grupeve* ***shoqja ime*** *dhe lexon shpejt janë ato që theksohen më shumë. Ky quhet theks sintagmatik.*
*Kemi edhe theksin emocional, i cili realizohet me zgjatje të zanoreve (Mooos, ashtu!) e të bashkëtingëlloreve (Shkatërrrrraq!) dhe shërben për t'u dhënë fjalëve ngarkesë emocionale.*

***Detyrë:***

***Lexojini këto fjali, duke e theksuar fjalën e shënuar me të zeza dhe tregoni a po vëreni ndonjë ndryshim:***

- ***Djali*** *erdhi nga shkolla. Djali* ***erdhi*** *nga shkolla. Djali erdhi* ***nga*** *shkolla. Djali erdhi nga* ***shkolla.***
- ***Eja*** *me mua! Eja me* ***mua****! Eja* ***me*** *mua!*
- ***Sot*** *e pashë Dritën. Sot* ***e pashë*** *Dritën. Sot e pashë* ***Dritën.***

***Përpiquni të aktroni emocione. Shqiptojini në mënyrë emocionale fjalët e shënuara me të zeza:***

- Ai është ***rebel***.
- Të kam thënë ***shtatë*** herë. *(inat)*
- ***Mos***.
- Sa e ***lehtë***!
- Sa qenush ***i mirë***! *(butësi)*

Shih fletoren e punës

47

## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

*Diagrami i Venit*




Nxënësit pas krahasimit të theksit të fjalës me atë të fjalisë, i lexojnë shkrimet. Më pas, merren shembuj ku i argumentojnë mendimet për identifikimin e theksit të fjalës dhe të fjalisë.

## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

*Shkrim i lirë*

Nxënësit krijojnë fjali ose vargje poezie dhe në to vendosin më pas theksin e fjalisë.
Disa nga nxënësit i lexojnë shkrimet dhe e përdorin theksin logjik për lexim shprehës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për krahasimin e theksit të fjalës me atë të fjalisë, argumentimin e mendimit për vendosjen e theksit, për shkrimin dhe leximin shprehës.

**Detyrë:**
(Shpjegojnë me shkrim theksin e fjalës dhe theksin e fjalisë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 27

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2, 3; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 2; 3. 3, 4




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përmbledhja (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Bën dallimin e teksteve letrare e joletrare;
- Përcakton llojin e tekstit;
- Shpjegon duke i përdorur ato në situata të caktuara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit, kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Historia, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Nxënësve u shtrohet pyetja: Cilit nga ju i kujtohet përralla e parë që ka mësuar?
Një përgjigje e mundshme: Mua më kujtohet përralla "Kësulëkuqja".
Nxënësit i shprehin mendimet e tyre dhe i ilustrojnë ato me gojë.



**Detyrë**

— Cili është filmi ose libri yt i preferuar?

— Përmblidhe me pak fjalë këtë film ose këtë libër.

**Projekt:**

1. Ju me siguri e keni lexuar Kësulëkuqen. Shihni edhe filmin për të, nëse nuk e keni parë.

2. Tashmë që i njihni karakteret, krijoni një ngjarje të re; sikur Kësulëkuqja nis një aventurë të re.

3. Mundohuni që këtë aventurë ta ndërlidhni me zhvillimin teknologjik sot (me medie, me internet etj.).

4. Lexojini krijimet në klasë.

Shih fletoren e punës

25

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Punë në grupe*

Nxënësit e lexojnë pjesën e tekstit në heshtje dhe mendimet e tyre rreth ngjarjes i shprehin mes vete.
Nxënësit ndahen në tri grupe, secili grup përgatit përgjigje për pyetjet e dhëna në libër.
Grupi A për pyetjen e parë.
Grupi B për pyetjen e dytë.
Grupi C për pyetjen e tretë.
Pyetjet dhe përgjigjet përgatiten dhe diskutohen para klasës.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Paragraf përshkrues*

Nxënësit udhëzohen që për pak minuta të shkruajnë një ngjarje për filmin ose përrallën e tyre të preferuar.
Shkrimet lexohen para klasës dhe nxënësit e tjerë nund të bëjnë pyetje.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të saktësisë së përgjigjeve, dallimit të teksteve letrare e joletrare dhe shpjegimit të tyre.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 28

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2, 3; II. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2,3; 2.1,2; 3.2




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përmbledhja (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kombinon idetë e veta me ato që i sheh në tekst;
- Rindërton një ngjarje të caktuar;
- Përshkruan ngjarjen e caktuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit, kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë gjermane, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim i përbashkët*

Përmbledhje nga ora e kaluar - *Stuhi mendimi*
Nxënësit pyeten: Si e keni përjetuar ngjarjen e Kësulëkuqes?
Disa nga përgjigjet e mundshme: Ngjarje që e kemi dëgjuar më herët.
Nxënësit mund të japin edhe përgjigje të tjera sesi ata e kanë kuptuar personazhin e përrallës.



Detyrë

— Cili është filmi ose libri yt i preferuar?

— Përmblidhe me pak fjalë këtë film ose këtë libër.

**Projekt:**

1. Ju me siguri e keni lexuar Kësulëkuqen. Shihni edhe filmin për të, nëse nuk e keni parë.

2. Tashmë që i njihni karakteret, krijoni një ngjarje të re; sikur Kësulëkuqja nis një aventurë të re.

3. Mundohuni që këtë aventurë ta ndërlidhni me zhvillimin teknologjik sot (me medie, me internet etj.).

4. Lexojini krijimet në klasë.

Shih fletoren e punës

25

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Paragraf përshkrues*

Nxënësit plotësojnë në rubrikat e librit ose në fletore për librin ose filmin e tyre të preferuar.
Ata duhen të përmbledhin me pak fjalë filmin ose librin e tyre të preferuar dhe nëse i shprehin me fjalë t'i ndajnë në paragrafë të caktuar.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Nxënësit radhazi i shprehin mendimet e tyre për veprën më të pëlqyer që ata kanë lexuar dhe filmin më të pëlqyer që ata e kanë parë. Nxënësit e tjerë janë të lirë të bëjnë pyetje rreth ngjarjeve dhe përjetimeve të shokëve dhe shoqeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të përshkrimit dhe rindërtimit të ngjarjeve që ata kanë kombinuar në përgjigjet e dhëna.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 29

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; 2; II. 3; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.4


njësia 5
SI TË PËRMBLEDHIM?

Detyrë

I keni lexuar tashmë tekstin me Pipi Çorapegjatën dhe vjershën "Gjashtë shokët besnikë".

Lexojini edhe një herë dhe përmblidhini me më pak se 50 fjalë!

Pipi Çorapegjata

Gjashtë shokët besnikë

9

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përmbledhja (ora III)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan për tekste të caktuara;
- Përmbledh informacionin e dhënë;
- Tregon mendimin e vet për tekste të lexuara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit, kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Artet, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim i përbashkët*

Rikujtim i njohurive të mëparshme - *Stuhi mendimi*
Në projektor u shfaqet nxënësve fotografia e Pipi Çorapegjatës dhe poezia "Gjashtë shokët besnikë".
Pyeten nxënësit se si e kanë parë Pipi Çorapegjatën në vepër apo edhe në film.
Përgjigje e mundshme: Pipi si vajzë shumë luftarake që nuk u bindet urdhrave.


njësia 5
SI TË PËRMBLEDHIM?

**Detyrë**

- *I keni lexuar tashmë tekstin me Pipi Çorapegjatën dhe vjershën "Gjashtë shokët besnikë".*

  *Lexojini edhe një herë dhe përmblidhini me më pak se 50 fjalë!*

***Pipi Çorapegjata***

***Gjashtë shokët besnikë***

9

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Punë në grupe*

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup e ka liderin e vet. Grupi A dhe B shkruajnë për veprën "Pipi Çorapegjata". Grupi C dhe D për poezinë "Gjashtë shokët besnikë". Plotësohen rubrikat në fletore pune, mendimet shtesë i vazhdojnë në fletore.
Në fund të përmbledhjes i ndajnë në paragrafë të caktuar.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pyetja e sjell pyetjen*

Nxënësit mendimet e strukturuara mirë i shpalosin para klasës dhe lideri i grupit ato i demonstron me fjali e të dhëna. Mësimdhënësja mendimin dhe shkrimin më të mirë e vlerëson nga çdo grup.
Nxënësit kanë përgatitur pyetje rreth veprës dhe poezisë dhe i diskutojnë mes vete.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të shkrimeve të tyre dhe përmbajtjes së përmbledhjes që ata kanë shkruar.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 30

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** 1. 1; 2. 1, 2; III. 2, 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2,3; 2.1,2 3.4


**Detyrë**

— Cili është filmi ose libri yt i preferuar?

— Përmblidhe me pak fjalë këtë film ose këtë libër.

**Projekt:**

1. Ju me siguri e keni lexuar Kësulëkuqen. Shihni edhe filmin për të, nëse nuk e keni parë.

2. Tashmë që i njihni karakteret, krijoni një ngjarje të re; sikur Kësulëkuqja nis një aventurë të re.

3. Mundohuni që këtë aventurë ta ndërlidhni me zhvillimin teknologjik sot (me medie, me internet etj.).

4. Lexojini krijimet në klasë.

Shih fletoren e punës

25

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përmbledhja (ora IV)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Interpreton mesazh për tekste të ndryshme;
- Vë në dukje personazhe të ndryshme;
- Parashikon situata të ndryshme lidhur me ngjarje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Artet.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Prezantim digjital*

Nxënësve u prezantohet në monitor përralla "Kësulëkuqja". Nxënësit një orë më herët janë përgatitur për luajtjen në role të kësaj përralle, janë pajisur me veshje të përshtatshme për përrallën.
Rolet i kanë përcaktuar vetë sipas dëshirës së tyre.


Detyrë

— Cili është filmi ose libri yt i preferuar?

— Përmblidhe me pak fjalë këtë film ose këtë libër.

Projekt:

1. Ju me siguri e keni lexuar Kësulëkuqen. Shihni edhe filmin për të, nëse nuk e keni parë.

2. Tashmë që i njihni karakteret, krijoni një ngjarje të re; sikur Kësulëkuqja nis një aventurë të re.

3. Mundohuni që këtë aventurë ta ndërlidhni me zhvillimin teknologjik sot (me medie, me internet etj.).

4. Lexojini krijimet në klasë.

Shih fletoren e punës

25

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pyetje-përgjigje*

Nxënësit i prezantojnë inprovizimet e tyre para klasës dhe mësimdhënësja u bën pyetje rreth përrallës në fjalë. Nxënësit i përgjigjen pyetjes: Sikur Kësulëkuqja të nisë një aventurë të re dhe ta lidhim me mjetet e komunikimit sot, si do ta mendoni ju personazhin e Kësulëkuqes?
Nxënësit vazhdojnë me përgjigje të ndryshme.
Ata që nuk shprehen me gojë përgjigjet i shkruajnë në fletore dhe i prezantojnë para klasës.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Nxënësit në këtë fazë të orës diskutojnë për pyetjet që i bëjnë njëri-tjetrit dhe pyetjen e mësimdhënësit. Ata që kanë dhënë përgjigjet në fletore i lexojnë para klasës mendimet e tyre dhe të tjerët janë të lirë të bëjnë pyetje rreth asaj që dëgjojnë nga shokët e shoqet e klasës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas saktësisë së përgjigjeve dhe interpretimit të roleve si personazhe të caktuara që aktruan.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 31

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2. 3, II: 2. 3, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 13
INTONACIONI

***Lexojeni dialogun.***

- A doni ndonjë shërbëtor, zotëri?
- Jo, hëpërhë kam dy shërbëtorë.
- A mund t'ju shërbej disi?
- Jo, nuk ka mundësi.
- Oh, sa keq! Në fakt unë do të dëshiroja të vija me ju në Amerikë.
- Ah! Ju nuk jeni japonez! Përse jeni veshur kështu?
- Vërtet unë jam francez.
- A mund të bëni një fytyrë qesharake?
- Natyrisht.

Zhyl Vern "Rreth botës për 80 ditë"

***Çka vutë re te toni i zërit tuaj? Ishte i njëtrajtshëm apo i ndryshueshëm? Si e dallojmë këtë në të shkruar?***

***Bashkëbisedojmë:***

– *Intonacion quajmë uljen dhe ngritjen e zërit gjatë të folurit. Ky ndryshim i tonit të zërit formon intonacionin e fjalisë.*

– *Përmes intonacionit, folësi shpreh qëndrimin e tij në raport me bashkëbiseduesin, emocione dhe ndjenja të ndryshme gëzimi dhe hidhërimi. Intonacioni ka funksion gjuhësor për t'i dalluar, për shembull, fjalitë e ndryshme për nga kumtimi apo qëllimi i thënies.*

48

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon tingujt;
- Lexon tekste me intonacion;
- Analizon tekste të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinatë e drejtuar*
Nxënësit në fillim do ta lexojnë dialogun e paraqitur në librin "Rreth botës për 80 ditë" nga Zhyl Verni.
- *A doni ndonjë shërbëtor, zotëri?*
- *Ja, hëpërhë kam dy shërbëtorë.*
- *A mund t'ju shërbej disi?*
- *Jo, nuk ka mundësi.*
- *Oh, sa keq! Në fakt unë do të dëshiroja të vija me ju në Amerikë.*
- *Ah! Ju nuk jeni japonez! Përse jeni veshur kështu?*
- *Vërtet unë jam francez.*
- *A mund të bëni një fytyrë qesharake?*
- *Natyrisht.*



njësia 13
INTONACIONI

*Lexojeni dialogun.*

- A doni ndonjë shërbëtor, zotëri?
- Jo, hëpërhë kam dy shërbëtorë.
- A mund t'ju shërbej disi?
- Jo, nuk ka mundësi.
- Oh, sa keq! Në fakt unë do të dëshiroja të vija me ju në Amerikë.
- Ah! Ju nuk jeni japonez! Përse jeni veshur kështu?
- Vërtet unë jam francez.
- A mund të bëni një fytyrë qesharake?
- Natyrisht.

Zhyl Vern "Rreth botës për 80 ditë"

***Çka vutë re te toni i zërit tuaj? Ishte i njëtrajtshëm apo i ndryshueshëm? Si e dallojmë këtë në të shkruar?***

***Bashkëbisedojmë:***

- *Intonacion quajmë uljen dhe ngritjen e zërit gjatë të folurit. Ky ndryshim i tonit të zërit formon intonacionin e fjalisë.*
- *Përmes intonacionit, folësi shpreh qëndrimin e tij në raport me bashkëbiseduesin, emocione dhe ndjenja të ndryshme gëzimi dhe hidhërimi. Intonacioni ka funksion gjuhësor për t'i dalluar, për shembull, fjalitë e ndryshme për nga kumtimi apo qëllimi i thënies.*

48

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Diskutim i përbashkët*

Pas leximit me zë të lartë, mësimdhënësi pyet nxënësit se çka vërejtën gjatë leximit të dialogut.

Një nga përgjigjet mund të jetë:
*Unë vërejta që gjatë leximit zëri ynë bën ulje dhe ngritje.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Mësimdhënësi jep disa infromacione për intonacionin duke lexuar edhe shembuj.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të tingujve dhe përdorimin e intonacionit.

**Detyrë:**
(Detyrë në *Fletore pune*, faqe 29)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 32

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2. 3, II: 2. 3, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 13
INTONACIONI

◇ *Formoni nga një fjali **dëftore, pyetëse** e **nxitëse** dhe lexoni me zë. Flitni për ndryshimin e intonacionit.*

◇ *Përcaktoni llojin e fjalisë dhe vendosni shenjat e pikësimit. Paraqiteni intonacionin me anë të skemës.*

- *Unë kam një koleksion me pulla postare*
- *Mos e prek*
- *Ç'do të bëjmë pasdite*

◇ *Shkruani nga një fjali që shpreh: **urim, urdhër, pyetje**. Lexoni me intonacionin e duhur.*

*Urim:* ____________________

*Urdhër:* ____________________

*Pyetje:* ____________________

◇ *Formoni një fjali dhe lexojeni me intonacione të ndryshme.*

◇ *Shqiptoni me intonacionin e duhur fjalitë. Në cilin rast intonacioni shërben si mjet i vetëm gramatikor?*

*A. a. Ishte shumë i gëzuar.*
*b. Sa i gëzuar ishte!*
*c. Ishte shumë i gëzuar?*

*B. a. Filloi loja.*
*b. Filloi loja!*
*c. Filloi loja?*

◇ *Dëgjoni një folës/e lajmesh dhe një pjesë humori. Krahasoni këto dy situata të komunikimit, duke përcaktuar rolin e intonacionit.*

***Detyrë***

◇ *Kërkoni në Fjalorin e Gjuhës Shqipe fjalët **fonemë, rrokje, theks, intonacion.***

◇ *Kërkoni në fjalor nga një fjalë të re që fillon me shkronjën **c, ç, d, dh, e** dhe **ë**.*

29

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon intonacionin e fjalive të ndryshme;
- Lexon tekste me intonacion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Ora fillon me leximin e detyrave në *Fletore pune,* faqe 29.

*Përcaktoni llojin e fjalisë dhe vendosni shenjat e pikësimit.*

- *Unë kam një koleksion me pulla postare.*
- *Mos e prek!*
- *Ç'do të bëjmë pasdite?*


njësia 13
INTONACIONI

*Lexojeni dialogun.*

- A doni ndonjë shërbëtor, zotëri?
- Jo, hëpërhë kam dy shërbëtorë.
- A mund t'ju shërbej disi?
- Jo, nuk ka mundësi.
- Oh, sa keq! Në fakt unë do të dëshiroja të vija me ju në Amerikë.
- Ah! Ju nuk jeni japonez! Përse jeni veshur kështu?
- Vërtet unë jam francez.
- A mund të bëni një fytyrë qesharake?
- Natyrisht.

Zhyl Vern "Rreth botës për 80 ditë"

***Çka vutë re te toni i zërit tuaj? Ishte i njëtrajtshëm apo i ndryshueshëm? Si e dallojmë këtë në të shkruar?***

***Bashkëbisedojmë:***

- *Intonacion quajmë uljen dhe ngritjen e zërit gjatë të folurit. Ky ndryshim i tonit të zërit formon intonacionin e fjalisë.*
- *Përmes intonacionit, folësi shpreh qëndrimin e tij në raport me bashkëbiseduesin, emocione dhe ndjenja të ndryshme gëzimi dhe hidhërimi. Intonacioni ka funksion gjuhësor për t'i dalluar, për shembull, fjalitë e ndryshme për nga kumtimi apo qëllimi i thënies.*

48

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditarët e të nxënit*

Nxënësit do të punojnë në tabelë citim/ koment. Ata do ta lexojnë pjesën e paraqitur në libër dhe udhëzohen të bëjnë nënvizime në pjesët që u bën përshtypje.

| Citim | Koment |
|---|---|
| Intonacion quajmë uljen dhe ngritjen e zërit gjatë të folurit. Nëse intonacioni në fillim të fjalës është i ulët dhe shkon duke u ngritur, fjalia është pyetëse. | Ky ndryshim i tonit të zërit formon intonacionin e fjalisë. |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shënime shtesë*

Intonacioni dhe theksi janë aktorë të rëndësishëm të të folurit. Në të folur nuk ka shenja të pikësimit, ato i manifestohen përmes intonacionit, tonit a theksit etj.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të tingujve dhe përdorimin e intonacionit gjatë leximit.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë tekste të ndryshme duke i respektuar shenjat e pikësimit)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 33

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon tingujt, rrokjen, theksin, intonacionin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2. 3, II: 2. 3, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



*P.sh., nëse intonacioni në fillim të fjalisë është i ulët dhe shkon duke u ngritur, fjalia është pyetëse.*

- *Për ku je nisur?*
- *A do të ndalemi për të pushuar diku?*
- *Sa veta do të udhëtojmë?*

*Ndryshe ndodh te fjalia dëftore, tek e cila intonacioni pëson ndryshim të tillë të intonacionit: ulje - ngritje - ulje.*

- *Më pëlqen të rri ulur nën hijen e pemës.*
- *Të gjithë u ulëm për të pushuar pas asaj ecjeje të gjatë.*
- *Ai nisi ta thërriste me zë të lartë emrin tim.*

*Te fjalia nxitëse, intonacioni është më i lartë në fillim të fjalisë dhe në fund zbret.*

- *Shko menjëherë te mjeku!*
- *Mos e kalo rrugën pa shikuar majtas e djathtas!*
- *Ejani shpejt tek unë!*

***Projekt:***

*Organizoni një orë letrare në klasë. Të gjithë nxënësit le të lexojnë shkrimet e tyre: tregime, drama, poezi etj. Në fund, analizoni rolin e intonacionit gjatë interpretimit.*

Shih fletoren e punës

49

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Intonacioni

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon intonacionin e fjalëve të ndryshme;
- Lexon qartë e pa gabime me intonacionin e duhur, duke i respektuar shenjat e pikësimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Projekt*

Nxënësit do ta bëjnë paraqitjen e projekteve të tyre.
Ata në detyrë shtëpie do të shkruajnë tekste të ndryshme duke i respektuar shenjat e pikësimit.



P.sh., nëse intonacioni në fillim të fjalisë është i ulët dhe shkon duke u ngritur, fjalia është pyetëse.

- Për ku je nisur?
- A do të ndalemi për të pushuar diku?
- Sa veta do të udhëtojmë?

Ndryshe ndodh te fjalia dëftore, tek e cila intonacioni pëson ndryshim të tillë të intonacionit: ulje - ngritje - ulje.

- Më pëlqen të rri ulur nën hijen e pemës.
- Të gjithë u ulëm për të pushuar pas asaj ecjeje të gjatë.
- Ai nisi ta thërriste me zë të lartë emrin tim.

Te fjalia nxitëse, intonacioni është më i lartë në fillim të fjalisë dhe në fund zbret.

- Shko menjëherë te mjeku!
- Mos e kalo rrugën pa shikuar majtas e djathtas!
- Ejani shpejt tek unë!

**Projekt:**

Organizoni një orë letrare në klasë. Të gjithë nxënësit le të lexojnë shkrimet e tyre: tregime, drama, poezi etj. Në fund, analizoni rolin e intonacionit gjatë interpretimit.

Shih fletoren e punës

49

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari krijuese*

Disa nxënës kanë shkruar tregime, disa poezi dhe dikush nga ta dramë.

Një nga poezitë e mundshme do të ishte kjo:

*Qenush i bukur,*
*me bishtin përpjetë.*
*Ku po shkon,*
*ti tatëpjetë.*

*Të zotin ku e ke?*
*I vetëm je?*
*Mos ke humbur vallë?*
*Për të ke mall?*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Përmbledhje në dyshe*

Në përfundim të orës nxënësit do ta bëjnë një përmbledhje të të gjithë njësisë duke i bërë edhe disa shembuj në tabelë.
*Po shkon? (pyetëse)*
*Erdhi. (pohore)*
*Erdhi? (pyetëse)*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të tingujve dhe përdorimin e intonacionit gjatë leximit.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________

______________________

# Mësimi 34

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Leksikologji

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Pasuron fjalorin dhe njeh kuptimin e fjalës.
Dallon dhe përdor fjalë me kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm.
Dallon dhe përdor fjalët me shumë kuptime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 5; II. 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 4; 3. 2.


njësia 17

FJALA DHE KUPTIMET E SAJ

Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë
kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti
gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt
pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk
heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët: **i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon **sende** e **dukuri.** Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë **kuptimi gramatikor** dhe **kuptimi leksikor.***

63

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon fjalën dhe kuptimin e saj;
- Përdor fjalë me kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, fletë me ngjyra, tabela.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Fjalori gjuhësor, Letërsi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Harta e konceptit/ e përkufizimit*

Shkruhet një fjalë-koncept, shembull fjalën *faqe* në mes të tabelës dhe pyeten nxënësit për kuptimin e saj.
Nga përgjigjet e marra analizohen nëse nxënësit mund ta dallojnë fjalën si njësi gjuhësore dhe kuptimet e saj.
Pastaj, mund të shkruajnë edhe disa fjalë në tabelë që lidhen me kuptimin e fjalës *faqe*, si në modelin e mëposhtëm:

faqe mali ----------------------Faqe-----------------faqe libri



***Kuptimi gramatikor*** *i përfshin të gjitha fjalëformat e fjalës në një fjali të dhënë, për shembull, në fjalinë më poshtë, trajta e gjinores (e nënvizuar) e shpreh kuptimin e përkatësisë së shtëpisë.*

*Atje është shtëpia* ***e vajzës****.*

***Kuptimi leksikor*** *është vetë kuptimi i morfemës apo fjalës bazë që shpreh diçka dhe përbën anën më thelbësore të fjalës, si shembull, më poshtë po e japim kuptimin leksikor të fjalës* ***shtëpi****:*

| *fjala* | *Shtëpi* |
|---|---|
| kuptimi leksikor | Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje); banesë; apartament ku banon një familje. |

*Kuptimi leksikor ndahet tutje në kuptim parësor (të drejtpërdrejtë) dhe në kuptim dytësor (të figurshëm).*

- *Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor apo i drejtpërdrejtë që ajo shpreh. Për shembull, në fjalinë: E dëgjova me* ***veshët*** *e mi - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin denotativ (parësor), pasi u referohet drejtpërdrejt organeve të dëgjimit.*
- *Kuptimi i figurshëm është kuptimi dytësor i fjalës që sugjerohet ose nënkuptohet. Për shembull, në fjalinë: I vari (i uli) veshët - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin e figurshëm (dytësor), pasi në këtë kontekst nënkupton dikë që nuk mburret më, nuk shet mend më.*
- *Disa fjalë kanë më shumë kuptime dhe kjo quhet polisemi.*
- *Për shembull, fjala* ***bisht*** *ka dy e më shumë kuptime leksikore, pra është fjalë polisemike (shumëkuptimëshe). Në fjalor, fjala* ***bisht*** *del me 13 kuptime, por këtu po i japim 3 prej tyre:*

| | |
|---|---|
| 1 | Pjesa e zgjatur në fund të kurrizit të kafshëve, që është e lëvizshme dhe zakonisht e mbuluar me qime të gjata te kafshët e mëdha; ana e prapme e trupit të shpendëve e mbuluar me një tufë puplash; copa e mishit që pritet nga kjo pjesë e kafshëve ose e shpendëve. Bisht dhelpre. |
| 2 | Pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me degën a me kërcellin e një bime. Bishti i dardhës. |
| 3 | Pjesë e një vegle a e një mjeti, shkop i ngulur në pjesën tjetër a i mbërthyer me të ose pjesë e zgjatur si shkop, që shërben si dorezë. Bishti i lopatës. |

Shih fletoren e punës



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analiza e tipareve semantike*

U japim nxënësve fletëza me ngjyra, të cilat i përzgjedhin sipas dëshirës; në to është shkruar nga një fjalë dhe kuptimi i tyre është dhënë gabimisht.
Kërkohet që ta gjejnë kuptimin e saktë të fjalës dhe ta shënojnë në anën e kundërt të fletëzës, si dhe t`i përcaktojnë pjesët e ligjëratës dhe kategoritë e tyre gramatikore.
Nëpërmjet kësaj shpjegohen kuptimet gramatikore dhe leksikore të fjalëve.

Fjalët e analizuara janë përdorur në kuptimin e tyre parësor, ndërsa kuptimt e tyre mund të jenë të shumta në kontekste të ndryshme. Kështu, fjalëve të caktuara nxënësit duhet të bëjnë përpjekje t`ua gjejnë kuptimet dytësore ose të figurshme. Pastaj, bashkë me mësimdhënësin/ en diskutojnë për kuptimet e gjetura të fjalëve.

Shembull: *verë* - stinë viti     *verë* - pije

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ruaje fjalën e fundit për mua*

Ndahen nxënësit në grupe dhe u jepet nga një fletë e bardhë, në të cilën duhet ta shkruajnë nga një fjalë të zgjedhur dhe t`i japin disa kuptime përdorimit të saj në kontekste të ndryshme, qoftë parësore ose kuptime të figurshme.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen në bazë të reflektimit të tyre për njohuritë e zotëruara për fjalën, si dhe përdorimin e tyre me kuptime të drejtpërdrejta e të figurshme.

**Detyrë:**
(Të hulumtojnë në Fjalorin e Gjuhës shqipe dhjetë fjalë sipas alfabetit, duke i paraqitur edhe kuptimet e tyre)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 35

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Pasuron fjalorin dhe e njeh kuptimin e fjalës. Dallon dhe përdor në fjali kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm. Dallon dhe përdor në fjali fjalët me shumë kuptime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 17
FJALA DHE KUPTIMET E SAJ
Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë
kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti
gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt
pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk
heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët:* ***i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon* ***sende*** *e* ***dukuri.*** *Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë* ***kuptimi gramatikor*** *dhe* ***kuptimi leksikor.***

63

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kuptimin e figurshëm të fjalës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë gjermane, Gjuhë angleze.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Në fillim të orës nxënësit pyeten për njohuritë paraprake që kanë për njësinë.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël. | | |



njësia 17

FJALA DHE KUPTIMET E SAJ

Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët:* ***i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon* ***sende*** *e* ***dukuri.*** *Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë* ***kuptimi gramatikor*** *dhe* ***kuptimi leksikor.***

63

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit punojnë në dyshe dhe do të shtrojnë pyetje se çfarë duan të mësojnë më shumë për të.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël. | Sa lloje të kuptimit të fjalës janë? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova më shumë*

Te rubrika mësova më shumë shtohen ato që nxënësit i mësuan gjatë leximit dhe shpjegimit nga mësimdhënësi.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël. | Sa lloje të kuptimit të fjalës janë? | Kemi kuptimin gramatikor dhe kuptimin leksikor. |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të kuptimeve të fjalës.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 36

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Pasuron fjalorin dhe e njeh kuptimin e fjalës. Dallon dhe përdor në fjali kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm. Dallon dhe përdor në fjali fjalët me shumë kuptime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2


njësia 16
FJALA DHE KUPTIMET E SAJ

**Detyrë**

1. A është fjala njësi kuptimplote?
2. Sa lloje të kuptimit të fjalës janë?
3. Çka është polisemia?
4. Çka shpreh kuptimi i figurshëm i fjalës?

**Detyrë**

◇ Tregoni kuptimet leksikore të fjalëve të dhëna:

a. guximtar
b. përballë
c. tradicional
d. modern
e. vesë
f. sinqeritet
g. dilemë
h. përpiqem
i. theksoj

◇ Tregojeni kuptimin leksikor të fjalës **verë** në fjalitë më poshtë (shikojeni fjalorin dhe shënoni kuptimin e fjalës **verë** në fjalinë e parë dhe kuptimin e fjalës **verë** në fjalinë e dytë):

a. Vera që shërbehej në restorant ishte e moçme.
b. Vera është stina më e nxehtë e vitit.

a. ____________________

b. ____________________

35

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kuptimin e figurshëm të fjalës;
- Jep shembuj të fjalëve me kuptim të figurshëm;
- Tregon kuptimin leksikor të fjalëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptopi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë gjermane, Gjuhë angleze.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Analiza e tipareve semantike*

Nxënësit bashkë me mësimdhënësin do t'i plotësojnë detyrat e dhëna në faqe 35 dhe 36 në librin fletore pune. Ata do ta gjejnë kuptimin leksikor të fjalëve të dhëna.



***Kuptimi gramatikor*** *i përfshin të gjitha fjalëformat e fjalës në një fjali të dhënë, për shembull, në fjalinë më poshtë, trajta e gjinores (e nënvizuar) e shpreh kuptimin e përkatësisë së shtëpisë.*

*Atje është shtëpia* ***e vajzës****.*

***Kuptimi leksikor*** *është vetë kuptimi i morfemës apo fjalës bazë që shpreh diçka dhe përbën anën më thelbësore të fjalës, si shembull, më poshtë po e japim kuptimin leksikor të fjalës* ***shtëpi****:*

| fjala | Shtëpi |
|---|---|
| kuptimi leksikor | Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje); banesë; apartament ku banon një familje. |

*Kuptimi leksikor ndahet tutje në kuptim parësor (të drejtpërdrejtë) dhe në kuptim dytësor (të figurshëm).*

- *Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor apo i drejtpërdrejtë që ajo shpreh. Për shembull, në fjalinë: E dëgjova me* ***veshët*** *e mi - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin denotativ (parësor), pasi u referohet drejtpërdrejt organeve të dëgjimit.*
- *Kuptimi i figurshëm është kuptimi dytësor i fjalës që sugjerohet ose nënkuptohet. Për shembull, në fjalinë: I vari (i uli) veshët - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin e figurshëm (dytësor), pasi në këtë kontekst nënkupton dikë që nuk mburret më, nuk shet mend më.*
- *Disa fjalë kanë më shumë kuptime dhe kjo quhet polisemi.*
- *Për shembull, fjala* ***bisht*** *ka dy e më shumë kuptime leksikore, pra është fjalë polisemike (shumëkuptimëshe). Në fjalor, fjala* ***bisht*** *del me 13 kuptime, por këtu po i japim 3 prej tyre:*

| | |
|---|---|
| 1 | Pjesa e zgjatur në fund të kurrizit të kafshëve, që është e lëvizshme dhe zakonisht e mbuluar me qime të gjata te kafshët e mëdha; ana e prapme e trupit të shpendëve e mbuluar me një tufë puplash; copa e mishit që pritet nga kjo pjesë e kafshëve ose e shpendëve. Bisht dhelpre. |
| 2 | Pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me degën a me kërcellin e një bime. Bishti i dardhës. |
| 3 | Pjesë e një vegle a e një mjeti, shkop i ngulur në pjesën tjetër a i mbërthyer me të ose pjesë e zgjatur si shkop, që shërben si dorezë. Bishti i lopatës. |

Shih fletoren e punës

64

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegimi i përparuar*

Mësimdhënësi do ta sqarojë dallimin midis kuptimit gramatikor dhe kuptimit leksikor të fjalës.

*- Kuptimi leksikor përbën anën thelbësore të saj, ndërsa kuptimi gramatikor i përfshin fjalëformimet e saj.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Në dyshe nxënësit do të shkruajnë shembuj me fjalëformim.

*Farefis (farë e fis)*
*Gjëegjëzë (gjë e gjëzë)*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të kuptimeve të fjalës.

**Detyrë:**
(Të gjejnë fjalë të reja me më shumë se një kuptim në fjalor)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 37



njësia 17

FJALA DHE KUPTIMET E SAJ

Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë
kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti
gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt
pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk
heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët: **i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon **sende** e **dukuri.** Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë **kuptimi gramatikor** dhe **kuptimi leksikor.***

63

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Pasuron fjalorin dhe e njeh kuptimin e fjalës. Dallon dhe përdor në fjali kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm. Dallon dhe përdor në fjali fjalët me shumë kuptime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjala dhe kuptimet e saj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kuptimin e figurshëm të fjalës;
- Jep shembuj të fjalëve me kuptim të figurshëm;
- Tregon kuptimin leksikor të fjalëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teatër.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do të bëjnë përsëritje të njësisë, ku dhe do t'i lexojnë detyrat e bëra në shtëpi.
Shembujt që mund të ishin:
*Tejkalim*
*Jugor*
*Përqindje*



***Kuptimi gramatikor*** *i përfshin të gjitha fjaléformat e fjalës në një fjali të dhënë, për shembull, në fjalinë më poshtë, trajta e gjinores (e nënvizuar) e shpreh kuptimin e përkatësisë së shtëpisë.*

*Atje është shtëpia* ***e vajzës****.*

***Kuptimi leksikor*** *është vetë kuptimi i morfemës apo fjalës bazë që shpreh diçka dhe përbën anën më thelbësore të fjalës, si shembull, më poshtë po e japim kuptimin leksikor të fjalës* ***shtëpi****:*

| ***fjala*** | ***Shtëpi*** |
|---|---|
| kuptimi leksikor | Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje); banesë; apartament ku banon një familje. |

*Kuptimi leksikor ndahet tutje në kuptim parësor (të drejtpërdrejtë) dhe në kuptim dytësor (të figurshëm).*

- *Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor apo i drejtpërdrejtë që ajo shpreh. Për shembull, në fjalinë: E dëgjova me* ***veshët*** *e mi - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin denotativ (parësor), pasi u referohet drejtpërdrejt organeve të dëgjimit.*
- *Kuptimi i figurshëm është kuptimi dytësor i fjalës që sugjerohet ose nënkuptohet. Për shembull, në fjalinë: I vari (i uli) veshët - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin e figurshëm (dytësor), pasi në këtë kontekst nënkupton dikë që nuk mburret më, nuk shet mend më.*
- *Disa fjalë kanë më shumë kuptime dhe kjo quhet polisemi.*
- *Për shembull, fjala* ***bisht*** *ka dy e më shumë kuptime leksikore, pra është fjalë polisemike (shumëkuptimëshe). Në fjalor, fjala* ***bisht*** *del me 13 kuptime, por këtu po i japim 3 prej tyre:*

| | |
|---|---|
| 1 | Pjesa e zgjatur në fund të kurrizit të kafshëve, që është e lëvizshme dhe zakonisht e mbuluar me qime të gjata te kafshët e mëdha; ana e prapme e trupit të shpendëve e mbuluar me një tufë puplash; copa e mishit që pritet nga kjo pjesë e kafshëve ose e shpendëve. Bisht dhelpre. |
| 2 | Pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me degën a me kërcellin e një bime. Bishti i dardhës. |
| 3 | Pjesë e një vegle a e një mjeti, shkop i ngulur në pjesën tjetër a i mbërthyer me të ose pjesë e zgjatur si shkop, që shërben si dorezë. Bishti i lopatës. |

Shih fletoren e punës

64

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Punë në grupe*

Nxënësit do të ndahen në grupe. Ata do të krijojnë fjalë të reja, nga kuptimi i parë i fjalës *punë*.




**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Mësimdhënësi bashkë me nxënësit e shfletojnë fjalorin e Gjuhës Shqipe. Me këtë rast, nxënësit do të mësojnë edhe se si të përdoret fjalori nëse atyre do t'u duhet në të ardhmen.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të kuptimeve të fjalës.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Për mësimdhënësin/en

# Mësimi 38

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan sipas modeleve të teksteve joletrare urime, informata, lutje, kërkesë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



njësia 6

SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*

**1**

I nderuari zoti drejtor,

Jam një nxënës i shkollës “Ismail Qemali”. Po Ju shkruaj me lutjen që të më mundësohet regjistrimi në bibliotekën e shkollës, në mënyrë që të shfrytëzoj lektyrat e klasës së gjashtë.
Me shpresën që dëshira ime të shqyrtohet,

Juaji
Agon Gashi, nxënës i klasës VI/2

**2**

E dashura zonja Dritë,

Çelësin e shtëpisë e keni tek unë. E ka lënë Agimi. Unë do të jem në shtëpi gjithë kohën.

Goni

**3** A po dalim me lujtë futboll? 😉⚽

***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të shkruajmë mesazhe?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon gjuhën e përdorur në shkrimet zyrtare, si: ftesa, kërkesa, njoftime etj.;
- Harton ftesa, kërkesa, njoftime etj.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*
Paraqitet një ftesë.
Pyetjet:
Cila është përmbajtja e shkrimit?
Është zyrtare apo shoqërore gjuha që është shkruar kjo ftesë?
Cilat janë elementet që përmban kjo ftesë?
Përgjigjet e mundshme:
Është ftesë për ditëlindje.
Gjuha e përdorur është zyrtare.
Data, ora, vendi, arsyeja e ftesës dhe emrat e të ftuarve.




Për mësimdhënësin/en



njësia 6

SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*

1

I nderuari zoti drejtor,

Jam një nxënës i shkollës "Ismail Qemali". Po Ju shkruaj me lutjen që të më mundësohet regjistrimi në bibliotekën e shkollës, në mënyrë që të shfrytëzoj lektyrat e klasës së gjashtë.
Me shpresën që dëshira ime të shqyrtohet,

Juaji
Agon Gashi, nxënës i klasës VI/2

2

E dashura zonja Dritë,

Çelësin e shtëpisë e keni tek unë. E ka lënë Agimi. Unë do të jem në shtëpi gjithë kohën.

Goni

3

A po dalim me lujtë futboll? 😉⚽

***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Teknika e pyetjeve të një tregimi*

Teksti lexohet me tri ndalesa.

Pyetjet pas ndalesës së parë:
Kujt i drejtohet kjo ftesë?
Çfarë gjuhe është përdorur?

Pyetjet pas ndalesës së dytë:
Kujt i drejtohet kjo ftesë?
Çfarë gjuhe është përdorur?

Pyetjet pas ndalesës së tretë:
Kujt i drejtohet kjo ftesë?
Çfarë gjuhe është përdorur?

Bashkëbisedohet rreth stileve të komunikimit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Kërkesë:
Zgjedh një person dhe shkruaj një mesazh.

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e analizimit të gjuhës së përdorur në mesazhet e ndryshme si dhe në strukturën e plotë të një mesazhi.

**Detyrë:**
(Shkruaj një ftesë për ditëlindjen tënde)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 39

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan sipas modeleve të teksteve joletrare urime, informata, lutje, kërkesë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



njësia 6

SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*



***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të shkruajmë mesazhe - ushtrime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon format si shkruhet një ftesë, kërkesë apo njoftim;
- Harton ftesë, kërkesë apo njoftim.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Rrjeti i diskutimit*

Lexohen disa nga punimet e nxënësve që kanë pasur për detyrë shtëpie.
Pyetjet për diskutim:
A i plotëson mesazhi të gjitha kërkesat?
A është përdorur gjuha e nevojshme sipas përmbajtjes?
A është respektuar forma, struktura e mesazhit?



njësia 6

SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*

1

I nderuari zoti drejtor,

Jam një nxënës i shkollës "Ismail Qemali". Po Ju shkruaj me lutjen që të më mundësohet regjistrimi në bibliotekën e shkollës, në mënyrë që të shfrytëzoj lektyrat e klasës së gjashtë.
Me shpresën që dëshira ime të shqyrtohet,

Juaji
Agon Gashi, nxënës i klasës VI/2

2

E dashura zonja Dritë,

Çelësin e shtëpisë e keni tek unë. E ka lënë Agimi. Unë do të jem në shtëpi gjithë kohën.

Goni

3

A po dalim me lujtë futboll?

***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shkrim i lirë*

Ndahen në gjashtë grupe treshe e katërshe.
Detyrat e grupeve:
Gr. 1: Kërkesë drejtuar drejtorit të shkollës.
Gr. 2: Njoftim për ekspozitën me rastin e ditës së shkollës.
Gr. 3: Ftesë arsimtarëve për në ekspozitë.
Gr. 4: Një urim shokut për ditëlindje.
Gr. 5: Një urim gjyshes për ditëlindje.
Gr. 6: Një falënderim drejtorit për ardhjen në ekspozitë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Turi i galerisë*

Grupet ngjitin në mure punimet e tyre.
Secili grup e viziton punimin e grupeve të tjera duke shkruar një lëvdatë dhe një kritikë.

Secili grup e lexon punimin e vet si dhe komentet e grupeve të tjera.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të formave të mesazheve dhe në saktësinë e shkrimit të mesazheve.

**Detyrë:**
(Shkruani një urim)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 40

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan sipas modeleve të teksteve joletrare urime, informata, lutje, kërkesë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



njësia 8
SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*

1
I nderuari zoti drejtor,
Jam një nxënës i shkollës "Ismail Qemali". Po Ju shkruaj me lutjen që të më mundësohet regjistrimi në bibliotekën e shkollës, në mënyrë që të shfrytëzoj lektyrat e klasës së gjashtë.
Me shpresën që dëshira ime të shqyrtohet,
Juaji
Agon Gashi, nxënës i klasës VI/2

2
E dashura zonja Dritë,
Çelësin e shtëpisë e keni tek unë. E ka lënë Agimi. Unë do të jem në shtëpi gjithë kohën.
Goni

3
A po dalim me lujtë futboll?

***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të shkruajmë mesazhe - kërkesa

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kërkesën nga format e tjera të mesazhit;
- Harton kërkesën sipas rregullave të shkrimit të një kërkese.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqiten tri fotografi.
Pyetjet:
Çfarë paraqesin secila nga fotografitë?
Ku dallojnë njëra nga tjetra?
Përgjigjet e mundshme:
E para është ftesë, e dyta kërkesë, e treta falënderim.
Nga përmbajtja dhe forma e shkrimit.









njësia 6
SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*



***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Të lexuarit ndërveprues*

Paraqitet një kërkesë përmes projektorit.



Diskutohet rreth përmbajtjes, formës të së shkruarit, gjuhës së përdorur dhe gjatësisë së shkrimit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Kërkesë:
Shkruani një kërkesë sipas rregullave të kërkuara.
Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të elementeve të kërkesës nga mesazhet e tjera si dhe hartimin e saktë të kërkesës.

**Detyrë:**
(Shkruani një kërkesë kujdestarit të klasës)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 41

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Njoftime, ftesa, falënderime, urime, pjesë humoristike, raporte, informata, kërkesë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan sipas modeleve të teksteve joletrare urime, informata, lutje, kërkesë etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


njësia 8
SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*

1

I nderuari zoti drejtor,

Jam një nxënës i shkollës "Ismail Qemali". Po Ju shkruaj me lutjen që të më mundësohet regjistrimi në bibliotekën e shkollës, në mënyrë që të shfrytëzoj lektyrat e klasës së gjashtë.
Me shpresën që dëshira ime të shqyrtohet,

Juaji
Agon Gashi, nxënës i klasës VI/2

2

E dashura zonja Dritë,

Çelësin e shtëpisë e keni tek unë. E ka lënë Agimi. Unë do të jem në shtëpi gjithë kohën.

Goni

3

A po dalim me lujtë futboll?

***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të shkruajmë mesazhe - Njoftimet

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon njoftimin nga format e tjera të mesazhit;
- Harton njoftimin sipas rregullave të shkrimit të një njoftimi.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*
Paraqiten tri fotografi.
Pyetjet:
Çfarë paraqesin secila nga fotografitë?
Ku dallojnë njëra nga tjetra?
Përgjigjet e mundshme:
E para është ftesë, e dyta kërkesë, e treta njoftim.
Nga përmbajtja dhe forma e shkrimit.


Me rastin e 175 vjetorit të ditëlindjes dhe 120 vjetorit të kalimit nga jeta të Naim Frashërit, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, organizon veprimtarinë në kuadrin e "Vitit të Naimit", në ambientet e Kryegjyshatës "Takim me poetët".
Po në këtë datë, përkujtohet edhe 40 vjetori i kalimit nga jeta, ish-Kryegjyshit Botëror Dede Ahmet Myftari, ditën e premte, datë 10 korrik 2020, ora 18:00
Pjesëmarrja juaj na nderon.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

NJOFTIM

Njoftohen të gjitha subjektet që kanë paraqitur Ankim Administrativ pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut se:

1. **Në datën 14.05.2021 Ora : 12:00 do të zhvillohet Komisioni i Ankimit** sipas Urdhërit Nr. 52 datë 16.07.2018 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurave të hollësishme të shqyrtimit të Ankimit Administrativ nga Komisioni i Ankimit pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut".
2. **Komisioni do të zhvillohet në ambientet e** Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me adresë: Rruga "Shyqyri Bërxolli", Nr 65, Tiranë.





njësia 6

SI TË SHKRUAJMË MESAZHE?

*Goni duhet t'i shkruajë tri mesazhe. Do t'i dërgojë një kërkesë drejtorit të shkollës, do t'i shkruajë një pusullë fqinjit dhe do t'i çojë mesazh me telefon shokut të tij më të ngushtë.*

*Ja si ka shkruar Goni:*



***Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit***

*Siç po mund të shihet, Goni ka përdorur zgjedhje të ndryshme fjalësh në të tri tekstet. Në tekstin e parë, ai ka bërë një kërkesë zyrtare. Prandaj, ka përdorur gjuhë formale - gjuhë standarde dhe me stil formal (po Ju shkruaj; duke shpresuar që dëshira ime të shqyrtohet).*
*Teksti i dytë është një pusullë për një fqinje, e cila është më e vjetër. Goni këtu shkruan me rregullat e mirësjelljes, duke tu drejtuar së vjetrës me Ju dhe me zonja Dritë.*
*Në tekstin e tretë, ai i drejtohet shokut të tij në mënyrë joformale, siç ia mundëson afërsia e tyre.*
*Nëse Goni do t'i kishte shkruar drejtorit me gjuhën që e ka përdorur me shokun e tij, drejtori do të fyhej. Nëse Goni do t'i shkruante shokut të tij të ngushtë me gjuhën që e ka përdorur me drejtorin, atëherë shoku do të kujtonte se është duke bërë shaka.*

26

## Ndërtimi i njohurive:
## Përpunimi i përmbajtjes
*Të lexuarit ndërveprues*

Paraqitet një kërkesë përmes projektorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

NJOFTIM

Njoftohen të gjitha subjektet që kanë paraqitur Ankim Administrativ pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut se:

1. **Në datën 14.05.2021 Ora : 12:00 do të zhvillohet Komisioni i Ankimit** sipas Urdhërit Nr. 52 datë 16.07.2018 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurave të hollësishme të shqyrtimit të Ankimit Administrativ nga Komisioni i Ankimit pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut".
2. **Komisioni do të zhvillohet në ambientet e** Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me adrese: Rruga "Shyqyri Bërxolli", Nr 65, Tiranë.

Bashkëbisedohet rreth përmbajtjes, formës të së shkruarit, gjuhës së përdorur dhe gjatësisë së shkrimit.

## Përforcimi:
## Konsolidimi i të nxënit:
*Shkrim i lirë*

Kërkesë:
Shkruani një kërkesë sipas rregullave të kërkuara.
Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të elementeve të njoftimit nga mesazhet e tjera si dhe hartimin e saktë të njoftimit.

**Detyrë:**
(Shkruaj një njoftim për një aktivitet në shkollë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 42

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij (gjininë, numrin, rasat, lakimin); Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3; II. 1; III. 4; VI. 2.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 2, 8; 2. 4, 9; 3. 9.


njësia 19
EMRI

VREMÇI DHE FERRA

Ka qenë qysh ka qenë. Ka qenë një plak me një plakë, e kanë prerë drurin me sëpatë. Ka qenë një vremç. E ka gjetur një ferrë. Ka shkuar te një derë.
- "Tak-tak-tak!"
- "Kush është në derë?"
- "Jam një vremç i mjerë. A ma ruani këtë therrë?"
Ata i kanë thënë: "Ani" Dhe vremçi është larguar për t'u kthyer sërish të nesërmen: "Tak-tak-tak!"
- "Kush është në derë?"
- "Jam një vremç i mjerë. A ma ktheni tash ferrën që jua dhashë dje?" -"Uuu", bënë të zotët e shtëpisë. "Me atë ferrë e kemi ndezur zjarrin për të pjekur bukën".
- "Ja ferrën, ja bukën ja ferrën, ja bukën!" bërtiste vremçi para derës, derisa të zotët e shtëpisë u detyruan që t'ia jepnin bukën. Sakaq, vremçi shkoi te një derë tjetër. "Tak-tak-tak!"
- "Kush është në derë?"
- "Jam një vremç i mjerë. A ma ruani këtë bukë?"
Ata i thanë:"Ani." Dhe vremçi u largua për të trokitur sërish të nesërmen.
- "A ma ktheni bukën që jua lashë të ma ruanit?" tha vremçi.
Mirëpo, e zonja e shtëpisë që kishte dalë te dera e bëri një grimasë në fytyrë që të bënte ta kuptosh se e kishte harruar fare punën e bukës.
- "Uuuu" bëri ajo."Atë bukë ia kemi dhënë dashit".
- "Ja bukën, ja dashin. Ja bukën, ja dashin!" ia filloi të thërriste vremçi para derës, derisa të zotët e shtëpisë nuk patën tjetër, pos t'ia jepnin dashin. Vremçi e mori dashin dhe shkoi te një derë tjetër. E kishte gjetur mënyrën e tij të përfitimit dhe nuk hiqte dorë.
- "Tak-tak-tak!"
- "Kush është në derë?"
- "Jam një vremç i mjerë. A ma ruani këtë dash deri nesër?"
Pasi i thanë: "Ani" Vremçi u largua për t'u kthyer pas disa muajsh.
- "A ma ktheni dashin që jua lashë?"
- "Uuuu" bëri e zonja e shtëpisë që kishte dalë në derë. "Kemi harruar fare, sepse e kishim një dasmë, e morëm një nuse dhe e poqëm dashin për vete" - "Ja dashin, ja nusen. Ja dashin, ja nusen", bënte vremçi para derës, derisa të zotët e shtëpisë u dorëzuan. Dhe ia dhanë nusen.
Me nusen në krahë, vremçi u nis për udhë. Nuk bëri shumë dhe në një livadh e pa një bari tek po i binte kavallit. Vremçi - vremç më - i tërhequr nga muzika, shkoi te bariu.

68

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon rrjedhshëm përrallën;
- Identifikon emrat në tekstin e dhënë;
- Nxjerr përfundime për emrat që gjen në tekst.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri, mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Biologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë parapake*

Nxënësit pyeten për njohuritë paraprake të emrave që kanë mbajtur në mend nga vitet e kaluara.
Pyeten se a kanë dëgjuar për emrin “vremç”.
Një përgjigje e munshme: lloj shpendi, zogu që fluturon shpejt.


- "A ma jep atë kavall?", e pyeti bariun.
- "Nëse ti ma jep nusen, unë ta jap kavallin", i tha bariu.
- "Mirë", u pajtua vremçi.

Dhe ashtu u bë. Bariu e mori nusen dhe iku sakaq, ndërsa vremçi e vuri kavallin në sqep dhe u hodh në lartësinë e qiellit. Mirëpo, derisa po përpiqej t'i binte, kavalli i ra nga sqepi në një lumë të rrëmbyeshëm dhe vremçi nuk e gjeti kurrë. Kështu vremçi i humbi edhe kavallin, edhe nusen, edhe dashin, edhe bukën, edhe ferrën.

Përralla në dhe, shëndeti ndër ne; përalla në tokë, shëndeti në carrokë.

**(Përrallë popullore)**

***Pyetje:***

- *Si përpiqej të përfitonte vremçi?*
- *Çfarë përfitoi nga një ferrë ai?*
- *A fitoi diçka në fund vremçi?*
- *Cili është subjekti i kësaj vepre?*
- *Cila është tema?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Si mendoni: si përfundojnë ata që përpiqen të fitojnë pa mund?*



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim me ndalesa*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë me ndalesa pjesën e tekstit.
Nxënësi i parë lexon deri te fjalia "Kush është në derë?".
Nxënësi i dytë deri te fjalia "Tak-tak-tak".
Nxënësi i tretë deri te fjalia "A ma jep atë kavall?"
Nxënësi i katërt e lexon pjesën e fundit.
Nxënësit e tjerë ndërkohë nënvizojnë sa më shumë emra që dallojnë në tekstin e dhënë.
Në fund të tekstit u përgjigjen pyetjeve:
- Si përpiqej të fitonte vremçi?
- Çfarë fitoi nga një ferrë ai?
- A fitoi në fund diçka vremçi?
- Cili është subjekti i kësaj vepre?
- Cila është tema?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit i shkëmbejnë fletoret mes vete dhe ia kontrollojnë njëri-tjetrit përgjigjet e dhëna.
Ndërkohë, mund të shtojnë pyetje.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të leximit dhe identifikimit të emrave që lexuan në tekst dhe përgjigjeve që japin për tekstin.

**Detyrë:**
(Shkruaj një tekst dhe dallo emrat që përdor)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 43

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE




**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri - kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasat, lakimin);
Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II. 3; III. 1, 2.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 8; 2. 7; 3. 7, 3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm;
- Dallon emrat abstraktë dhe konkretë;
- Zbaton emrat në shkrime të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjeografi, Histori.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Prezantim dixhital - Stuhi mendimi*

Nxënësve u shfaqet në monitor një seri me fotografi të ndryshme ku aty i shohin dhe disa janë të paraqitura edhe në librin e tyre.
Pyeten nxënësit: Si emërtohen këto figura: njerëz, kafshë, sende, objekte?
Një përgjigje e mundshme: Emërtohen me emra të ndryshëm ku disa prej tyre i prekim, i shohim, i mendojmë.
Nxënësit i analizojnë fotografitë edhe disa minuta.



**Bashkëbisedojmë:**

- *Emri emërton qenie të gjalla dhe sende.*
- *Ai i ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.*

**Emra të përgjithshëm:**
- *Emra konkretë: fletore, libër, laps, shkollë.*
- *Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër.*

***Emra të përveçëm:*** *Vjollca, Migjeni, Kosovë, Shqipëri, Rilindja.*

*Emrat konkretë janë emrat e sendeve që shihen e preken. Emra abstraktë janë emra të gjërave që nuk mund të preken: dashuri, liri, shpejtësi, mendim.*

- *Grup i veçantë i emrave të përgjithshëm janë emrat e lëndës, si: djathë, mjaltë, qumësht etj.*
- *Emri në gjuhën shqipe i ka: gjininë femërore dhe mashkullore.*

  *Fush-a - gjinia femërore;* *Mal-i - gjinia mashkullore;*
- *Emri e ka numrin njëjës dhe numrin shumës, p.sh.: një vajzë - shumë vajza, një mik- shumë miq.*
- *Rasa quhen format e emrit me anën e të cilave lidhet emri me fjalë të tjera në fjali. Emri në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren. Çdo rasë e ka trajtën e shquar dhe të pashquar.*

| ***Rasat*** | ***Pyetjet*** |
|---|---|
| *Emërore* | *kush, cili?* |
| *Gjinore* | *i, e kujt; i, e cilit?* |
| *Dhanore* | *kujt, cilit?* |
| *Kallëzore* | *kë, cilin, çfarë?* |
| *Rrjedhore* | *prej kujt, prej cilit?* |

71

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shënime mbi shënime*

Nxënësve u jepet si detyrë t'i shikojnë njohuritë fillestare të emrave dhe pastaj të vazhdohet me ndarjen e tyre dhe kategoritë gramatikore të emrit.
Vazhdohet këtë orë me emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.
Emrat e përgjithshëm ndahen në konkretë dhe abstraktë.
Emra konkretë: fletore, libër, laps etj.
Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër etj.
Emra të përveçëm: Vjollca, Migjeni, Kosovë, Rilindja etj.
Nxënësit punojnë në fletore dhe gjejnë sa më shumë emra konkretë dhe abstraktë me sendet që i rrethojnë në klasë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit punimet e tyre i shkëmbejnë me njëri-tjetrin dhe bëjnë pyetje për gjërat që dëshirojnë të mësojnë nga shokët e tyre. Mësimdhënësja i analizon dhe dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe në fund përmblidhet së bashku me nxënësit se a janë emërtuar të gjitha sendet dhe gjërat që i janë përreth në klasë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për saktësinë e përgjigjeve të dhëna në bazë të ndarjes, dallimit dhe zbatimit të emrave.

**Detyrë:**
(Shkruaj nga pesë fjali me emra konkretë, abstraktë, të përgjithshëm dhe të përveçëm)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 44

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri - kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasat, lakimin);
Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 7; III. 4, 8.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 8; 2. 7; 3. 7, 8

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora III)



***Bashkëbisedojmë:***

- *Emri emërton qenie të gjalla dhe sende.*
- *Ai i ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.*

***Emra të përgjithshëm:*** *Emra konkretë: fletore, libër, laps, shkollë.* / *Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër.*

***Emra të përveçëm:*** *Vjollca, Migjeni, Kosovë, Shqipëri, Rilindja.*

*Emrat konkretë janë emrat e sendeve që shihen e preken. Emra abstraktë janë emra të gjërave që nuk mund të preken: dashuri, liri, shpejtësi, mendim.*

- *Grup i veçantë i emrave të përgjithshëm janë emrat e lëndës, si: djathë, mjaltë, qumësht etj.*
- *Emri në gjuhën shqipe i ka: gjininë femërore dhe mashkullore.*

  *Fush-a - gjinia femërore;* *Mal-i - gjinia mashkullore;*
- *Emri e ka numrin njëjës dhe numrin shumës, p.sh.: një vajzë - shumë vajza, një mik- shumë miq.*
- *Rasa quhen format e emrit me anën e të cilave lidhet emri me fjalë të tjera në fjali. Emri në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren. Çdo rasë e ka trajtën e shquar dhe të pashquar.*

| ***Rasat*** | ***Pyetjet*** |
|---|---|
| *Emërore* | *kush, cili?* |
| *Gjinore* | *i, e kujt; i, e cilit?* |
| *Dhanore* | *kujt, cilit?* |
| *Kallëzore* | *kë, cilin, çfarë?* |
| *Rrjedhore* | *prej kujt, prej cilit?* |

71

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kategorizon emrat në gjini;
- Identifikon numrin e emrit;
- Zbaton kategoritë gramatikore të emrit në shkrime të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di-Dua të di-Mësova*

Mësimdhënësja ia shpërndan secilit nxënës nga një fletë A4 me tabelën e vizatuar të kësaj metode me tri rubrika. Gjatë kësaj ore vazhdohet me gjininë dhe numrin e emrit ku nxënësit paraprakisht në pjesën "Di" duhet t'i plotësojnë njohuritë që i dinë nga mësimet e mëhershme për njësinë mësimore.
Nxënësit punojnë në mënyrë individuale.



**Bashkëbisedojmë:**

- *Emri emërton qenie të gjalla dhe sende.*
- *Ai i ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.*

***Emra të përgjithshëm:***
- *Emra konkretë: fletore, libër, laps, shkollë.*
- *Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër.*

***Emra të përveçëm:*** *Vjollca, Migjeni, Kosovë, Shqipëri, Rilindja.*

*Emrat konkretë janë emrat e sendeve që shihen e preken. Emra abstraktë janë emra të gjërave që nuk mund të preken: dashuri, liri, shpejtësi, mendim.*

- *Grup i veçantë i emrave të përgjithshëm janë emrat e lëndës, si: djathë, mjaltë, qumësht etj.*
- *Emri në gjuhën shqipe i ka: gjininë femërore dhe mashkullore.*

  *Fush-a - gjinia femërore;* *Mal-i - gjinia mashkullore;*
- *Emri e ka numrin njëjës dhe numrin shumës, p.sh.: një vajzë - shumë vajza, një mik- shumë miq.*
- *Rasa quhen format e emrit me anën e të cilave lidhet emri me fjalë të tjera në fjali. Emri në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren. Çdo rasë e ka trajtën e shquar dhe të pashquar.*

| ***Rasat*** | ***Pyetjet*** |
|---|---|
| *Emërore* | *kush, cili?* |
| *Gjinore* | *i, e kujt; i, e cilit?* |
| *Dhanore* | *kujt, cilit?* |
| *Kallëzore* | *kë, cilin, çfarë?* |
| *Rrjedhore* | *prej kujt, prej cilit?* |

71



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di-Dua të di-Mësova*

Në pjesën "Dua të di" nxënësit i vendosin në formë të pyetjeve përgjigjet që japin për gjininë dhe numrin e emrit.
Informacionet shtesë që u interesojnë nxënësve i gjejnë në librin që e shfletojnë dhe njihen me shembuj konkretë të njësisë në fjalë.
Informacionet e reja që do të marrin i vendosin në rubrikën përkatëse.



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Di-Dua të di-Mësova*

Pas përfundimit të pjesës së dytë vazhdohet me pjesën "Mësova" ku nxënësit udhëzohen ta plotësojnë me njohuritë që morën pas pjesës së leximit të njohurive për njësinë mësimore. I shënojnë njohuritë që i mësuan në këtë pjesë dhe informacionet e paqarta ua sqaron mësimdhënësi.
Nëse ndonjë nxënës ka më pak informata rreth njësisë mësimore kërkohet nga nxënësit e tjerë të plotësohet me ndihmën e mësimdhënësit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të emrit.

**Detyrë:**
(Shkruaj një ese dhe përdor sa më shumë emra të tri gjinive dhe dallo numrin e këtyre emrave)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 45

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri - kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasat, lakimin);
Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II. 3; III. 2, 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 8; 2. 4, 9; 3. 9.



***Bashkëbisedojmë:***

- *Emri emërton qenie të gjalla dhe sende.*
- *Ai i ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.*

***Emra të përgjithshëm:*** *Emra konkretë: fletore, libër, laps, shkollë.* / *Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër.*

***Emra të përveçëm:*** *Vjollca, Migjeni, Kosovë, Shqipëri, Rilindja.*

*Emrat konkretë janë emrat e sendeve që shihen e preken. Emra abstraktë janë emra të gjërave që nuk mund të preken: dashuri, liri, shpejtësi, mendim.*

- *Grup i veçantë i emrave të përgjithshëm janë emrat e lëndës, si: djathë, mjaltë, qumësht etj.*
- *Emri në gjuhën shqipe i ka: gjininë femërore dhe mashkullore.*
  *Fush-a - gjinia femërore;* *Mal-i - gjinia mashkullore;*
- *Emri e ka numrin njëjës dhe numrin shumës, p.sh.: një vajzë - shumë vajza, një mik- shumë miq.*
- *Rasa quhen format e emrit me anën e të cilave lidhet emri me fjalë të tjera në fjali. Emri në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren. Çdo rasë e ka trajtën e shquar dhe të pashquar.*

| ***Rasat*** | ***Pyetjet*** |
|---|---|
| *Emërore* | *kush, cili?* |
| *Gjinore* | *i, e kujt; i, e cilit?* |
| *Dhanore* | *kujt, cilit?* |
| *Kallëzore* | *kë, cilin, çfarë?* |
| *Rrjedhore* | *prej kujt, prej cilit?* |

71

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora IV)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon dhe nënvizon emrat në rasa;
- Shpjegon përdorimin e tyre;
- Zbaton emrat në mënyrë të drejtë në shkrime të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri, mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Rikujto-përmblidh*

Nxënësit për disa minuta udhëzohen të rikujtojnë ato që i dinë për emrin nga orët paraprake. Mendimet e tyre i përmbledhin në fletore pastaj i lexojnë para klasës.
Këtë orë vazhdohet me rasat dhe trajtat e emrit.
Nxënësit udhëzohen të lexojnë në librin bazë njohuritë e dhëna për rasat dhe trajtat e emrit.



**Bashkëbisedojmë:**

- *Emri emërton qenie të gjalla dhe sende.*
- *Ai i ka këto kategori gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën.*

**Emra të përgjithshëm:**
*Emra konkretë: fletore, libër, laps, shkollë.*
*Emra abstraktë: dëshirë, guxim, fitore, urdhër.*

***Emra të përveçëm:*** *Vjollca, Migjeni, Kosovë, Shqipëri, Rilindja.*

*Emrat konkretë janë emrat e sendeve që shihen e preken. Emra abstraktë janë emra të gjërave që nuk mund të preken: dashuri, liri, shpejtësi, mendim.*

- *Grup i veçantë i emrave të përgjithshëm janë emrat e lëndës, si: djathë, mjaltë, qumësht etj.*
- *Emri në gjuhën shqipe i ka: gjininë femërore dhe mashkullore.*

  *Fush-a - gjinia femërore;* *Mal-i - gjinia mashkullore;*
- *Emri e ka numrin njëjës dhe numrin shumës, p.sh.: një vajzë - shumë vajza, një mik- shumë miq.*
- *Rasa quhen format e emrit me anën e të cilave lidhet emri me fjalë të tjera në fjali. Emri në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren dhe rrjedhoren. Çdo rasë e ka trajtën e shquar dhe të pashquar.*

| ***Rasat*** | ***Pyetjet*** |
|---|---|
| *Emërore* | *kush, cili?* |
| *Gjinore* | *i, e kujt; i, e cilit?* |
| *Dhanore* | *kujt, cilit?* |
| *Kallëzore* | *kë, cilin, çfarë?* |
| *Rrjedhore* | *prej kujt, prej cilit?* |

71

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analizo-plotëso*

Mësimdhënësja ua paraqet nxënësve rasat e emrit në monitor.
Udhëzohen të analizojnë me kujdes rasat e emrit dhe pyetjet që i ka secila rasë.
Rasat Pyetjet
Emërore - kush, cili?
Gjinore - i, e kujt; i, e cilit?
Dhanore - kujt, cilit?
Kallëzore - kë, cilin, çfarë?
Rrjedhore - prej kujt, prej cilit?
Nxënësit pajisen me nga një fletë të bardhë dhe udhëzohen të shkruajnë nga një emër dhe ta lakojnë atë në rasa.
Secili nxënës e lexon para klasës emrin e lakuar që ka përzgjedhur.
Dy ose tre nxënës dalin në tabelë dhe lakojnë një emër, mësimdhënësja i vëzhgon dhe korrigjon vazhdimisht.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ushtro-diskuto*

Nxënësit udhëzohen të punojnë individualisht me detyrën e dhënë nga mësimdhënësja.
Punën e tyre e diskutojnë me shokun apo shoqen e bankës dhe informacionet e paqarta i sqaron mësimdhënësja.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet për lakimin e emrave, zbatimin e tyre dhe saktësinë e zgjidhjeve që kanë punuar gjatë orës.

**Detyrë:**
(Të lakohet nëpër rasa emri *vajzë*)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 46

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri - kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasat, lakimin);
Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II. 3; IV. 3, 7.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 1.



***Lakimi i emrave në numrin njëjës***

| | Lakimi I (-i) | | Lakimi II (-u) | | Lakimi III (-a) | | Lakimi IV (-të) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rasa | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar |
| E. | një libër | libr**i** | një mik | mik**u** | një fushë | fush**a** | një të folur | të folur**it** |
| Gj. (i, e) | një libr**i** | libr**it** | një mik**u** | mik**ut** | një fush**e** | fush**ës** | një të folur**i** | të folur**it** |
| Dh. | një libr**i** | libr**it** | një mik**u** | mik**ut** | një fush**e** | fush**ës** | një të folur**i** | të folur**it** |
| K. | një libër | libr**in** | një mik | mik**un** | një fushë | fush**ën** | një të folur | të folur**it** |
| Rr. | një libr**i** | libr**it** | një mik**u** | mik**ut** | një fush**e** | fush**ës** | një të folur**i** | të folur**it** |

***Mbaresat e emrave në numrin shumës janë:***

| Trajta e pashquar | | Trajta e shquar |
|---|---|---|
| E. | - | -(i)t(ë) |
| GJ. | -ve | -ve |
| Dh. | -ve | -ve |
| K. | - | -(i)t(ë) |
| RR. | -sh | -ve |

**Detyrë:**

- *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët me shkronja të zeza?*
- *Cilat janë kategoritë gramatikore të emrit?*
- *Si ndahen emrat për nga kuptimi që shprehin?*
- *Sa rasa ka emri?*
- *Sa lakime ka emri?*

Shih fletoren e punës

72

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora V)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon lakimin e emrave nga kategoritë e tjera gramatikore;
- Rindërton shembuj në paragrafë të caktuar;
- Zbaton lakimin në tekste të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, mjete shkrimi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Nxënësit nxiten t'i rikujtojnë njohuritë e mësuara në orët paraprake për emrin.
Shtrohet pyetja për nxënësit: Cilat ishin kategoritë gramatikore të emrave?
Ja një përgjigje e mundshme: Kategoritë gramatikore të emrit, janë: gjinia, numri, rasa, trajta dhe lakimi.
Në këtë orë ndalemi te lakimi i emrit si kategori gramatikore.
Mësimdhënësja shkruan në tabelë disa shembuj dhe nxënësit i analizojnë ata disa minuta.



***Lakimi i emrave në numrin njëjës***

| | Lakimi I (-i) | | Lakimi II (-u) | | Lakimi III (-a) | | Lakimi IV (-të) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rasa | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar | E pashquar | E shquar |
| E. | një libër | libri | një mik | miku | një fushë | fusha | një të folur | të folurit |
| Gj. (i, e) | një libri | librit | një miku | mikut | një fushe | fushës | një të foluri | të folurit |
| Dh. | një libri | librit | një miku | mikut | një fushe | fushës | një të foluri | të folurit |
| K. | një libër | librin | një mik | mikun | një fushë | fushën | një të folur | të folurit |
| Rr. | një libri | librit | një miku | mikut | një fushe | fushës | një të foluri | të folurit |

***Mbaresat e emrave në numrin shumës janë:***

| Trajta e pashquar | | Trajta e shquar |
|---|---|---|
| E. | - | -(i)t(ë) |
| GJ. | -ve | -ve |
| Dh. | -ve | -ve |
| K. | - | -(i)t(ë) |
| RR. | -sh | -ve |

**Detyrë:**

- *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët me shkronja të zeza?*
- *Cilat janë kategoritë gramatikore të emrit?*
- *Si ndahen emrat për nga kuptimi që shprehin?*
- *Sa rasa ka emri?*
- *Sa lakime ka emri?*

Shih fletoren e punës

72

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analizo-plotëso*

Nxënësit e lakojnë emrin *libër, fushë* në trajtën e pashquar dhe të shquar, në të dy numrat në tabelë.
Bëjnë analizën morfologjike të fjalisë së dhënë:
*Bardhi dhe Arta janë në klasë të gjashtë.*
Vazhdohet me klasifikimin e emrave në katër lakimet.
Lakimi i parë (i) - libër-libri
Lakimi i dytë (u) - mik-miku
Lakimi i tretë (a) - fushë-fusha
Lakimi i katërt (të) - të folur-të folurit
Mbaresat e emrave në numrin shumës, janë:
Trajta e pashquar
E. -
Gj. -ve
Dh. -ve
K. -
Rr. -sh

Trajta e shquar

E. -(i) t(ë)
Gj. -ve
Dh. -ve
K. -(i) t(ë)
Rr. -ve

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ushtro-diskuto*

Nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të lakojnë sa më shumë emra që munden.
Pas përfundimit ta shikojnë punën e shokut/ shoqes dhe ta korrigjojnë njëri-tjetrin nëse kanë gabime.
Nxënësit që nuk kanë shumë përgjigje kanë të drejtë t'i pyesin të tjerët për ato që u intereson, ndërkohë mësimdhënësja plotëson aty ku është nevoja.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të rindërtimit të shembujve dhe zbatimit të tyre.

**Detyrë:**
(Lako nga një emër në të katër lakimet)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 47

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Emri - kategoritë e tij gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon emrin dhe kategoritë e tij gramatikore (gjininë, numrin, rasat, lakimin);
Dallon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II. 4; IV. 7.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 3, 4; 2. 1; 3. 2.


njësia 18
EMRI

Ushtrime

Plotësojeni tabelën me emrat: **guxim, tavolinë, tabelë, nxënës, frikë, Arbër, dritare, laps, Vjosë, derë, shtëpi, dëshirë, Prishtinë, shkollë, mësuese.**

| Emra të përveçëm: | Emra konkretë: | Emra abstraktë: |
| --- | --- | --- |
| | | |

*Emrat e përveçëm shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.

Emri **bukuri** është i gjinisë:

a. Femërore
b. Mashkullore

41

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Emri (ora VI)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përpilon shembuj me kategoritë gramatikore të emrave;
- Gjen emrat në tekste të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Biologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit pyeten për emrin dhe karakteristikat kryesore që ka.
Një pyetje mund të jetë: A është emri pjesë e ndryshueshme apo e pandryshueshme e ligjëratës?
Një përgjigje e mundshme: Emri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që emërton qenie të gjalla dhe sende.
Nxënësit diskutojnë për informacionet e tjera.
Udhëzohen të hapin fletore pune dhe të punojnë individualisht.



◇ *Formoni numrin shumës të këtyre emrave dhe tregoni çfarë prapashtesa marrin ata: **parazit, krimb, gjë, vit, këmbë, sy, vjedhje, pyll, bir, mur, natë, qen, njeri.***

◇ *Lakoni këta emra në formën e shumësit: **krimb, plak, dërrasë.***

| | **Lakimi I (-i)** | | **Lakimi II (-u)** | | **Lakimi III (-a)** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *E pashquar* | *E shquar* | *E pashquar* | *E shquar* | *E pashquar* | *E shquar* |
| **E.** | | | | | | |
| **Gj.** | | | | | | |
| **Dh.** | | | | | | |
| **K.** | | | | | | |
| **Rr.** | | | | | | |

◇ *Shënoni:*

*5 emra të përveçëm:* ______
*5 emra abstraktë:* ______
*5 emra konkretë:* ______

42

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analizo-plotëso*

Nxënësit udhëzohen që në shembujt e dhënë në libër t'i ndajnë në rubrikat përkatëse emrat e përveçëm, konkretë dhe abstraktë.
Vazhdohet me lakimin e emrave: krimb, plak, dërrasë në formën e shumësit.
Pasi përfundohet plotësimi i rubrikave të zbrazëta në libër i përgjigjen pyetjes:

Emri të ftohtët është i gjinisë:
A) Femërore
B) Mashkullore
C) Asnjanëse

Si detyrë duhet të shënojnë:
5 emra të përveçëm
5 emra abstraktë
5 emra konkretë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit udhëzohen që përgjigjet e dhëna në libër t'i diskutojnë me shokun/ shoqen e bankës.
Vazhdohet me pyetjet e dhëna ku ia japin njëri-tjetrit përgjigjet që i kanë shkruar.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të saktësisë së përgjigjeve, përpilimit dhe ilustrimit të tyre.

**Detyrë:**
(Lako nga një emër në të katër lakimet)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______

## Mësimi 48

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 3; 2. 2.


njësia 7

DON KISHOTI LUFTON ME GJIGANTËT
Migel de Servantes

Përpara u dolën nja tridhjetë e dyzet mullinj të erës në një lëndinë. Kur i pa Don Kishoti, i tha ndihmësit të tij: "Fati na buzëqeshi, se as vetë nuk do të dinim të thurnim dëshira më mirë. Shiko, o shoku im Sanço Pança, tridhjetë gjigantë monstra na dolën përpara dhe me që të gjithë do të luftoj e do t'i mbys...
Cilët gjigantë? - pyeti Sanço Pança.
"Ata që po i sheh atje", tha i zoti. "Ata me duar të gjata, disa prej të cilëve edhe disa kilometra të gjatë".
"Madhëri", tha Sançoja."Këta nuk janë gjigantë, por janë mullinj ere dhe ato nuk janë duar, por janë krahët, të cilët shtyhen nga era dhe e rrotullojnë mokrën e mullirit".
"Po shihet, se ti nuk merr erë nga aventurat", ia ktheu Don Kishoti. "Këta janë gjigantë dhe nëse ua ke frikën shtyju tutje dhe lutu, derisa unë përfshihem në luftë të ashpër dhe të pabarabartë me ta".
Sa i tha këto fjalë e goditi me mamuze kalin e tij rrangallë, Rosinantin, dhe u nis duke shpërfillur fjalët e Sanço Pançës se këta ishin vetëm mullinj ere. As fjalët e Sanço Pançës, as afërsia e objekteve nuk ia ndërruan mendimin se këta ishin gjigantë, por nisi të thërriste: "Mos ikni tani frikacakë e krijesa të fëlliqura, se një kalorës i vetmuar ju sulet tani".
Një puhi e lehtë nisi të frynte dhe, sakaq, krahu i mullirit nisi të rrotullohej ngadalë.
Don Kishoti u nis me galop drejt mullirit të parë, por krahu i mullirit që po rrotullohej, ia goditi me forcë shtizën dhe ia bëri copa, duke e rrëzuar kështu kalorësin me gjithë kalë. Kalorësi u rrotullua në lëndinë për faqe të zezë. Sançoja u ngut ta ndihmonte dhe, kur arriti te ai, pa se kishte mbetur nën Rosinantin.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Don Kishoti lufton me gjigantët"

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon tematikën e tekstit;
- Identifikon tiparet letrare në tekst.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, tabela, projektori

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Histori, Kinematografi, TIK.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*
Prezantohet para nxënësve një sekuencë nga filmi Don Kishoti https://www.youtube.com/watch?v=fhWT-k_-6-U.
Gjatë shikimit të videos nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve:
- *Për çfarë flitet në këtë film?*
- *Cilat janë personazhet kryesore?*
- *Çfarë kujtonte Don Kishoti se janë mullinjtë e erës?*
- *Çfarë ndodhi më pas?*

Disa nga përgjigjet e mundshme, janë:
Flitet për një kalorës që lufton kundër padrejtësive dhe dëshiron t'u ndihmojë të tjerëve. Personazhet, janë: Don Kishoti, Sanço Pança, Dylqineja e Tobozës.


"E marrtë e mira" tha Sançoja. "Po a nuk i thashë madhërisë suaj se këta ishin vetëm mullinj?" "Hesht, miku Sanço", ia ktheu Don Kishoti. "Fatet e luftës më shumë se gjithçka tjetër u nënshtrohen luhatjeve të shpeshta dhe jam i bindur se magjistari Friston që më ndau nga librat dhe mësimi, i shndërroi këta gjigantë në mullinj që të mos ma lejojë lavdinë e triumfit mbi ta" "Ashtu qoftë!"- tha Sanço Pança, ndërsa po e ndihmonte të ngrihej dhe të hipte sërish në kalë.
Më pas, duke folur për aventurën e fundit, u nisën drejt Porto Lapises, ku, siç thoshte Don Kishoti, nuk do të dështonin për të gjetur aventura të shumta e të ndryshme...

**Bashkëbisedojmë: Gjuha e Gonit**

*"Don Kishoti" është vepër në prozë. Konsiderohet si romani i parë i mirëfilltë në letërsinë botërore.*

***Detyrë dhe pyetje:***

*Shkruani për këtë tekst, duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:*

- *Për çfarë bën fjalë ky tekst?*
- *Cilat janë personazhet kryesore?*
- *Çfarë kujtonte Don Kishoti se janë mullinjtë e erës?*
- *Çfarë ndodhi më pas?*

***Fjalë të reja:***

*Galop, lëndinë, puhi, mamuze, rrangallë, mokër*
*Kilometër = njësi matëse.*
*(Autori, në të vërtetë, e përdor fjalën legë. Një legë është përafërsisht aq sa mund të ecë një njeri për një orë. Pra, përfshin distancën 4 deri gati 6 kilometra).*

29



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditarët e të nxënit (Ditari dypjesësh)*

Nxënësit organizohen të punojnë në dyshe. Në fletoret e tyre duhet ta paraqesin tabelën e ndarë në dy pjesë Citat dhe Koment, si më poshtë.
Në pjesën e citatit përzgjedhin nga një pjesë të tekstit, ndërsa në pjesën e komentit e interpretojnë me fjalët e tyre pjesën e përzgjedhur.

| Citat | Koment |
|---|---|
| Përpara u dolën nja tridhjetë a dyzet mullinj të erës në një lëndinë. Kur i pa Don Kishoti, i tha ndihmësit të tij: "Fati na buzëqeshi, se as vetë nuk dinim të thurnim dëshira..." | Kjo pjesë më pëlqeu më shumë, sepse Don Kishoti është i gëzuar që do t'i vrasë gjigantët. |

Prezantohet pjesa për lexim dhe u thuhet nxënësve që në fillim t'i nënvizojnë pjesët që u bëjnë përshtypje gjatë leximit, në qoftë se kanë edhe pyetje. Pas leximit dhe nxjerrjes së citimeve, u jepet kohë t'i bëjnë komentet e tyre.
Pastaj, u kërkohet t'i tregojnë pjesët që kanë përzgjedhur dhe t'i lexojnë komentet e tyre. Mësimdhënësi/ ja mund të bëjë pyetje gjatë leximit të komenteve nga nxënësit, në mënyrë që ata të nxiten të flasin dhe të aftësohen për t'u përgjigjur sipas mënyrës që u kërkojnë pyetjet.



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Harta e konceptit/ e përkufizimit*

Në mes të tabelës shënohet Don Kishoti, ndërsa nxënësit mund të ndahen në grupe apo edhe individualisht të shkruajnë për karakteristikat e Don Kishotit si personazh kryesor në tekstin e analizuar gjatë orës mësimore.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i analizës tematike të tekstit dhe identifikimit të elementeve letrare në tekst, si: tema, ngjarja, motivi, personazhet, rrëfimi dhe figurat stilistike-letrare.

**Detyrë:**
(Të plotësohet fletore pune në faqe 11-12)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 49

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia dhe autobiografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve letrare dhe joletrare, tekstit biografik dhe autobiografik

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; 2. 1; II. 1, 2, 3
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I. 1, 3; II. 1, 2, 3



*Biografia e shkrimtarit*
**Migel de Servantes Savedra**
**(1547—1616)**

Migel de Servantes Savedra është shkrimtar spanjoll. Ai konsiderohet njëri ndër romancierët e parë botërorë. Romani i tij më i njohur është "Don Kishoti". Ky roman është më i përkthyeri në botë nga të gjitha romanet e tjera. Në gjuhën shqipe është përkthyer nga Fan Noli.
Para se ta shkruante "Don Kishotin", Servantesi ka qenë i marrë rob nga piratët, por është liruar pas pesë vjetësh. Ka punuar punë të ndryshme, përfshirë edhe detyrën e mbledhësit të taksave për Mbretërinë e Spanjës. Përveç "Don Kishotit", ka shkruar edhe vepra të tjera. Ka vdekur në Madrid në moshën 69-vjeçare.

*Autobiografia*
**Unë jam Ariu i Murrmë dhe kjo është një autobiografi imja e shkurtër**

Kam lindur në pyll në një familje të madhe. Familja ime është më e madhja ndër të gjitha familjet e arinjve. Kushërinj të mi jetojnë në Evropë, në Amerikë. Natyrisht, kam do të afërm edhe në Kosovë, në Malet e Sharrit.
Nëna më ka ushqyer mirë dhe unë jam bërë i fortë. I kam fituar të gjitha garat e forcës në kategorinë e arinjve.
Jam i gjatë 2 metra e gjysmë. Më i gjati në familjen time. Nejse, disa kushërinj të mi janë më të shkurtër. Qe, po e zëmë, djali i mixhës është më i vogli në familje dhe është 170 centimetra i gjatë. Unë jam i rëndë 350 kilogramë. Po ashtu, jam shumë i fuqishëm. Kam gjymtyrë të fuqishme, vrapoj me tërë shputën dhe mund të qëndroj dhe të bëj

30

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
"Don Kishoti lufton me gjigantët" (ora e dytë)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan biografinë e shokut;
- Zbërthen kuptimin përmes pyetjeve;
- Përgjigjet rreth pyetjeve;

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6
**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Edukatë qytetare

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shkruaj- shkëmbe- lexo*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë biografinë e shokut apo shoqes së bankës.
Pasi t'i shkruajnë, shkëmbejnë fletoret dhe plotësojnë ato që mungojnë.
Më pas, lexojnë shkrimet e tyre



hapa edhe duke qëndruar arithi (bile edhe vetë kjo fjalë në gjuhën shqipe ka lindur prej fjalës ari) - pra, në dy këmbët e prapme. Në gishtërinj kam kthetra të mprehta që më shërbejnë për t'u ngjitur nëpër drurë dhe për gjah. Më pëlqen mjalti. Natyrisht, nuk jam vegjetarian dhe më pëlqen edhe mishi, ndonëse herë-herë mund të ha edhe ndonjë bimë sa për sallatë. Gruaja ime, Harushahja, kujdeset për fëmijët. Ajo i lind 2-3 fëmijë në vit. Ne arinjtë mund të jetojmë deri në 35 vjet.
T'ju them të drejtën, dimrin nuk e dua hiç. Gjatë dimrit ia kërcas gjumë dhe nuk zgjohem deri në pranverë. Prandaj, thonë se bëj gjumë dimëror. Mirëpo, sivjet diçka nuk po më zë gjumi dhe thashë ta shkruaj këtë autobiografi.

***Detyrë:***

- *Mbështetur në tekstin e mësipërm...*
  *a) Ku jetojnë arinjtë e murrmë?*
  *b) Sa mund të jetë gjatësia e arinjve të murrmë dhe sa mund të jetë pesha e tyre?*
  *c) Si ecën ariu i murrmë?*
  *d) Për çfarë i duhen kthetrat?*
  *e) Me çfarë ushqehet një ari i murrmë?*
  *f) Sa këlyshë të ariut të murrmë lindin brenda vitit?*
  *g) Përse për arinjtë thonë se bëjnë gjumë dimëror?*
- *Biografia e Don Kishotit është:*
  *a) Prozë*
  *b) Poezi*
- *Biografia është:*
  *a) Tekst letrar*
  *b) Tekst joletrar*

***Bashkëbisedojmë: Biografia dhe autobiografia***

*Teksti për Servantesin është biografi. **Biografia** është një rrëfim i përmbledhur për jetën e një personi të rëndësishëm. Përfshin faktet për jetën e tij, shkollimin, veprat dhe (nëse personi ka vdekur) vdekjen. Biografinë e dikujt e tregojnë të tjerët.*
*Nëse ne shkruajmë biografinë e vetes sonë, atëherë kemi shkruar autobiografi.*
***Autobiografia** është një rrëfim i përmbledhur për jetën tonë, ku tregojmë për punën tonë, shkollimin, veprat, aktivitetet e ndryshme.*
*Teksti i Ariut të Murrmë është një autobiografi e letrarizuar dhe humoristike.*

***Detyrë:***

*Shkruani autobiografi dhe lexoni në klasë.*

Shih fletoren e punës

31

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-analizo-përgjigju*

Nxënësit e lexojnë mësimin në paragrafë. Secili grup e ka të përcaktuar paragrafin e vet
Udhëzohen të formulojnë pyetje rreth paragrafit të lexuar. Kështu veprojnë të gjitha grupet.
Pastaj, lexohet mësimi në tërësi dhe diskutohet rreth pyetjeve të krijuara që do t'i parashtrohen grupit që ata përzgjedhin.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pyetje – përgjigje*

Nxënësve u drejtohen pyetjet rreth dy teksteve:
- Kush janë personazhet në tekstin e parë?
- Çfarë kujtonte Don Kishoti se janë mullinjtë e erës?
- Po teksti i dytë, është i shkruar në prozë a poezi?
- Përse për arinjtë thonë se bëjnë gjumë dimëror?

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për shkrimin e biografisë, zbërthimin e kuptimit dhe të saktësisë së përgjigjeve të dhëna.

**Detyrë:**
Punohen ushtrimet në Fletore pune

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 50

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 20
MBIEMRI

(Nga Vizatori)
**PEGAZI**

Askush nuk e kishte parë në të vërtetë. Për të vetëm flitej. Dikush thoshte se është një kalë i madh e i bardhë që fluturonte me krahë të mëdhenj e të gjerë nëpër qiell. Të tjerë thoshin se e kishte një bri magjik në majë të kokës dhe se mund të bënte çudira me të. Të tjerët thoshin se ai ishte një princ që e kishin mallkuar zanat dhe e kishin shndërruar në kalë, për shkak se e kishte dashur zanën më të bukur. Mirëpo, që të gjithë pajtoheshin se ai ekzistonte dikund, se ishte një kalë i jashtëzakonshëm dhe se quhej Pegaz.

Dhe Pegazi jetonte vërtet. Jetonte në një mal komshi me pallatin e perëndive. Nuk zbriste asnjëherë në botën e njerëzve. Asnjëherë, derisa një ditë poshtë në botën e njerëzve të rëndomtë ia nisi një luftë e madhe. Një fis me luftëtarë të egër e të stërvitur po i sulmonte fshatrat e një princi trim. Luftëtarët e egër mbanin heshta të gjata dhe helmeta me simbol të ujkut. E quanin veten ujq të zinj. Princi trim i kishte mbledhur fshatarët e varfër me ato pak armë që kishin dhe po i rreshtonte për luftë me armikun e rrezikshëm. Në mbrëmje, derisa fshatarët po i këndonin këngët e luftës dhe po i ndiznin zjarret, princi u ul para vatrës dhe iu lut perëndisë së tij të preferuar, Athinës, që ta ndihmonte. Sakaq, ai e mori shpatën e mprehtë dhe doli t'i shikonte edhe një herë ushtarët e tij, për herë të fundit para betejës. Në largësi po vërehej një lumë i tërë zjarri që po ndrinte natën. Ujqit e zinj po afroheshin dhe po e rrethonin fshatin.

"Dorëzohuni, po jua japim shansin e fundit", thirri prijësi i luftëtarëve të egër. "Na jepni ato që i kërkojmë dhe do t'jua kursejmë jetën".

Ata po kërkonin dukat dhe gra. Këtë gjë nuk mund ta pranonte princi.

"Largohuni, sa nuk bëhet vonë, për herë të fundit po ju them" iu përgjigj princi prijësit të luftëtarëve të egër. "Largohuni tani dhe nuk do të vdisni. Nuk do të merrni gjë nga ky fshat".

Ujqit e zinj qeshën me fjalët e princit, po princi i besonte lutjes së tij dhe perëndisë së tij të preferuar, Athinës.

Ndërsa princi po u jepte udhëzimet e fundit ushtarëve të tij, në largësi e vërejti një dritë

73

**Njësia mësimore:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për mbiemrin;
- Përdor drejt mbiemrin në fjali;
- Dallon kategoritë gramatikore të mbiemrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, tekste të ndryshme të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësve u ndahet teksti nga libri për të lexuar, në të cilin do ta dallojnë mbiemrin.
*Askush nuk e kishte parë në të vërtetë. Për të vetëm flitej. Dikush thoshte se është një kalë i madh dhe i bardhë që fluturonte me krahë të mëdhenj e të gjerë nëpër qiell...*
Nxënësit i dallojnë mbiemrat dhe i lexojnë para klasës.
Përgjigjet e mundshme:
*i madh, i bardhë, të mëdhenj, të gjerë.*

Për mësimdhënësin/en



të zbehtë që po afrohej nga qielli. Drita u ndal afër çadrës së tij. Ishte një kalë i bardhë me krahë dhe me një bri në majë të kokës. Menjëherë e kuptoi: Athina ishte perëndi e luftës dhe ajo e donte luftën pa masë dhe dëshironte që të shihte luftëra të barabarta. Tani po e ndihmonte princin duke ia dërguar Pegazin.
Pegazi, ndërkaq, i përplasi këmbët përtokë dhe hingëlliu. I bëri me kokë princit dhe ky shpejt e shpejt i hipi mbi shpinë. Ishin në vrap e sipër, kur ujqit e zinj bënë thirrjen për sulm. U dëgjuan thirrjet e luftëtarëve të egër që po vinin të etshëm për plaçkë lufte. Së shpejti qëlluan edhe shigjetat e furishme të luftëtarëve të egër dhe përgjigjja e fshatarëve me shigjeta, po ashtu. Pegazi u dha krahëve dhe me princin në shpinë fluturoi prapa radhëve të ushtrisë armike. Princi po e kërkonte me sy prijësin e luftëtarëve të egër.
Poshtë po bëhej një betejë e ashpër. Trima të mëdhenj të të dyja palëve po binin një nga një në fushën e blertë që sa po vinte e po skuqej nga gjaku. Princi vërejti në largësi helmetën e zezë dhe lëkurën e ujkut të prijësit të luftëtarëve të egër. Duke fluturuar mbi kalë iu afrua aq sa të mund ta qëllonte me shigjetë. Mori në shenjë. Shigjeta e qëlloi prijësin mu në zemër. Luftëtarët e egër u tmerruan kur e panë vdekjen e prijësit të tyre dhe nisën të tërhiqeshin. Fshatarët po i brohorisnin fitores së madhe. Mbi shpinën e kalit të tij magjik, princi zbriti në tokë. Ishte bërë një hero i madh i popullit të tij.
Atë natë, fshatarët festuan deri në agim. Mirëpo, Pegazin nuk e panë më kurrë. Ai ishte kthyer në malin e tij, komshi pallatit të perëndive dhe po e vazhdonte jetën e tij të përditshme të një qenieje të gjallë. Jetoi derisa u plak dhe një natë me shi ndërroi jetë i vetëm në malin e tij. Perënditë e nderuan, duke hedhur për hir të tij nga një yll në qiell. Yjet u vendosën me formën e tij. Sot e kësaj dite, netëve të kthjellëta në qiell mund të shihet imazhi i tij i vizatuar me yje.

***Bashkëbisedojmë:***

— *Në dy paragrafët e parë të kësaj përralle, janë nënvizuar disa fjalë. Këto fjalë janë mbiemra.*

— *Mbiemri emërton një tipar të emrit dhe përshtatet në gjini e në numër me të. Mbiemri ka kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shkallës.*

— *Sa i përket ndërtimit, mbiemrat ndahen në:*
- *Mbiemra të nyjshëm: i rrezikshëm, i mirë, i gjatë;*
- *Mbiemra të panyjshëm: magjik, trim.*

— *Mbiemri i përshtatet gjinisë dhe numrit të emrit, p.sh.: laps i kuq, sy të zi, vajzë trime, djem punëtorë.*

— *Mbiemrat e nyjshëm e kanë kategorinë e rasës para dhe pas emrit, kurse mbiemrat e panyjshëm vetëm kur vihen para emrit, p.sh.: djali i mirë, djali punëtor.*

74

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Mësimdhënie e ndërsjellë*

Në këtë pjesë sqarimet do t’i bëjë mësimdhënësi, i cili do të ketë bashkëbisedim me nxënësit.

Nxënësit pyeten se çka janë fjalët e nënvizuara në tekstin e lexuar. Pastaj e shpjegon mbiemrin me shembuj në tabelë, duke i dhënë kategoritë e tij gramatikore dhe duke i ndarë ata sipas ndërtimit.

Nxënësit do t’i rikujtojnë njohuritë e mëparshme nga klasa V.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lojë në dyshe*

Në këtë fazë të orës nxënësit do ta luajnë së bashku lojën në çifte. Njëri nga nxënësit e thotë një mbiemër në shkallën pohore, kurse tjetri e formon shkallën krahasore dhe sipërore.
*Pohore: Trëndafilat blu janë të rrallë.*
*Krahasore: Trëndafilat blu janë më të rrallë, se trëndafilat e verdhë.*
*Sipërore: Trëndafilat blu janë më të rrallët.*

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të mbiemrit dhe përdorimit të drejtë të mbiemrit.

**Detyrë:**
(Prezantim i njohurive për mbiemrin në PowerPoint)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 51

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2


të zbehtë që po afrohej nga qielli. Drita u ndal afër çadrës së tij. Ishte një kalë i bardhë me krahë dhe me një bri në majë të kokës. Menjëherë e kuptoi: Athina ishte perëndi e luftës dhe ajo e donte luftën pa masë dhe dëshironte që të shihte luftëra të barabarta. Tani po e ndihmonte princin duke ia dërguar Pegazin.
Pegazi, ndërkaq, i përplasi këmbët përtokë dhe hingëlliu. I bëri me kokë princit dhe ky shpejt e shpejt i hipi mbi shpinë. Ishin në vrap e sipër, kur ujqit e zinj bënë thirrjen për sulm. U dëgjuan thirrjet e luftëtarëve të egër që po vinin të etshëm për plaçkë lufte. Së shpejti qëlluan edhe shigjetat e furishme të luftëtarëve të egër dhe përgjigjja e fshatarëve me shigjeta, po ashtu. Pegazi u dha krahëve dhe me princin në shpinë fluturoi prapa radhëve të ushtrisë armike. Princi po e kërkonte me sy prijësin e luftëtarëve të egër.
Poshtë po bëhej një betejë e ashpër. Trima të mëdhenj të të dyja palëve po binin një nga një në fushën e blertë që sa po vinte e po skuqej nga gjaku. Princi vërejti në largësi helmetën e zezë dhe lëkurën e ujkut të prijësit të luftëtarëve të egër. Duke fluturuar mbi kalë iu afrua aq sa të mund ta qëllonte me shigjetë. Mori në shenjë. Shigjeta e qëlloi prijësin mu në zemër. Luftëtarët e egër u tmerruan kur e panë vdekjen e prijësit të tyre dhe nisën të tërhiqeshin. Fshatarët po i brohorisnin fitores së madhe. Mbi shpinën e kalit të tij magjik, princi zbriti në tokë. Ishte bërë një hero i madh i popullit të tij.
Atë natë, fshatarët festuan deri në agim. Mirëpo, Pegazin nuk e panë më kurrë. Ai ishte kthyer në malin e tij, komshi pallatit të perëndive dhe po e vazhdonte jetën e tij të përditshme të një qenieje të gjallë. Jetoi derisa u plak dhe një natë me shi ndërroi jetë i vetëm në malin e tij. Perënditë e nderuan, duke hedhur për hir të tij nga një yll në qiell. Yjet u vendosën me formën e tij. Sot e kësaj dite, netëve të kthjellëta në qiell mund të shihet imazhi i tij i vizatuar me yje.

***Bashkëbisedojmë:***

— *Në dy paragrafët e parë të kësaj përralle, janë nënvizuar disa fjalë. Këto fjalë janë mbiemra.*

— *Mbiemri emërton një tipar të emrit dhe përshtatet në gjini e në numër me të. Mbiemri ka kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shkallës.*

— *Sa i përket ndërtimit, mbiemrat ndahen në:*
- *Mbiemra të nyjshëm: i rrezikshëm, i mirë, i gjatë;*
- *Mbiemra të panyjshëm: magjik, trim.*

— *Mbiemri i përshtatet gjinisë dhe numrit të emrit, p.sh.: laps i kuq, sy të zi, vajzë trime, djem punëtorë.*

— *Mbiemrat e nyjshëm e kanë kategorinë e rasës para dhe pas emrit, kurse mbiemrat e panyjshëm vetëm kur vihen para emrit, p.sh.: djali i mirë, djali punëtor.*

74

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon llojet e mbiemrave;
- Klasifikon mbiemrat sipas ndërtimit;
- Përdor drejt mbiemrin në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptopi, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do t'i bëjnë prezantimet e punuara në PowerPoint. Në këtë formë bëhet një përsëritje e njësisë së mësuar.

Një prezantim i tillë mund të jetë ky:
*Mbiemri është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që tregon cilësi të emrit.*
*Roli i tij është të emërtojë një tipar të emrit.*



të zbehtë që po afrohej nga qielli. Drita u ndal afër çadrës së tij. Ishte një kalë i bardhë me krahë dhe me një bri në majë të kokës. Menjëherë e kuptoi: Athina ishte perëndi e luftës dhe ajo e donte luftën pa masë dhe dëshironte që të shihte luftëra të barabarta. Tani po e ndihmonte princin duke ia dërguar Pegazin.

Pegazi, ndërkaq, i përplasi këmbët përtokë dhe hingëlliu. I bëri me kokë princit dhe ky shpejt e shpejt i hipi mbi shpinë. Ishin në vrap e sipër, kur ujqit e zinj bënë thirrjen për sulm. U dëgjuan thirrjet e luftëtarëve të egër që po vinin të etshëm për plaçkë lufte. Së shpejti qëlluan edhe shigjetat e furishme të luftëtarëve të egër dhe përgjigjja e fshatarëve me shigjeta, po ashtu. Pegazi u dha krahëve dhe me princin në shpinë fluturoi prapa radhëve të ushtrisë armike. Princi po e kërkonte me sy prijësin e luftëtarëve të egër.

Poshtë po bëhej një betejë e ashpër. Trima të mëdhenj të të dyja palëve po binin një nga një në fushën e blertë që sa po vinte e po skuqej nga gjaku. Princi vërejti në largësi helmetën e zezë dhe lëkurën e ujkut të prijësit të luftëtarëve të egër. Duke fluturuar mbi kalë iu afrua aq sa të mund ta qëllonte me shigjetë. Mori në shenjë. Shigjeta e qëlloi prijësin mu në zemër. Luftëtarët e egër u tmerruan kur e panë vdekjen e prijësit të tyre dhe nisën të tërhiqeshin. Fshatarët po i brohorisnin fitores së madhe. Mbi shpinën e kalit të tij magjik, princi zbriti në tokë. Ishte bërë një hero i madh i popullit të tij.

Atë natë, fshatarët festuan deri në agim. Mirëpo, Pegazin nuk e panë më kurrë. Ai ishte kthyer në malin e tij, komshi pallatit të perëndive dhe po e vazhdonte jetën e tij të përditshme të një qenieje të gjallë. Jetoi derisa u plak dhe një natë me shi ndërroi jetë i vetëm në malin e tij. Perënditë e nderuan, duke hedhur për hir të tij nga një yll në qiell. Yjet u vendosën me formën e tij. Sot e kësaj dite, netëve të kthjellëta në qiell mund të shihet imazhi i tij i vizatuar me yje.

***Bashkëbisedojmë:***

— *Në dy paragrafët e parë të kësaj përralle, janë nënvizuar disa fjalë. Këto fjalë janë mbiemra.*

— *Mbiemri emërton një tipar të emrit dhe përshtatet në gjini e në numër me të. Mbiemri ka kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shkallës.*

— *Sa i përket ndërtimit, mbiemrat ndahen në:*
- *Mbiemra të nyjshëm: i rrezikshëm, i mirë, i gjatë;*
- *Mbiemra të panyjshëm: magjik, trim.*

— *Mbiemri i përshtatet gjinisë dhe numrit të emrit, p.sh.: laps i kuq, sy të zi, vajzë trime, djem punëtorë.*

— *Mbiemrat e nyjshëm e kanë kategorinë e rasës para dhe pas emrit, kurse mbiemrat e panyjshëm vetëm kur vihen para emrit, p.sh.: djali i mirë, djali punëtor.*

74

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Nxënësit do të rikthehen te përralla e lexuar, ku mësimdhënësi do të shtrojë disa pyetje rreth saj.

- Çfarë ishin fjalët e nënvizuara?
- *Këto fjalë janë mbiemra.*
- Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?
- *E gjinisë, e numrit, e rasës dhe e shkallës.*
- Si ndahet mbiemri?
- *I nyjshëm dhe i panyjshëm.*

*Mbiemrat e nyjshëm e kanë kategorinë e rasës para dhe pas emrit, kurse mbiemrat e panyjshëm vetëm kur vihen para emrit, psh.: djalë i mirë, djalë punëtor.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditarët e të nxënit*

Nxënësit do të shkruajnë në tabelë *citim/ koment.*

| Citim | Koment |
|---|---|
| Mbiemri emërton | Një tipar të emrit |
| Mbiemri ndahet | Të nyjshëm dhe të panyjshëm |
| Mbiemri përshtatet | Gjinisë dhe numrit të emrit |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të llojeve të mbiemrit dhe përdorimit të drejtë të tij.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

______________________________________________

______________________________________________

Për mësimdhënësin/en

# Mësimi 52

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 2, II: 4, III: 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2


njësia 19
MBIEMRI

Detyrë

◇ Plotësojeni tabelën me mbiemrat nga teksti "Pegazi"!

| | |
|---|---|
| Mbiemra të nyjshëm: | |
| Mbiemra të panyjshëm: | |

◇ E bukura është:

a. emër
b. mbiemër

◇ Përshtatni mbiemrat në kllapa me emrat që lidhen në këtë tekst:

Një ditë në fshatin e tyre erdhi një fatkeqe................(i varfër), e veshur e tëra me zhele, me këmbët................(i zbathur) e të................(i çarë) nga gurët..................(i mprehtë) të rrugës. ......................(i dërrmuar) dhe ...................(i rraskapitur), ajo u ul të çlodhej nën një gështenjë.

43

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për mbiemrin;
- Përdor drejt mbiemrin në fjali;
- Dallon kategoritë gramatikore të mbiemrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë e pavarur*

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë në librin fletore pune.

*Plotësojeni tabelën me mbiemrat nga teksti "Pegazi"?*

*Mbiemra të nyjshëm:*

*Mbiemra të panyjshëm:*


◇ Çka janë njësitë me të zeza te këta mbiemra: fytyrë të bardhë e të ëmbël, shtresë e ulët, ata ishin të zeshkët e flokëzinj.

◇ Nga teksti për Pegazin, hiqini mbiemrat epitete. Shikoni si do të dalë teksti.

◇ Shkruajeni një ese pa përdorur fare mbiemra. Sa më pak mbiemra ka një tekst, aq më objektiv do të dalë.

◇ Gjejini pesë mbiemra që fillojnë me shkronjën **k** dhe pesë që fillojnë me shkronjën **l** në Fjalorin e Gjuhës Shqipe.

**Detyrë**

◇ Bashkë me arsimtarin/en, vizitoni një ekspozitë arti në galeri. Pastaj, vlerësoni veprat duke shkruar për to në fletoret tuaja. Në fund, analizoni përdorimin e mbiemrave në këtë rast.
(Përveç vizitave fizike në galeri, ju mund t'i eksploroni galeritë e ndryshme nëpër botë përmes internetit.)

44

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit në mënyrë individuale i kanë plotësuar pyetjet në *Fletore pune* në dy faqet e dhëna.

Mësimdhënësi tregon për përdorimin e mbiemrit dhe ngjyrimin që ia jep tekstit. Sa më pak që përdoren mbiemrat, teksti është më objektiv.

Nxënësit i lexojnë me radhë detyrat e bëra.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutimi*

Mësimdhënësi e bën një përsëritje të të gjithë njësisë për mbiemrin ku sillen ndërmend situatat e diskutuara që nga fillimi duke marrë shembuj të ndryshëm.
*Trimi është djalë i mirë.*
*Kjo lule është e bukur.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të mbiemrit dhe përdorimit të drejtë të mbiemrit.

**Detyrë:**
(Shkruaj disa shembuj me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 53

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 5, II: 2. 5, III: 2.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2


***Mbiemri në gjuhën shqipe i ka tri shkallë:***

- ***Shkalla pohore:*** *Moshatarët e tij i bindeshin, sepse ai ishte* ***i bukur, i shkathët****, dinte të kërcente, t'i binte fyellit.*
- ***Shkalla krahasore:*** *Ai ishte* ***më i bukur*** *se shokët.*
- ***Shkalla sipërore:*** *Ai ishte* ***jashtëzakonisht i bukur.***

- *Mbiemrat shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim emrit. Zakonisht, sa më pak mbiemra ka, aq më objektiv është teksti.*
- *Mbiemrat mund të jenë epitete - kur shprehin qëndrimin e atij që flet: p.sh. luftëtar trim, djalë i mirë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është i mirë një djalë e kur jo, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*
- *Mbiemrat mund të jenë konventa, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin - p.sh. lule e kuqe, shpatë e hekurt, me ç'rast nuk varet nga folësi cilësia e dhënë.*

***Detyrë:***

- *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët e nënvizuara?*
- *Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?*
- *Si ndahen mbiemrat për nga ndërtimi?*
- *Çfarë kategorie gramatikore kanë mbiemrat (që nuk e kanë emrat)?*
- *Me cilën pjesë të ligjëratës përshtaten mbiemrat dhe në ç'kategori?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Blerina:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë që bën fjalë për një vajzë që niset për ta vizituar gjyshen, por rrugës nuk i dëgjon këshillat e nënës dhe mashtrohet nga ujku. Kjo përrallë na mëson se fëmijët duhet të kenë kujdes nga të këqijtë që u dalin në rrugë dhe nuk duhet t'u besojnë gjithmonë të panjohurve.*

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Çatrafili:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë e mirë. Në këtë përrallë është një vajzë e bukur dhe një ujk i keq. Përrallat e mira duhet t'i lexojnë të gjithë nxënësit e dëgjueshëm.*

***Këshillë:***
*Teksti i dytë është tekst subjektiv që nuk na tregon, në të vërtetë, asgjë për përrallën. Ai i ka përdorur mbiemrat:* ***e mirë, e bukur, i keq, të dëgjueshëm*** *për të shprehur ndjenjën e vet e jo për t'u treguar të tjerëve për përmbajtjen e përrallës. Në tekste të tilla si esetë apo komentimet e teksteve, mbiemrat epitete duhet të përdoren sa më pak. Kurse në tekstet letrare mbiemrat janë të mirëpritur.*

Shih fletoren e punës

75

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon nyjen e mbiemrit;
- Përcakton llojin e mbiemrit;
- Dallon mbiemrin e nyjshëm nga ai i panyjshëm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Ora do të fillojë me rubrikën *Di*. Nxënësit do të ndahen në katër grupe. Fillimisht në rubrikën *Di* do t'i shkruajnë njohuritë e tyre të mëhershme, të cilat shkruhen edhe në tabelë.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Mbiemra quhen fjalët që shënojnë se çfarë lloji është ose çfarë vetie ka emri. | | |

Për mësimdhënësin/en



***Mbiemri në gjuhën shqipe i ka tri shkallë:***

- ***Shkalla pohore:*** *Moshatarët e tij i bindeshin, sepse ai ishte* ***i bukur, i shkathët****, dinte të kërcente, t'i binte fyellit.*
- ***Shkalla krahasore:*** *Ai ishte* ***më i bukur*** *se shokët.*
- ***Shkalla sipërore:*** *Ai ishte* ***jashtëzakonisht i bukur.***
- *Mbiemrat shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim emrit. Zakonisht, sa më pak mbiemra ka, aq më objektiv është teksti.*
- *Mbiemrat mund të jenë epitete - kur shprehin qëndrimin e atij që flet: p.sh. luftëtar trim, djalë i mirë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është i mirë një djalë e kur jo, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*
- *Mbiemrat mund të jenë konventa, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin - p.sh. lule e kuqe, shpatë e hekurt, me ç'rast nuk varet nga folësi cilësia e dhënë.*

***Detyrë:***

- *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët e nënvizuara?*
- *Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?*
- *Si ndahen mbiemrat për nga ndërtimi?*
- *Çfarë kategorie gramatikore kanë mbiemrat (që nuk e kanë emrat)?*
- *Me cilën pjesë të ligjëratës përshtaten mbiemrat dhe në ç'kategori?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Blerina:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë që bën fjalë për një vajzë që niset për ta vizituar gjyshen, por rrugës nuk i dëgjon këshillat e nënës dhe mashtrohet nga ujku. Kjo përrallë na mëson se fëmijët duhet të kenë kujdes nga të këqijtë që u dalin në rrugë dhe nuk duhet t'u besojnë gjithmonë të panjohurve.*

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Çatrafili:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë e mirë. Në këtë përrallë është një vajzë e bukur dhe një ujk i keq. Përrallat e mira duhet t'i lexojnë të gjithë nxënësit e dëgjueshëm.*

***Këshillë:***
*Teksti i dytë është tekst subjektiv që nuk na tregon, në të vërtetë, asgjë për përrallën. Ai i ka përdorur mbiemrat:* ***e mirë, e bukur, i keq, të dëgjueshëm*** *për të shprehur ndjenjën e vet e jo për t'u treguar të tjerëve për përmbajtjen e përrallës. Në tekste të tilla si esetë apo komentimet e teksteve, mbiemrat epitete duhet të përdoren sa më pak. Kurse në tekstet letrare mbiemrat janë të mirëpritur.*

Shih fletoren e punës

75

## Ndërtimi i njohurive:
## Përpunimi i përmbajtjes
*Dua të di*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë dhe të mbajnë shënime duke i vendosur të gjitha njohuritë shtesë që duan të dinë te paragrafi *Dua të di.* Një nxënës që e përfaqëson grupin do t'i shkruajë ato në tabelë.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Mbiemra quhen fjalët që shënojnë se çfarë lloji është ose çfarë vetie ka emri. | Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit? | |

## Përforcimi:
## Konsolidimi i të nxënit:
*Mësova më shumë*

Në këtë fazë të orës do të plotësohen në tabelë të gjithë paragrafët dhe do të merren shembuj ku nxënësit do të gjejnë rrokjet në fjalë.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Mbiemra quhen fjalët që shënojnë se çfarë lloji është ose çfarë vetie ka emri. | Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit? | Të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shkallës. |

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të llojeve të mbiemrave.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë shembuj të përshtatjes së mbiemrit në rasë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 54



**Mbiemri në gjuhën shqipe i ka tri shkallë:**

— ***Shkalla pohore:*** *Moshatarët e tij i bindeshin, sepse ai ishte* ***i bukur, i shkathët****, dinte të kërcente, t'i binte fyellit.*
— ***Shkalla krahasore:*** *Ai ishte* ***më i bukur*** *se shokët.*
— ***Shkalla sipërore:*** *Ai ishte* ***jashtëzakonisht i bukur.***

— *Mbiemrat shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim emrit. Zakonisht, sa më pak mbiemra ka, aq më objektiv është teksti.*

— *Mbiemrat mund të jenë epitete - kur shprehin qëndrimin e atij që flet: p.sh. luftëtar trim, djalë i mirë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është i mirë një djalë e kur jo, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*

— *Mbiemrat mund të jenë konventa, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin - p.sh. lule e kuqe, shpatë e hekurt, me ç'rast nuk varet nga folësi cilësia e dhënë.*

***Detyrë:***

— *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët e nënvizuara?*
— *Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?*
— *Si ndahen mbiemrat për nga ndërtimi?*
— *Çfarë kategorie gramatikore kanë mbiemrat (që nuk e kanë emrat)?*
— *Me cilën pjesë të ligjëratës përshtaten mbiemrat dhe në ç'kategori?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Blerina:*
— *"Kësulëkuqja" është një përrallë që bën fjalë për një vajzë që niset për ta vizituar gjyshen, por rrugës nuk i dëgjon këshillat e nënës dhe mashtrohet nga ujku. Kjo përrallë na mëson se fëmijët duhet të kenë kujdes nga të këqijtë që u dalin në rrugë dhe nuk duhet t'u besojnë gjithmonë të panjohurve.*
*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Çatrafili:*
— *"Kësulëkuqja" është një përrallë e mirë. Në këtë përrallë është një vajzë e bukur dhe një ujk i keq. Përrallat e mira duhet t'i lexojnë të gjithë nxënësit e dëgjueshëm.*

***Këshillë:***
*Teksti i dytë është tekst subjektiv që nuk na tregon, në të vërtetë, asgjë për përrallën. Ai i ka përdorur mbiemrat:* ***e mirë, e bukur, i keq, të dëgjueshëm*** *për të shprehur ndjenjën e vet e jo për t'u treguar të tjerëve për përmbajtjen e përrallës. Në tekste të tilla si esetë apo komentimet e teksteve, mbiemrat epitete duhet të përdoren sa më pak. Kurse në tekstet letrare mbiemrat janë të mirëpritur.*

Shih fletoren e punës

75

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbiemri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për mbiemrin;
- Përdor drejt mbiemrin në fjali;
- Dallon kategoritë gramatikore të mbiemrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do t'i lexojnë detyrat e shtëpisë.

Përshtatje në rasë:
*Mjeku i ri*
*I, e mjekut të ri*
*Mjekun e ri*
*Mjekja e re*
*I, e mjekes së re*
*Mjeken e re*



***Mbiemri në gjuhën shqipe i ka tri shkallë:***

- ***Shkalla pohore:*** *Moshatarët e tij i bindeshin, sepse ai ishte **i bukur, i shkathët**, dinte të kërcente, t'i binte fyellit.*
- ***Shkalla krahasore:*** *Ai ishte **më i bukur** se shokët.*
- ***Shkalla sipërore:*** *Ai ishte **jashtëzakonisht i bukur.***

- *Mbiemrat shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim emrit. Zakonisht, sa më pak mbiemra ka, aq më objektiv është teksti.*

- *Mbiemrat mund të jenë epitete - kur shprehin qëndrimin e atij që flet: p.sh. luftëtar trim, djalë i mirë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është i mirë një djalë e kur jo, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*

- *Mbiemrat mund të jenë konventa, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin - p.sh. lule e kuqe, shpatë e hekurt, me ç'rast nuk varet nga folësi cilësia e dhënë.*

***Detyrë:***

- *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët e nënvizuara?*
- *Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?*
- *Si ndahen mbiemrat për nga ndërtimi?*
- *Çfarë kategorie gramatikore kanë mbiemrat (që nuk e kanë emrat)?*
- *Me cilën pjesë të ligjëratës përshtaten mbiemrat dhe në ç'kategori?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Blerina:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë që bën fjalë për një vajzë që niset për ta vizituar gjyshen, por rrugës nuk i dëgjon këshillat e nënës dhe mashtrohet nga ujku. Kjo përrallë na mëson se fëmijët duhet të kenë kujdes nga të këqijtë që u dalin në rrugë dhe nuk duhet t'u besojnë gjithmonë të panjohurve.*

*Përmbledhja e përrallës me Kësulëkuqen, siç e ka shkruar Çatrafili:*
- *"Kësulëkuqja" është një përrallë e mirë. Në këtë përrallë është një vajzë e bukur dhe një ujk i keq. Përrallat e mira duhet t'i lexojnë të gjithë nxënësit e dëgjueshëm.*

***Këshillë:***
*Teksti i dytë është tekst subjektiv që nuk na tregon, në të vërtetë, asgjë për përrallën. Ai i ka përdorur mbiemrat: **e mirë, e bukur, i keq, të dëgjueshëm** për të shprehur ndjenjën e vet e jo për t'u treguar të tjerëve për përmbajtjen e përrallës. Në tekste të tilla si esetë apo komentimet e teksteve, mbiemrat epitete duhet të përdoren sa më pak. Kurse në tekstet letrare mbiemrat janë të mirëpritur.*

Shih fletoren e punës

75

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Në këtë fazë të orës do të bëhet një ushtrim në librin bazë me disa pyetje për mbiemrin.

1. Sa shkallë ka mbiemri?
2. Cilat janë kategoritë gramatikore të mbiemrit?
3. Si ndahen mbiemrat për nga ndërtimi?
4. Me cilat pjesë të ligjëratës përshtaten mbiemrat dhe në ç'kategori?

Një përgjigje e mundshme që mund të japin, është:

1. Shkalla pohore, shkalla krahasore dhe shkalla sipërore.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pyetja e sjell pyetjen*

Nxënësit parashtrojnë pyetje:
A i përshtatet gjinisë dhe numrit të emrit?
Mbiemri i përshtatet gjinisë dhe numrit të emrit: laps i kuq, sy të zi, vajzë trime.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të mbiemrit dhe përdorimit të drejtë të mbiemrit.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 55

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; I. 3, I. 5; III. 1; IV. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2, 5



njësia 7
DON KISHOTI LUFTON ME GJIGANTËT
Migel de Servantes

Përpara u dolën nja tridhjetë e dyzet mullinj të erës në një lëndinë. Kur i pa Don Kishoti, i tha ndihmësit të tij: "Fati na buzëqeshi, se as vetë nuk do të dinim të thurnim dëshira më mirë. Shiko, o shoku im Sanço Pança, tridhjetë gjigantë monstra na dolën përpara dhe me që të gjithë do të luftoj e do t'i mbys...
Cilët gjigantë? - pyeti Sanço Pança.
"Ata që po i sheh atje", tha i zoti. "Ata me duar të gjata, disa prej të cilëve edhe disa kilometra të gjatë".
"Madhëri", tha Sançoja."Këta nuk janë gjigantë, por janë mullinj ere dhe ato nuk janë duar, por janë krahët, të cilët shtyhen nga era dhe e rrotullojnë mokrën e mullirit".
"Po shihet, se ti nuk merr erë nga aventurat", ia ktheu Don Kishoti. "Këta janë gjigantë dhe nëse ua ke frikën shtyju tutje dhe lutu, derisa unë përfshihem në luftë të ashpër dhe të pabarabartë me ta".
Sa i tha këto fjalë e goditi me mamuze kalin e tij rrangallë, Rosinantin, dhe u nis duke shpërfillur fjalët e Sanço Pançës se këta ishin vetëm mullinj ere. As fjalët e Sanço Pançës, as afërsia e objekteve nuk ia ndërruan mendimin se këta ishin gjigantë, por nisi të thërriste: "Mos ikni tani frikacakë e krijesa të fëlliqura, se një kalorës i vetmuar ju sulet tani ".
Një puhi e lehtë nisi të frynte dhe, sakaq, krahu i mullirit nisi të rrotullohej ngadalë.
Don Kishoti u nis me galop drejt mullirit të parë, por krahu i mullirit që po rrotullohej, ia goditi me forcë shtizën dhe ia bëri copa, duke e rrëzuar kështu kalorësin me gjithë kalë. Kalorësi u rrotullua në lëndinë për faqe të zezë. Sançoja u ngut ta ndihmonte dhe, kur arriti te ai, pa se kishte mbetur nën Rosinantin.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Don Kishoti lufton me gjigantët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon tekstin biografik nga teksti autobiografik;
- Identifikon elementet biografike brenda një teksti;
- Analizon tekstin "Don Kishoti".

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fotografi të siguruara nga mësimdhënësi, romani "Don Kishoti"

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Histori.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Mësimdhënësi paraqet para klasës disa fotografi të mullinjve të erës dhe të kalorësve. Diskuton me nxënësit se çfarë mendojnë kur i shohin ato fotografi.






njësia 7
DON KISHOTI

Detyrë

◇ Përmblidhe fragmentin e romanit "Don Kishoti" në më pak se 50 fjalë.

◇ Shkruaj çfarë mendon për Don Kishotin (mendimi yt personal).

11

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Mësimdhënësi lexon me pauza tekstin "Don Kishoti", ndërsa nxënësit dëgjojnë.
Gjatë pauzës së parë ai drejton disa pyetje te nxënësit, si:
Çka do të ndodhë në vazhdim?
Çka mendoni për Don Kishotin dhe veprimet e tij?

Nxënësit përgjigjen duke i dhënë mendimet e tyre.

Mësimdhënësi diskuton bashkë me ta.

Mësimdhënësi e lexon pjesën tjetër të fragmentit dhe pastaj i pyet nxënësit:
A doli ashtu siç menduat?
Si e mendoni Don Kishotin?
Si do të vepronit po të kishit një shok të tillë si Don Kishoti? A do të ndiheshit të turpëruar?

Mësimdhënësi diskuton me nxënësit duke dhënë edhe shpjegime shtesë për romanin "Don Kishoti".

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit plotësojnë fletore punë faqe 11.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të biografisë dhe autobiografisë, identifikimin e elementeve biografike në tekst.

**Detyrë:**
(Detyrë dhe pyetje faqe 29)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 56

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; I. 3, I. 5; III. 1; IV. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2,


*Biografia e shkrimtarit*
**Migel de Servantes Savedra**
**(1547—1616)**

Migel de Servantes Savedra është shkrimtar spanjoll. Ai konsiderohet njëri ndër romancierët e parë botërorë. Romani i tij më i njohur është "Don Kishoti". Ky roman është më i përkthyeri në botë nga të gjitha romanet e tjera. Në gjuhën shqipe është përkthyer nga Fan Noli.
Para se ta shkruante "Don Kishotin", Servantesi ka qenë i marrë rob nga piratët, por është liruar pas pesë vjetësh. Ka punuar punë të ndryshme, përfshirë edhe detyrën e mbledhësit të taksave për Mbretërinë e Spanjës. Përveç "Don Kishotit", ka shkruar edhe vepra të tjera. Ka vdekur në Madrid në moshën 69-vjeçare.

*Autobiografia*
**Unë jam Ariu i Murrmë dhe kjo është një autobiografi imja e shkurtër**

Kam lindur në pyll në një familje të madhe. Familja ime është më e madhja ndër të gjitha familjet e arinjve. Kushërinj të mi jetojnë në Evropë, në Amerikë. Natyrisht, kam do të afërm edhe në Kosovë, në Malet e Sharrit.
Nëna më ka ushqyer mirë dhe unë jam bërë i fortë. I kam fituar të gjitha garat e forcës në kategorinë e arinjve.
Jam i gjatë 2 metra e gjysmë. Më i gjati në familjen time. Nejse, disa kushërinj të mi janë më të shkurtër. Qe, po e zëmë, djali i mixhës është më i vogli në familje dhe është 170 centimetra i gjatë. Unë jam i rëndë 350 kilogramë. Po ashtu, jam shumë i fuqishëm. Kam gjymtyrë të fuqishme, vrapoj me tërë shputën dhe mund të qëndroj dhe të bëj

30

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Don Kishoti

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon tekstin biografik nga teksti autobiografik;
- Dallon elementet biografike brenda një teksti;
- Shkruan tekst biografik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** romani "Don Kishoti"

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji, Histori.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i njohurive paraprake*

Mësimdhënësi e paraqet para klasës romanin "Don Kishoti" dhe pyet nxënësit për njësinë e orës së kaluar. Nxënësit në pika të shkurtra shpjegojnë për përmbajtjen e fragmentit që ata kanë lexuar një orë më parë. Po ashtu, mësimdhënësi tregon shkurtimisht për autorin e veprës dhe njëkohësisht flet për biografinë. Nxënësit e lexojnë në libër biografinë e autorit Migel de Servantes Savedra.


**Pyetje**

a. Kur ka lindur Migel Servantesi?
b. Cili është profesioni i tij?
c. Për çfarë është i njohur?
d. Cila ka qenë përvoja e Migel Servantesit me piratët?
e. Ku dhe në ç'moshë ka vdekur ai?

**Detyrë**

◇ Kërko në internet dhe shkruaje biografinë e shkrimtarit tënd të preferuar. Përmbledhe në më pak se 80 fjalë.

12

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)*

Nxënësit të ndarë në dyshe shkruajnë një tekst biografik për njëri-tjetrin.

Secila nga dyshet i lexon me zë biografitë, të cilat i ka shkruar.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit plotësojnë fletore punë faqe 12 dhe 13.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të biografisë dhe autobiografisë, identifikimin e elementeve biografike në tekst.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 57

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia dhe autobiografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; II- 1, 2, 7, 8; III- 1, 2, 3, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 1,2; II:3; III: 1,2,3,4,5,6.


njësia 40

RRËFIMI PËR KILIAN MBAPENË

Kilian Mbapeja ka lindur më 1998 në kryeqytetin e Francës, në Paris. Babai i tij ishte emigrant nga Kameruni, i cili kishte ardhur për të jetuar në Francë. Nëna e tij ka origjinë nga Algjeria. Kilian Mbapeja është rritur në lagjen Bondi në Paris dhe nisi të luante futboll në skuadrën e lagjes qysh në moshën 6-vjeçare. Ai dallohej nga futbollistët e tjerë për shpejtësinë e tij dhe aftësinë për të dribluar me top.

Më pas, ishte ftuar të stërviste në institutin Klerfonten, që është qendër kombëtare franceze për zhvillimin e futbollistëve të dalluar. Aty ka qëndruar disa vjet. Shumë klube të rëndësishme kishin dëshirë ta merrnin në skuadër Mbapenë e ri. Ai zgjodhi të luante me skuadrën e Monakos. Ishte 15-vjeçar atëherë. Luante fillimisht me skuadrën e të rinjve të Monakos.

Pa i mbushur 16 vjet, e luajti lojën e parë zyrtare me skuadrën e të rriturve të Monakos. Pa i mbushur 17 vjet, ai u bë i famshëm, pasi luajti një stinor të plotë me Monakon, si startues. Shënoi 15 gola atë vit dhe ishte golashënuesi i pestë në kategorinë e parë të Francës. Atë vit skuadra e tij doli kampione e Francës dhe arriti deri në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Zuri vend edhe në përfaqësuesen e Francës.

Më pas ka bërë një karrierë të madhe. Konsiderohet ndër futbollistët më të mirë në botë.

Lexo dhe përmblidh

1. Për kë bëhet fjalë në këtë tekst?
2. Çfarë origjine ka ai?
3. Me se dallohej ai nga fëmijët e tjerë?
4. Çfarë profesioni ka ai?
5. Kur u bë i famshëm?
6. Si u bë i famshëm?
7. Çfarë ka bërë ai më pas dhe cila është vlera e punës së tij?

141

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrëfimi për Kilian Mbapenë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon elementet biografike në tekst;
- Dallon veçoritë e një sportisti të famshëm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Pyetjet e mundshme:
Cili sport ju pëlqen?
Pse ju pëlqen ai sport?
Cili nga sportistët ju pëlqen më shumë?
Sa dini për jetën e sportistëve të famshëm?
Diskutohen përgjigjet e tyre.


njësia 40

RRËFIMI PËR KILIAN MBAPENË

Kilian Mbapeja ka lindur më 1998 në kryeqytetin e Francës, në Paris. Babai i tij ishte emigrant nga Kameruni, i cili kishte ardhur për të jetuar në Francë. Nëna e tij ka origjinë nga Algjeria. Kilian Mbapeja është rritur në lagjen Bondi në Paris dhe nisi të luante futboll në skuadrën e lagjes qysh në moshën 6-vjeçare. Ai dallohej nga futbollistët e tjerë për shpejtësinë e tij dhe aftësinë për të dribluar me top.

Më pas, ishte ftuar të stërviste në institutin Klerfonten, që është qendër kombëtare franceze për zhvillimin e futbollistëve të dalluar. Aty ka qëndruar disa vjet. Shumë klube të rëndësishme kishin dëshirë ta merrnin në skuadër Mbapenë e ri. Ai zgjodhi të luante me skuadrën e Monakos. Ishte 15-vjeçar atëherë. Luante fillimisht me skuadrën e të rinjve të Monakos.

Pa i mbushur 16 vjet, e luajti lojën e parë zyrtare me skuadrën e të rriturve të Monakos. Pa i mbushur 17 vjet, ai u bë i famshëm, pasi luajti një stinor të plotë me Monakon, si startues. Shënoi 15 gola atë vit dhe ishte golashënuesi i pestë në kategorinë e parë të Francës. Atë vit skuadra e tij doli kampione e Francës dhe arriti deri në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Zuri vend edhe në përfaqësuesen e Francës.

Më pas ka bërë një karrierë të madhe. Konsiderohet ndër futbollistët më të mirë në botë.

Lexo dhe përmblidh

1. Për kë bëhet fjalë në këtë tekst?
2. Çfarë origjine ka ai?
3. Me se dallohej ai nga fëmijët e tjerë?
4. Çfarë profesioni ka ai?
5. Kur u bë i famshëm?
6. Si u bë i famshëm?
7. Çfarë ka bërë ai më pas dhe cila është vlera e punës së tij?

141

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Paraqiten disa fjalë kyçe.
Futbollist, francez, i famshëm.
Pyetja: Për cilin futbollist mendoni se bëhet fjalë?
Çka dini për jetën e tij?
Lexohet pjesa e parë e mësimit.
Pyetjet:
Ishin të sakta përgjigjet tuaja?
Ku luante deri në moshën 15 vjeçare?
Lexohet pjesa e dytë.
Pyetjet:
Ishin të sakta përgjigjet tuaja?
Kur fillon të luajë në kombëtaren e Francës?
Sa gola ka shënuar në kategorinë e parë të Francës?
Lexohet edhe pjesa e tretë.
Pyetja:
Ishin të sakta përgjigjet tuaja?

Bashkëbisedim

Cilat informata i dinit dhe cilat i mësuat pasi e lexuat tekstin?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim*

Lexo dhe përmblidh:
1. Për kë bëhet fjalë në tekst?
2. Çfarë origjine ka ai?
3. Çfarë profesioni ka ai?
4. Kur u bë i famshëm?
5. Çfarë ka bërë ai më pas dhe cila është vlera e punës së tij?

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të veçorive të një sportisti të suksesshëm.

**Detyrë:**
(Lexoni për jetën e ndonjë sportisti të famshëm)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 58

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia dhe autobiografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; II- 1, 2, 7, 8; III- 1, 2, 3, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 1,2,3,4; II:1,2,3,4; III: 1,2,3,4,5,6,7.


**Njih gramatikën dhe leksikun**

1. Gjeji përemrat në tekstin e mësipërm!
2. Gjeji foljet në tekstin e mësipërm!
3. Gjeni mbiemrat në tekstin e mësipërm!

**Detyrë:**

- *Shkruani një tekst me tri ose katër fjali, me fjalë tuajat, duke i shfrytëzuar të dhënat e tekstit të mësipërm.*
- *Gjeni të dhëna shtesë në internet dhe plotësojeni tekstin e mësipërm, duke e ilustruar karrierën e mëpasme të protagonistit.*

142

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrëfimi për Kilian Mbapenë - ushtrime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Harton tekst biografik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Veprimtari në grupe*

Ndahen në katër grupe: katërshe e pesëshe.
Secilit grup i jepet një fotografi e ndarë në copëza.
Kërkesa: bashkoni copëzat e përziera dhe plotësoni mozaikun.

Pyetja: Kush gjendet në foto?





**Njih gramatikën dhe leksikun**

1. Gjeji përemrat në tekstin e mësipërm!
2. Gjeji foljet në tekstin e mësipërm!
3. Gjeni mbiemrat në tekstin e mësipërm!

***Detyrë:***

- *Shkruani një tekst me tri ose katër fjali, me fjalë tuajat, duke i shfrytëzuar të dhënat e tekstit të mësipërm.*
- *Gjeni të dhëna shtesë në internet dhe plotësojeni tekstin e mësipërm, duke e ilustruar karrierën e mëpasme të protagonistit.*

142

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rrjeti i diskutimit*

Ndahen në grupe: katërshe e pesëshe.

Kërkesa:

- Shkruani një tekst me pesë ose gjashtë fjali tuajat duke i shfrytëzuar të dhënat e tekstit "Rrëfimi për Kilian Mbapenë".
- Shtoni informata që i dini e që nuk janë në tekst.




**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Turi i galerisë*

Punimet e nxënësve paraqiten në formë ekspozite. Secili grup e viziton punimin e grupit tjetër dhe japin komentet e tyre rreth punimit duke i shkruar ato.

Secili grup e lexon punimin e tij, së bashku me komentet e grupeve të tjera.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e hartimit të një teksti biografik.

**Detyrë:**
(Lexoni për jetën e ndonjë sportisti të famshëm)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 59

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë dhe të pacaktuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I- 1, 2, 3, 4, 5; II- 1, 2, 3; III- 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 2; 2. 4; 3. 1, 2.



njësia 22
PËREMRI

Nga Jeff Kinney
**DITARI I GREGUT**

*(Gregu ka ftuar shokun e tij, Roulin, për ta ndihmuar që ta kosisë barin në oborrin e zonjës Kenfild. Ai i ka propozuar shokut të tij që përmes kositjes së barit të bëjnë biznes, për të fituar para.)*

***Dita e kositjes***

*Unë i thashë Roulit të fillonte për ta kositur barin, derisa unë të pushoja nën hije, duke menduar për rritjen e biznesit. Atij s'i pëlqeu propozimi im. Ai tha se kishim biznes të përbashkët dhe se duhet të punonim sa unë, sa ai. Unë u befasova. Kositja e barit ishte ideja ime. Nuk ishte ideja e tij. Prandaj, unë duhet të isha njëfarë shefi e jo partner i barabartë me të. I thashë Roulit se dikush duhet të punojë e dikush të mendojë dhe t'i mbledhë paratë.*

*Pjesë nga seria e librave "Ditari i Gregut" Jeff Kinney (Ideart Botime)*

*Merre me mend, veç për kaq u hidhërua dhe e la punën.*
*Ta dini, nëse Rouli më kërkon ndonjëherë referencë pune, do ta shkruaj një referencë negative për të.*
*Nuk më duhet ai. Kur biznesi të lulëzojë, do të kem 100 të tillë si ai.*
*Mirëpo, ndërkohë, duhet ta kosis barin në oborrin e zonjës Kensfild.*
*Unë e lexova doracakun për përdorimin e kositëses elektrike të barit. E ndeza motorin. Ai nisi të punonte.*

80

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemri (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan njohuritë për përemrat vetorë;
- Identifikon përemrat sipas gjinisë, numrit dhe rasës;
- Krijon fjali me përemrat vetorë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

- Çfarë dini për përemrat vetorë?

Mendimet e tyre paraqiten në tabelë.




Për mësimdhënësin/en



***Bashkëbisedojmë:***

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Teksti i dhënë në libër ndahet në dy pjesë.
Pyetjet për pjesën e parë:
- Çfarë janë përemrat?
- Cilat kategori gramatikore i kanë përemrat?
- Cilët janë përemrat vetorë?

Pyetjet për pjesën e dytë:
- Cilët përemra nuk kanë gjini?
- Cilat rasa kanë trajta të shkurtra?
- Klasifiko përemrat sipas gjinisë.
- Klasifiko përemrat sipas numrit.

Lakojnë ndonjërin nga përemrat në fletore.
E. unë
Gj. -
Dh. mua, më
K. mua, më
Rr. prej meje

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë nga dy fjali me përemrat: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.
Ja një shembull:
Mua më dha një libër.
Ti lexon shumë.
Neve na njoftuan.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të peremrave vetorë, klasifikimin e përemrave sipas gjinisë, numrit dhe rasës dhe për shkrimin e lirë.

**Detyrë:**
(Shkruajnë një fletë ditari, ku do t'i përdorin dhe nënvizojnë përemrat vetorë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 60

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, të pacaktuar, vetvetorë dhe lidhorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I- 1, 2, 3, 4, 5; II- 1, 2, 3; III- 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.



***Bashkëbisedojmë:***

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemri vetor (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon trajtat e shkurtra të përemrit vetor sipas rasës;
- Identifikon përemrin dhe trajtat e shkurtra të përemrit vetor;
- Krijon fjali me përemër vetor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Disa nxënës i lexojnë detyrat e shtëpisë dhe së bashku me ta shqyrtohet identifikimi i përemrave vetorë. Shqyrtohet nëse janë përdorur drejt përemrat dhe trajtat e shkurtra sipas rasës, numrit e gjinisë.



**Bashkëbisedojmë:**

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Harta e koncepteve*

Vendosen trajtat e shkurtra sipas rasës.

*Rasa dhanore - kujt?*




*Rasa kallëzore - kë?*



Pas vendosjes së trajtave të shkurtra, formojnë fjali me ndonjërën nga to.
Ja një shembull:
Mua më duhet ai libër.
Ty të duhet një libër.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditari dypjesësh*

Shkruhen shembuj nga mësuesi.

| Fjalia | Përemri vetor |
|---|---|
| Ai të pa në bibliotekë. | ai, të |
| Ma bleve ti librin? | ma, ti |
| | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e përemrit vetor, klasifikimin e trajtave të shkurtra sipas rasës dhe përdorimin e tyre në fjali.

**Detyrë:**
(Shkruajnë një fletë ditari)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 61

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Përemri

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, të pacaktuar, vetvetorë dhe lidhorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I- 1, 2, 3, 4, 5; II- 1, 2, 3; III- 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemri vetvetor dhe dëftor



***Bashkëbisedojmë:***

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan njohuritë që ka për përemrin vetvetor e dëftor;
- Shkruan fjali duke i përdorur përemrat dëftorë e vetvetorë;
- Identifikon përemrin vetvetor e dëftor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Diskutohet me nxënës rreth njohurive që kanë për përemrat dëftorë e vetvetorë.
U drejtohet pyetja:
Çfarë dini për përemrat dëftorë e vetvetorë?
Idetë e tyre paraqiten në tabelë.




Për mësimdhënësin/en



**Bashkëbisedojmë:**

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-analizo-plotëso*

Nxënësit lexojnë informacione nga teksti lidhur me përemrat dëftorë e vetvetorë.
Lexojnë se cilat fjalë janë përemra dëftorë, pas kësaj udhëzohen t'i lakojnë një ose dy përemra.
Sqarohet se kur përemrat: ai, ajo, ata, ato janë dëftorë e kur përemra vetorë (vetorët zëvendësojnë një emër të përmendur më parë dhe mund të përdoren pa anistore, psh. me ata me ta, kurse dëftorët shoqërohen me emër dhe mund të vendoset pas tyre ndajfolja e vendit: ai djalë, ai atje).
Njëjtë veprohet edhe me përemrin vetvetor.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Shkruajnë një tekst ku do t'i përdorin përemrat: dëftorë, vetorë e vetvetorë.
Disa nxënës i lexojnë punimet e tyre dhe i identifikojnë përemrat.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e përemrit dëftor e vetvetor dhe për shkrimin e lirë.

**Detyrë:**
(Përshkruaje një ditë, përdor dhe nënvizo përemrat dëftorë e vetvetorë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 62

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përemrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, të pacaktuar, vetvetorë dhe lidhorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I- 1, 2, 3, 4, 5; II- 1, 2, 3; III- 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.



***Bashkëbisedojmë:***

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë *kryesore:* ***që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemrat pronorë dhe pyetës.

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan njohuritë për përemrat;
- Kategorizon përemrat sipas gjinisë, numrit dhe rasës;
- Rendit fisha me përemra pronorë e pyetës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë pune, fisha

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësve u drejtohet pyetja:
- Çfarë dini për përemrat pronorë dhe pyetës?

Mendimet e nxënësve paraqiten në tabelë.




Për mësimdhënësin/en


**Bashkëbisedojmë:**

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë ***kryesore: që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-analizo-plotëso*

Nxënësit udhëzohen që nga teksti në fletën e punës, ku janë nënvizuar përemrat pronorë e pyetës, t'i klasifikojnë në tabelë.

| Përemër | Pyetës | Pronor |
|---|---|---|
| kush | + | |
| ynë | | + |
| | | |

Nxënësit pas kësaj i analizojnë kategoritë gramatikore të përemrave. Përemrat: ç dhe çfarë nuk kanë asnjë kategori.
Lakojnë përemrin kush?
Sqarohet se përemri pronor siç shihet edhe në tekst mund të përdoret vetëm ose bashkë me emrin.
Libri im është i ri.
Yni është ky vend.
Roli i përemrit pronor kur është bashkë me emër është përcaktor.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në grupe*

Nxënësve në grupe u shpërndahen fisha me lakimin e përemrave pronorë e pyetës nëpër rasa.
Renditen fishat dhe zbulohet mënyra e lakimit të përemrave pronorë e pyetës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e përshkrimit të përemrave pronorë e pyetës, saktësinë e identifikimit dhe renditjen e përemrave.

**Detyrë:**
(Lakojnë disa përemra)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 63

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përemrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, të pacaktuar, vetvetorë dhe lidhorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.


***Bashkëbisedojmë:***

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë *kryesore:* ***që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës



## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemri lidhor dhe përemri i pacaktuar

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon përemrin lidhor dhe të pacaktuar;
- Identifikon kategoritë gramatikore të përemrave;
- Krahason përemrin lidhor me përemrin e pacaktuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*

Shpërndahen fletët e përgatitura me tekst të dhënë, ku përemrat e pacaktuar e lidhorë janë të nënvizuar dhe nxënësit do të provojnë t'i zëvendësojnë me emra.
Ja një shembull:
Dikush mungoi sot. Artani mungoi sot. Diçka u thye. Gota u thye.



**Bashkëbisedojmë:**

*Përemri*

Përemri tregon në mënyrë të përgjithshme sende, tipare ose sasi të pacaktuar. Ata, në tërësi, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

1. ***Përemrat vetorë*** *janë përemrat që tregojnë veta të ndryshme:* ***unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.***
2. ***Përemrat vetvetorë*** *janë përemrat që e tregojnë vetën, ata mbi të cilët ushtrohet një veprim dhe ata që e kryejnë këtë veprim:* ***vetja, vetvetja.***
3. ***Përemrat dëftorë*** *janë përemrat që tregojnë sende, frymorë që ndodhen afër ose larg folësit:* ***ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto, i këtillë, i atillë, i tillë.***
4. ***Përemrat pronorë*** *tregojnë se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar:* ***im, jote, yt, i tij, ynë, tuaj, tanë, tonë.***
5. ***Përemrat pyetës*** *janë përemrat me të cilët pyetet për frymorë apo për sende:* ***kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati.***
6. ***Përemrat lidhorë*** janë përemrat që e lidhin një fjali të varur me fjalinë *kryesore:* ***që, i cili, çka.***
7. ***Përemrat e pacaktuar*** janë përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo për frymorë: ***kush, dikush, ndonjë, asnjë, diçka, gjithfarë, kurrgjë, gjithë, secili.***

***Lakimi i përemrave vetorë***

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *E. unë* | *ti* | *ai* | *ajo* | *ne* | *ju* | *ata* | *ato* |
| *Gj. -* | *-* | *i, e atij* | *i, e asaj* | *-* | *-* | *i, e atyre* | *i, e atyre* |
| *Dh. mua, më* | *ty të* | *atij, i* | *asaj, i* | *neve, na* | *juve, ju* | *atyre, u* | *atyre, u* |
| *K. mua, më* | *ty, të* | *atë, e* | *atë, e* | *ne, na* | *ju, ju* | *ata, i* | *ato, i* |
| *Rr. (prej) meje* | *teje* | *atij* | *asaj* | *nesh* | *jush* | *atyre* | *atyre* |

Shih fletoren e punës

82

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në tekst informacionet se çfarë janë përemrat lidhorë dhe të pacaktuar.
Pyetjet për pjesën e parë:

- Çfarë janë përemrat lidhorë?
- Provoni ta lakoni përemrin *që* dhe *i cili,* cili mund të lakohet?
- Si lakohet përemri *i cili?* (nxënësit e lakojnë në fletore)
- Cilat kategori gramatikore i ka përemri lidhor *i cili?*

Pyetjet për pjesën e dytë:

- Cilët shënojnë frymorë e cilët sende?
- A lakohen të gjithë përemrat e pacaktuar?
- Si lakohet përemri *të gjithë?* (shënojnë lakimin në fletore)
- Lakojnë në fletore ndonjërin nga përemrat e pacaktuar dhe përemrin lidhor *e cila.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diagrami i Venit*

Nxënësit e krahasojnë përemrin lidhor me përemrin e pacaktuar.

Përemri lidhor — Përemri i pacaktuar



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shpjegimit të përemrave të pacaktuar e lidhorë, saktësinë e identifikimit dhe krahasimin e tyre.

**Detyrë:**
(Nënvizojnë përemrat në tekstin "Ditari i Gregut")

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 64



njësia 21

PËREMRI

**Detyrë**

◇ *Shkruaj në fletore një faqe ditari, sipas modelit të Gregut. (Zgjidhe një ditë interesante të jetës sate.)*

**Detyrë**

◇ *Gjej përemrat në ditarin e Gregut dhe trego secili prej tyre çfarë përemri është. Gjej përemrat në faqen tënde të ditarit dhe trego secili prej tyre çfarë përemri është. (Provo t'i zëvendësosh me emra.)*

**Pyetje**

1. *Çfarë pjese e ligjëratës janë fjalët me shkronja të zeza?*
2. *Cilat janë kategoritë gramatikore të përemrit?*
3. *Sa lloje përemrash ka gjuha shqipe?*
4. *Cilën rasë nuk e kanë përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë?*
5. *Si quhen përemrat që tregojnë në mënyrë të pacaktuar për sende apo frymorë?*

◇ *Trego llojin e përemrave që përdoren në tekstin e mësipërm: ai, ne, çfarë, cili që, vetvetja, ky, kjo, vetja, ajo, në, ata, dikush, askush, jote, ynë, im, i tillë, kush.*

| p. vetorë | p. vetvetorë | p. dëftorë | p. pronorë | p. pyetës | p. lidhorë | p. të pacaktuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

46

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Përemrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon dhe përdor drejt përemrat: vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, të pacaktuar, vetvetorë dhe lidhorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I- 1, 2, 3, 4, 5; II- 1, 2, 3; III- 3, 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përemri (ora VI)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon llojin e përemrave;
- Lakon përemrin;
- Dallojnë veçoritë gramatikore të përemrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shqyrtim i përbashkët*

Nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë dhe diskutohet nëse i kanë gjetur saktë përemrat në tekstin "Ditari i Gregut".



◇ *Me cilin përemër lidhor mund të zëvendësohet përemri me shkronja të zeza në këtë tekst:*

*Në ëndrra dëgjonte bubullimat e tmerrshme, e shihte flakën* ***që*** *rrëmbente çdo gjë dhe menjëherë e bënte shpuzë, ujërat* ***që*** *vërshonin, plasaritjet e pambarim hapeshin nëpër tokë, shkëmbinjtë rrokulliseshin nga të gjitha anët, nga toka e fortë përnjëherë hapeshin humbella mu përpara syve të tij, kaosi i rrënimit të përgjithshëm shfaqej i plotë në ëndërr e nëpër të bukuria* ***që*** *zhdukej.*

◇ *Lakoni nëpër rasa përemrin* ***dikë:***

***E.*** ______________________

***Gj.*** ______________________

***Dh.*** ______________________

***K.*** ______________________

***Rr.*** ______________________

◇ *Gjeni përemrat që e ndryshojnë formën e tyre gjatë lakimit:* ***cili, dikë, kurrfarë, kurrkush, tjetër, kurrgjë.***

***Detyrë***

◇ *Ndahuni në grupe në klasë. Krijoni një "skenar" që do ta luani në role, ku të demonstroni përdorimin e llojeve të ndryshme të përemrave.*

47

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analiza e tipareve semantike*

Shpërndahen organizuesit grafikë te secili grup dhe udhëzohen t'i plotësojnë sipas kërkesës.
Pas plotësimit lexojnë para klasës.

| permeri | vetor | dëftor | pyetës | lidhor | vetvetor | pronor | i pacaktuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ç' | | | + | | | | |
| Çdo | | | | | | | + |
| të cilin | | | | + | | | |
| më | + | | | | | | |
| ynë | | | | | | + | |
| vete | | | | | + | | |
| këtij | | + | | | | | |

Vazhdohet me pyetjet në fletore pune, detyra 3 dhe 4, faqe 46.
Nxënësit përgjigjen shpejt në pyetjet, më pas i klasifikojnë përemrat e dhënë sipas llojit.
Shembull: ky, kjo, i tillë - përemra dëftorë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit e plotësojnë lakimin e përemrit dikë, në fletore pune dhe, në detyrën tjetër i gjejnë përemrat që e ndryshojnë formën gjatë lakimit.
Pas përfundimit, i shkëmbejnë librat në dyshe, kontrollojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit dhe lakimit të përemrave.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Për mësimdhënësin/en

# Mësimi 65


*Biografia e shkrimtarit*
**Migel de Servantes Savedra**
**(1547—1616)**

Migel de Servantes Savedra është shkrimtar spanjoll. Ai konsiderohet njëri ndër romancierët e parë botërorë. Romani i tij më i njohur është "Don Kishoti". Ky roman është më i përkthyeri në botë nga të gjitha romanet e tjera. Në gjuhën shqipe është përkthyer nga Fan Noli.
Para se ta shkruante "Don Kishotin", Servantesi ka qenë i marrë rob nga piratët, por është liruar pas pesë vjetësh. Ka punuar punë të ndryshme, përfshirë edhe detyrën e mbledhësit të taksave për Mbretërinë e Spanjës. Përveç "Don Kishotit", ka shkruar edhe vepra të tjera. Ka vdekur në Madrid në moshën 69-vjeçare.

*Autobiografia*
**Unë jam Ariu i Murrmë dhe kjo është një autobiografi imja e shkurtër**

Kam lindur në pyll në një familje të madhe. Familja ime është më e madhja ndër të gjitha familjet e arinjve. Kushërinj të mi jetojnë në Evropë, në Amerikë. Natyrisht, kam do të afërm edhe në Kosovë, në Malet e Sharrit.
Nëna më ka ushqyer mirë dhe unë jam bërë i fortë. I kam fituar të gjitha garat e forcës në kategorinë e arinjve.
Jam i gjatë 2 metra e gjysmë. Më i gjati në familjen time. Nejse, disa kushërinj të mi janë më të shkurtër. Qe, po e zëmë, djali i mixhës është më i vogli në familje dhe është 170 centimetra i gjatë. Unë jam i rëndë 350 kilogramë. Po ashtu, jam shumë i fuqishëm. Kam gjymtyrë të fuqishme, vrapoj me tërë shputën dhe mund të qëndroj dhe të bëj

30

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia dhe autobiografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrae si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2, 3; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 2, 3; 3. 1, 2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Autobiografia (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon një ngjarje në vetën e parë;
- Përmbledh ngjarjen e përjetuar;
- Krahason me tekste të tjera.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri, mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Biologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Nxënësit pyeten: "A keni shkruar ndonjëherë për veten tuaj?"
Një përgjigje e mundshme: "Jo, vetëm e kam përshkruar veten time me fjalë." ose "Po."
Udhëzohen nxënësit ta shfletojnë librin për tekstin e dhënë.



hapa edhe duke qëndruar arithi (bile edhe vetë kjo fjalë në gjuhën shqipe ka lindur prej fjalës ari) - pra, në dy këmbët e prapme. Në gishtërinj kam kthetra të mprehta që më shërbejnë për t'u ngjitur nëpër drurë dhe për gjah. Më pëlqen mjalti. Natyrisht, nuk jam vegjetarian dhe më pëlqen edhe mishi, ndonëse herë-herë mund të ha edhe ndonjë bimë sa për sallatë. Gruaja ime, Harushahja, kujdeset për fëmijët. Ajo i lind 2-3 fëmijë në vit. Ne arinjtë mund të jetojmë deri në 35 vjet.
T'ju them të drejtën, dimrin nuk e dua hiç. Gjatë dimrit ia kërcas gjumë dhe nuk zgjohem deri në pranverë. Prandaj, thonë se bëj gjumë dimëror. Mirëpo, sivjet diçka nuk po më zë gjumi dhe thashë ta shkruaj këtë autobiografi.

***Detyrë:***

— *Mbështetur në tekstin e mësipërm...*
*a) Ku jetojnë arinjtë e murrmë?*
*b) Sa mund të jetë gjatësia e arinjve të murrmë dhe sa mund të jetë pesha e tyre?*
*c) Si ecën ariu i murrmë?*
*d) Për çfarë i duhen kthetrat?*
*e) Me çfarë ushqehet një ari i murrmë?*
*f) Sa këlyshë të ariut të murrmë lindin brenda vitit?*
*g) Përse për arinjtë thonë se bëjnë gjumë dimëror?*

— *Biografia e Don Kishotit është:*
*a) Prozë*
*b) Poezi*

— *Biografia është:*
*a) Tekst letrar*
*b) Tekst joletrar*

***Bashkëbisedojmë: Biografia dhe autobiografia***

*Teksti për Servantesin është biografi.* ***Biografia*** *është një rrëfim i përmbledhur për jetën e një personi të rëndësishëm. Përfshin faktet për jetën e tij, shkollimin, veprat dhe (nëse personi ka vdekur) vdekjen. Biografinë e dikujt e tregojnë të tjerët.*
*Nëse ne shkruajmë biografinë e vetes sonë, atëherë kemi shkruar autobiografi.*
***Autobiografia*** *është një rrëfim i përmbledhur për jetën tonë, ku tregojmë për punën tonë, shkollimin, veprat, aktivitetet e ndryshme.*
*Teksti i Ariut të Murrmë është një autobiografi e letrarizuar dhe humoristike.*

***Detyrë:***

*Shkruani autobiografi dhe lexoni në klasë.*

Shih fletoren e punës

31

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim me ndalesa*

Udhëzohen nxënësit të fillojnë ta lexojnë tekstin me ndalesa.
Nxënësi i parë lexon deri te fjalia: ''Po ashtu, jam shumë i fuqishëm."
Nxënësi i dytë e lexon pjesën deri në fund të tekstit.
Nxënësit udhëzohen që në tekstin e lexuar t'i gjejnë foljet dhe të tregojnë se në cilën vetë janë përdorur.
Autobiografia është një rrëfim i përmbledhur për jetën tonë, ku tregojmë për punën, shkollimin, veprat, aktivitete të ndryshme.
Autobiografia shkruhet në vetën e parë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti diskutimit*

Nxënësit udhëzohen të tregojnë se foljet e gjetura në tekst në cilën vetë janë përdorur dhe e pyesin njëri-tjetrin për përmbajtjen e tekstit.
Diskutojnë mes vete dhe bëjnë pyetje në ndërkohë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të përmbledhjes së tregimit dhe saktësisë së përgjigjeve të dhëna.

**Detyrë:**
(Shkruani një autobiografi)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 66

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Biografia dhe autobiografia

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare dh joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 2, 3; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 2, 3; 3. 1, 2.



**Detyrë**

◇ *Shkruaj autobiografi (përmblidhe në më pak se 80 fjalë).*

**Detyrë**

◇ *Kërko në fjalor fjalët **galop, lëndinë, puhi, mamuze, rrangallë, mokër** dhe shkruaji në fletore kuptimet e tyre.*

◇ *Kërko në fjalor nga dy fjalë të reja që nisin me **b** dhe shëno kuptimet e tyre.*

◇ *Bashkë më arsimtarin/en, organizoni një aktivitet për të shikuar një film në kinemanë e qytetit. Pastaj, secili do ta përmbledhë në klasë ngjarjen e filmit, njësoj siç keni bërë me tekstet. Në fund, diskutoni për dallimet/vështirësitë.*

14

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Autobiografia (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përmbledh ngjarjen në tekste të caktuara;
- Zbaton rregullat e autobiografisë në shkrime të ndryshme;
- Krahason atë me shkrime të tjera.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Artet.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shkrim i drejtuar*

Nxënësit janë të pajisur me nga një fotografi personale dhe në bazë të fotografisë që ata kanë zgjedhur të shkruajnë për veten e tyre. Fillojnë me shkrimin e autobiografisë.
Shkrimin e tyre do ta shkruajnë në rubrikat e fletore punës dhe do ta përmbledhin me më pak se 80 fjalë.


**Detyrë**

- Shkruaj autobiografi (përmblidhe në më pak se 80 fjalë).

**Detyrë**

- Kërko në fjalor fjalët **galop, lëndinë, puhi, mamuze, rrangallë, mokër** dhe shkruaji në fletore kuptimet e tyre.
- Kërko në fjalor nga dy fjalë të reja që nisin me **b** dhe shëno kuptimet e tyre.
- Bashkë me arsimtarin/en, organizoni një aktivitet për të shikuar një film në kinemanë e qytetit. Pastaj, secili do ta përmbledhë në klasë ngjarjen e filmit, njësoj siç keni bërë me tekstet. Në fund, diskutoni për dallimet/vështirësitë.

14

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-plotëso*

Shkrimet e tyre nxënësit i shkruajnë në rubrikat përkatëse dhe i kompletojnë ato me ndihmën e mësimdhënësit.
Shpalosin njohuritë për autobiografinë.
Nxënësit udhëzohen që pas përfundimit të shkrimit të autobiografisë të gjejnë në fjalor dy fjalë me shkronjën b.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Nxënësit shkrimet e tyre i lexojnë para klasës dhe të tjerët dëgjojnë. Mund të parashtrojnë pyetje dhe të komentojnë për ndjenjat e tyre, se si i kanë përjetuar ngjarjet e shkruara.
Fjalët në fjalor nëse nuk i kanë gjetur të gjithë mund të vazhdojnë në shtëpi.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të shkrimeve të tyre dhe përmbledhjes që kanë bërë duke i krahasuar shkrimet e tyre me shkrime të tjera dhe zbatimit të rregullave për autobiografinë.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 67

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE




**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Nxënësi e dallon numërorin që tregon sasi të caktuar, dallon kategoritë gramatikore të numërorit dhe veçon drejtshkrimin e tyre, i përdor drejt në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për numërorët;
- Përdor drejt numërorin në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, tekste të ndryshme të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare, Matematikë, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësve u shpërndahet një tekst në të cilin do t'i dallojnë numërorët.
*Klasa jonë i ka tridhjetë e tre nxënës, shtatëmbëdhjetë vajza dhe gjashtëmbëdhjetë djem. Ne jemi në klasën e gjashtë dhe kemi gjashtë orë në ditë. Ne shkojmë në shkollë pesë herë në javë.*

Nxënësit i dallojnë numërorët në fjali dhe i lexojnë para klasës.
*Tridhjetë e tre, shtatëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, gjashtë, pesë.*




**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Në këtë pjesë sqarimet do t'i bëjë mësimdhënësi ku do të ketë bashkëbisedim me nxënësit.
*Numërori është fjalë e ndryshueshme e ligjëratës që tregon numër ose sasi të caktuara qeniesh ose sendesh, një, dy, tre, etj.: dy fëmijë, tri gra, katër burra.*
*Pra, kuptimi themelor i numërorëve është shënimi i sasisë së caktuar.*
*Numërorët ndahen në: numërorë të mirëfilltë apo themelorë dhe numërorë thyesorë.*
*Për nga ndërtimi ndahen në: numërorë të parmë, të përngjitur, të përbërë dhe numërorë lokucione.*
*Kemi dhe numërorë rreshtorë.*
Nxënësit marrin informacione për numërorin dhe rëndësinë e tij në fjali.
Numërorë të mirëfilltë apo themelorë: *një, dy, tre, katër, pesë.*
Numërorë thyesorë: *një e dyta, tri të katërtat, dy të gjashtat.*
Numërorë të parmë: *një, dy, tre.*
Numërorë të përngjitur: *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë.*
Numërorë të përbërë: *tridhjetë, pesëdhjetë, njëqind, dyqind.*
Numërorë lokucione: *tridhjetë e një, një mijë, një milion.*
Numërorë rreshtorë: *i pari, i dyti, i treti.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Në këtë fazë të orës nxënësit do t'i shkruajnë datat e tyre të rëndësishme, datat e lindjes së tyre, të prindërve, por edhe datat historike kombëtare dhe ndërkombëtare.
*28 Nëntori, 17 Shkurti, 7 dhe 8 Marsi.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të numërorit nga pjesët e tjera të ligjëratës dhe përdorimit të drejtë të tij.
**Detyrë:**
(Prezantim i njohurive për numërorët në PowerPoint)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 68




## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Nxënësi e dallon numërorin që tregon sasi të caktuar, dallon kategoritë gramatikore të numërorit dhe e veçon drejtshkrimin e tyre, i përdor drejt në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton llojin e numërorit;
- Përdor drejt numërorët në drejtshkrim;
- Dallon kategoritë gramatikore të numërorit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptopi, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare, Matematikë, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë e pavarur*

Në fillim të orës nxënësit do t'i bëjnë prezantimet e punuara në PowerPoint.
Një nga prezantimet mund të ishte:


Tri banane


Një mollë


Katër dardha


Shtatë luleshtrydhe



**Bashkëbisedojmë:**

- *Numrat kanë "emra". I quajmë numërorë.*
  *Numërori tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh apo qeniesh të një lloji. Numërorët kanë një tipar kryesor: dallojnë një numër nga numrat e tjerë. Kuptimi i tyre kategorial është shënimi i sasisë së caktuar.*

*Numërorët ndahen në:*
***Numërorë të mirëfilltë apo themelorë:***
- *një, dy, tre, katër, pesë etj.*

***Numërorë thyesorë:***
*një e dyta, tre të katërtat, dy të gjashtat etj.*

**Bashkëbisedojmë:**

- *Numërorët themelorë, kur përdoren si elemente të sistemit të numërimit ose në veprimet matematike, shprehin një numër abstrakt dhe nuk shoqërohen me ndonjë emër sendi. P.sh.* ***5+3+2=10****.*

  *Ata përdoren edhe si përcaktues të sasisë së emrave. P.sh.* ***tri fletore, katër libra, pesë lapsa etj.****; për të treguar datën dhe vitin:* ***më 12.VI.1992****; një periudhë të caktuar kohore:* ***në vitet '90****; orën:* ***ora ishte tetë e njëzet****.*
  *Vetëm numërori tre e ka kategorinë gramatikore të gjinisë:* ***tri vajza - tre djem****.*

  *Për nga ndërtimi, numërorët ndahen në:*

- ***Numërorë të parmë:*** *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë.*
  ***Numërorë të përngjitur:*** *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, ...nëntëmbëdhjetë.*
  ***Numërorë të përbërë:*** *tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, njëqind, dyqind, treqind etj.*
  ***Lokucione:*** *tridhjetë e një, njëqind e nëntëdhjetë e nëntë, një mijë, dy mijë, një milion etj.*
  *Ekzistojnë edhe numërorët rreshtorë:* ***i parë, i dytë, i tretë,*** *që luajnë rolin e mbiemrave.*
  *Si shkruhen numrat:*
  ***Dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e një (2371)***
  *Por:* ***trembëdhjetëvjeçar (13-vjeçar); dymbëdhjetërrokësh (12-rrokësh), dymotorësh, tremujor*** *(kur përdoren si emra ose mbiemra).*

Shih fletoren e punës

84

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit do t'i mësojnë kategoritë gramatikore të numërorit dhe drejtshkrimin e tyre.

Numërorët në përgjithësi nuk e kanë kategorinë e gjinisë, vetëm numërori tre e ka kategorinë e gjinisë.
Pesë djem – pesë vajza
Tre djem – tri vajza
Tridhjetë e tre djem – tridhjetë e tri vajza

Numërorët shkruhen me shifra dhe me fjalë:

*Një – 1*
*Dhjetë – 10*
*Njëqind – 100*
*Tridhjetë e katër – 34*

Numërori përdoret i shoqëruar me emra:
*Një flutur*
*Tre djem*
*Dymbëdhjetë metra*

I pashoqëruar me emra në veprimet matematikore:
*3 + 10 = 13*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditarët e të nxënit*

Nxënësit do të shkruajnë në tabelë *citim/ koment*

| *Citim* | *Koment* |
|---|---|
| *Kategoritë gramatikore* | *Vetëm numërori tre e ka kategorinë e gjinisë* |
| *Numërorët shkruhen* | *Me shifra dhe me fjalë* |
| *Numërori përdoret* | *I shoqëruar dhe i pashoqëruar me emra* |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të numërorit dhe përdorimit të drejtë të tij.
**Detyrë:**
(Nxënësit do të shkruajnë një tekst ku do të përdorin numërorë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 69



**Bashkëbisedojmë:**

– *Numrat kanë "emra". I quajmë numërorë.*
*Numërori tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh apo qeniesh të një lloji. Numërorët kanë një tipar kryesor: dallojnë një numër nga numrat e tjerë. Kuptimi i tyre kategorial është shënimi i sasisë së caktuar.*

*Numërorët ndahen në:*
***Numërorë të mirëfilltë apo themelorë:***
– *një, dy, tre, katër, pesë etj.*

***Numërorë thyesorë:***
*një e dyta, tre të katërtat, dy të gjashtat etj.*

**Bashkëbisedojmë:**

– *Numërorët themelorë, kur përdoren si elemente të sistemit të numërimit ose në veprimet matematike, shprehin një numër abstrakt dhe nuk shoqërohen me ndonjë emër sendi. P.sh.* ***5+3+2=10****.*

*Ata përdoren edhe si përcaktues të sasisë së emrave. P.sh.* ***tri fletore, katër libra, pesë lapsa etj.****; për të treguar datën dhe vitin:* ***më 12.VI.1992****; një periudhë të caktuar kohore:* ***në vitet '90****; orën:* ***ora ishte tetë e njëzet****.*
*Vetëm numërori tre e ka kategorinë gramatikore të gjinisë:* ***tri vajza - tre djem****.*

*Për nga ndërtimi, numërorët ndahen në:*

– ***Numërorë të parmë:*** *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë.*
***Numërorë të përngjitur:*** *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, ...nëntëmbëdhjetë.*
***Numërorë të përbërë:*** *tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, njëqind, dyqind, treqind etj.*
***Lokucione:*** *tridhjetë e një, njëqind e nëntëdhjetë e nëntë, një mijë, dy mijë, një milion etj.*
*Ekzistojnë edhe numërorët rreshtorë:* ***i parë, i dytë, i tretë,*** *që luajnë rolin e mbiemrave.*
*Si shkruhen numrat:*
***Dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e një (2371)***
*Por:* ***trembëdhjetëvjeçar (13-vjeçar); dymbëdhjetërrokësh (12-rrokësh), dymotorësh, tremujor*** *(kur përdoren si emra ose mbiemra).*

Shih fletoren e punës

84

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Nxënësi e dallon numërorin që tregon sasi të caktuar, dallon kategoritë gramatikore të numërorit dhe e veçon drejtshkrimin e tyre, i përdor drejt në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rikujton njohuritë për numërorët;
- Përdor drejt numërorin në fjali;
- Dallon kategoritë gramatikore të numërorit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** metri, peshorja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare, Matematikë, Gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë e pavarur*

Në këtë fazë të orës do të lexohen tekstet e punuara nga nxënësit.
*Para <u>një</u> viti shkolla jonë organizoi <u>një</u> shfaqje për vitin e ri. Në shfaqje morën pjesë <u>100</u> persona. Shfaqja u zhvillua në katin <u>e dytë</u> të një lokali. Nxënësit u ndanë në <u>katër</u> grupe. Ata që prezantonin, ata që bënin humor, ata që këndonin dhe ata që kërcenin. <u>Tre</u> nxënës ndihmuan në sistemimin e ulëseve. E gjithë shfaqja doli e mrekullueshme.*

Nxënësit do ta komentojnë numërorin në tekst, sa numërorë janë shkruar me fjalë dhe sa me shifra.
*<u>Një, 100, e dytë, katër, tre.</u>*



*Bashkëbisedojmë:*

- *Numrat kanë "emra". I quajmë numërorë.*
  *Numërori tregon numra abstraktë ose sasi të caktuar sendesh apo qeniesh të një lloji. Numërorët kanë një tipar kryesor: dallojnë një numër nga numrat e tjerë. Kuptimi i tyre kategorial është shënimi i sasisë së caktuar.*

*Numërorët ndahen në:*
***Numërorë të mirëfilltë apo themelorë:***
- *një, dy, tre, katër, pesë etj.*

***Numërorë thyesorë:***
*një e dyta, tre të katërtat, dy të gjashtat etj.*

*Bashkëbisedojmë:*

- *Numërorët themelorë, kur përdoren si elemente të sistemit të numërimit ose në veprimet matematike, shprehin një numër abstrakt dhe nuk shoqërohen me ndonjë emër sendi. P.sh.* ***5+3+2=10***.

  *Ata përdoren edhe si përcaktues të sasisë së emrave. P.sh.* ***tri fletore, katër libra, pesë lapsa etj.****; për të treguar datën dhe vitin:* ***më 12.VI.1992****; një periudhë të caktuar kohore:* ***në vitet '90****; orën:* ***ora ishte tetë e njëzet***.
  *Vetëm numërori tre e ka kategorinë gramatikore të gjinisë:* ***tri vajza - tre djem***.

  *Për nga ndërtimi, numërorët ndahen në:*

- ***Numërorë të parmë:*** *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë.*
  ***Numërorë të përngjitur:*** *njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, ...nëntëmbëdhjetë.*
  ***Numërorë të përbërë:*** *tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, njëqind, dyqind, treqind etj.*
  ***Lokucione:*** *tridhjetë e një, njëqind e nëntëdhjetë e nëntë, një mijë, dy mijë, një milion etj.*
  *Ekzistojnë edhe numërorët rreshtorë:* ***i parë, i dytë, i tretë,*** *që luajnë rolin e mbiemrave.*
  *Si shkruhen numrat:*
  ***Dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e një (2371)***
  *Por:* ***trembëdhjetëvjeçar (13-vjeçar); dymbëdhjetërrokësh (12-rrokësh), dymotorësh, tremujor*** *(kur përdoren si emra ose mbiemra).*

Shih fletoren e punës

84

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Përmbledhje e lidhjeve në shkencat e natyrës*

Pas leximit të detyrave do të bëhet punë praktike. Pasi tani nxënësit janë të informuar me numërorin, do të merret një peshore ku do të matet pesha trupore e disa nxënësve të klasës. Pesha e tyre do të shkruhet në tabelë.

*Anda - 50 kg*
*Era - 52 kg*
*Vlora - 48 kg*
*Kaoni - 53 kg*

Pastaj do të merret metri i siguruar po ashtu nga mësimdhënësi me të cilin do të matet gjatësia e nxënësve:

*Poema - 1.51 cm*
*Leoni - 1.54 cm*
*Akili - 1.53 cm*
*Vlera - 1.43 cm*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Mësimdhënësi e bën një përsëritje të të gjithë njësisë për numërorin ku sillen ndër mend situatat e diskutuara që nga fillimi.




## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në dallimin e saktë të kategorive gramatikore të numërorit dhe përdorimit të drejtë të tij.

**Detyrë:**
(Në librin *Fletore pune*, faqe 24 dhe 25)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 70

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan ese të ndryshme letrare e joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3 , 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4



njësia 8
ESE

***Goni shkruan ese***
Goni kishte dëgjuar shumë përralla. Kur mësuesja i kishte kërkuar të shkruante një ese në shkollë, ai kishte shkruar një ese për ujkun. Këtë ese ai ua ka dërguar me postë disa shkrimtarëve që shkruajnë përralla për fëmijë.

**NAMI I PAMERITUAR I UJKUT**

**Autor: Goni**

"Ujku ka një nam të personazhit negativ nëpër përralla dhe kjo nuk është e drejtë, sipas mendimit tim. Ujqit janë kafshë që jetojnë në pyje, kryesisht larg njerëzve dhe kanë frikë nga njerëzit, për shkak të gjuetarëve që vrasin shumë ujq.
Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.
Në përrallën me Kësulëkuqen, ujku është personazh dinak që i ha gjyshen dhe mbesën. Në përrallën me shtatë edhat, ai i ha gjashtë nga shtatë edhat. Në përrallën me tre derrkucët, ai ua prish shtëpitë dy derrkucëve të parë, dembelë.
Vetëm për shkak se ujku është kafshë e fuqishme dhe e zgjuar nuk meriton të ketë namin e personazhit më negativ të pyllit.
Prandaj, mendoj se në përrallat e ardhshme ujku do të mund të paraqitej si personazh pozitiv. Gjuetari që e vret ujkun, le të jetë personazhi negativ."

***Bashkëbisedojmë:***

*Kjo që ka shkruar Goni është një ese. Në këtë ese ai e shpreh dhe e mbron një mendim të tjin. Për ta shprehur mendimin e tij, Goni i ka ofruar edhe disa argumente.*

- *Cili është mendimi i Gonit?*
- *Cilat janë argumentet e tij për ta mbrojtur mendimin e shprehur?*
- *Çfarë propozon Goni?*

32

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ese

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon esenë nga shkrimet e tjera;
- Harton një ese duke u bazuar në esenë në libër.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqiten dy fotografi.
Kërkesa:
Ku dallojnë këto dy fotografi?
Çfarë lloji i tekstit mund të jenë?
Përgjigjet e mundshme:
Në foton e parë ka edhe vizatime dhe bëhet fjalë për kafshët, ndërsa në foton e dytë shkruhet për një temë të caktuar. E para është përrallë, kurse e dyta ese.






ESE


njësia 8
ESE

***Goni shkruan ese***
Goni kishte dëgjuar shumë përralla. Kur mësuesja i kishte kërkuar të shkruante një ese në shkollë, ai kishte shkruar një ese për ujkun. Këtë ese ai ua ka dërguar me postë disa shkrimtarëve që shkruajnë përralla për fëmijë.

**NAMI I PAMERITUAR I UJKUT**

**Autor: Goni**

"Ujku ka një nam të personazhit negativ nëpër përralla dhe kjo nuk është e drejtë, sipas mendimit tim. Ujqit janë kafshë që jetojnë në pyje, kryesisht larg njerëzve dhe kanë frikë nga njerëzit, për shkak të gjuetarëve që vrasin shumë ujq.
Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.
Në përrallën me Kësulëkuqen, ujku është personazh dinak që i ha gjyshen dhe mbesën. Në përrallën me shtatë edhat, ai i ha gjashtë nga shtatë edhat. Në përrallën me tre derrkucët, ai ua prish shtëpitë dy derrkucëve të parë, dembelë.
Vetëm për shkak se ujku është kafshë e fuqishme dhe e zgjuar nuk meriton të ketë namin e personazhit më negativ të pyllit.
Prandaj, mendoj se në përrallat e ardhshme ujku do të mund të paraqitej si personazh pozitiv. Gjuetari që e vret ujkun, le të jetë personazhi negativ."

***Bashkëbisedojmë:***

*Kjo që ka shkruar Goni është një ese. Në këtë ese ai e shpreh dhe e mbron një mendim të tjin. Për ta shprehur mendimin e tij, Goni i ka ofruar edhe disa argumente.*

- *Cili është mendimi i Gonit?*
- *Cilat janë argumentet e tij për ta mbrojtur mendimin e shprehur?*
- *Çfarë propozon Goni?*

32

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Teknika e pyetjeve të një tregimi*

Teksti në libër lexohet me katër ndalesa. Pas çdo ndalese bëhen pyetje.
Pyetjet pas ndalesës së parë:
Cili është mendimi i Gonit për ujkun?
A pajtoheni edhe ju me mendimin e Gonit?
Pyetjet pas ndalesës së dytë:
Sipas Gonit, pse shkrimtarët kanë shkruar më shumë për ujkun, sesa për ndonjë kafshë tjetër?
Për cilën kafshë tjetër keni lexuar nga shkrimtarët?
Pyetjet pas ndalesës së tretë:
Cilat janë veprimet e ujkut në parrallat e cekura në tekst nga Goni?
Pyetjet pas ndalesës së fundit:
Cili është propozimi i Gonit?
Sa e mbështetni ju propozimin e Gonit?
Cilat janë argumentet tuaja për idenë e Gonit?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ese e shkurtër*

Kërkesa:
Shkruani një ese të shkurtër me njërën nga temat:
1. “Roli i dhelprës në përrallat tona”
2. “Roli i lepurit në përrallat tona”
3. “Roli i luanit në përrallat tona”

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të argumenteve dhe në argumentimin e ideve të dhëna.
**Detyrë:**
(Shkruani një ese me temë të lirë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 71

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


**Si të shkruajmë një ese?**

**Fillojmë me një ose dy fjali që shprehin idenë kryesore.** — *Cila është ideja kryesore e Gonit?*

**Vazhdojmë me mbarështrimin që përfshin disa fjali hyrëse.** — *Në esenë e Gonit, kjo është pjesa: Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.*

**Pastaj ofrohen argumentet, në formën e fakteve ose të shembujve.** — *Në esenë e Gonit, ofrohen shembujt e Kësulëkuqes, të Ujkut dhe shtatë edhave dhe të Tre derrkucëve.*

**Në fund, ofrohet një mendim i përmbledhur që mund të jetë edhe propozim se çfarë duhet të bëhet.** — *Në esenë e Gonit, ky është propozimi që përrallat e ardhshme të shkruhen duke i pasur ujqit si personazhe pozitive e gjuetarët si personazhe negative.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A jeni dakord me idenë e Gonit? A mund të mos e lëmë gjithmonë fajtor ujkun?*
- *Bashkëbisedoni ju që jeni dakord me idenë e Gonit me ata që nuk janë dakord me atë ide. Jepni argumentet tuaja.*

***Bashkëbisedajmë: Kërkimi i fakteve***

- *Për të ditur të ofrojmë argumente duhet të gjejmë fakte.*
- *Kërkoni në internet fakte për ujkun dhe pastaj shkruajeni vetë një ese për të.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A dini ndonjë kafshë tjetër që del çdoherë negative në libra të ndryshëm. Nëse po, shkruani një tekst ku ta nxirrni si pozitive. Lexoni në klasë shkrimet tuaja dhe diskutoni për to.*

Shih fletoren e punës

33

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan ese të ndryshme letrare e joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Si të shkruajmë një ese?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon rregullat e shkrimit të esesë;
- Harton një ese sipas rregullave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Harta e koncepteve*

Vizatohet harta e koncepteve në tabelë me konceptin "ESEJA"
Kërkesë:
Plotësoni hartën e koncepteve për përkufizimin e konceptit të dhënë.




**Si të shkruajmë një ese?**

| | |
|---|---|
| **Fillojmë me një ose dy fjali që shprehin idenë kryesore.** | *Cila është ideja kryesore e Gonit?* |
| **Vazhdojmë me mbarështrimin që përfshin disa fjali hyrëse.** | *Në esenë e Gonit, kjo është pjesa: Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.* |
| **Pastaj ofrohen argumentet, në formën e fakteve ose të shembujve.** | *Në esenë e Gonit, ofrohen shembujt e Kësulëkuqes, të Ujkut dhe shtatë edhave dhe të Tre derrkucëve.* |
| **Në fund, ofrohet një mendim i përmbledhur që mund të jetë edhe propozim se çfarë duhet të bëhet.** | *Në esenë e Gonit, ky është propozimi që përrallat e ardhshme të shkruhen duke i pasur ujqit si personazhe pozitive e gjuetarët si personazhe negative.* |

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A jeni dakord me idenë e Gonit? A mund të mos e lëmë gjithmonë fajtor ujkun?*
- *Bashkëbisedoni ju që jeni dakord me idenë e Gonit me ata që nuk janë dakord me atë ide. Jepni argumentet tuaja.*

***Bashkëbisedajmë: Kërkimi i fakteve***

- *Për të ditur të ofrojmë argumente duhet të gjejmë fakte.*
- *Kërkoni në internet fakte për ujkun dhe pastaj shkruajeni vetë një ese për të.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A dini ndonjë kafshë tjetër që del çdoherë negative në libra të ndryshëm. Nëse po, shkruani një tekst ku ta nxirrni si pozitive. Lexoni në klasë shkrimet tuaja dhe diskutoni për to.*

Shih fletoren e punës

33

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di, dua të di, mësova*

Paraqitet në projektor tabela di, dua të di, mësova.
Kërkesa:
Plotësoni kolonën e parë me njohuritë që i keni, në kolonën e dytë hartoni pyetje që ju interesojnë për esenë, ndërsa kolonën e tretë do ta plotësoni pas leximit të tekstit.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Eseja paraqet një ide. Shkruhet në paragrafë. Ka argumentim, rrëfim, përshkrim. | Sa duhet të jetë e gjatë një ese? Për çfarë temash mund të shkruhet eseja? Sa lloje të eseve kemi? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ese*

Kërkesa:
Shkruani një ese me temë të lirë, sipas rregullave të shkrimit të esesë.

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të rregullave të esesë si dhe në respektimin e tyre gjatë hartimit.
**Detyrë:**
(Shkruani një ese për dhelprën, por në aspektin pozitiv)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 72

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan ese të ndryshme letrare e joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


**Si të shkruajmë një ese?**

**Fillojmë me një ose dy fjali që shprehin idenë kryesore.** — *Cila është ideja kryesore e Gonit?*

**Vazhdojmë me mbarështrimin që përfshin disa fjali hyrëse.** — *Në esenë e Gonit, kjo është pjesa: Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.*

**Pastaj ofrohen argumentet, në formën e fakteve ose të shembujve.** — *Në esenë e Gonit, ofrohen shembujt e Kësulëkuqes, të Ujkut dhe shtatë edhave dhe të Tre derrkucëve.*

**Në fund, ofrohet një mendim i përmbledhur që mund të jetë edhe propozim se çfarë duhet të bëhet.** — *Në esenë e Gonit, ky është propozimi që përrallat e ardhshme të shkruhen duke i pasur ujqit si personazhe pozitive e gjuetarët si personazhe negative.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***
— *A jeni dakord me idenë e Gonit? A mund të mos e lëmë gjithmonë fajtor ujkun?*
— *Bashkëbisedoni ju që jeni dakord me idenë e Gonit me ata që nuk janë dakord me atë ide. Jepni argumentet tuaja.*

***Bashkëbisedajmë: Kërkimi i fakteve***
— *Për të ditur të ofrojmë argumente duhet të gjejmë fakte.*
— *Kërkoni në internet fakte për ujkun dhe pastaj shkruajeni vetë një ese për të.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***
— *A dini ndonjë kafshë tjetër që del çdoherë negative në libra të ndryshëm. Nëse po, shkruani një tekst ku ta nxirrni si pozitive. Lexoni në klasë shkrimet tuaja dhe diskutoni për to.*

Shih fletoren e punës

33

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ese argumentuese

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Argumenton idenë e tij/ të saj;
- Harton ese argumentuese.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqitet një foto.
Pyetjet:
Çka po shihni në foto?
A ju pëlqejnë sportet e rrezikshme?
Nëse po, pse?
Nëse jo, pse?
Cilat nga sportet ju pëlqejnë më shumë?
Cilat nga sportet ju duken më pak të rrezikshme?





**Si të shkruajmë një ese?**

| | |
|---|---|
| **Fillojmë me një ose dy fjali që shprehin idenë kryesore.** | *Cila është ideja kryesore e Gonit?* |
| **Vazhdojmë me mbarështrimin që përfshin disa fjali hyrëse.** | *Në esenë e Gonit, kjo është pjesa: Për shkak se është i shkathët dhe i fuqishëm në mesin e kafshëve të tjera, ujku është bërë interesant për studiuesit e shkrimtarët. Për ujkun janë shkruar më shumë libra se për cilëndo kafshë tjetër. Ata, zakonisht, e paraqesin si personazh negativ.* |
| **Pastaj ofrohen argumentet, në formën e fakteve ose të shembujve.** | *Në esenë e Gonit, ofrohen shembujt e Kësulëkuqes, të Ujkut dhe shtatë edhave dhe të Tre derrkucëve.* |
| **Në fund, ofrohet një mendim i përmbledhur që mund të jetë edhe propozim se çfarë duhet të bëhet.** | *Në esenë e Gonit, ky është propozimi që përrallat e ardhshme të shkruhen duke i pasur ujqit si personazhe pozitive e gjuetarët si personazhe negative.* |

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A jeni dakord me idenë e Gonit? A mund të mos e lëmë gjithmonë fajtor ujkun?*
- *Bashkëbisedoni ju që jeni dakord me idenë e Gonit me ata që nuk janë dakord me atë ide. Jepni argumentet tuaja.*

***Bashkëbisedajmë: Kërkimi i fakteve***

- *Për të ditur të ofrojmë argumente duhet të gjejmë fakte.*
- *Kërkoni në internet fakte për ujkun dhe pastaj shkruajeni vetë një ese për të.*

***Pyetje (diskutim në klasë):***

- *A dini ndonjë kafshë tjetër që del çdoherë negative në libra të ndryshëm. Nëse po, shkruani një tekst ku ta nxirrni si pozitive. Lexoni në klasë shkrimet tuaja dhe diskutoni për to.*

Shih fletoren e punës

33

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rrjeti i diskutimit*

Ndahen në gjashtë grupe, treshe dhe katërshe.
Paraqiten vetëm tri tema:
- A është më mirë të hamë hamburger apo gjellë në shtëpi?
- A është më mirë të luajmë futboll apo basketboll?
- A duhet të luajmë videolojëra?

Kërkesa:
Tri grupet e para marrin njërën nga temat, por do të shkruajnë për argumentin PËR. Tri grupet e tjera marrin temat e njëjta, por shkruajnë për argumentin KUNDËR.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutimi i ideve*

Kërkesa:
Secili përfaqësues i grupeve të temës së njëjtë e lexon punimin dhe i mbron argumentet e grupit të vet.
Koha: pesë minuta për secilën temë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e hartimit të argumenteve pro dhe kundër si dhe për mbrojtjen e argumenteve të shkruara.
**Detyrë:**
(Ese argumentuese "Akullorja")

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 73

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ese

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Shkruan ese të ndryshme letrare e joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


njësia 8
ESE

**Detyrë**

◇ *Ndahuni në grupe nga dy dhe merreni secili prej grupeve njërën prej këtyre temave dhe shkruani ese. Njëri shkruan argumentin **për** dhe tjetri argumentin **kundër:***

- *A është më mirë të hamë hamburger apo gjellë në shtëpi?*
- *A është më mirë të luajmë futboll apo basketboll?*
- *A duhet të luajmë videolojëra?*

***(Hyrja - ideja kryesore, 2-3 fjali)***

***Detajet ose faktet***

15

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ese treguese

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon esenë treguese nga eseja argumentuese;
- Harton ese treguese.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Ese*

Paraqitet një foto.
Kërkesa:
Shkruani një ese të shkurtër duke u bazuar në ngjarjen në foto.




njësia 8
ESE

**Detyrë**

◇ Ndahuni në grupe nga dy dhe merreni secili prej grupeve njërën prej këtyre temave dhe shkruani ese. Njëri shkruan argumentin **për** dhe tjetri argumentin **kundër:**

- A është më mirë të hamë hamburger apo gjellë në shtëpi?
- A është më mirë të luajmë futboll apo basketboll?
- A duhet të luajmë videolojëra?

**(Hyrja - ideja kryesore, 2-3 fjali)**

**Detajet ose faktet**

15

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pyetje autorit*

Kërkesa:
Shkruani një ese treguese (rrëfyese) sipas rregullave me temën: “Një ngjarje e përjetuar”.
Pasi të shkruhet disa prej tyre do ta lexojnë, mirëpo të tjerët do t`i bëjnë pyetje autorit të punimit.
Disa nga pyetjet e mundshme:
Kur ka ndodhur kjo ngjarje?
A të kujtohet shpesh ngjarja?
Pse pikërisht këtë ngjarje e shkrove sot? etj.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diagrami i Venit*

Paraqitni në diagram dallimet dhe të përbashkëtat e esesë argumentuese dhe esesë treguese (rrëfyese).




**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të veçorive të eseve argumentuese e treguese si dhe në respektimin e rregullave të shkrimit të esesë.

**Detyrë:**
Ese treguese “Libri im i preferuar”

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 74

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


njësia 24
FOLJA

*Rrahman Dedaj*
**DUART MË TË BUKURA**

- Duart më të bukura ***janë*** ato që ***gatuajnë*** bukën, tha Trina.
- Ato që ***rrisin*** lulet, ***janë*** më të bukura, ***kundërshtoi*** Antigona.
- Duart më të bukura janë ato që **kanë** në gishtërinj unazat e arta, ***ndërhyri*** Trina.
- Nuk ***është*** e vërtetë, duart më të bukura i ***ka pasur*** një princeshë për të cilën më ***ka folur*** gjyshja ime. Ajo më ***thoshte*** se duart e saj ***ishin*** të bardha si qumështi dhe të buta si bari i livadhit.
- Mua më ***ka thënë*** një njeri i mirë që **ka shëtitur** tërë botën dhe ka parë lloj-lloj duarsh, të bardha... të verdha... të kuqe e të zeza se duart më të bukura ***janë*** ato që ***lahen*** në vesën e trëndafilave. Trëndafili ***është*** mbretëresha e luleve. Prandaj, duart që e ***rrisin*** dhe ***lahen*** në vesën e tyre ***janë*** më të bukurat, tha Trina.
- Unë ***kam dëgjuar*** edhe për shumë duar të tjera që ***janë*** më të bukura se këto, për të cilat të ***ka folur*** ai njeri i mirë. Për shembull, ***thuhet*** se para shumë kohësh ***ka jetuar*** një vashë flokë - gjatë që i ***binin*** deri në bel. Ajo, ***thonë,*** i ***ka pasur*** edhe duart e gjata dhe i ***këpuste*** yjet nga qielli dhe më ta i ***qëndiste*** fustanet e çupave. Ato kjo i ***gëzonte*** dhe ***thoshin*** me dashuri se si ato duar s'***ka*** në botë.Tash, ***do të pajtohesh*** edhe ti me fjalët e atyre çupave.
- S'***mund të pajtohem***, kur e ***di*** se dora më e bukur ***është*** ajo me unazë të artë, ***tha*** e vendosur Trina.
- Ty të ***duket*** ashtu, se e ***do*** unazën e artë, ***foli*** Antigona.
- Jo pse e ***dua,*** po sepse ***janë*** më të bukurat.
- Më të bukura se ato me unazë ***janë*** ato që ***bëjnë*** kukulla.
- S'***janë.***

Dhe kështu Trina e Antigona ***do të ziheshin*** ndër vete sikur para tyre ***të*** mos ***dilte*** nëna e Trinës.
- Tash ***do t'***ju tregoj unë se cilat ***janë*** duart më të bukura në botë, ***tha*** ajo ***duke buzëqeshur.***
- Më ***përqafo,*** i ***tha*** nëna Trinës.

Ajo i ***u lidh*** nënës në qafë.
Atëherë nëna ***tha:***
- Këto ***janë*** duart më të bukura në botë!

Në atë çast edhe Antigona ***vrapoi*** te nëna e saj që ***ta përqafonte, duke*** ia ***lidhur*** duart në qafë.

85

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Folja - kuptimi i përgjithshëm

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon foljen nga pjesët e tjera të ligjëratës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shkrim i lirë*

Kërkesë:
Shkruani një tregim duke përdorur këto fjalë kyçe:
Punoi, vraponte, u lëndua, pajtohet, fituan.

Lexohen disa nga punimet.



njësia 24
FOLJA

*Rrahman Dedaj*

**DUART MË TË BUKURA**

- Duart më të bukura ***janë*** ato që ***gatuajnë*** bukën, tha Trina.
- Ato që ***rrisin*** lulet, ***janë*** më të bukura, ***kundërshtoi*** Antigona.
- Duart më të bukura janë ato që **kanë** në gishtërinj unazat e arta, ***ndërhyri*** Trina.
- Nuk ***është*** e vërtetë, duart më të bukura i ***ka pasur*** një princeshë për të cilën më ***ka folur*** gjyshja ime. Ajo më ***thoshte*** se duart e saj ***ishin*** të bardha si qumështi dhe të buta si bari i livadhit.
- Mua më ***ka thënë*** një njeri i mirë që **ka shëtitur** tërë botën dhe ka parë lloj-lloj duarsh, të bardha... të verdha... të kuqe e të zeza se duart më të bukura ***janë*** ato që ***lahen*** në vesën e trëndafilave. Trëndafili ***është*** mbretëresha e luleve. Prandaj, duart që e ***rrisin*** dhe ***lahen*** në vesën e tyre ***janë*** më të bukurat, tha Trina.
- Unë ***kam dëgjuar*** edhe për shumë duar të tjera që ***janë*** më të bukura se këto, për të cilat të ***ka folur*** ai njeri i mirë. Për shembull, ***thuhet*** se para shumë kohësh ***ka jetuar*** një vashë flokë - gjatë që i ***binin*** deri në bel. Ajo, ***thonë,*** i ***ka pasur*** edhe duart e gjata dhe i ***këpuste*** yjet nga qielli dhe më ta **i *qëndiste*** fustanet e çupave. Ato kjo i ***gëzonte*** dhe ***thoshin*** me dashuri se si ato duar s'***ka*** në botë.Tash, ***do të pajtohesh*** edhe ti me fjalët e atyre çupave.
- S'***mund të pajtohem***, kur e ***di*** se dora më e bukur ***është*** ajo me unazë të artë, ***tha*** e vendosur Trina.
- Ty të ***duket*** ashtu, se e ***do*** unazën e artë, ***foli*** Antigona.
- Jo pse e ***dua,*** po sepse ***janë*** më të bukurat.
- Më të bukura se ato me unazë ***janë*** ato që ***bëjnë*** kukulla.
- S'***janë.***

Dhe kështu Trina e Antigona ***do të ziheshin*** ndër vete sikur para tyre ***të*** mos ***dilte*** nëna e Trinës.

- Tash ***do t'***ju tregoj unë se cilat ***janë*** duart më të bukura në botë, ***tha*** ajo ***duke buzëqeshur.***
- Më ***përqafo,*** i ***tha*** nëna Trinës.

Ajo i***u lidh*** nënës në qafë.

Atëherë nëna ***tha:***

- Këto ***janë*** duart më të bukura në botë!

Në atë çast edhe Antigona ***vrapoi*** te nëna e saj që ***ta përqafonte, duke*** ia ***lidhur*** duart në qafë.

85

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditari i të nxënit*

Kërkesa:
Ndani fletën në mes me një vizë, në dy kolona, të cilat do të plotësohen gjatë leximit të tekstit.
Kolona e majtë plotësohet me citatet që u pëlqejnë nga teksti, ndërsa kolona e djathtë me komentet pse u ka pëlqyer ai citat.

| Citati | Komenti |
|---|---|
| | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Pyetjet e mundshme:
Cili është subjekti i këtij tregimi?
Cila është tema e këtij tregimi?

Bashkëbisedohet rreth shkronjave me të zeza, të cilat tregojnë veprime ose gjendje dhe janë folje, si pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të foljes nga pjesët e tjera të ligjëratës.

**Detyrë:**
(Gjeni një lajm në internet dhe nënvizoni foljet në tekst)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 75

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


FOLJA

Folja është elementi ose pjesa kryesore e fjalisë që tregon një veprim ose gjendje. Kategoritë gramatikore të saj janë: ***veta, numri, mënyra, koha*** dhe ***diateza***.



***Pyetje dhe diskutim:***

- *Përse qeshin nxënësit e tjerë me nxënësin e hutuar në këto ilustrime?*

***Shpjegim:***

- *Edhe te fjalitë e tilla:* ***nuk punoj, nuk bëj asgjë, rri kot,*** *është duke u kryer një veprim, prandaj* ***punoj, bëj, rri*** *janë folje.*

87

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Folja – Llojet e foljes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon llojet e foljes;
- Harton fjali me folje në njërën nga llojet e saj.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Harta e konceptit*

Kërkesa:
Plotëso hartën me informacionet që i di.




**Bashkëbisedojmë:**

- ***Llojet e foljeve janë:***
  ***Ndihmëse:*** *kam mësuar, jam mësuar.*
  ***Gjysmëndihmëse:*** *mund të mësoj, duhet të mësoj, do mësuar etj.*

*Sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në:*

***Kalimtare.*** *Te foljet kalimtare veprimi nuk mbetet te ai që e kryen, por bie mbi një person apo send tjetër. P.sh. Antigona e përqafoi nënën e saj.*

***Jokalimtare.*** *Te foljet jokalimtare veprimi mbetet tek ai që e kryen, pra folja nuk merr kundrinë të drejtë, p.sh.:* ***eci, rri, dal, shkoj, vrapoj*** *etj.*

*Trina vrapon çdo ditë.*

***Kategoritë gramatikore të foljes***

***Veta.*** *Folja i ka tri veta: vetën e parë (unë punoj - ne punojmë), vetën e dytë (ti punon - ju punoni) dhe vetën e tretë (ai, ajo punon - ata, ato punojnë).*

***Numri.*** *Kategoria e numrit te folja varet nga numri i asaj/atij që e kryen veprimin. P.sh. Vajza punoi shumë. Vajzat punuan shumë.*

***Diateza.*** *Lidhja midis veprimit dhe asaj/atij që e kryen veprimin i ka dy forma: formën veprore* ***mësoj*** *dhe formën joveprore* ***mësohem, u mësova, jam mësuar.***

***Mënyra.*** *Në gjuhën shqipe janë gjashtë mënyra të foljes: dëftore (mësoj), lidhore (të mësoj), habitore (mësuakam), kushtore (do të mësoja), dëshirore (mësofsha) dhe urdhërore (mëso).*

***Koha:*** *Kohët themelore të foljes janë: e tashmja (lexoj), e shkuara (kam lexuar) dhe e ardhmja (do të lexoj).*

***Foljet ndahen në tri zgjedhime:***

- **I.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën -j: puno-j, shkrua-j, rrëfe-j etj.*
- **II.** *Tema e foljeve mbaron me bashkëtingëllore (përveç -j): hap, mat etj.*
- **III.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në tri vetat e para të njëjësit të dëftores nuk marrin fare mbaresë: vë, zë, di etj.*

88

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Bashkëbisedim*

Paraqiten tri ilustrime.




Pyetje për diskutim:
Pse qeshin nxënësit e tjerë me nxënësin e hutuar në këto ilustrime?
Bashkëbisedojmë: Llojet e foljeve janë:
Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse.

Foljet kalimtare: Antigona e përqafoi nënën e saj.

Foljet jokalimtare: Trina vrapon çdo ditë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pesëvargëshi*

Ndahen në pesë grupe, treshe e katërshe.
Kërkesa: Krijoni nga një pesëvargësh me temë të lirë.

Emri

Mbiemri | Mbiemri

Folje | Folje | Folje

Fjali | me | katër | fjalë

Sinonim

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të llojeve të foljes si dhe në përdorimin e drejtë të foljes në fjali në njërën nga llojet e saj.

**Detyrë:**
(Gjeni foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse në tekstin “Duart më të bukura”, fq. 85)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 76

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



***Bashkëbisedojmë:***

- ***Llojet e foljeve janë:***
  ***Ndihmëse:*** *kam mësuar, jam mësuar.*
  ***Gjysmëndihmëse:*** *mund të mësoj, duhet të mësoj, do mësuar etj.*

*Sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në:*

***Kalimtare.*** *Te foljet kalimtare veprimi nuk mbetet te ai që e kryen, por bie mbi një person apo send tjetër. P.sh. Antigona e përqafoi nënën e saj.*

***Jokalimtare.*** *Te foljet jokalimtare veprimi mbetet tek ai që e kryen, pra folja nuk merr kundrinë të drejtë, p.sh.:* ***eci, rri, dal, shkoj, vrapoj*** *etj.*

*Trina vrapon çdo ditë.*

***Kategoritë gramatikore të foljes***

***Veta.*** *Folja i ka tri veta: vetën e parë (unë punoj - ne punojmë), vetën e dytë (ti punon - ju punoni) dhe vetën e tretë (ai, ajo punon - ata, ato punojnë).*

***Numri.*** *Kategoria e numrit te folja varet nga numri i asaj/atij që e kryen veprimin. P.sh. Vajza punoi shumë. Vajzat punuan shumë.*

***Diateza.*** *Lidhja midis veprimit dhe asaj/atij që e kryen veprimin i ka dy forma: formën veprore* ***mësoj*** *dhe formën joveprore* ***mësohem, u mësova, jam mësuar.***

***Mënyra.*** *Në gjuhën shqipe janë gjashtë mënyra të foljes: dëftore (mësoj), lidhore (të mësoj), habitore (mësuakam), kushtore (do të mësoja), dëshirore (mësofsha) dhe urdhërore (mëso).*

***Koha:*** *Kohët themelore të foljes janë: e tashmja (lexoj), e shkuara (kam lexuar) dhe e ardhmja (do të lexoj).*

*Foljet ndahen në tri zgjedhime:*

- **I.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën -j: puno-j, shkrua-j, rrëfe-j etj.*
- **II.** *Tema e foljeve mbaron me bashkëtingëllore (përveç -j): hap, mat etj.*
- **III.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në tri vetat e para të njëjësit të dëftores nuk marrin fare mbaresë: vë, zë, di etj.*

88

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Folja – Kategoritë gramatikore të foljes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kategoritë gramatikore të foljes;
- Analizon foljen nëpër kategoritë gramatikore të saj.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Harta e koncepteve*
Në tabelë shkruhet tema "Llojet e foljeve", e cila rrethohet me vijë.
Kërkesë: Shkruaj tani për këtë fjalë rreth e rreth e përmbledhtas çdo gjë që të vjen në mendje (të gjitha përfytyrimet e tua, idetë, mendimet). Rrethoji, gjithashtu, fjalët e reja dhe lidhi me fjalën kryesore në mes. Shembull:





*Forma të shtjelluara të foljes janë ato folje që e ndryshojnë formën e tyre sipas vetës dhe numrit: mënyra dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore.*

*Forma të pashtjelluara të foljes janë ato folje që nuk e ndryshojnë formën e tyre: pjesorja (punuar), paskajorja (për të punuar), përcjellorja (duke punuar) dhe mohorja (pa punuar).*

***Mënyra dëftore** i ka këto kohë: e tashmja (mësoj), e pakryera (mësoja), e kryera e thjeshtë (mësova), e kryera (kam mësuar), më se e kryera (kisha mësuar), e kryera e tejshkuar (pata mësuar), e ardhmja (do të mësoj), e ardhmja e përparme (do të kem mësuar).*

*Zgjedhimi joveprор: mësohem, mësohesha, u mësova, jam mësuar, isha mësuar, qeshë mësuar, do të mësohem, do të jem mësuar.*

***Mënyra lidhore** i ka këto kohë: e tashme (të mësoj), e pakryer (të mësoja), e kryer (të kem mësuar), më se e kryer (të kisha mësuar).*

*Zgjedhimi joveprор: të mësohem, të mësohesha, të jem mësuar, të isha mësuar.*

***Pyetje:***

- *Çfarë kategori gramatikore ka folja?*
- *Sipas mundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, si ndahen foljet?*
- *Në sa zgjedhime ndahet folja?*
- *Cilat janë format e pashtjelluara të foljes?*
- *Cilat janë kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore?*

***Detyrë:***

- *Zgjedhoni foljet **mësoj, mat, zë** në mënyrën dëftore dhe lidhore, zgjedhimi vepror dhe joveprор.*

Shih fletoren e punës

89

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)*

Kërkesa: Gjatë leximit të tekstit plotësoni këtë tabelë.

| "√" informacion i njohur | "–" Informacion ndryshe | "+" Informacion i ri | "?" Informacion që kërkon sqarime |
|---|---|---|---|
| | | | |

Lexohen disa nga tabelat e plotësuara.
Rëndësi të veçantë marrin kolonat e fundit, pyetjet e përpiluara nga nxënësit. Së pari, nxënësit e tjerë mundohen të japin përgjigje për pyetjet e mundshme, ndërsa për ndonjë pyetje përgjigjet edhe mësimdhënësi.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim*

Kërkesë: Analizoni foljen "mësoj", "lexoi" dhe "shkrova" në vetë, numër, mënyrë dhe kohë.

| Folja | Veta | Numri | Koha | Mënyra |
|---|---|---|---|---|
| Mësoj | | | | |
| Lexoi | | | | |
| Shkrova | | | | |

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të kategorive të foljes si dhe analizimin e saktë të foljes nëpër kategori.

**Detyrë:**
(Analizo tri folje në të gjitha kategoritë e saj)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 77

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE



**Bashkëbisedojmë:**

- ***Llojet e foljeve janë:***
  ***Ndihmëse:*** *kam mësuar, jam mësuar.*
  ***Gjysmëndihmëse:*** *mund të mësoj, duhet të mësoj, do mësuar etj.*

*Sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në:*

***Kalimtare.*** *Te foljet kalimtare veprimi nuk mbetet te ai që e kryen, por bie mbi një person apo send tjetër. P.sh. Antigona e përqafoi nënën e saj.*

***Jokalimtare.*** *Te foljet jokalimtare veprimi mbetet tek ai që e kryen, pra folja nuk merr kundrinë të drejtë, p.sh.:* ***eci, rri, dal, shkoj, vrapoj*** *etj.*

*Trina vrapon çdo ditë.*

***Kategoritë gramatikore të foljes***

***Veta.*** *Folja i ka tri veta: vetën e parë (unë punoj - ne punojmë), vetën e dytë (ti punon - ju punoni) dhe vetën e tretë (ai, ajo punon - ata, ato punojnë).*

***Numri.*** *Kategoria e numrit te folja varet nga numri i asaj/atij që e kryen veprimin. P.sh. Vajza punoi shumë. Vajzat punuan shumë.*

***Diateza.*** *Lidhja midis veprimit dhe asaj/atij që e kryen veprimin i ka dy forma: formën veprore* ***mësoj*** *dhe formën joveprore* ***mësohem, u mësova, jam mësuar.***

***Mënyra.*** *Në gjuhën shqipe janë gjashtë mënyra të foljes: dëftore (mësoj), lidhore (të mësoj), habitore (mësuakam), kushtore (do të mësoja), dëshirore (mësofsha) dhe urdhërore (mëso).*

***Koha:*** *Kohët themelore të foljes janë: e tashmja (lexoj), e shkuara (kam lexuar) dhe e ardhmja (do të lexoj).*

*Foljet ndahen në tri zgjedhime:*

- **I.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën -j: puno-j, shkrua-j, rrëfe-j etj.*
- **II.** *Tema e foljeve mbaron me bashkëtingëllore (përveç -j): hap, mat etj.*
- **III.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në tri vetat e para të njëjësit të dëftores nuk marrin fare mbaresë: vë, zë, di etj.*

88

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Folja – Zgjedhimet dhe format e foljes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon foljet se cilit zgjedhim i takojnë;
- Zgjedhon foljet në kategoritë e saj.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Kërkesa:
Çka dini për foljen?

Përgjigjet e mundshme:
Pjesë e ndryshueshme.

Ka kategori.
Ka mënyrë.
Ka vetë.
Ka numër.
Zgjedhohet.
Ka diatezë.



***Bashkëbisedojmë:***

- ***Llojet e foljeve janë:***
  ***Ndihmëse:*** *kam mësuar, jam mësuar.*
  ***Gjysmëndihmëse:*** *mund të mësoj, duhet të mësoj, do mësuar etj.*

*Sipas mundësisë ose pamundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, foljet ndahen në:*

***Kalimtare.*** *Te foljet kalimtare veprimi nuk mbetet te ai që e kryen, por bie mbi një person apo send tjetër. P.sh. Antigona e përqafoi nënën e saj.*

***Jokalimtare.*** *Te foljet jokalimtare veprimi mbetet tek ai që e kryen, pra folja nuk merr kundrinë të drejtë, p.sh.:* ***eci, rri, dal, shkoj, vrapoj*** *etj.*

*Trina vrapon çdo ditë.*

***Kategoritë gramatikore të foljes***

***Veta.*** *Folja i ka tri veta: vetën e parë (unë punoj - ne punojmë), vetën e dytë (ti punon - ju punoni) dhe vetën e tretë (ai, ajo punon - ata, ato punojnë).*

***Numri.*** *Kategoria e numrit te folja varet nga numri i asaj/atij që e kryen veprimin. P.sh. Vajza punoi shumë. Vajzat punuan shumë.*

***Diateza.*** *Lidhja midis veprimit dhe asaj/atij që e kryen veprimin i ka dy forma: formën veprore* ***mësoj*** *dhe formën joveprore* ***mësohem, u mësova, jam mësuar.***

***Mënyra.*** *Në gjuhën shqipe janë gjashtë mënyra të foljes: dëftore (mësoj), lidhore (të mësoj), habitore (mësuakam), kushtore (do të mësoja), dëshirore (mësofsha) dhe urdhërore (mëso).*

***Koha:*** *Kohët themelore të foljes janë: e tashmja (lexoj), e shkuara (kam lexuar) dhe e ardhmja (do të lexoj).*

*Foljet ndahen në tri zgjedhime:*

- **I.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme marrin mbaresën -j: puno-j, shkrua-j, rrëfe-j etj.*
- **II.** *Tema e foljeve mbaron me bashkëtingëllore (përveç -j): hap, mat etj.*
- **III.** *Tema e foljeve mbaron me zanore dhe në tri vetat e para të njëjësit të dëftores nuk marrin fare mbaresë: vë, zë, di etj.*

88

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Të lexuarit në dyshe*

Ndahen në grupe dyshe.
Kërkesë:
Lexoni tërë pjesën e tekstit dhe diskutojeni me shokun/shoqen tuaj.

| Rolet në pjesën e parë | | Rolet në pjesën e dytë | |
|---|---|---|---|
| Raportuesi | Pyetësi | Raportuesi | Pyetësi |
| Nxënësi A | Nxënësi B | Nxënësi B | Nxënësi A |
| | | | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Kërkesa: Zgjedhoni nga një folje nga tri zgjedhimet, në mënyrën dëftore dhe në të gjitha kohët.

Punimet e nxënësve diskutohen për saktësinë e zgjedhimit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit dhe në saktësinë e zgjedhimit të tyre në kategori.

**Detyrë:**
(Zgjedhoni nga tri folje të secilit zgjedhim. Mënyra dëftore)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 78

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



*Forma të shtjelluara të foljes janë ato folje që e ndryshojnë formën e tyre sipas vetës dhe numrit: mënyra dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore.*

*Forma të pashtjelluara të foljes janë ato folje që nuk e ndryshojnë formën e tyre: pjesorja (punuar), paskajorja (për të punuar), përcjellorja (duke punuar) dhe mohorja (pa punuar).*

***Mënyra dëftore** i ka këto kohë: e tashmja (mësoj), e pakryera (mësoja), e kryera e thjeshtë (mësova), e kryera (kam mësuar), më se e kryera (kisha mësuar), e kryera e tejshkuar (pata mësuar), e ardhmja (do të mësoj), e ardhmja e përparme (do të kem mësuar).*

*Zgjedhimi jovepror: mësohem, mësohesha, u mësova, jam mësuar, isha mësuar, qeshë mësuar, do të mësohem, do të jem mësuar.*

***Mënyra lidhore** i ka këto kohë: e tashme (të mësoj), e pakryer (të mësoja), e kryer (të kem mësuar), më se e kryer (të kisha mësuar).*

*Zgjedhimi jovepror: të mësohem, të mësohesha, të jem mësuar, të isha mësuar.*

***Pyetje:***

- *Çfarë kategori gramatikore ka folja?*
- *Sipas mundësisë për të marrë kundrinë të drejtë në fjali, si ndahen foljet?*
- *Në sa zgjedhime ndahet folja?*
- *Cilat janë format e pashtjelluara të foljes?*
- *Cilat janë kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore?*

***Detyrë:***

- *Zgjedhoni foljet **mësoj, mat, zë** në mënyrën dëftore dhe lidhore, zgjedhimi vepror dhe jovepror.*

Shih fletoren e punës

89

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Folja - Mënyra dëftore dhe mënyra lidhore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon mënyrën dëftore dhe lidhore;
- Zgjedhon folje në mënyrën dëftore dhe lidhore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët** *Diskutimi i ideve*
Kërkesë:
Shëno foljen në kohën e duhur.
Një ditë më ____________ (ngjan) një ndodhi e çuditshme. Nilsi __________(gjendem) në shtëpi vetëm. Dita _________ (jam) e bukur. I ati dhe e ëma ________ (shkoj) në fshatin fqinj për të bërë pazar. Edhe Nilsi u _________ (bëj) gati __________ (shkoj) me ta, madje ____________(vesh) edhe rrobat më të mira, por këtë herë fati nuk i __________(ec).
Diskutohet saktësia e foljeve të duhura.


njësia 23
FOLJA

- *Shëno të gjitha foljet e tekstit "Duart më të bukura" dhe përcaktoni në cilën vetë, kohë dhe në cilën mënyrë janë.*
- *Trego foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse në tregimin "Duart më të bukura".*
- *Trego format e pashtjellueshme që gjenden në tregimin "Duart më të bukura".*
- *Trego cilat janë foljet joveprore në tregimin "Duart më të bukura".*

***Pyetje***

- *Zgjedho foljen **këndoj** në mënyrën dëftore dhe lidhore:*

| *Kohët e përbashkëta* | *Koha e tashme* | *Koha e pakryer* | *E kryer* | *Më se e kryer* |
|---|---|---|---|---|
| *Mënyra dëftore* | | | | |
| *Mënyra lidhore* | | | | |

- *Në cilën kohë janë foljet **do të shkoj, do të kem shkuar:***

*a. E tashme*
*b. E shkuar*
*c. E ardhme*

50

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Mësimi lexohet me ndalesa.
Pas çdo ndalese bëhen disa pyetje.
Pyetjet pas ndalesës së parë:
Cilat janë kohët e mënyrës dëftore?
Si bëjnë foljet e mënyrës dëftore në formën veprore dhe joveprore?

Pyetjet pas ndalesë së dytë:
Cilat janë kohët e mënyrës lidhore?
Si bëjnë foljet e mënyrës lidhore në formën veprore dhe joveprore?

| Mënyra lidhore | | | |
|---|---|---|---|
| E tashme | E pakryer | E kryer | Më se e kryer |
| Të mësoj | Të mësoja | Të kem mësuar | Të kisha mësuar |

| Mënyra dëftore | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E tashme | E pakryer | E kryer e thjeshtë | E kryer | Më se e kryer | E kryer e tejshkuar | E ardhme | E ardhme e përparme |
| mësoj | mësoja | mësova | Kam mësuar | Kisha mësuar | Pata mësuar | Do të mësoj | Do të kem mësuar |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mendo, punë në dyshe, thuaja grupit*

Ndahen në grupe dyshe.
Kërkesa:
Njëri anëtar i grupit e zgjedhon foljen në mënyren dëftore, ndërsa tjetri në mënyrën lidhore. Pas përfundimit e diskutojnë në grupin e tyre në dyshe. Pas diskutimit mes vete, diskutojnë me tërë klasën.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e analizimit të foljeve për secilën mënyrë si dhe në zgjedhimin e saktë të foljeve në të dyja mënyrat.

**Detyrë:**
(Zgjedhoni tri folje në mënyrën lidhore dhe dëftore)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 79



**Veta e dytë njëjës dhe shumës.** Folja është në vetën e dytë njëjës, kur kryefjala është bashkëbiseduesi dhe në vetën e dytë shumës, kur përfshin një grup personash ku bën pjesë edhe bashkëbiseduesi.

| **Veta e dytë njëjës** | **Veta e dytë shumës** |
| --- | --- |
| *Ti lexo**n*** | *Ju lexo**ni*** |

**Veta e tretë njëjës dhe shumës.** Folja është në vetën e tretë njëjës dhe shumës, kur u referohet personave apo objekteve në bashkëbisedim.

| **Veta e tretë njëjës** | **Veta e tretë shumës** |
| --- | --- |
| *Ai, ajo lexo**n*** | *Ata, ato lexo**jnë*** |

Kategoria gramatikore e numrit te folja varet nga kryefjala. Folja e përdorur në numrin shumës tregon se veprimi kryhet nga shumë njerëz, p.sh.: ***Ata** punojnë shumë*. Kategoria gramatikore e numrit shprehet me të njëjtat mbaresa si kategoria e vetës.

***Pyetje:***

- *Kur përdoret folja në vetën e parë njëjës dhe shumës?*
- *Kur përdoret folja në vetën e dytë njëjës dhe shumës?*
- *Kur përdoret folja në vetën e tretë njëjës dhe shumës?*
- *Nga cili element kushtëzohet numri i foljes në fjali?*

***Detyrë:***

*Zgjedhoni foljet **punoj, dal, di** në mënyrën dëftore dhe lidhore.*

92

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbaresat e foljes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon mbaresat e foljeve në tekst;
- Analizon foljet që nuk marrin mbaresa.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diagrami i Venit*




Kërkesa:
Plotëso rrathët.



- Kam frikë se nuk më shko**n** me fustanin, - u përgjigj ajo.

- Pastaj, veç kësaj, nipi i kryeoborrtarit më ka dërguar bizhuteri të mrekullueshme dhe të gjithë e di**në** se ato vle**jnë** shumë më tepër se lulet.

- Ç'gjë budallaqe qenka dashuria, - tha studenti, ndërsa largo**hej**. - Nuk vle**n** as sa gjysma e logjikës, sepse nuk provo**n** asgjë dhe gjithmonë tho**të** gjëra që s'ka**në** për të ndodhur. Të bë**n** të beso**sh** gjëra që nuk ja**në** të vërteta... Kështu, studenti u kthy**e** në dhomë, nxor**i** një libër të madh mbuluar nga pluhuri dhe nis**i** të lexo**nte**.

***Detyrë:***

*Cila është tema e këtij tregimi?*
*Pse Bilbili e sakrifikon veten?*
*Çfarë mendoni për sjelljen e vajzës ndaj studentit?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Elementet e fjalës me ngjyrë të zezë janë mbaresa vetore. Cila mbaresë vetore dhe cili numër përdoret më shumë?*
*Pse disa folje në tekstin e mësipërm nuk marrin mbaresa vetore?*

**Folja - kategoria e vetës dhe e numrit**

Kategoria gramatikore e vetës shpreh folësin, marrësin apo objektin e diskutimit. Folja ka tri veta.

**Veta e parë njëjës dhe shumës.** Folja është në vetën e parë njëjës, kur kryefjala e fjalisë është vetë folësi dhe në vetën e parë shumës, kur përfshin një grup personash ku bën pjesë edhe folësi.

| Veta e parë njëjës | Veta e parë shumës |
|---|---|
| *Unë lexo**j*** | *Ne lexo**jmë*** |

91

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditari i të nxënit*

Kërkesë:
Gjatë leximit të tekstit "Bilbili dhe Trëndafili" plotësoni tabelën.

Shembull.

| Foljet me të zeza në tekst | Foljet pa të zeza në tekst | Koment |
|---|---|---|
| | | |

Pasi ta plotësoni tabelën e parë dhe të dytë, te kolona Koment jepni komentet tuaja pse disa folje janë me të zeza e disa jo.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në grupe*

Lexohen disa nga komentet rreth foljeve me të zeza.
Bashkëbisedohet rreth mbaresave që disa folje marrin gjatë përdorimit të tyre e disa folje nuk marrin.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohën në saktësinë e dallimit të mbaresave të foljeve dhe analizimit të foljeve që nuk marrin mbaresa.

**Detyrë:**
(Ndaj tri folje nga mbaresat e tyre)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 80

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 1,2; II:3; III: 1,2,3,4,5,6.


◇ *Foljen **punoj** në mënyrën dëftore shënoje në:*

*Kohën e kryer të thjeshtë* ____________

*Kohën e tashme* ____________

*Kohën e pakryer* ____________

*Kohën e kryer të tejshkuar* ____________

◇ *Në fjalinë: **Djali shkoi në shkollë,** ktheje foljen në kohën e ardhme të përparme të dëftores.*

*Në kohën e pakryer të dëftores* ____________

*Në mënyrën urdhërore* ____________

◇ *Shëno në kohën e duhur foljen:*

*Një ditë më.............(ngjan) një ndodhi e çuditshme. Nilsi.............(gjendem) në shtëpi vetëm. Dita.............(jam) e bukur. I ati dhe e ëma.............(shkoj) në fshatin fqinj për të bërë pazar. Edhe Nilsi u.............(bëj) gati.............(shkoj) me ta, madje.............(vesh) dhe rrobat më të mira, por këtë herë fati nuk i.............(eci).*

◇ *Lidh përemrat me foljet që përshtaten:*

51

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mënyrat e foljes - ushtrime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Zgjedhon foljet në mënyrën dëftore e lidhore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Analiza e tipareve semantike*

Punë individuale.
Kërkesë:
Zëvendësoni fjalët sipas modelit të dhënë.

| | | |
|---|---|---|
| • Bëj mësimet - mësoj | • Bëj gjellën - gatuaj | • Bëj garën - garoj |
| • Bëj punë - punoj | • Bëj balet - vallëzoj | • Bëj projekt - projektoj |
| Fjalët: Gjuaj peshkun - | Kaloj lumin me not - | Bëj vizatimin - |



| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Unë*** | ***punuam*** | ***Unë*** | ***pati punuar*** |
| ***Ti*** | ***punuat*** | ***Ti*** | ***patët punuar*** |
| ***Ai/Ajo*** | ***punuan*** | ***Ai/Ajo*** | ***pata punuar*** |
| ***Ne*** | ***punoi*** | ***Ne*** | ***patën punuar*** |
| ***Ju*** | ***punove*** | ***Ju*** | ***pate punuar*** |
| ***Ata/Ato*** | ***punova*** | ***Ata/Ato*** | ***patëm punuar*** |

◇ *Në tekstin më poshtë, gjeji foljet dhe trego për secilën prej tyre në ç'vetë, numër, mënyrë dhe kohë është:*

*Natën ra borë. Kur u zgjuam, e pamë të hutuar bardhësinë që ishte shtrirë deri në pafundësi. Dimri gjithmonë na lidhte me njëfarë pjalmi të hidhur trishtues. Im ungj e kuptoi se sytë tanë e shprehnin këtë dhe tha se lugina përpara mesditës do ta hidhte borën nga supet. Po ky ishte një ngushëllim i vockël...*

*(Rushit Ramabaja "Grigja")*

*Folja 1 ______ (ra), veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 2 ______ (zgjuam) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 3 ______ (pamë) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 4 ______ (ishte shtrirë) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 5 ______ (lidhte) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 6 ______ (kuptoi) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 7 ______ (shprehnin) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 8 ______ (tha) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 9 ______ (do ta hidhte) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*
*Folja 10 ______ (ishte ngushëllim) veta ______, numri ______, mënyra ______, koha ______.*

*Fjalët që nuk i keni kuptuar nga teksti sipër, kërkojini në fjalor.*

52

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rrjeti i diskutimit*

Kërkesat:

1. Zgjedhoni foljen këndoj në mënyrën dëftore e

| Kohët e përbashkëta | E tashme | E pakryer | E kryer | Më se e kryer |
|---|---|---|---|---|
| Mënyra dëftore | | | | |
| Mënyra lidhore | | | | |

lidhore

2. Foljen punoj të mënyrës dëftore shënoje në:

Kohën e kryer të thjeshtë: ____________________

Kohën e tashme: ____________________

Kohën e pakryer: ____________________

Kohën e kryer: ____________________

3. Foljen në fjalinë "Djali shkoi në shkollë" ktheje në kohën e ardhme të përparme të mënyrës dëftore.

Pas çdo leximi të kërkesave hapet diskutimi për saktësinë e detyrave të mbaruara.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Turi i galerisë*

Ndahen në grupe, katërshe e pesëshe.
Kërkesë:
Zgjedhohen nga pesë folje në të dyja mënyrat.

Pas përfundimit prezantohen në ekspozitë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e zgjedhimit të foljeve

**Detyrë:**
(Identifiko foljet joveprore në tregimin "Duart më të bukura")

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 81

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Folja, kuptimet e saj gramatikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimet gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe të diatezës; Dallon foljen, kohët e thjeshta dhe të përbëra të saj; Dallon zgjedhimin e foljes; Dallon dhe kupton foljen, mënyrat veprore dhe joveprore të saj; Dallon fjalitë foljore dhe jofoljore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 1, 2, 3, 7, 8; III- 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 1,2,; II:3; III: 1,2,3,4,5,6.



**Detyrë**

◇ *Kërkoni në fjalor pesë folje të reja që fillojnë me shkronjën **m**, pesë që fillojnë me shkronjën **n** dhe dy që fillojnë me shkronjën **nj**. Tregojuani ato fjalë shoqeve dhe shokëve të klasës.*

**Detyrë**

◇ *Dalloni mbaresat vetore te foljet e tekstit "Bilbili dhe trëndafili" dhe përcaktoni në cilën vetë dhe në cilin numër përdoren.*

Lidhni temat e foljeve me mbaresat vetore që përshtaten:

| a. Zgjedhimi I | | |
|---|---|---|
| Unë | vallëzo | -jnë |
| Ti | vallëzo | -ni |
| Ai/Ajo | vallëzo | -j |
| Ne | vallëzo | -n |
| Ju | vallëzo | -jmë |
| Ata/Ato | vallëzo | -n |

| b. Zgjedhimi II | | |
|---|---|---|
| Unë | mbyll | |
| Ti | mbyll | -im |
| Ai/Ajo | mbyll | -ni |
| Ne | mbyll | |
| Ju | mbyll | -in |
| Ata/Ato | mbyll | |

| c. Zgjedhimi III | | |
|---|---|---|
| Unë | di | -më |
| Ti | di | |
| Ai/Ajo | di | -ni |
| Ne | di | -në |
| Ju | di | |
| Ata/Ato | di | |

53

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbaresat e foljeve - ushtrime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan foljet në tema dhe mbaresa;
- Lidh temat me mbaresat e foljeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim*

Kërkesë:
Lidh përemrat me foljet që përshtaten.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Unë | punuam | Unë | pati punuar |
| Ti | punuat | Ti | patët punuar |
| Ai/Ajo | punuan | Ai/Ajo | pata punuar |
| Ne | punoi | Ne | patën punuar |
| Ju | punove | Ju | pate punuar |
| Ata/Ato | punova | Ata/Ato | patëm punuar |

Diskutohen punimet.

Për mësimdhënësin/en



**Detyrë**

◇ Kërkoni në fjalor pesë folje të reja që fillojnë me shkronjën **m**, pesë që fillojnë me shkronjën **n** dhe dy që fillojnë me shkronjën **nj**. Tregojuani ato fjalë shoqeve dhe shokëve të klasës.

**Detyrë**

◇ Dalloni mbaresat vetore te foljet e tekstit "Bilbili dhe trëndafili" dhe përcaktoni në cilën vetë dhe në cilin numër përdoren.

Lidhni temat e foljeve me mbaresat vetore që përshtaten:

**a. Zgjedhimi I**

| | | |
|---|---|---|
| Unë | vallëzo | -jnë |
| Ti | vallëzo | -ni |
| Ai/Ajo | vallëzo | -j |
| Ne | vallëzo | -n |
| Ju | vallëzo | -jmë |
| Ata/Ato | vallëzo | -n |

**b. Zgjedhimi II**

| | | |
|---|---|---|
| Unë | mbyll | |
| Ti | mbyll | -im |
| Ai/Ajo | mbyll | -ni |
| Ne | mbyll | |
| Ju | mbyll | -in |
| Ata/Ato | mbyll | |

**c. Zgjedhimi III**

| | | |
|---|---|---|
| Unë | di | -më |
| Ti | di | |
| Ai/Ajo | di | -ni |
| Ne | di | -në |
| Ju | di | |
| Ata/Ato | di | |

53

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rrjeti i diskutimit*

Në tekstin më poshtë gjej foljet dhe trego për secilën prej tyre në ç`vetë, numër, mënyrë dhe kohë është.

*Natën ra borë. Kur u zgjuam, e pamë të hutuar bardhësinë që ishte shtrirë deri në pafundësi. Dimri gjithmonë na lidhte me njëfarë pjalmi të hidhur trishtues. Im ungj e kuptoi se sytë tanë e shprehnin këtë dhe tha se lugina përpara mesditës do ta hidhte borën nga supet. Po ky ishte një ngushëllim i vockël.*

Lidhni temat e foljeve me mbaresat që përshtaten.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Unë | | vallëzo | -jnë |
| Ti | | vallëzo | -ni |
| Ai/Ajo | | vallëzo | -j |
| Ne | | vallëzo | -n |
| Ju | | vallëzo | -jmë |
| Ata/Ato | | vallëzo | -n |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutimi i ideve*

Kërkesa: Ndaj foljet në tema dhe mbaresa.

| Foljet | Tema | Mbaresa |
|---|---|---|
| Punoj | | |
| Thej | | |
| Vendosa | | |
| Dola | | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohet në saktësinë e ndarjes së foljeve në tema dhe mbaresa si dhe në lidhjen e temave me mbaresa.

**Detyrë:**
(Detyra në fletore pune, fq. 54)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 82

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon një tekst rrëfyes nga një tekst përshkrues. Shkruan një tekst rrëfyes. Shkruan një tekst përshkrues.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 3, II: 3. 5, III: 1
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2. 5, 2: 1, 3: 2. 3



njësia 9
PËRSHKRIMI DHE RRËFIMI

Nga romani "Gropat" i autorit Luis Sahar

DY AHET NË FUSHËN E SHKRETË

Pamja shtrihet e gjerë, në një fushë që ka mbetur nga liqeni i madh i shteruar. Drurët e vetëm janë dy ahet në anën e djathtë të fushës së shkretë. Një rrjetë gjumi është e varur ndërmjet dy drurëve dhe një kasolle druri qëndron prapa saj.

*Detyrë:*
- *A mund ta imagjinoni pamjen e asaj që është paraqitur në tekstin sipër?*
- *Provoni ta vizatoni.*

***Bashkëbisedojmë:***

*Teksti i mësipërm është një përshkrim. Përshkrimi paraqet gjëra, dukuri, sende të orientuara në hapësirë. Duket si një fotografi.*
*Teksti i tillë quhet tekst përshkrues.*
*Gjatë përshkrimit, realizohet procesi i të vërejturit në hapësirë.*
*Shërben për të përshkruar njerëz, veprime, gjendje, objekte të ndryshme, por edhe procese, duke përdorur fjalë që krijojnë një pamje në mendjen e lexuesve/lexueseve.*

***Diskutojmë***

*A dini ndonjë përrallë popullore?*

(Përrallë popullore)

TRE DERRKUCËT

Na ishin njëherë tre derrkucë. Ata po kërkonin nga një vend të përshtatshëm për të ndërtuar nga një shtëpi. Duke kërkuar, u lodhën.
Derrkuci i parë tha se përtonte ta vazhdonte rrugën. Pa ca kashtë aty pranë dhe tha: "Do ta ndërtoj një shtëpi nga kashta". Vëllai dhe motra e tij vazhduan rrugën, ndërsa ai i mbylli sytë dhe ia kërciti gjumit. Shtëpinë e ndërtoi pasdite, pasi u zgjua.
Në mesnatë, dëgjoi trokitje në derë.
"Derrkuc, o derrkuc, hapja derën xhaxhit ujk", dëgjoi ai.

34

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për artikuj të ndryshëm;
- Shkruan një tekst përshkrues;
- Dallon tekstin rrëfyes nga ai përshkrues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Lexim*

Nxënësit e fillojnë leximin e pjesës së parë të tekstit në libër nga romani "Gropat" të autorit Luis Sahar.



njësia 9
PËRSHKRIMI DHE RRËFIMI

Nga romani "Gropat" i autorit Luis Sahar

DY AHET NË FUSHËN E SHKRETË

Pamja shtrihet e gjerë, në një fushë që ka mbetur nga liqeni i madh i shteruar. Drurët e vetëm janë dy ahet në anën e djathtë të fushës së shkretë. Një rrjetë gjumi është e varur ndërmjet dy drurëve dhe një kasolle druri qëndron prapa saj.

**Detyrë:**

- *A mund ta imagjinoni pamjen e asaj që është paraqitur në tekstin sipër?*
- *Provoni ta vizatoni.*

**Bashkëbisedojmë:**

*Teksti i mësipërm është një përshkrim. Përshkrimi paraqet gjëra, dukuri, sende të orientuara në hapësirë. Duket si një fotografi.*
*Teksti i tillë quhet tekst përshkrues.*
*Gjatë përshkrimit, realizohet procesi i të vërejturit në hapësirë.*
*Shërben për të përshkruar njerëz, veprime, gjendje, objekte të ndryshme, por edhe procese, duke përdorur fjalë që krijojnë një pamje në mendjen e lexuesve/lexueseve.*

**Diskutojmë**

*A dini ndonjë përrallë popullore?*

(Përrallë popullore)

TRE DERRKUCËT

Na ishin njëherë tre derrkucë. Ata po kërkonin nga një vend të përshtatshëm për të ndërtuar nga një shtëpi. Duke kërkuar, u lodhën.
Derrkuci i parë tha se përtonte ta vazhdonte rrugën. Pa ca kashtë aty pranë dhe tha: "Do ta ndërtoj një shtëpi nga kashta". Vëllai dhe motra e tij vazhduan rrugën, ndërsa ai i mbylli sytë dhe ia kërciti gjumit. Shtëpinë e ndërtoi pasdite, pasi u zgjua.
Në mesnatë, dëgjoi trokitje në derë.
"Derrkuc, o derrkuc, hapja derën xhaxhit ujk", dëgjoi ai.

34

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Diskutim*

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që pas leximit ta imagjinojnë pamjen e asaj që është paraqitur në tekst. Provojnë ta vizatojnë.

Nxënësit në mënyrë individuale provojnë ta vizatojnë në fletore tekstin të cilin e lexuan.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Imagjinatë e drejtuar*

Nxënësit do ta përshkruajnë shokun apo shoqen e bankës.

Një nga përshkrimet mund të ishte:
*Shoku im i bankës ka sy të kaltër, flokë të verdhë, është i gjatë dhe ka një buzëqeshje të veçantë.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tekstit rrëfyes nga ai përshkrues si dhe krijiminn e një teksti përshkrues.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë një përrallë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 83

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon një tekst rrëfyes nga një tekst përshkrues. Shkruan një tekst rrëfyes. Shkruan një tekst përshkrues.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 3, II: 3. 5, III: 1
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2. 5, 2: 1, 3: 2. 3


njësia 9
PËRSHKRIMI DHE RRËFIMI

Nga romani "Gropat" i autorit Luis Sahar

DY AHET NË FUSHËN E SHKRETË

Pamja shtrihet e gjerë, në një fushë që ka mbetur nga liqeni i madh i shteruar. Drurët e vetëm janë dy ahet në anën e djathtë të fushës së shkretë. Një rrjetë gjumi është e varur ndërmjet dy drurëve dhe një kasolle druri qëndron prapa saj.

*Detyrë:*
- *A mund ta imagjinoni pamjen e asaj që është paraqitur në tekstin sipër?*
- *Provoni ta vizatoni.*

*Bashkëbisedojmë:*
*Teksti i mësipërm është një përshkrim. Përshkrimi paraqet gjëra, dukuri, sende të orientuara në hapësirë. Duket si një fotografi.*
*Teksti i tillë quhet tekst përshkrues.*
*Gjatë përshkrimit, realizohet procesi i të vërejturit në hapësirë.*
*Shërben për të përshkruar njerëz, veprime, gjendje, objekte të ndryshme, por edhe procese, duke përdorur fjalë që krijojnë një pamje në mendjen e lexuesve/lexueseve.*

*Diskutojmë*
*A dini ndonjë përrallë popullore?*

(Përrallë popullore)
TRE DERRKUCËT

Na ishin njëherë tre derrkucë. Ata po kërkonin nga një vend të përshtatshëm për të ndërtuar nga një shtëpi. Duke kërkuar, u lodhën.
Derrkuci i parë tha se përtonte ta vazhdonte rrugën. Pa ca kashtë aty pranë dhe tha: “Do ta ndërtoj një shtëpi nga kashta". Vëllai dhe motra e tij vazhduan rrugën, ndërsa ai i mbylli sytë dhe ia kërciti gjumit. Shtëpinë e ndërtoi pasdite, pasi u zgjua.
Në mesnatë, dëgjoi trokitje në derë.
“Derrkuc, o derrkuc, hapja derën xhaxhit ujk”, dëgjoi ai.

34

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për artikuj të ndryshëm;
- Shkruan një tekst rrëfyes;
- Dallon tekstin rrëfyes nga ai përshkrues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të dëgjuarit aktiv*

Nxënësit fillojnë t’i lexojnë përrallat e shkruara në shtëpi.

Një nga përrallat mund të ishte “Kësulëkuqja”.

*Na ishte njëherë një vajzë që e quanin Kësulëkuqe...*



Derrkuci nisi të dridhej nga frika. E dinte sa i rrezikshëm ishte ujku.
"Nuk ta hap derën, nuk ta hap dot, jo, obobo", tha derrkuci.
"Pra, do të fryj e do të fryj, shtëpinë tënde rrafsh me tokë do të shtrij", bërtiti ujku.
Ashtu ndodhi vërtet.
Të nesërmen në mëngjes, dy derrkucët e tjerë erdhën ta vizitonin vëllanë, por mbetën të befasuar. Kashta ishte shkapërderdhur kudo, ndërsa gjësendet e të vëllait kishin mbetur në fushë.Të frikësuar nisën të iknin.
Motra nisi të thoshte se kishin ikur boll larg dhe se tash ky ishte një vend i mirë për të ndërtuar shtëpi. Disa dërrasa që i kishte lënë druvari kishin mbetur në një kënd të pyllit. Me to mund të ndërtohej një shtëpi.
"Ujku nuk do të më gjejë mua", tha derrkucja. Mirëpo, posa u bë ora dy- mbëdhjetë e natës, u dëgjua një trokitje në derë.
"Derrkuc, o derrkuc, hapja derën xhaxhit ujk", dëgjoi ajo. "Jam i uritur, dua të të ha".
Zemra e derrkuces nisi të godiste fort. Tash e mori vesh se çka i kishte ngjarë vëllait të saj të madh.
"Ik ore ujk! Nuk ta hap derën, nuk ta hap dot, jo, obobo", bërtiti ajo.
"Pra, do të fryj e do të fryj, shtëpinë tënde rrafsh me tokë do ta shtrij", bërtiti ujku.
Ashtu ndodhi vërtet.
Derrkuci i tretë erdhi të nesërmen në mëngjes ta vizitonte motrën, por pa se dërrasat e shtëpisë së saj ishin shkapërderdhur në fushë. Rraqet e motrës i kishte marrë era. Derrkuci i tretë nisi të vraponte me gjithë fuqinë që kishte. Iu kujtua se e kishte parë një fabrikë tullash para disa ditësh. Shkoi atje dhe bleu tulla. Bleu aq sa për ta ndërtuar një shtëpi të fortë e të mirë. Atë natë, u dëgjua trokitja në derë sërish.
"Derrkuc, o derrkuc, hapja derën xhaxhit ujk".
"Ik ore ujk! Nuk ta hap derën, nuk ta hap dot jo, obobo", tha derrkuci i tretë.
"Pra, do të fryj e do të fryj, shtëpinë tënde rrafsh me tokë do ta shtrij", bërtiti ujku.
Ujku nisi të frynte. Frynte me gjithë fuqinë që kishte, por muret nuk lëviznin. Ishin të forta, të ndërtuara nga tullat. Ujku frynte e frynte, por vetëm dritaret pak dridheshin e asgjë më shumë.
U hidhërua. Vendosi të hynte brenda nëpërmjet oxhakut.
Mirëpo, derrkuci i tretë e priste këtë gjë. I dha zjarr oxhakut dhe zjarri lëshoi nxehtësi menjëherë. Ujku ra në zjarr e u bë shkrumb. Lëkura e tij u ça nga zjarri dhe nga barku i tij dolën derrkuci i parë dhe derrkucja. Ujku i kishte përpirë pa i kafshuar dhe ata ishin ende gjallë.Tre derrkucët ishin të lumtur që u takuan përsëri. Të lumtur, jetuan gjithë jetën në atë shtëpi të fortë të ndërtuar nga tullat. Përralla në shkallë, dukati në ballë.

35

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Në vazhdim të orës do të lexohet përralla e paraqitur në libër.

Përrallë popullore *"Tre derrkucët"*

*Na ishin njëherë tre derrkucë. Ata po kërkonin nga një vend të përshtatshëm për të ndërtuar nga një shtëpi. Duke kërkuar, u lodhën...*

Nxënësit pasi ta kenë lexuar në mënyrë individuale, do të tregojnë se a ishte një rrëfim apo një përshkrim kjo përrallë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit në fund të orës do të nxiten të tregojnë rrëfime të cilat i kanë dëgjuar nga prindërit e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tekstit rrëfyes nga ai përshkrues si dhe krijiminn e një teksti rrëfyes.

**Detyrë:**
(Në *Fletore pune,* faqe 16 dhe 17)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 84

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon një tekst rrëfyes nga një tekst përshkrues.
Shkruan një tekst rrëfyes. Shkruan një tekst përshkrues.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 3, II: 3. 5, III: 1
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2. 5, 2: 1, 3: 2. 3


**Detyrë:**
— Përmblidhe tekstin e mësipërm në më pak se 50 fjalë.

**Bashkëbisedojmë:**

*Në këtë tekst mund të vërejmë se kemi një ngjarje që lëviz në kohë. Kemi diçka që ngjet në fillim, pastaj zhvillohet me kohën. Ky tekst në të cilin bëhet paraqitja e detajeve dhe e fakteve në shpërndarjen kohore quhet rrëfim.*
*Merret me procesin e të vërejturit në kohë.*
*Pra, me këtë tip shkrimi tregohet një ngjarje a një histori dhe ndryshimi me një përshkrim të thjeshtë qëndron te dimensioni i kohës.*
*Ndryshe nga* **përshkrimi**, *këtë tekst nuk mund ta shohim si një fotografi, por mund ta shohim si një video që i ndërron fotografitë njërën pas tjetrës në kohë.*

**Detyrë:**
*Ndahuni në grupe në klasë. Luajeni përrallën "Tre derrkucët" në role.*

Shih fletoren e punës

36

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Imagjinon atë që e lexon në tekst;
- Mëson të rrëfejë;
- Dallon tekstin rrëfyes nga ai përshkrues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Shpjegim i përparuar*

Mësimdhënësi i rikujton elementet e tekstit rrëfyes dhe tekstit përshkrues.

*Në aspektin gjuhësor teksti rrëfyes karakterizohet nga prania e treguesve kohorë (më parë, më pas, pastaj...).*

*Teksti përshkrues e mundëson përvijimin dhe karakteristikat e një personi, vendi, objekti etj.*


*Detyrë:*

- *Përmblidhe tekstin e mësipërm në më pak se 50 fjalë.*

***Bashkëbisedojmë:***

*Në këtë tekst mund të vërejmë se kemi një ngjarje që lëviz në kohë. Kemi diçka që ngjet në fillim, pastaj zhvillohet me kohën. Ky tekst në të cilin bëhet paraqitja e detajeve dhe e fakteve në shpërndarjen kohore quhet rrëfim.*
*Merret me procesin e të vërejturit në kohë.*
*Pra, me këtë tip shkrimi tregohet një ngjarje a një histori dhe ndryshimi me një përshkrim të thjeshtë qëndron te dimensioni i kohës.*
*Ndryshe nga* përshkrimi, *këtë tekst nuk mund ta shohim si një fotografi, por mund ta shohim si një video që i ndërron fotografitë njërën pas tjetrës në kohë.*

*Detyrë:*

*Ndahuni në grupe në klasë. Luajeni përrallën "Tre derrkucët" në role.*

Shih fletoren e punës

36

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lojë me role*

Të luajnë në role përrallën "Tre derrkucët".

*Derrkuci i parë:*

*Derrkuci i dytë:*

*Derrkuci i tretë:*

Nxënësit do të argëtohen shumë gjatë interpretimit në role.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Paragraf përmbledhës*

Në fund të orës nxënësit do të kenë për detyrë ta përmbledhin përrallën me 50 fjalë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për kreativitetin dhe interpretimin në role.

**Detyrë:**
(Në librin *Fletore pune* të lexohet përralla "Djaloshi dhe kali", ndërsa do të komentohet në klasë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 85

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon një tekst rrëfyes nga një tekst përshkrues. Shkruan një tekst rrëfyes. Shkruan një tekst përshkrues.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 3, II: 3. 5, III: 1
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2. 5, 2: 1, 3: 2. 3

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përshkrimi dhe rrëfimi


***Teksti i mësipërm është:***

*a. Tekst letrar*
*b. Tekst joletrar*

***Teksti i mësipërm është:***

*a. Prozë*
*b. Poezi*

***Teksti i mësipërm i përshkruan ngjarjet në rrafshin kohor, prandaj është:***

*a. Përshkrim*
*b. Rrëfim*

◇ *Lexoje tekstin:*

*Përrallë popullore shqiptare*
***Djaloshi dhe kali***

*Ka qenë qysh ka qenë.*
*Ka qenë njëherë një fshat dhe në të ka jetuar një djalë. Djali kishte qenë gjahtar. Çdo ditë ai i gjuante nga dymbëdhjetë pata dhe ua falte bashkëfshatarëve. Fshatarët, të cilët kishin shumë pela, vendosën ta shpërblenin djaloshin. Vendosën t'i grumbullonin 72 mëza dhe t'ia falnin djalit. Djaloshi i mori 72 mëzat. I dërgoi në shtallë. U befasua kur dëgjoi njërin prej tyre tek fliste.*
*- "Humbi këta 11 mëzat e tjerë që mua të më ushqejnë 72 pela, se do të vijë koha dhe do të të shpërblej", - i tha mëzi djalit.*
*Mirëpo, djaloshi i humbi vetëm 10 mëzetër dhe i la dy. Mëzati që piu nga 77 pela u bë shumë i egër dhe çdo gjë që gjente e copëtonte. Kjo punë e mori dhenë dhe për të dëgjoi edhe mbreti, i cili çoi fjalë që ta sillnin djaloshin.*
*- "Ti e paske një kalë shumë të mirë", - i tha mbreti djaloshit. "Duhet të ma japësh mua atë kalë".*
*Mirëpo, djaloshi iu përgjigj: "Më mirë merrma shpirtin, sesa kalin", sepse djaloshi ishte mësuar tashmë me kalin e tij.*
*Mbreti u hidhërua dhe vendosi që t'ia merrte kalin me dredhi djaloshit. Mendoi si t'ia bënte dhe, më në fund, i dha urdhër që të shkonte në det dhe t'ia sillte nuse një sirenë të detit. Djaloshi u kthye në shtëpi i pikëlluar. Kali e pa të zotin e tij të paqejf dhe iu afrua.*
*- "Përse të thirri mbreti dhe çka të tha?" - e pyeti ai djaloshin.*
*Djaloshi i tregoi se si qëndronte puna, por kali i tha se kjo nuk është ndonjë punë e vështirë dhe sakaq e hipi djaloshin mbi shpinë dhe ia dha vrapit tutje.*

17

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për artikuj të ndryshëm;
- Dallon tekstin rrëfyes nga ai përshkrues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit në shtëpi e kanë lexuar përrallën “Djaloshi dhe kali” nga libri *Fletore pune*, ata do ta komentojnë në mënyrë individuale se cilit lloj të tekstit i përket.



Rrugës e panë një dru që po digjej dhe në të disa zogj që posa e panë djaloshin iu lutën që t'i ndihmonte: "Ju lutem, shuajeni këtë zjarr, se kur të keni nevojë do t'ju ndihmojmë ne!
Djaloshi e shoi zjarrin dhe vazhdoi rrugën. Arritën buzë detit, kur aty një peshk kishte mbetur në breg dhe posa e pa djaloshin i kërkoi ndihmë: "Aman, më hidh në ujë, se kur të kesh nevojë do të të ndihmoj!"
Djaloshi e hodhi peshkun në det dhe pastaj arriti deri te një kështjellë në mes të detit. Kështjella i kishte muret e larta dhe anembanë ishte e rrethuar me ujë. Djaloshi e pa se nuk mund të hynte brenda, por kali i tha: "Unë do të hyj brenda!" Kali mori hov dhe e kapërceu murin e lartë dhe u fut në oborr. Banorët e kështjellës u çuditën kur e panë kalin dhe u mblodhën të gjithë përreth tij, duke u shtyrë se cili do t'i hipte. Atypari kaloi edhe e bija e mbretit të detit, sirena më e bukur, e cila, kur e pa kalin, po ashtu, deshi që ta shalonte. Kali, posa e pa princeshën, u ul në gjunjë dhe ajo hipi. Sakaq, kali mori hov e kaloi murin e lartë të kështjellës dhe doli përjashta. Atje po e priste djaloshi. Kali e mori djaloshin me vete dhe vrap e te mbreti i tyre. Mirëpo, sirena nuk e donte mbretin.
- "Që të të marr unë ty ti duhet të ma gjesh unazën që më ka rënë në det", - i tha ajo mbretit. Mbreti përsëri e thirri djaloshin dhe e urdhëroi që ta gjente unazën e sirenës.
- "Si mund të gjendet një unazë e vogël në gjithë atë det, lartmadhëri?", - qante djaloshi, por mbreti kishte dhënë urdhër dhe urdhri duhej të zbatohej. Djaloshi shkoi në shtëpi i mërzitur. Kali e vërejti të zotin e tij dhe e pyeti se çfarë halli kishte dhe djaloshi ia tregoi të gjitha fije e për pe.
- "Kjo punë është kollaj dhe mos u mërzit se do ta gjejmë", - i tha kali djaloshit. U nisën edhe një herë për udhë drejt detit. E thirrën atë peshkun që kishte mbetur në të thatë dhe që djaloshi e ktheu sërithi në det. Peshku iu përgjigj menjëherë dhe këta ia treguan nevojën e tyre. Peshku u krodh në thellësi dhe i mblodhi të gjitha gjallesat e detit, për t'i pyetur se çka kishin ngrënë gjatë javës.
- "Unë e kam ngrënë një unazë të vogël", - i përgjigjet një peshk laraman. Peshku e urdhëroi mikun e tij që ta nxjerrë nga barku unazën dhe ia dha djaloshit. Djaloshi dhe kali u kthyen te mbreti dhe ia dhanë unazën. Mbreti ia dha unazën sirenës, por ajo, meqë nuk e donte mbretin, vazhdoi të bënte ojna.
- "Që të të marr unë ty, o mbret i ndritur, duhet që të m'i gjesh kërrabëzat e çorapëve", - i tha ajo.
Mbreti përsëri e thirri djaloshin dhe e urdhëroi që të nisej sërish në rrugë. Djaloshi u pikëllua sërish dhe vajti te kali për t'ia qarë hallin.
- "Mos u mërzit", - e ngushëlloi kali. "Kërrabëzat do të na i gjejnë ata zogjtë e malit që i shpëtuam tek ai druri që digjej". Dhe vërtet, zogjtë nuk shkoi shumë dhe i gjetën kërrabëzat. Djaloshi ia dorëzoi kërrabëzat mbretit dhe mbreti ia dorëzoi sirenës. Mirëpo, mbretëresha donte ta zgjaste punën edhe më dhe, këtë herë, e kërkoi kalin e saj, i cili ishte i njëjtë me të djaloshit. Djaloshi edhe këtë herë shkoi të qante hall te kali i tij.
- "A e mban mend kur të pata thënë që t'i therje 11 mëzetërit e tjerë, se do të bëheshe pishman. Mirëpo, ti nuk më pate dëgjuar", - ia përkujtoi kali punën djaloshit. Tani ai kali tjetër që e le gjallë është edhe më i fortë se unë dhe do të na bëjë copë-copë posa t'i afrohemi."
Kali pastaj u mendua një grimë dhe i ra ndërmend çka të bënte.
- "M'i sill 12 lëkura bualli dhe 40 kilogramë gozhda dhe patkonj", - i tha djaloshit, i cili menjëherë e përmbushi kërkesën. Kali i veshi 12 lëkurat e buallit dhe i mbathi

18

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Harta e konceptit*

Nxënësit në tabelë me ndihmën e mësimdhënësit do të ndërtojnë hartën e konceptit.




Të përbashkëtat:
- rendin hapësinor kohor,
- personazhet
- rrëfimin
- historinë (fabula dhe subjekti).

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shqyrtim i përbashkët*

Në përfundim të orës do të shqyrtohen të gjitha ato që i mësuan deri më tani për tekstin përshkrues dhe rrëfyes.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tekstit rrëfyes nga ai përshkrues.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 86

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon një tekst rrëfyes nga një tekst përshkrues. Shkruan një tekst rrëfyes. Shkruan një tekst përshkrues.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 3, II: 3. 5, III: 1
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2. 5, 2: 1, 3: 2. 3


40 kilogramë gozhda e patkonj, e hipi djaloshin në shpinë dhe u nisën. Kur arritën te një livadh i madh, e panë kalin e sirenës tek po kulloste.
Atëherë, kali i tha djaloshit: "Unë tash po shkoj të ndeshem me të, kurse ti fshihu këtu dhe pritmë. Nëse e sheh se mua po më del shkumë nga goja, ti ik se ai do të më mposhtë dhe pastaj do të të copëtojë edhe ty. Nëse e sheh se atij po i del shkumë nga goja, atëherë afrohu dhe varja frerin".
Sakaq, kali doli në mejdan dhe kali i sirenës e sulmoi menjëherë kundërshtarin e tij. U bë një luftë e rreptë. Kali i sirenës e qëllonte fuqishëm kalin e djaloshit, saqë ia shqeu të gjitha lëkurët. Mirëpo, në dyluftim e sipër, kalit të sirenës filloi t'i dilte shkumë nga goja. Djaloshi e vërejti dhe menjëherë iu afrua për t'ia vënë frerin.
Djaloshi e mori edhe kalin e mbretëreshës dhe e shpuri në pallat. Sirena këtë herë i kërkoi edhe 12 pelat e saj dhe, djaloshi, ia plotësoi edhe këtë dëshirë.
Atëherë sirena e bëri edhe një kërkesë: "Milni të gjitha pelat dhe qumështin e tyre vëreni në një kazan dhe vlojeni në zjarr. Në kazan i pari do të hyjë djaloshi dhe pas tij edhe mbreti".

Djaloshi u bë zeher. E dinte se do të digjej në qumështin e vluar. Mirëpo, edhe këtë herë kali i tij e ngushëlloi: "Kur ata të të thonë të futesh në kazan, ti thuaju: mirë, unë do të futem, por dua që ta kem kalin afër që të më qajë, derisa të më dalë shpirti".
Djaloshi vajti dhe bëri ashtu siç i kishte thënë kali. Askush nuk pati asgjë kundër që ai ta merrte kalin para se të hynte në kazan. Djaloshi u zhvesh, u mat një çast dhe, pastaj, u hodh duke lënë prapa klithma tmerri të të pranishmëve. Posa ky kërceu, kali i fryu qumështit dhe ai u ftoh në çast. Djaloshi u hodh brenda, u zhyt disa sekonda dhe doli si mos më mirë. Atëherë, sirena kërkoi që qumështi të zihej edhe një herë dhe në të të kërcente mbreti. Ashtu u bë. Mbreti, duke menduar se do të shpëtonte si djaloshi, u hodh me vetëbesim dhe u dogj përnjëherësh.
Pastaj sirena u martua me djaloshin, i cili u bë mbret dhe të dy mbretëruan një kohë të gjatë me dheun dhe me detin. Përralla në shkallë, dukati në ballë.

(Marrë nga Vizatori)

*Teksti i mësipërm është:*

*c. Tekst letrar*
*d. Tekst joletrar*

*Teksti i mësipërm është:*

*c. Prozë*
*d. Poezi*

*Teksti i mësipërm është:*

*c. Përshkrim*
*d. Rrëfim*

19

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përshkrimi dhe rrëfimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për artikuj të ndryshëm;
- Dallon tekstin rrëfyes nga ai përshkrues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit do të bëjnë një përsëritje të njësisë së mësuar, ku do të përcillen me disa pyetje të shtruara nga mësimdhënësi.
Disa nga pyetjet dhe përgjigjet mund të jenë:
Çfarë mësuat në orët e kaluara?
*Ne kemi mësuar për tekstet rrëfyese dhe tekstet përshkruese.*
Përrallat, a janë tekste rrëfyese apo përshkruese?
*Përrallat mund të jenë edhe tekste rrëfyese, edhe tekste përshkruese.*


**Njeriu me vragë**

*Në fytyrë kishte një vragë që i hiqej e gjatë dhe e kuqe në formë gjysmëhëne nga tëmthi deri në mjekër... Mbante veshur një palë rroba të ndrydhura ngjyrë hiri, një këmishë të kaftë dhe një kapelë në kokë...*

(Pjesë nga tregimet e Uiliam Samerset Mom)

*Teksti i mësipërm është:*

*e. Tekst letrar*
*f. Tekst joletrar*

*Teksti i mësipërm është:*

*e. Prozë*
*f. Poezi*

*Teksti i mësipërm është:*

*e. Përshkrim*
*f. Rrëfim*

**Detyrë**

- *Përshkruaje pamjen e klasës sate.*
- *Përshkruaje pamjen e një anëtari të familjes sate.*
- *Rrëfeje (me më pak se 80 fjalë) një ngjarje që të ka ndodhur.*
- *Rrëfe si e ke kaluar ditën në shkollë.*
- *Bashkë me arsimtarin/en, vizitoni bibliotekën më të afërt. Gjeni libra me përralla dhe huazoni ata. Pastaj, diskutoni në klasë për përrallat që ju kanë pëlqyer më shumë gjatë leximit.*
- *Përzgjidh një temë dhe krijo një tregim ose përrallë. Lexoni krijimet tuaja në klasë dhe diskutoni.*

20

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Përmbledhje pohim-mbështetje*

Nxënësit i rikthehen edhe njëherë përrallës "Djaloshi dhe kali".

*Teksti i lexuar është:*

*a.* *Tekst letrar*
*b.* *Tekst joletrar*
*c.* *Prozë*
*ç.* *Poezi*
*d.* *Përshkrim*
*dh.* *Rrëfim*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit kanë për detyrë që të bëjnë përshkrimin e klasës.
*Klasa ime ka shumë banka, karrige, ka dhe dollapë, është e madhe, ka shumë dritare ku depërton drita.*

Të rrëfejnë se si e kalojnë një ditë në shkollë.
*Unë sot kalova shumë mirë në shkollë, mora shumë dashuri nga shokët dhe shoqet. Me mësime isha shumë mirë.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të tekstit rrëfyes nga ai përshkrues.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 87

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 25
NDAJFOLJA



***Pyetje:***

- *Fjalët **bukur, vazhdimisht, rrallë, shpesh, bashkë** tregojnë tipar të veprimit ose të gjendjes (të foljes) dhe janë ndajfolje. Ndajfoljet kanë kategori të shkallës.*

***Ndajfoljet ndahen në:***

- *Ndajfolje mënyre (plotëson foljen, duke i dhënë përgjigje pyetjes **si**): Do të ecim **ngadalë**; A nuk jua demonstrova **konkretisht?** (Si do të ecim? Ngadalë)*
- *Ndajfolje sasie (plotëson foljen, duke i dhënë përgjigje pyetjes sa): Ai fliste **pak** dhe punonte **shumë.***
- *Ndajfolje kohe (plotëson foljen, duke i dhënë përgjigje pyetjes **kur**): **Natën** është errësirë, **ditën** duket shumë mirë.*
- *Ndajfolje vendi (plotëson foljen, duke i dhënë përgjigje pyetjes **ku**): **Aty** ku shkon ai, **atje** do të jem edhe unë.*
- *Ndajfolje shkaku (plotëson foljen, duke i dhënë përgjigje pyetjes **pse**): **Pse** pushoi muzika? **Përse** qesh?*

93

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Morfologji- ndajfolja dhe llojet e saj

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon llojet e ndajfoljes, si ndajfolje mënyre, sasie, kohe,vendi dhe i përdor ato drejt në të folur e të shkruar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 1; III. 7
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 4; 3. 2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndajfolja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon ndajfoljet dhe llojet e saj;
- Përdor llojet e ndajfoljeve në shembuj të ndryshëm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, tabela.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Artet, Gjuha angleze.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Pyeten nxënësit se cilat janë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe çfarë dallojnë nga pjesët e ndryshueshme. Pasi merren përgjigjet e tyre, ndalemi te ndajfolja që është planifikuar si njësi mësimore.



***Sa i përket ndërtimit, ndajfoljet ndahen në:***

- *Të thjeshta: mirë, keq, sot, këtu.*
- *Të përbëra: besnikërisht, kalimthi, gjithmonë, menjëherë.*
- *Shprehje ndajfoljore: ditë për ditë, lart e poshtë, copa-copa.*

***Ndajfolja i ka tri shkallë:***

- *Pohore: Ajo fliste **shpejt**.*
- *Krahasore: Ajo fliste **më shpejt** se shoqet e saj.*
- *Sipërore: Ajo fliste **shumë shpejt**.*

***Bashkëbisedojmë:***

*Ndajfolet shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim veprimit - foljes. Zakonisht, sa më pak ndajfolje ka, aq më objektiv është teksti. Ndajfoljet mund të shprehin qëndrimin e atij që flet. P.sh. luaj bukur, punoj shumë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është bukur ose shumë, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*
*Ndajfoljet mund të jenë objektive, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin. P.sh. punoj sot, erdha ditën.*

***Pyetje:***

- *Çfarë kategori gramatikore ka ndajfolja?*
- *Cilën pjesë të ligjëratës e plotëson ndajfolja?*
- *Si ndahen ndajfoljet?*
- *Si ndahen ndajfoljet për nga ndërtimi?*
- *Sa shkallë i ka ndajfolja?*

Shih fletoren e punës

94

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Shpjegohen elementet kryesore për ndajfoljen me anë të pyetjeve, si:
- Cilën pjesë të ligjëratës e plotëson ndajfolja?
- Si klasifikohen ndajfoljet sipas kuptimit?
- Si klasifikohen ndajfoljet sipas ndërtimit?
- A kanë kategori gramatikore ndajfoljet dhe cilat janë ato?

Pyetjeve të mësipërme u përgjigjemi, duke diskutuar bashkërisht me nxënësit rreth tyre. Gjithashtu, merren shembuj për secilin lloj të ndajfoljeve, si dhe te shkallëzimi i ndajfoljeve ndalemi më shumë për ta thjeshtësuar pjesën teorike me atë praktike.

Shkalla pohore - *pastër*
Shkalla krahasore - *më pastër*
Shkalla sipërore - *shumë pastër*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikimi në dyshe*

Shkruhen disa ndajfolje në tabelë: *afër, herët, bukur, thjesht, tepër.* Nxënësit punojnë në dyshe; i klasifikojnë ndajfoljet sipas kuptimit dhe ndërtimit, si dhe marrin shembuj me ndajfoljet e dhëna në tri shkallët.
Shembull:
*Afër* - ndajfolje vendi sipas kuptimit, sipas ndërtimit ndajfolje e thjeshtë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njohurive për identifikimin e ndajfoljeve dhe përdorimin e tyre të saktë në shembuj të ndryshëm.

**Detyrë:**
(Të plotësohet fletore pune në faqe 55-56)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 88

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndajfolja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon llojet e ndajfoljes, si: ndajfolje mënyre, sasie, kohe, vendi, shkaku dhe i përdor drejt në të folur e në të shkruar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 24

NDAJFOLJA

*Detyrë*

◇ *Plotësojeni tabelën me llojet e ndajfoljeve:* ***mbrëmë, sot, diku, aty, shumë, pak, gjerësisht, bukur, pse, tmerrësisht, qëllimisht, shqip, anglisht, befas, natyrshëm, nesër, atje, këtu, përse.***

| | |
|---|---|
| *Ndajfolje mënyre* | |
| *Ndajfolje sasie* | |
| *Ndajfolje kohe* | |
| *Ndajfolje vendi* | |
| *Ndajfolje shkaku* | |

55

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndajfolja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon ndajfoljen dhe kategorinë gramatikore të saj;
- Klasifikon ndajfoljet sipas ndërtimit;
- Dallon llojet e ndajfoljeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit do t'i lexojnë detyrat e bëra në shtëpi, faqe 55.

Plotësojeni tabelën me llojet e ndajfoljeve: *mbrëmë, sot, dikur, aty, shumë, pak, gjerësisht, bukur, pse, tmerrësisht, qëllimisht, shqip, anglisht, befas, natyrisht, nesër, atje, këtu, përse.*

| | |
|---|---|
| Ndajfolje mënyre | gjerësisht, bukur |
| Ndajfolje sasie | shumë, pak |
| Ndajfolje kohe | mbrëmë, sot |
| Ndajfolje vendi | aty, atje |
| Ndajfolje shkaku | pse, përse |



◇ *Cila shkallë e ndajfoljes përdoret në shembullin:* ***Këndonte jashtëzakonisht bukur.***

*a. pohore*
*b. krahasore*
*c. sipërore*

◇ *Gjeni ndajfoljet që kanë kuptim të kundërt me ndajfoljet e dhëna më poshtë:*

| | | |
|---|---|---|
| *Mirë* ______ | *Shumë* ______ | *Herët* ______ |
| *Lehtë* ______ | *Shpejt* ______ | *Lart* ______ |

◇ *Lidhni emrat me prapashtesat që përshtaten për të ndërtuar ndajfolje:*

| | |
|---|---|
| *Fluturim* | *-sht* |
| *Bark* | *-thi* |
| *Gjerësi* | *-as* |
| *Fshatar* | *-shëm* |
| *Hare* | *-çe* |

◇ *Shkruani një ese pa përdorur ndajfolje që shprehin qëndrim.*

56

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Në pjesën e dytë do të shpjegohen dhe përforcohen njohuritë për ndajfoljen. Mësimdhënësi e shpjegon përdorimin e ndajfoljeve, sa më pak ndajfolje teksti është më objektiv. Marrim shembuj në tabelë.

Ndajfolje mënyre:

*Arta* ***luan*** *bukur në piano.*

*Bukur në piano* ***luan*** *Arta.*

*Arta në piano* ***luan*** *bukur.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Detyrë*

Nxënësit do t'i plotësojnë detyrat në *Fletore pune,* faqe 56.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të ndajfoljeve nga pjesë të tjera, klasifikimit të tyre dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë shembuj me ndajfolje kohe dhe sasie)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 89



**Sa i përket ndërtimit, ndajfoljet ndahen në:**

- *Të thjeshta: mirë, keq, sot, këtu.*
- *Të përbëra: besnikërisht, kalimthi, gjithmonë, menjëherë.*
- *Shprehje ndajfoljore: ditë për ditë, lart e poshtë, copa-copa.*

**Ndajfolja i ka tri shkallë:**

- *Pohore: Ajo fliste* ***shpejt****.*
- *Krahasore: Ajo fliste* ***më shpejt*** *se shoqet e saj.*
- *Sipërore: Ajo fliste* ***shumë shpejt****.*

**Bashkëbisedojmë:**

*Ndajfolet shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim veprimit - foljes. Zakonisht, sa më pak ndajfolje ka, aq më objektiv është teksti. Ndajfoljet mund të shprehin qëndrimin e atij që flet. P.sh. luaj bukur, punoj shumë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është bukur ose shumë, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*
*Ndajfoljet mund të jenë objektive, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin. P.sh. punoj sot, erdha ditën.*

**Pyetje:**

- *Çfarë kategori gramatikore ka ndajfolja?*
- *Cilën pjesë të ligjëratës e plotëson ndajfolja?*
- *Si ndahen ndajfoljet?*
- *Si ndahen ndajfoljet për nga ndërtimi?*
- *Sa shkallë i ka ndajfolja?*

Shih fletoren e punës

94

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndajfolja

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon llojet e ndajfoljes, si: ndajfolje mënyre, sasie, kohe, vendi, shkaku dhe i përdor drejt në të folur e në të shkruar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndajfolja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon ndajfoljen dhe kategorinë gramatikore të saj;
- Klasifikon ndajfoljet sipas ndërtimit;
- Dallon llojet e ndajfoljeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit i shkruajnë disa shembuj me ndajfolje kohe dhe sasie në tabelë.

Shembujt që mund të ishin:

- ***Sot*** *do të shkojmë në shkollë* (ndajfolje kohe).
- *Ai fliste* ***pak*** *dhe punonte* ***shumë*** (ndajfolje sasie).



***Sa i përket ndërtimit, ndajfoljet ndahen në:***

- *Të thjeshta: mirë, keq, sot, këtu.*
- *Të përbëra: besnikërisht, kalimthi, gjithmonë, menjëherë.*
- *Shprehje ndajfoljore: ditë për ditë, lart e poshtë, copa-copa.*

***Ndajfolja i ka tri shkallë:***

- *Pohore: Ajo fliste **shpejt**.*
- *Krahasore: Ajo fliste **më shpejt** se shoqet e saj.*
- *Sipërore: Ajo fliste **shumë shpejt**.*

***Bashkëbisedojmë:***

*Ndajfolet shërbejnë edhe për t'i dhënë ngjyrim veprimit - foljes. Zakonisht, sa më pak ndajfolje ka, aq më objektiv është teksti. Ndajfoljet mund të shprehin qëndrimin e atij që flet. P.sh. luaj bukur, punoj shumë. Meqë nuk ka një kriter universal për të caktuar kur është bukur ose shumë, kjo i mbetet folësit për ta vlerësuar.*
*Ndajfoljet mund të jenë objektive, kur ekziston një marrëveshje ose kriter për ta caktuar tiparin. P.sh. punoj sot, erdha ditën.*

***Pyetje:***

- *Çfarë kategori gramatikore ka ndajfolja?*
- *Cilën pjesë të ligjëratës e plotëson ndajfolja?*
- *Si ndahen ndajfoljet?*
- *Si ndahen ndajfoljet për nga ndërtimi?*
- *Sa shkallë i ka ndajfolja?*

Shih fletoren e punës

94

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit t'i lexojnë pyetjet në fund të njësisë në librin bazë, faqe 94.

*Çfarë kategorie gramatikore ka ndajfolja?*
*Cilën pjesë të ligjëratës e plotëson ndajfolja?*
*Si ndahet ndajfoljet?*
*Si ndahen ndajfoljet sipas ndërtimit?*
*Sa shkallë i ka ndajfolja?*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Paragraf përmbledhës*

Nxënësit do të bëjnë një përmbledhje të njësisë për ndajfoljen.

*Ndajfoljet ndahen në ndajfolje mënyre, sasie, kohe, vendi, shkaku, kurse sipas ndërtimit kemi ndajfolje të thjeshta, të përbëra dhe shprehje ndajfoljore. Ndajfolja ka tri shkallë: pohore, krahasore dhe sipërore.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të ndajfoljeve nga pjesë të tjera, klasifikimit të tyre dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 90

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Pjesëza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon pjesëzat në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 6, II: 2. 4, III: 3. 5

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 4



nJësia 26
PJESËZAT

Fragment nga "Magelani", Stefan Zweig"

**"MAGELANI ZBULON..."**

Rezervat ushqimore **po** pakësoheshin në mënyrë të tmerrshme gjatë atij lundrimi, që zgjati aq shumë, sa **s**'ishte parashikuar dhe mjerimi shtohej jashtë masës. Ajo që i jepte çdo ditë nozulluesi ekuipazhit mund **të** quhej **qysh** prej një kohe të gjatë **më** tepër pleh se ushqim. **S**'kishte mbetur asnjë pikë verë, që **t**'u freskonte një çikëz buzët dhe shpirtin. Po, uji pa kripë, i përvëluar nga dielli i pamëshirshëm dhe i prishur në fuçitë dhe në kacekët e ndotur, binte erë aq të keqe, sa ishin të detyruar të zinin hundët me dorë, kur lagnin gurmazin e tharë me gllënjkën e vetme që **u** ishte caktuar për tërë ditën. Peksimadhet dhe peshqit që zinin në det ishin ushqimi i tyre i vetëm. Por, peksimadhet ishin bërë prej kohësh një pluhur bojë hiri, i fëlliqur, ku lëvrinin krimbat dhe veç kësaj i ndytë nga të pëgërat e minjve, që ishin bërë edhe ata si të çmendur nga uria dhe që vërsuleshin mbi këto mbeturina ushqimi si **mos më** keq.. Detarët i gjuanin si të tërbuar, në tërë qoshet... Këtë **nuk** e bënin **vetëm për** t'i shfarosur, por edhe **për** të shitur kërmat e tyre si gjellë të zgjedhur...
**Më së** fundi, **më** 6 mars 1521 (**gjer** atëherë dielli **më** shumë se njëqind herë kishte dalë mbi kaltërsinë e shkretë, të palëvizshme...të pamëshirshme, **më** shumë se njëqind herë dita ishte bërë natë dhe nata ditë...) **dhe ja** ku erdhi koha **për** ta lëshuar atë britmë: Tokë! Tokë! Anijet me një ekuipazh të vdekur urie, **mu** si varreza mbi ujë, **do të** endeshin andej-këtej nga **t**'i shtynte era, **do t**'i përpinin dallgët ose **do t**'i përplasnin pas shkëmbit.

***Diskutim:***
- *Kush ishte Ferdinand Magelani?*
- *Çfarë dini për Ngushticën e Magelanit?*
- *Çfarë vërtetoi Magelani me lundrimin e tij rreth Tokës?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Në tekstin e dhënë "Magelani zbulon" të Stefan Zweig janë disa fjalë me shkronja të theksuara. Këto i quajmë **pjeseza**.*

***Pjesëzat** janë fjalë që hyjnë në grupin e fjalëve të pandryshueshme (nuk lakohen gjatë përdorimit në një kontekst të caktuar) e që nuk kanë kuptim leksiko-gramatikor të pavarur. Ato i shërbejnë një fjale, një grupi fjalësh apo një fjalie për të shprehur:*
- *ngjyrime kuptimore të përgjithshme;*
- *ngjyrime emocionale-shprehëse;*
- *ngjyrime që tregojnë modalitet.*

95

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pjesëzat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton llojin e pjesëzës;
- Dallon pjesëzën në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Në fillim të orës nxënësit pyeten për njohuritë paraprake që kanë për pjesëzat.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Pjesëzat janë fjalë të pandryshueshme që përdoren për ta plotësuar kuptimin e një fjale apo fjalie. | | |



njësia 26

PJESËZAT

Fragment nga "Magelani", Stefan Zweig"

**"MAGELANI ZBULON..."**

Rezervat ushqimore **po** pakësoheshin në mënyrë të tmerrshme gjatë atij lundrimi, që zgjati aq shumë, sa **s**'ishte parashikuar dhe mjerimi shtohej jashtë masës. Ajo që i jepte çdo ditë nozulluesi ekuipazhit mund **të** quhej **qysh** prej një kohe të gjatë **më** tepër pleh se ushqim. **S**'kishte mbetur asnjë pikë verë, që **t**'u freskonte një çikëz buzët dhe shpirtin. Po, uji pa kripë, i përvëluar nga dielli i pamëshirshëm dhe i prishur në fuçitë dhe në kacekët e ndotur, binte erë aq të keqe, sa ishin të detyruar të zinin hundët me dorë, kur lagnin gurmazin e tharë me gllënjkën e vetme që **u** ishte caktuar për tërë ditën. Peksimadhet dhe peshqit që zinin në det ishin ushqimi i tyre i vetëm. Por, peksimadhet ishin bërë prej kohësh një pluhur bojë hiri, i fëlliqur, ku lëvrinin krimbat dhe veç kësaj i ndytë nga të pëgërat e minjve, që ishin bërë edhe ata si të çmendur nga uria dhe që vërsuleshin mbi këto mbeturina ushqimi si **mos më** keq.. Detarët i gjuanin si të tërbuar, në tërë qoshet... Këtë **nuk** e bënin **vetëm për** t'i shfarosur, por edhe **për** të shitur kërmat e tyre si gjellë të zgjedhur...
**Më së** fundi, **më** 6 mars 1521 (**gjer** atëherë dielli **më** shumë se njëqind herë kishte dalë mbi kaltërsinë e shkretë, të palëvizshme...të pamëshirshme, **më** shumë se njëqind herë dita ishte bërë natë dhe nata ditë...) **dhe ja** ku erdhi koha **për** ta lëshuar atë britmë: Tokë! Tokë! Anijet me një ekuipazh të vdekur urie, **mu** si varreza mbi ujë, **do të** endeshin andej-këtej nga **t**'i shtynte era, **do t**'i përpinin dallgët ose **do t**'i përplasnin pas shkëmbit.

***Diskutim:***

- *Kush ishte Ferdinand Magelani?*
- *Çfarë dini për Ngushticën e Magelanit?*
- *Çfarë vërtetoi Magelani me lundrimin e tij rreth Tokës?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Në tekstin e dhënë "Magelani zbulon" të Stefan Zweig janë disa fjalë me shkronja të theksuara. Këto i quajmë* ***pjesëza****.*

***Pjesëzat*** *janë fjalë që hyjnë në grupin e fjalëve të pandryshueshme (nuk lakohen gjatë përdorimit në një kontekst të caktuar) e që nuk kanë kuptim leksiko-gramatikor të pavarur. Ato i shërbejnë një fjale, një grupi fjalësh apo një fjalie për të shprehur:*

- *ngjyrime kuptimore të përgjithshme;*
- *ngjyrime emocionale-shprehëse;*
- *ngjyrime që tregojnë modalitet.*

95

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit punojnë në dyshe dhe do të shtrojnë pyetje rreth pjesëzës për të mësuar më shumë për të.

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Pjesëzat janë fjalë të pandryshueshme që përdoren për ta plotësuar kuptimin e një fjale apo fjalie. | Çfarë lloje të pjesëzave kemi? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova*

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Pjesëzat janë fjalë të pandryshueshme që përdoren për ta plotësuar kuptimin e një fjale apo fjalie. | Çfarë lloje të pjesëzave kemi? | a) të thjeshta<br>b) të përngjitura<br>c) shprehje ose lokucione |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të pjesëzave nga pjesë të tjera dhe klasifikimin e tyre.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë fjali ku do të përdorin pjesëza)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 91



njësia 26

PJESËZAT

Fragment nga "Magelani", Stefan Zweig"

**"MAGELANI ZBULON..."**

Rezervat ushqimore **po** pakësoheshin në mënyrë të tmerrshme gjatë atij lundrimi, që zgjati aq shumë, sa **s**'ishte parashikuar dhe mjerimi shtohej jashtë masës. Ajo që i jepte çdo ditë nozulluesi ekuipazhit mund **të** quhej **qysh** prej një kohe të gjatë **më** tepër pleh se ushqim. **S**'kishte mbetur asnjë pikë verë, që **t**'u freskonte një çikëz buzët dhe shpirtin. Po, uji pa kripë, i përvëluar nga dielli i pamëshirshëm dhe i prishur në fuçitë dhe në kacekët e ndotur, binte erë aq të keqe, sa ishin të detyruar të zinin hundët me dorë, kur lagnin gurmazin e tharë me gllënjkën e vetme që **u** ishte caktuar për tërë ditën. Peksimadhet dhe peshqit që zinin në det ishin ushqimi i tyre i vetëm. Por, peksimadhet ishin bërë prej kohësh një pluhur bojë hiri, i fëlliqur, ku lëvrinin krimbat dhe veç kësaj i ndytë nga të pëgërat e minjve, që ishin bërë edhe ata si të çmendur nga uria dhe që vërsuleshin mbi këto mbeturina ushqimi si **mos më** keq.. Detarët i gjuanin si të tërbuar, në tërë qoshet... Këtë **nuk** e bënin **vetëm për** t'i shfarosur, por edhe **për** të shitur kërmat e tyre si gjellë të zgjedhur...
**Më së** fundi, **më** 6 mars 1521 (**gjer** atëherë dielli **më** shumë se njëqind herë kishte dalë mbi kaltërsinë e shkretë, të palëvizshme...të pamëshirshme, **më** shumë se njëqind herë dita ishte bërë natë dhe nata ditë...) **dhe ja** ku erdhi koha **për** ta lëshuar atë britmë: Tokë! Tokë! Anijet me një ekuipazh të vdekur urie, **mu** si varreza mbi ujë, **do të** endeshin andej-këtej nga **t**'i shtynte era, **do t**'i përpinin dallgët ose **do t**'i përplasnin pas shkëmbit.

***Diskutim:***

- *Kush ishte Ferdinand Magelani?*
- *Çfarë dini për Ngushticën e Magelanit?*
- *Çfarë vërtetoi Magelani me lundrimin e tij rreth Tokës?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Në tekstin e dhënë "Magelani zbulon" të Stefan Zweig janë disa fjalë me shkronja të theksuara. Këto i quajmë* ***pjesëza****.*

***Pjesëzat*** *janë fjalë që hyjnë në grupin e fjalëve të pandryshueshme (nuk lakohen gjatë përdorimit në një kontekst të caktuar) e që nuk kanë kuptim leksiko-gramatikor të pavarur. Ato i shërbejnë një fjale, një grupi fjalësh apo një fjalie për të shprehur:*

- *ngjyrime kuptimore të përgjithshme;*
- *ngjyrime emocionale-shprehëse;*
- *ngjyrime që tregojnë modalitet.*

95

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Pjesëza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon pjesëzën në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 6, II: 2, III: 5

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 4

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pjesëzat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan drejt fjalët;
- Dallon pjesëzën në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptopi

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit bashkë me mësimdhënësin i rikujtojnë njohuritë e fituara nga orët e mëparshme për pjesëzën.
Mbani mend:
- Pjesëzat janë fjalë që hyjnë në grupin e fjalëve të pandryshueshme e që nuk kanë kuptim leksiko-gramatikor të pavarur.



— ***Pjesëzat me ngjyrime kuptimore ndahen tutje në:***

*a. pjesëza dëftuese (ja dhe qe)*

*Ku janë letrat? - **Ja**, këtu janë.*
*A u pajtuam? - **Qe** dorën.*

*b. pjesëza përcaktuese-saktësuese **(mu, plot, pikërisht, që, qysh, gjer, rrumbullak)***

*Po unë do të bëj të pamundurën*
***Pikërisht** me ty*
***Pikërisht** ngaqë të kam thënë*
***Pikërisht** ngaqë më ke thënë*
***Pikërisht** ngaqë ma kanë thënë*
***Pikërisht** ngaqë edhe vetë e dimë*
***Pikërisht** ngaqë thonë*
*Arsyeja*
*Logjika*
*Matematika...*
*Pjesë nga poezia "Pikërisht" e Agron Tufës*

*Kjo gjë më erdhi **mu** në majë të hundës.*
***Që** nga Shkodra **gjer** në Vlorë!*

*c. pjesëzat përforcuese **(madje, bile, edhe, sidomos, veç, veçse, veçanërisht, vetëm, dhe, edhe)***
- *Ata mund të bëjnë shaka, **madje** edhe në situatat më të zeza.*
- *E ka bërë **veç** një gabim.*

*d. pjesëzat përafruese (**afro, nja, rreth, gati, desh, aty-aty, thuajse**)*
- *Pinguinët mund të kërcejnë **gati** 2 metra lart.*
- *Bletës, për të prodhuar 1 kavanoz me mjaltë, i duhet të fluturojë **rreth** 80 mijë km dhe të ndalet në 2 milionë lule.*

— ***Pjesëzat me ngjyrime emocionale-shprehëse (ç', seç, pa, pale, pra, se, de etj.):***

*Dhe thënia e vjetër e Heraklitit*
***Seç** m'u kujtua sot për dreq:*
*"Të zgjuarit janë bashkë në botë,*
*Kurse të fjeturit janë veç".*
*Strofë nga poezia "Mall" e Ismail Kadaresë*

96

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Harta e konceptit*

Nxënësit do të punojnë në grupe *hartën e konceptit.*




Pasi të punohet në tabelë harta e konceptit, bëhet një përsëritje e njësisë për pjesëzën, për funksionin dhe rëndësinë e saj.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Në dyshe nxënësit do të shkruajnë shembuj me pjesëza.

Shembujt mund të jenë:
*Vetëm klasa ime nuk shkoi.*
*Le të shkojnë edhe fëmijët.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të pjesëzave nga pjesë të tjera dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 92

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 26
PJESËZAT

Fragment nga “Magelani”, Stefan Zweig”

**“MAGELANI ZBULON…”**

Rezervat ushqimore **po** pakësoheshin në mënyrë të tmerrshme gjatë atij lundrimi, që zgjati aq shumë, sa **s**'ishte parashikuar dhe mjerimi shtohej jashtë masës. Ajo që i jepte çdo ditë nozulluesi ekuipazhit mund **të** quhej **qysh** prej një kohe të gjatë **më** tepër pleh se ushqim. **S**'kishte mbetur asnjë pikë verë, që **t**'u freskonte një çikëz buzët dhe shpirtin. Po, uji pa kripë, i përvëluar nga dielli i pamëshirshëm dhe i prishur në fuçitë dhe në kacekët e ndotur, binte erë aq të keqe, sa ishin të detyruar të zinin hundët me dorë, kur lagnin gurmazin e tharë me gllënjkën e vetme që **u** ishte caktuar për tërë ditën. Peksimadhet dhe peshqit që zinin në det ishin ushqimi i tyre i vetëm. Por, peksimadhet ishin bërë prej kohësh një pluhur bojë hiri, i fëlliqur, ku lëvrinin krimbat dhe veç kësaj i ndytë nga të pëgërat e minjve, që ishin bërë edhe ata si të çmendur nga uria dhe që vërsuleshin mbi këto mbeturina ushqimi si **mos më** keq.. Detarët i gjuanin si të tërbuar, në tërë qoshet… Këtë **nuk** e bënin **vetëm për** t'i shfarosur, por edhe **për** të shitur kërmat e tyre si gjellë të zgjedhur…
**Më së** fundi, **më** 6 mars 1521 (**gjer** atëherë dielli **më** shumë se njëqind herë kishte dalë mbi kaltërsinë e shkretë, të palëvizshme…të pamëshirshme, **më** shumë se njëqind herë dita ishte bërë natë dhe nata ditë…) **dhe ja** ku erdhi koha **për** ta lëshuar atë britmë: Tokë! Tokë! Anijet me një ekuipazh të vdekur urie, **mu** si varreza mbi ujë, **do të** endeshin andej-këtej nga **t**'i shtynte era, **do t**'i përpinin dallgët ose **do t**'i përplasnin pas shkëmbit.

***Diskutim:***

- *Kush ishte Ferdinand Magelani?*
- *Çfarë dini për Ngushticën e Magelanit?*
- *Çfarë vërtetoi Magelani me lundrimin e tij rreth Tokës?*

***Bashkëbisedojmë:***

*Në tekstin e dhënë “Magelani zbulon” të Stefan Zweig janë disa fjalë me shkronja të theksuara. Këto i quajmë **pjesëza**.*

***Pjesëzat** janë fjalë që hyjnë në grupin e fjalëve të pandryshueshme (nuk lakohen gjatë përdorimit në një kontekst të caktuar) e që nuk kanë kuptim leksiko-gramatikor të pavarur. Ato i shërbejnë një fjale, një grupi fjalësh apo një fjalie për të shprehur:*

- *ngjyrime kuptimore të përgjithshme;*
- *ngjyrime emocionale-shprehëse;*
- *ngjyrime që tregojnë modalitet.*

95

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Pjesëza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon pjesëzën në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pjesëzat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan drejt fjalët;
- Dallon pjesëzën në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të fillojnë ta lexojnë tekstin “Magelani Zbulon” në librin bazë.
Gjatë leximit nga nxënësit kërkohet t'i rrethojnë pjesëzat në tekstin e dhënë.


— ***Pjesëzat me ngjyrime kuptimore ndahen tutje në:***

*a. pjesëza dëftuese (ja dhe qe)*

*Ku janë letrat? - **Ja**, këtu janë.*
*A u pajtuam? - **Qe** dorën.*

*b. pjesëza përcaktuese-saktësuese **(mu, plot, pikërisht, që, qysh, gjer, rrumbullak)***

*Po unë do të bëj të pamundurën*
***Pikërisht** me ty*
***Pikërisht** ngaqë të kam thënë*
***Pikërisht** ngaqë më ke thënë*
***Pikërisht** ngaqë ma kanë thënë*
***Pikërisht** ngaqë edhe vetë e dimë*
***Pikërisht** ngaqë thonë*
*Arsyeja*
*Logjika*
*Matematika...*
*Pjesë nga poezia "Pikërisht" e Agron Tufës*

*Kjo gjë më erdhi **mu** në majë të hundës.*
***Që** nga Shkodra **gjer** në Vlorë!*

*c. pjesëzat përforcuese **(madje, bile, edhe, sidomos, veç, veçse, veçanërisht, vetëm, dhe, edhe)***
- *Ata mund të bëjnë shaka, **madje** edhe në situatat më të zeza.*
- *E ka bërë **veç** një gabim.*

*d. pjesëzat përafruese (**afro, nja, rreth, gati, desh, aty-aty, thuajse**)*
- *Pinguinët mund të kërcejnë **gati** 2 metra lart.*
- *Bletës, për të prodhuar 1 kavanoz me mjaltë, i duhet të fluturojë **rreth** 80 mijë km dhe të ndalet në 2 milionë lule.*

— ***Pjesëzat me ngjyrime emocionale-shprehëse (ç', seç, pa, pale, pra, se, de etj.):***

*Dhe thënia e vjetër e Heraklitit*
***Seç** m'u kujtua sot për dreq:*
*"Të zgjuarit janë bashkë në botë,*
*Kurse të fjeturit janë veç".*
*Strofë nga poezia "Mall" e Ismail Kadaresë*

96

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Pasi të jenë nënvizuar pjesëzat e gjetura në tekst, një nxënës nga grupi do t'i lexojë ato.
*Po, s', të, qysh, më, t', mos, më etj.*

*Diskutim*
Diskutohet me nxënës rreth tekstit të lexuar duke marrë edhe njohuri që ata mund të kenë për Ferdinand Magelanin.
- Kush ishte Ferdinand Magelani?
- Çfarë dini për Ngushticën e Magelanit?
- Çfarë vërtetoi Magelani me lundrimin e tij rreth Tokës?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit në dyshe do të shkruajnë shembuj me pjeseza dëftuese, përcaktuese-saktësuese, përforcuese, përafruese.
Po ashtu për pjesëzat modale: pohuese, mohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse.
*Ku janë letrat? – Ja ku janë.*
*As që do ta kuptosh ndonjëherë.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të pjesëzave nga pjesë të tjera dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 93

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Parafjala

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt parafjalët: me, për, në, nga, te, gjer, prej, ndaj, pranë, larg dhe i dallon nga ndajfoljet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2; I. 4; II. 5; III. 3
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2; 2: 1, 4; 3: 2



njësia 27
PARAFJALA

Nga "Histori e Skënderbeut", Marin Barleti

LINDJA E SKËNDERBEUT

Në Epir,...shquhej ***ndërmjet*** mbretërve të vegjël dhe princërve të tjerë, emri fisnik i Gjon Kastriotit ***për*** sundimin e tij ***në*** qytete të tjera, si ***në*** Krujë veçanërisht... Krerët e fisit të Kastriotëve kanë rrjedhur ***nga*** Mati ***prej*** një dere fisnike dhe kanë sunduar ***në*** Epir njëkohësisht ***me*** lavdi e fatbardhë- si... Gruaja e këtij e kishte emrin Vojsavë... (Ajo) lindi dhe rriti nëntë fëmijë. Më i vogli ***nga*** mosha ishte Gjergji, të cilit, më vonë, ***te*** barbarët,.. iu dha emri Skënderbej.

...Thonë, pra, se kur e ëma mbeti ***me*** barrë ***me*** të, pa ***në*** ëndërr se lindi një dragua aq të madh, saqë mbulonte Epirin, kokën e shtrinte ***ndërmjet*** kufijve të turqve, ndërsa bishtin e mbante ***në*** det, ***ndërmjet*** kufijve... të shtetit venedikas...

Gjoni e qetësoi të shoqen - do të lindte një burrë i përmendur ***në*** luftë dhe ***në*** vepra, i cili do të ishte armiku më i rreptë i turqve dhe, njëkohësisht, kapedani më fatbardh...

*Diskutim:*
- *Për kë bëhet fjalë në këtë tekst?*
- *Çfarë dini për Skënderbeun?*
- *Tregoni në klasë rrëfimet që i keni dëgjuar për Skënderbeun.*

100

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Parafjala

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon parafjalët në tekst;
- Dallon parafjalët nga gjymtyrët e tjera në fjali;
- Shkruan tekst duke përdorur parafjalët.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor, video nga youtube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Mësimdhënësi i drejton pyetjet:
Ku jeni tani?
Kë keni para jush?
Kë keni prapa?
Kush është ulur pranë jush?
Disa nga përgjigjet mund të jenë:
Ne jemi në shkollë.
Para meje është shoqja ime.
Pranë meje është miku im.
Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa nga fjalitë e nxënësve duke i nënvizuar parafjalët. Nxënësit i tregojnë njohuritë që kanë paraprakisht lidhur me parafjalën.



njësia 27

PARAFJALA

Nga "Histori e Skënderbeut", Marin Barleti

**LINDJA E SKËNDERBEUT**

Në Epir,...shquhej ***ndërmjet*** mbretërve të vegjël dhe princërve të tjerë, emri fisnik i Gjon Kastriotit ***për*** sundimin e tij ***në*** qytete të tjera, si ***në*** Krujë veçanërisht... Krerët e fisit të Kastriotëve kanë rrjedhur ***nga*** Mati ***prej*** një dere fisnike dhe kanë sunduar ***në*** Epir njëkohësisht ***me*** lavdi e fatbardhë- si... Gruaja e këtij e kishte emrin Vojsavë... (Ajo) lindi dhe rriti nëntë fëmijë. Më i vogli ***nga*** mosha ishte Gjergji, të cilit, më vonë, ***te*** barbarët,.. iu dha emri Skënderbej.

...Thonë, pra, se kur e ëma mbeti ***me*** barrë ***me*** të, pa ***në*** ëndërr se lindi një dragua aq të madh, saqë mbulonte Epirin, kokën e shtrinte ***ndërmjet*** kufijve të turqve, ndërsa bishtin e mbante ***në*** det, ***ndërmjet*** kufijve... të shtetit venedikas...

Gjoni e qetësoi të shoqen - do të lindte një burrë i përmendur ***në*** luftë dhe ***në*** vepra, i cili do të ishte armiku më i rreptë i turqve dhe, njëkohësisht, kapedani më fatbardh...

***Diskutim:***

- *Për kë bëhet fjalë në këtë tekst?*
- *Çfarë dini për Skënderbeun?*
- *Tregoni në klasë rrëfimet që i keni dëgjuar për Skënderbeun.*

100

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pyetja sjell pyetjen*

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë informacionin e dhënë në libër për parafjalën dhe përgatitin pyetje rreth parafjalës dhe tekstit të dhënë në libër. Disa nga pyetjet mund të jenë:
Çka është parafjala?
Para cilave fjalë qëndrojnë parafjalët?
Cili është roli i parafjalës?
Nxënësit punojnë në grupe dyshe në ndërtimin e pyetjeve.
Disa nxënës i lexojnë pyetjet dhe të tjerët përgjigjen.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Mësimdhënësi lëshon një video rreth Skënderbeut në linkun:
https://www.youtube.com/watch?v=pVelxlQUBwY.
Pas dëgjimit, nxënësit shkruajnë një tekst rreth Skënderbeut duke përdorur parafjalë.
Nxënësit i lexojnë tekstet dhe diskutojnë rreth Skënderbeut duke treguar njëkohësisht edhe parafjalët që kanë përdorur.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të parafjalëve nga pjesë të tjera dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**
(Nxënësit shkruajnë një histori rreth Skënderbeut duke i gjetur parafjalët brenda atij teksti)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 94

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Parafjala

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt parafjalët: me, për, në, nga, te, gjer, prej, ndaj, pranë, larg dhe i dallon nga ndajfoljet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I; I. 2; I. 3; III. 3, IV. 7
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2; 2: 1, 4; 3: 2


*Ndarja e parafjalëve sipas rasave me të cilat përdoren:*

- ***Rasa emërore:*** *nga, te(k).*

  *Vërtet shumë bujare **nga** ana jote, - ia ktheu Hansi i vogël dhe fytyra e qeshur i ndriti nga kënaqësia.*
  *Gëzofi i gjatë i zbriste deri **te** këmbët, ndërsa në kokë kishte një kapelë prej stofi ngjyrë argjendi*

- ***Rasa gjinore:*** *me anë, në drejtim, për punë, për shkak etj.*

  *Suksesi arrihet **me anë** të punës së vazhdueshme.*
  *Kishte gabuar **për shkak** të frikës.*

- ***Rasa kallëzore:*** *në, me, për, pa, mbi, nën, nëpër etj.*

  *Jetonte i vetëm **në** një kasolle të vogël dhe çdo ditë punonte **në** kopsht.*
  *Ky është mendimi im **për** shoqërinë dhe jam i sigurt që nuk gabohem.*

- ***Rasa rrjedhore:*** *prej, ndaj, përveç, sipas etj.*

  *Vetëm njëri **prej** tyre është shqiptar.*
  *Menjëherë morën masa **ndaj** tij.*

- ****Rasa dhanore përdoret pa parafjalë.***

***Pyetje:***

- *Cilat pjesë të ligjëratës përdoren pas parafjalës?*
- *A ndikon parafjala që emri ose përemri të vihet në ndonjë rasë të caktuar?*
- *Si ndahen parafjalët sipas ndërtimit?*
- *Cila rasë përdoret pa parafjalë?*
- *Cilat janë parafjalët e rasës emërore?*

Shih fletoren e punës

102

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rasat e parafjalëve

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon rasat e parafjalës;
- Klasifikon parafjalët sipas rasës;
- Shkruan fjali duke i përdorur parafjalët nëpër rasa.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazike

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë që kanë pasur për shkrimin e tekstit të një historie rreth Skënderbeut duke i përdorur parafjalët. Parafjalët e përdorura mësimdhënësi i shkruan në tabelë. Disa nga parafjalët që mund të përdoren, janë: prej tij, nga ai, me të, për të etj.

Mësimdhënësi e shpjegon përdorimin e fjalëve nëpër rasa.



***Ndarja e parafjalëve sipas rasave me të cilat përdoren:***

- ***Rasa emërore:*** *nga, te(k).*

  *Vërtet shumë bujare* ***nga*** *ana jote, - ia ktheu Hansi i vogël dhe fytyra e qeshur i ndriti nga kënaqësia.*
  *Gëzofi i gjatë i zbriste deri* ***te*** *këmbët, ndërsa në kokë kishte një kapelë prej stofi ngjyrë argjendi*

- ***Rasa gjinore:*** *me anë, në drejtim, për punë, për shkak etj.*

  *Suksesi arrihet* ***me anë*** *të punës së vazhdueshme.*
  *Kishte gabuar* ***për shkak*** *të frikës.*

- ***Rasa kallëzore:*** *në, me, për, pa, mbi, nën, nëpër etj.*

  *Jetonte i vetëm* ***në*** *një kasolle të vogël dhe çdo ditë punonte* ***në*** *kopsht.*
  *Ky është mendimi im* ***për*** *shoqërinë dhe jam i sigurt që nuk gabohem.*

- ***Rasa rrjedhore:*** *prej, ndaj, përveç, sipas etj.*

  *Vetëm njëri* ***prej*** *tyre është shqiptar.*
  *Menjëherë morën masa* ***ndaj*** *tij.*

- ****Rasa dhanore përdoret pa parafjalë.***

***Pyetje:***

- *Cilat pjesë të ligjëratës përdoren pas parafjalës?*
- *A ndikon parafjala që emri ose përemri të vihet në ndonjë rasë të caktuar?*
- *Si ndahen parafjalët sipas ndërtimit?*
- *Cila rasë përdoret pa parafjalë?*
- *Cilat janë parafjalët e rasës emërore?*

Shih fletoren e punës

102

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Punë në grupe*

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë në libër faqe 102. Pas leximit, ndahen në grupe dhe secili grup ka për detyrë të ndërtojë një tekst duke përdorur parafjalë nëpër rasa.

Pastaj secili grup e lexon tekstin dhe grupet e tjera i gjejnë rasat e parafjalëve. Grupi që jep më së shumti përgjigje të sakta e fiton garën.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit udhëzohen t'u përgjigjen pyetjeve në libër faqe 102.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të parafjalëve sipas rasave dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________

______________________

# Mësimi 95

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Parafjala

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt parafjalët: me, për, në, nga, te, gjer, prej, ndaj, pranë, larg dhe i dallon nga ndajfoljet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I; I. 2; I. 3; III. 3, IV. 7
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2; 2: 1, 4; 3: 2



DREJTSHKRIMI I PARAFJALËVE

**Nënvizoni parafjalët dhe analizoni mënyrën e shkrimit të tyre. Çka po vini re?**

*Kishte vendosur të shkonte buzë lumit. Në breg dukej një fshat i vogël. Rreth e rrotull tij kishte gjelbërim. Vajza u ngjit majë kodrinës. Jo shumë larg saj pa dy varka. Një grua e moshuar po afrohej në drejtim të vajzës. Pas pak u ndodhën përballë njëra-tjetrës. - Kush je ti? - e pyeti. Në krahasim me pamjen e rëndë, zëri i saj ishte tepër i butë. Megjithatë, vajza ndjeu të ngjethura në trup. - Je nisur të shkosh me këmbë në Benares? - tha me habi gruaja duke hedhur vështrimin rreth e qark vendit ku ndodhej. - Hajde, hip në varkën tonë. Do të vish bashkë me ne. Që atë çast ndërmjet tyre sikur u lidh një miqësi e heshtur.*

(R. Tagora, "Stuhi në Gang")

*Në këtë tekst janë përdorur disa parafjalë:* ***buzë, në, rreth e rrotull, majë, larg, në drejtim, përballë, në krahasim me, më, me, rreth e qark, bashkë me, ndërmjet****. Disa prej tyre shkruhen bashkë dhe disa të tjera ndaras. Cilat shkruhen bashkë dhe cilat ndaras?*

- *Shkruhen* ***bashkë*** *të gjitha parafjalët që sipas strukturës morfologjike janë fjalë:*

| | |
|---|---|
| *të thjeshta:* | *në, me, pa, për, më, nën, mbi, nga, te(k), ndër, prej, ndaj; midis, mes, buzë, ballë, bri, faqe, majë, rrëzë, rreth, anës; afër, larg, pranë, lart, sipër, poshtë, brenda, jashtë, gjatë, para, pas, prapa, rrotull, drejt, kundër, veç etj.* |
| *të përngjitura:* | *nëpër, sipas, simbas, përveç, ndërmjet, nëpërmjet, kundrejt, anembanë, anekënd, matanë, përballë, përbri, përmbi, përfundi, përjashta, përkrah, përkundër, përkundrejt, përmbrapa, përmes, përpara, përqark, përreth, përsipër, përtej, përgjatë etj.* |

- *Shkruhen* ***ndaras*** *të gjitha parafjalët që sipas strukturës morfologjike janë:*

| | |
|---|---|
| *shprehje parafjalore:* | *ballë për ballë, rreth e rrotull, rreth e qark, rreth e rreth, në mes, në vend, në drejtim, në bazë, në saje, për shkak, për arsye, për hir, për nder, për faj, me përjashtim, me anë, nga shkaku; bashkë me, tok me, në krahasim me, krahasuar me, në lidhje me, lidhur me, në kundërshtim me, në pajtim me, në përputhje me, në bashkëpunim me etj.* |

103

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Drejtshkrimi i parafjalëve

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan drejt parafjalët;
- Dallon parafjalët sipas ndërtimit;
- Shkruan fjali duke përdorur parafjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*DI*

Mësimdhënësi pyet nxënësit se çka dinë për parafjalën duke u bazuar në orën paraprake dhe e plotëson tabelën Di me përgjigjet e tyre.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Parafjalët janë pjesë të pandryshueshme. | | |



— *Parafjalët **në, për te(k), me, nga, prej** etj., zakonisht përsëriten në fjali sa herë që bashkërenditen dy a më shumë emra apo përemra. P.sh.*

- *Nxënësve të klasës sonë u pëlqen të udhëtojnë **në** pranverë, **në** verë, **në** vjeshtë e **në** dimër.*
- *Elemente të përbashkëta folklorike gjejmë **tek** ilirët, **te** trakasit e **te** grekët.*
- *Ne u përpoqëm **me** mish e **me** shpirt ta mundnim kundërshtarin në fushë.*
- *Skënderbeu **nga** shtati, **nga** dituria e **nga** fjala nuk kishte shok.*
- *Çdo ditë na vijnë vizitorë **prej** Prishtine, **prej** Prizreni e **prej** Gjakove.*

— *Këto parafjalë mund të mos përsëriten për arsye të caktuara kuptimore ose stilistike. P.sh.*

- ***Me** shokë e shoqe udhëtuam **në** fshatra e qytete të ndryshme të Kosovës.*

— *Parafjalët **te** dhe **tek** janë dy forma të së njëjtës parafjalë. Forma **te** përdoret para një emri a përemri që nis me bashkëtingëllore, kurse forma **tek** përdoret para një emri a përemri që nis me zanore. P.sh.*

- *Ndonëse u morëm vesh që të takoheshim **te** shkolla, Joni kishte ardhur në shtëpi **tek** unë.*
- *Ai erdhi te ti dhe jo **tek** unë.*

*Në Kosovë përdoren disa ndërtime që ngjajnë si grupe parafjalore të tipit **në/ me + emër në rasën emërore,** si: **në deti, me guri, me kali** etj. Këto përdorime janë mbeturinë e rasës vendore: në detit, në kalit, me gurit, sigurisht pas rënies së mbaresës -t. Në gjendjen e sotme këto ndërtime janë përdorime jo të rregullta sintaksore, sepse parafjalët **në** dhe **me** përdoren vetëm para emrave të rasës kallëzore. Prandaj në vend të tyre kemi përdorimet: në det, me gur, me kalë.*

***Pra,***

| Jo | Por |
|---|---|
| *Shkova në deti. | Shkova në det. |
| *Gjuajta me guri. | Gjuajta me gur. |
| *Hipa në kali. | Hipa në kalë. |
| *Udhëtova me kali. | Udhëtova me kalë. |

104

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit e lexojnë tekstin "Stuhi në Gang". Gjejnë parafjalët e përdorura në tekst. Parafjalët shkruhen në tabelë dhe mësimdhënësi jep sqarimet rreth ndërtimit morfologjik të tyre.
Pastaj, nxënësit e plotësojnë rubrikën Dua ta di me pyetjet që kanë rreth njësisë.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Parafjalët janë pjesë të pandryshueshme. | Cila nga ndërtimet morfologjike përdoret më së shpeshti? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në libër, pastaj e plotësojnë rubrikën Mësova dhe krijojnë fjali duke i përdorur parafjalët sipas ndërtimit.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Parafjalët janë pjesë të pandryshueshme. | Cila nga ndërtimet morfologjike përdoret më së shpeshti? | Parafjalët e parme i hasim më së shumti në përdorim. |

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të parafjalëve sipas ndërtimit dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**
(Detyrë, faqe 106)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 96

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Parafjala

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt parafjalët: me, për, në, nga, te, gjer, prej, ndaj, pranë, larg dhe i dallon nga ndajfoljet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2; II. 3, II. 4
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2; 2: 1, 4



njësia 25
PARAFJALËT

◇ *Shkruani në tabelë parafjalët e tekstit të mëposhtëm, sipas strukturës së tyre morfologjike:*

*Kishte vendosur të shkonte buzë lumit. Në breg dukej një fshat i vogël. Rreth e rrotull tij kishte gjelbërim. Vajza u ngjit majë kodrinës. Jo shumë larg saj, pa dy varka. Një grua e moshuar po afrohej në drejtim të vajzës. Pas pak u ndodhën përballë njëra-tjetrës.*
*- Kush je ti? - e pyeti. Në krahasim me pamjen e rëndë, zëri i saj ishte tepër i butë. Megjithatë, vajza ndjeu të ngjethura në trup. - Je nisur të shkosh me këmbë në Benares? - tha me habi gruaja duke hedhur vështrimin rreth e qark vendit ku ndodhej. - Hajde, hip në varkën tonë. Do të vish bashkë me ne. Që atë çast, ndërmjet tyre sikur u lidh një miqësi e heshtur.*

| Parafjalë të thjeshta | Parafjalë të përngjitura | Shprehje parafjalore |
|---|---|---|
| | | |

◇ *Vini në dukje para cilës pjesë të ligjëratës qëndron parafjala. Thoni në ç'rasë është përdorur.*

*Pastaj u kthye nga perëndimi dhe u nis për udhë, por as ajo s'e dinte se për ku u nis. Pemët anës rrugës, si udhëtarë në rresht për një, e frikësonin. Nga larg dëgjohej buçima e lumit. Zallishtja e bardhë ndrinte turbull në errësirë, sikur dikush kishte fshirë një pjesë të tablosë së bukur të pikturuar nga natyra. Nata pa hënë, me atë qiell të errët mbushur me yje, regëtinte sipër bregut të lumit. Nga fushat mbjellë me elb vinte angullima e zgjatur e çakejve. Atë mbasdite erdhi një lajmërim për mua. Tre prej tyre u afruan e u takuan me të gjithë. Pastaj ikën larg nga sheshi. Në sallë hynin nga katër e nga katër.*

57

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përsëritje për parafjalët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan drejt parafjalët;
- Dallon parafjalët sipas rasave;
- Përshtat parafjalët më fjalët që përcaktojnë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletore pune

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë individuale*

Nxënësit plotësojnë fletore pune faqe 57-58.



- *Krijoni fjali me fjalët:* ***afër, përballë, rreth e rrotull, anembanë, matanë, sipër, ballë për ballë, përmes, nga, përtej, larg,*** *duke i përdorur një herë si ndajfolje e një herë si parafjalë.*
- *Krijoni fjali me fjalët:* ***midis, mes, buzë, rrëzë, rreth, majë, anës,*** *duke i përdorur një herë si emra e një herë si parafjalë.*
- *Formoni parafjalë të përngjitura dhe shprehje parafjalore me fjalët e dhëna:* ***për, ndër, pas, anë, ballë, rreth, në, drejt, me.*** *Tri prej tyre përdorni në fjali.*
- *Shkruani në tabelë parafjalët e mëposhtme sipas rasave që u takojnë.* ***me, për, në, më, nga, te, prej, mes, buzë, rreth, anës, ndaj, afër, brenda, drejt, jashtë, pranë, nëpër, sipas, përveç, ndërmjet, kundrejt, anembanë, matanë, përballë, përkrah, përpara, përreth, përtej, ballë për ballë, rreth e rrotull, rreth e qark, në drejtim, në mes, në vend, në krahasim me, lidhur me, në pajtim me, tok me, për shkak.***

| *Parafjalë të rasës emërore* | *Parafjalë të rasës gjinore* | *Parafjalë të rasës kallëzore* | *Parafjalë të rasës rrjedhore* |
|---|---|---|---|
| | | | |

58

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Diskutim i përbashkët*

Nxënësit së bashku me mësimdhënësin i diskutojnë detyrat e plotësuara në fletore pune. Korrigjohen gabimet që mund të kenë ndodhur gjatë plotësimit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Veprimtari zbatuese*

Nxënësit kanë për detyrë të shkruajnë fjali ku fjalët e njëjta i përdorin edhe si ndajfolje, edhe si parafjalë.
Një shembull mund të jetë:
Ajo ishte afër meje - parafjalë
Ishte afër – ndajfolje
Njëri nxënës i lexon fjalitë, ndërsa nxënësit e tjerë duhet ta gjejnë funksionin e fjalës, a është ndajfolje apo parafjalë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm duke e marrë për bazë saktësinë e përgjigjeve.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 97

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Tekste letrare dhe joletrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.


njësia 14

ZHANRET DHE KATEGORITË LETRARE: **POEZI, PROZË, TEKST DRAMATIK**

Shkrimtarët, kur shkruajnë, zgjedhin një kategori të caktuar të tekstit për të shprehur mendimet e veta. Këto kategori i quajmë zhanre. Zhanret dallohen mes vete për stile të ndryshme, forma të ndryshme dhe përmbajtje të ndryshme.

***Disa nga kategoritë:***
Vepër letrare
Prozë letrare
Tregimi - novela - romani - tregimet popullore

***Poezi***
Poezia lirike - poezia epike - poezia epiko-lirike
Soneti - poema - vjersha me vargje të lira etj.

***Teksti dramatik***
Komedia - tragjedia - drama

***Vepra joletrare***
Biografia - autobiografia - eseja - artikulli i gazetës - fjalimet - tekstet shkencore - tekstet shkollore

***Proza letrare:***
Tregimi është më i shkurtër dhe e trajton një ide më të thjeshtë.
Romani është më i gjatë dhe personazhet e ngjarja ofrohen në mënyrë më të gjerë e më të detajuar.
Novela është mes tregimit dhe romanit

50

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zhanret dhe kategoritë letrare: Poezi, prozë, tekst dramatik (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Argumenton mendimin për tekstin e pëlqyer;
- Shpjegon përbërësit e gjuhës;
- Identifikon tekstin sipas zhanrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetja e sjell pyetjen*

Drejtohen pyetjet:
- Përse shërben gjuha? (për komunikim)
- Cila është njësia më e vogël e gjuhës? (shkronja)
- Pas shkronjës?
- Pas rrokjes?
- Pas fjalës?
- Po si ndahen tekstet?


njësia 14

ZHANRET DHE KATEGORITË LETRARE: **POEZI, PROZË, TEKST DRAMATIK**

Shkrimtarët, kur shkruajnë, zgjedhin një kategori të caktuar të tekstit për të shprehur mendimet e veta. Këto kategori i quajmë zhanre. Zhanret dallohen mes vete për stile të ndryshme, forma të ndryshme dhe përmbajtje të ndryshme.

***Disa nga kategoritë:***
Vepër letrare
Prozë letrare
Tregimi - novela - romani - tregimet popullore

***Poezi***
Poezia lirike - poezia epike - poezia epiko-lirike
Soneti - poema - vjersha me vargje të lira etj.

***Teksti dramatik***
Komedia - tragjedia - drama

***Vepra joletrare***
Biografia - autobiografia - eseja - artikulli i gazetës - fjalimet - tekstet shkencore - tekstet shkollore

***Proza letrare:***
Tregimi është më i shkurtër dhe e trajton një ide më të thjeshtë.
Romani është më i gjatë dhe personazhet e ngjarja ofrohen në mënyrë më të gjerë e më të detajuar.
Novela është mes tregimit dhe romanit

50

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Organizues grafik i analogjisë*

Çdo gjë që lexojmë e marrim përmes teksteve.
Mësuesi ua paraqet nxënësve grafikun e mëposhtëm për ta shpjeguar tekstin dhe llojet e tij.

| Teksti letrar | | |
|---|---|---|
| Tipi i tekstit-zhanri | karakteristika | lloji |
| Tekst rrefimtar letrar | Tranmeton ngjarje ,ka personazhe . | Fabul,përrallë,legjendë,tregim,novelë,roman. |
| Tekst poetik | Përcjell ide, emocione.Shkruhet në vargje,strofa | Poezi,poemë |
| Tekst dramatik | Historia shkruhet në formë dialogu. | Tragjedi,komedi,dramë |

Nxënësit i lexojnë shpjegimet në tekst se ç'është tregimi, novela e romani dhe diskutohet rreth tyre.
Kujtojnë tekstet e mësuara për të klasifikuar në janë poezi, prozë apo dramë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditari dypjesësh*

Nxënësit kujtojnë një tekst letrar që e pëlqejnë duke e identifikuar nëse është poetik, dramatik, rrëfimtar dhe argumentojnë pse e pëlqejnë.

| Teksti letrar | Mendimi im |
|---|---|
| | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e tekstit sipas zhanrit dhe argumentimin e mendimeve për pjesën e pëlqyer.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 98

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.



Nga Tajar Hatipi

**PESHKAQENI**

Plazhi shtrihej sa nuk ta zinte syri.
Mbi sipërfaqen e detit të qetë hidhej një avull i dendur, kurse krerët e njerëzve në të dukeshin si shalqinj të rritur në ndonjë arë të paanshme. Në një skaj po rrinin dy djem e këmbët i kishin futur në ujë.
Këqyrnin detin dhe kuvendonin.
Deri ku mund të shkosh me not?
Deriiii... atje tek ajo barka.
Barka ishte nja njëqind metra larg bregut.
Unë edhe një herë më larg - ia priti tjetri.
Eh, unë do të kisha mundur edhe dhjetë herë më shumë, por nuk guxoj. Pse?
Prej peshkaqenit.
Peshkaqenit? Iiii, sa frikacake je ti. Unë, edhe sikur të më dalë, notoj shpejt fap e fap-fap-fap e në rërë.
Hajt njëherë ta shohim.
Ai u çua në këmbë dhe e këqyri detin ashtu të kaltër dhe që dukej si ta thërriste me dorë notarin e vogël. Djali u përmblodh dhe u zhyt në ujë. Humbi për një grimë dhe mandej doli prapë përmbi. Shoku në breg e shihte me vëmendje. Kur doli në sipërfaqe, u shtrua dhe çau përpara. Duke notuar u largua mjaft. Lëshoi sytë në hapësirën e detit, por kudo kaltër e kaltër. I uli prapë dhe i mbushur frymë u shty edhe më tej. Dikur i çoi sytë përsëri, kur njëherë iu bë terr, mandej prapë qartë. Një hije si shpatë e zezë po çante ujin si vetëtimë e po vinte drejt nga ai... U dëgjua një britmë e tmerrshme:
Ndihmë, ndihmë...
Shoku që rrinte në breg u çua në këmbë dhe ngriti veshët. Njerëzit u ndalën të mbajnë vesh nga po vinte bërtima. Duke shikuar, vunë re se pranë djalit që bërtiti u çua edhe koka e një djali tjetër dhe të dy nisën të notonin këndej.
Çka ndodhi?
Mu kur djaloshi ra me not, prej barkës atje larg kishte kërcyer në ujë një djalosh tjetër. Në kokë kishte vënë një kokore gome të zezë me një bisht që i ngjante atij të peshkaqenit. Shoku ynë, i hutuar në ndërmarrjen e guximshme të tij, nuk e kishte dalluar fare dhe i ishte dukur si peshkaqen. Kur arritën në breg, njerëzit u grumbulluan për ta pyetur se ç'pati që bërtiti aq, por njëri tha:
Lëreni të qetë detarin trim. U turpërua pak, por nejse!

51

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Peshkaqeni" Tajar Hatipi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan disa tituj përrallash dhe tregimesh;
- Përgjigjet në pyetjet rreth tekstit;
- Komenton pjesën më të pëlqyer të tekstit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Mendo – shkruaj*

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë disa tituj tregimesh dhe përrallash. Lexohen disa prej tyre.


**Detyrë dhe pyetje:**

- *Teksti i mësipërm është:*

  *a) Prozë*
  *b) Poezi*

  *a) Tekst letrar*
  *b) Tekst joletrar*

  *a) Roman*
  *b) Novelë*
  *c) Tregim*

- *Përmblidhe në më pak se 50 fjalë tregimin "Peshkaqeni".*

Nga "Shpella e piratëve" e Petro Markos

**PESHKAQENI**

U hodha në ujë e mora peshq sa munda. Kur ja, arriti peshkaqeni. Ai dreq e nuhat shpejt gjakun e peshkut të vrarë, sado larg që të jetë... me të arritur zuri ti gëlltiste levrekët si llokume... Kur isha në fund të detit, zura një levrek të madh. Unë i zë nga koka. Po, fap, erdhi peshkaqeni dhe e gëlltiti nga bishti. Unë nuk e lëshova. Siç e kisha zënë peshkun nga koka, e mbërtheva më mirë me të dyja duart dhe i shtrëngova këmbët në shkëmb. Peshkaqeni hiq dhe unë hiq... Në fund levreku u nda në dysh dhe mua më mbeti në duar koka e tij. Nxora thikën dhe ia futa peshkaqenit nja dy herë mu prapa veshit. Siç duket i dhembi shumë, andaj u largua.

***Bashkëbisedojmë:***

- *Kjo është një pjesë nga romani "Shpella e piratëve". Në këtë pjesë kemi shtjellimin e një ideje. Romani brenda vetes i shtjellon ngjarjet në mënyrë më të gjerë, duke përfshirë më shumë episode. Ky është një episod i përballjes së një peshkatari me peshkaqenin.*

52

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Paraqitet titulli i tregimit para nxënësve. Lexohet i ndarë në paragrafë.

Pas leximit të çdo paragrafi, u drejtohen pyetjet:
- Për çfarë bëhet fjalë në tekst?
- Cilat janë personazhet?
- Cilin karakter përfaqësojnë dy djemtë?
- Çfarë do të ndodhë?

Pyetjet e pjesës së dytë:
- A shkoi larg djali?
- Çfarë i ndodhi?
- A ishte trim ky djalë?
- Nëse po, pse?
- Nëse jo, pse?
- Cilin mësim jep ky tregim?

Më pas nxënësit përgjigjen në detyrën e dhënë në tekst.
Detyrë dhe pyetje
Teksti i mësipërm është:
a. poezi
b. prozë
Vazhdohet me pyetjet e tjera.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Pesëvargësh*

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë një pesëvargësh për djalin që notoi. Lexohen nga grupet dhe krahasohen.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve dhe për mënyrën e përshkrimit të personazhit përmes pesëvargëshit.

**Detyrë:**
(Përmbledhin tregimin me 50 fjalë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 99

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.


Detyrë

**Në munç**

*Përkthyer nga Fan S. Noli (Namik Namazi)*

*Në munç të mbash në kokë terezinë*
*Kur shokët çmendër dhe fajtor të nxijnë;*
*Në munç të kesh besim, kur të dyshon*
*Kushdo, dhe s'ka njeri që të beson;*
*Në munç të preç, dhe pritjen s'e kursen,*
*Në të gënjefshin, ti nuk i gënjen,*
*Në të urrefshin, ti s'i çan me brirë,*
*Dhe s'hiqesh as m'i mënçim as m'i mirë.*
*Në munç të çndërrosh e të mejtosh,*
*Dhe nga këto në mos u robërofsh;*
*Në munç të preç Triumfin dhe Hatanë,*
*Dhe t'i shkelmosh të dysi kallpazanë;*
*Në munç të mbahesh, kur një dreq ta dreth*
*Të drejtën dhe në lak syleshin heth,*

*Kur sheh kalan' e jetës të rëzuar*
*Dhe prap e ngre me veglën e çkallmuar;*
*Në munç të vësh m'i grumbull çdo thesar,*
*Edhe t'i loç të gjitha me një zar,*
*T'i humpç edhe të nisësh përsëri*
*Pa thën' asgjë për këtë batërdi;*
*Në munç të kesh një zemër, trup e kokë*
*Që të shërbejnë sa të bëhen trokë,*
*Dhe të vazhdosh i djegur shkrump në furrë,*
*Dhe të thërret vullneti: "Mbahu, or burrë!";*
*Në munç të zbreç në turm' e të mbash nderin,*
***Të hash me mbretin, të pish me neferin;***
*Në mos të ngaftë dot as mik as hasmë,*
*N'i daç të gjithë, po asnjë për dasmë;*
*Në munç për çdo minutë të përpjetë*
*Të rënç tamam sekunda gjashtëdhjetë;*
*Zaptove dhenë me çdo mall dhe hir,*
*Dhe ca më mirë, qënke trim, or bir!*

*Teksti i mësipërm është:*

*a. Prozë*
*b. Poezi*

*c. Tekst letrar*
*d. Tekst joletrar*

*a. Në gjuhën standarde*
*b. Në dialektin toskë*
*c. Në dialektin gegë*

31

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Në munç" Rejard Kipling

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon njohuritë rreth poezisë;
- Përmbledh me një fjali disa vargje;
- Krahason këshillat e prindërve me ato të autorit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit rikujtojnë se çfarë dinë për poezinë.
Idetë e tyre paraqiten në tabelë dhe plotësohen nga mësuesi.




- *Shëno disa shembuj që të tregojnë se në cilin dialekt apo gjuhë standarde është ky tekst.*

***Detyrë***

- *Shiko fjalët e panjohura të poezisë "Në munç". Kërkoji në fjalor dhe shiko format standarde që gjenden në fjalor. P.sh. Në munç = Në mundsh.*
- *Kërko në fjalor nga një fjalë të re që fillon me shkronjën: **f, g, gj,** dhe **h.***

***Detyrë***

- *Shëno lektyrat që i keni pasur deri tash dhe trego se çfarë zhanri janë ato.*

***Detyrë***

- *Shkruani poezi në dialektin gegë. Pastaj, provoni t'i ktheni në shqipen standarde dhe vëreni ndryshimet. Në cilin variant ju duket se tingëllojnë më mirë (shprehni mendimet tuaja). Po ashtu, poezitë mund t'i interpretoni në klasë. Mund ta ndërlidhni edhe me një orë muzikore, ku t'i shoqëroni ato me instrumente të ndryshme.*

32

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Vjersha lexohet nga mësuesja.
Leximi me zërin, gjestet, shpejtësinë dhe mimikën krijon një gjendje emocionale te nxënësit dhe ndihmon në kuptim të përmbajtjes.
Pas kësaj, nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të përmbledhin me një fjali vargje nga poezia.
E gjithë poezia ndahet nga mesuesi dhe përmblidhet nga nxënësit.
Ja një shembull.
Për katër vargjet e para, poeti do të thotë: "Mundohu të jesh vetvetja!"
Jepen sqarime për fjalët e panjohura dhe për ndonjë vështirësi tjetër.
Pasi përfundojnë, nxënësit i lexojnë fjalitë, të cilat shënohen në tabelë.
Nga përmbledhja kuptohen idetë dhe këshillat që autori ia drejton birit të tij edhe të gjithë lexuesve.
Shpjegohen edhe elementet e poezisë: rima, ritmi, vargu, figurat letrare.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë disa këshilla që prindërit u japin dhe i krahasojnë me ato të autorit.
Disa nxënës i lexojnë shkrimet e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përmbledhjes, për identifikimin e rimës, për shkrimin dhe krahasimin e këshillave.

**Detyrë:**
(Shkruan katër këshillat më të mira për të)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 100

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.



**Tekst në dramë**
Nga "Trimi i mirë me shokë shumë" i Sylejman Pitarkës.

***MOISIU:*** Kisha me thanë se gjithkush duhet të flasë për vete.
***GJERGJI:*** Por, jo vetëm për vete, Moisi.
***MOISIU:*** Mandej, princi Tanush si gjithherë, në çdo kaçubë sheh një armik. ***TANUSHI:*** Po, në qoftë se në çdo kaçubë është fshehur dikush, ai nuk është mik.
***MOISIU:*** E ku do të dalësh me këto fjalë, o princ?
***TANUSHI:*** Dua të them se kush nuk është krejtësisht me ne, mbërrin të jetë kundër nesh.
***GJERGJI:*** Në paqe, burra! Nuk është nevoja... E duam njëri-tjetrin si dy sytë e ballit. Është fjala për ta forcuar gjithë Shqipërinë. Duhet mirëkuptim ndërmjet nesh! Asgjë e askënd me dhunë!
***MOISIU:*** Çka nuk është zakon, nuk bëhet ligj, o Gjergj. Pra, mendoj se çdo princ përgjigjet për principatën e trojet e veta, si për të ardhurat, bujqit e për ushtarët e vet. (Hyn një rrogëtar).
***RROGËTARI:*** Të dërguarit e Sulltan Mehmetit të Dytë të Turqisë kërkojnë për ta takuar kryeprijësin e shqiptarëve, Gjergj Kastriotin.

***Bashkëbisedojmë:***

– *Ky është tekst dramatik. Perzonazhet janë Gjergj Kastrioti, Moisi Golemi, Tanush Topia dhe një rrogëtar. Mund të shihni se teksti është paraqitur përmes fjalëve të personazheve dhe pritet që aktorët t'i thonë ato fjalë në skenë. Kur e lexojmë tekstin e këtillë, ne imagjinojmë si do të dukej kjo shfaqje.*

***Detyrë:***

*Përmendni edhe vepra të tjera të autorëve shqiptarë për Skënderbeun dhe diskutoni për to. Pastaj, përzgjidhni një pjesë drame dhe përgatiteni ta luani në role.*

Shih fletoren e punës

53

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** "Trimi i mirë me shokë shumë" Sylejman Pitarka

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon çfarë di për tekstin dramatik;
- Identifikon tekstin dramatik;
- Vazhdon shkrimin e dramës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekst drame.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Histori, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit rikujtojnë se çfarë dinë për dramën.
Idetë e tyre paraqiten në tabelë dhe plotësohen nga mësuesi.




Për mësimdhënësin/en


## Tekst në dramë
Nga "Trimi i mirë me shokë shumë" i Sylejman Pitarkës.

***MOISIU:*** Kisha me thanë se gjithkush duhet të flasë për vete.
***GJERGJI:*** Por, jo vetëm për vete, Moisi.
***MOISIU:*** Mandej, princi Tanush si gjithherë, në çdo kaçubë sheh një armik. ***TANUSHI:*** Po, në qoftë se në çdo kaçubë është fshehur dikush, ai nuk është mik.
***MOISIU:*** E ku do të dalësh me këto fjalë, o princ?
***TANUSHI:*** Dua të them se kush nuk është krejtësisht me ne, mbërrin të jetë kundër nesh.
***GJERGJI:*** Në paqe, burra! Nuk është nevoja... E duam njëri-tjetrin si dy sytë e ballit. Është fjala për ta forcuar gjithë Shqipërinë. Duhet mirëkuptim ndërmjet nesh! Asgjë e askënd me dhunë!
***MOISIU:*** Çka nuk është zakon, nuk bëhet ligj, o Gjergj. Pra, mendoj se çdo princ përgjigjet për principatën e trojet e veta, si për të ardhurat, bujqit e për ushtarët e vet. (Hyn një rrogëtar).
***RROGËTARI:*** Të dërguarit e Sulltan Mehmetit të Dytë të Turqisë kërkojnë për ta takuar kryeprijësin e shqiptarëve, Gjergj Kastriotin.

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ky është tekst dramatik. Perzonazhet janë Gjergj Kastrioti, Moisi Golemi, Tanush Topia dhe një rrogëtar. Mund të shihni se teksti është paraqitur përmes fjalëve të personazheve dhe pritet që aktorët t'i thonë ato fjalë në skenë. Kur e lexojmë tekstin e këtillë, ne imagjinojmë si do të dukej kjo shfaqje.*

***Detyrë:***

*Përmendni edhe vepra të tjera të autorëve shqiptarë për Skënderbeun dhe diskutoni për to. Pastaj, përzgjidhni një pjesë drame dhe përgatiteni ta luani në role.*

Shih fletoren e punës

53

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Në secilin dyshe jepet një pjesë e dramës (vazhdim i pjesës në libër).
Teksti lexohet me ndalesa, pas çdo ndalese shtrohen pyetjet:
- Ku dallon ky tekst nga tekst "Peshkaqeni"?
- Cilat janë personazhet?
- Si ndërtohet teksti?
- Skënderbeu është personazh real apo i imagjinuar?
- Cilës periudhë i takon kjo ngjarje?
- Njëjtë vazhdohet edhe me pjesën tjetër.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Udhëzohen nxënësit ta vazhdojnë tekstin e dramës "Trimi i mirë me shokë shumë".
Nxënësit e kuptojnë se teksti shkruhet në role.
Disa nxënës i lexojnë shkrimet e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e tekstit dramatik, saktësinë e përgjigjeve, për krijimtarinë e tekstit dramatik.

**Detyrë:**
(Pesëvargësh për Skënderbeun)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 101

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.


njësia 14
ZHANRET DHE KATEGORITË LETRARE

◇ *Shëno të gjitha romanet që ke lexuar:*

◇ *Shëno tregimet që të pëlqejnë më shumë:*

◇ *Shëno tekstet dramatike që i ke lexuar ose parë:*

30

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zhanret dhe kategoritë letrare (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegojnë zhanret letrare;
- Krahason zhanret dhe kategoritë letrare;
- Përcaktojnë zhanrin e veprave të lexuara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Organizuesi grafik*

Nxënësit e plotësojnë hartën e konceptit me temën "Teksti letrar".




njësia 14

ZHANRET DHE KATEGORITË LETRARE

◇ *Shëno të gjitha romanet që ke lexuar:*

◇ *Shëno tregimet që të pëlqejnë më shumë:*

◇ *Shëno tekstet dramatike që i ke lexuar ose parë:*

30

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analiza e tipareve semantike*

Shpërndahen organizuesit grafikë te secili grup dhe udhëzohen t'i analizojnë dhe plotësojnë elementet e teksteve letrare, si: tregimi, romani, novela, përralla, poezia, drama.
Pas plotësimit i lexojnë para klasës.

| Lloji I zhanrit | personazhe | ngjarje | strofë | varg | ide | dialog | emocion |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| tregimi | + | + | - | - | + | + | + |
| romani | + | + | - | - | + | + | + |
| legjenda | | | | | | | |
| komedia | | | | | | | |
| poezia | | | | | | | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Nxënësit shkruajnë titujt e lektyrave që kanë pasur deri tani dhe tregojnë se cilit zhanër i takojnë.
Lexohen shkrimet para klasës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e zhanreve letrare, për identifikimin e tekstit sipas zhanrit.

**Detyrë:**
(Shkruan për zhanrin më të pëlqyer)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 102

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Lidhëzat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon lidhëzat bashkërenditëse.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 1; III. 1, 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 5; 2. 5; 3. 2, 6.


Pyetje:
- Cili është subjekti i këtij tregimi?
- Cila është tema?
- Çfarë përmban hyrja e këtij tregimi?
- Cili është rrëfimi?
- Cili është përfundimi i këtij tregimi?
- Kë i quan tullumba autori në këtë tregim?
- Cila figurë është fjala tullumbë në këtë tregim?

Bashkëbisedojmë:
- Në cilin dialekt është shkruar teksti i mësipërm?
- Lexoje me kujdes tekstin dhe shiko pjesët që tregojnë se në cilin dialekt është shkruar.

Diskutim:
- Disa fjalë të këtij tregimi janë të shënuara ndryshe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe.
Shikoji në fjalor si janë shënuar fjalët: tollumb, puça, shof, picrrok, hangër, ftyrë, kureshta.

Fjalë të reja: apostull, dëlirë, lustër.

Shih fletoren e punës

107

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lidhëzat (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan njohuritë për lidhëzat;
- Shkruan llojet e lidhëzave në tekste dhe fjali;
- Identifikon ato në tekste të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Matematikë, Artet.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Nxënësve u jepet për disa minuta ta shikojnë fotografinë në libër.
Pasi shikohet fotografia, shtrohet pyetja:
Çfarë dini për lidhëzat?
Si lidhen fjalët në fjali?
Një përgjigje e mundshme: Lidhëzat janë pjesë të pandryshueshme që lidhin dy e më shumë fjalë ose fjali.
Fjalët në fjali lidhen përmes lidhëzave.
U shpjegohet definicioni i lidhëzave dhe ndarja e tyre: bashkërenditëse dhe nënrenditëse.
Lidhëza bashkërenditëse, janë: as, dhe, edhe, e, a, apo, o, kurse, mirëpo etj.
Lidhëza nënrenditëse, janë: se, që, në, nëse, ku, nga, sapo, derisa, sikurse etj.



## Lidhëza

UNË DHE TI

Lidhëza është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, e cila i lidh pjesët e një fjalie ose dy fjali mes vete.

***Llojet e lidhëzave janë:***

— ***Lidhëzat bashkërenditëse*** *shërbejnë për të lidhur pjesë të njëjta të fjalisë ose fjali të një lloji.*
*Jam tepër mirënjohës që erdhët të më nderoni* ***dhe*** *jam shumë i gëzuar që ndodheni përsëri këtu.*

— ***Lidhëzat nënrenditëse*** *shërbejnë për ta lidhur fjalinë kryesore me pjesën e varur.*

| ***(fjalia kryesore)*** | ***(pjesa e varur)*** |
|---|---|
| *Jam tepër mirënjohës* | ***që*** *erdhët të më nderoni.* |
| *Jam shumë i gëzuar* | ***që*** *ndodheni përsëri këtu.* |

— ***Lidhëza bashkërenditëse janë:*** *as, dhe, edhe, e, a, apo, o, kurse, mirëpo, por, veçse, andaj, ndaj, prandaj etj.*

108

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-Analizo-Diskuto*

Nxënësit udhëzohen t'i lexojnë informacionet nga teksti lidhur me lidhëzat, pastaj të vazhdojnë në heshtje me pjesën e tekstit "Luli i vocërr".
Pas leximit të pjesës së tekstit nxënësit duhet t'i nënvizojnë lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

*Jam tepër mirënjohës që erdhët të më nderoni dhe jam shumë i gëzuar që ndodheni përsëri këtu.*

*Jam shumë i gëzuar që ndodheni përsëri këtu.*

Sipas ndërtimit lidhëzat ndahen në:
- Lidhëza të thjeshta: apo, as, dhe, edhe, por etj.
- Lidhëza të përbëra: kurse, meqë, meqenëse, derisa etj.
- Shprehje lidhëzore: për arsye se, me kusht që, ngado që, në vend që etj.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditari dypjesësh*

Nxënësit udhëzohen që fletoren ta ndajnë me një vizë në mes dhe t'i ndajnë lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse në tekstin e lexuar më herët.

| Lidhëzat bashkërenditëse | Lidhëzat nënrenditëse |
|---|---|
| | |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të lidhëzave dhe përdorimit të tyre.

**Detyrë:**
(Shkruani nga 5 fjali dhe përdor lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 103

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Lidhëzat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon lidhëzat bashkërenditëse.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 1; III. 1, 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 5; 2. 5; 3. 2, 6.



— ***Lidhëza nënrenditëse janë:*** *se, që, në, nëse, ku, nga, kur, sapo, derisa, pasi, sepse, meqenëse, ngaqë, meqë, ngase, me qëllim që, se, si, sikurse, saqë, megjithëse, ndonëse etj.*

***Sipas ndërtimit, lidhëzat ndahen në:***

— ***Lidhëza të thjeshta:*** *apo, as, dhe, e, edhe, ose, por etj.*
— ***Lidhëza të përbëra:*** *kurse, meqë, meqenëse, derisa etj.*
— ***Shprehje lidhëzore:*** *për arsye se, me kusht që, ngado që, në vend që etj.*

***Pyetje:***
— *Për çka shërbejnë lidhëzat?*
— *Cilat janë llojet e lidhëzave?*
— *Çka lidhin lidhëzat bashkërenditëse?*
— *Çka lidhin lidhëzat nënrenditëse?*
— *Sipas ndërtimit, si ndahen lidhëzat?*

DREJTSHKRIMI I LIDHËZAVE

Nënvizoni lidhëzat dhe analizoni mënyrën e shkrimit të tyre.
Çka po vini re?

- *Në këngë e sipër Adilit iu duk sikur yjet e largët u afruan, siç afrohen në verë përmbi majat e maleve të Kosovës. Por, as yjet s'kishin luajtur nga vendi, as gjethet që po kalbëzoheshin. Përsëri, u dëgjua çiftelia dhe Adili që këndonte. Ishte kënga e vet kjo, andaj druhej të ngrinte zërin lart. Kur kërciti një ashkë nën këmbët e Vitës, djaloshi ngriti kokën. Megjithëse ishte e treta herë që takonte këtë vajzë, ai i vuri re bukurinë, që buronte nga të gjitha tiparet e grizarakes e mblidhej me një hijeshi të përgjithshme, ashtu siç buron ujët nga të katër anët e dheut.*
- *Edhe pse e ftohta të përpinte, kuajt lëviznin nëpër rrugën e ngrirë. Sa herë që fshikullonte kamxhikun, hapi i tyre bëhej më i shpejtë.*
- *Karroca u anua, u lëkund, derisa qëndroi, mirëpo njeri s'po dilte prej saj.*
- *Ky seminar bëhet me qëllim që të forcohet puna drejtuese në shkollë.*
- *Ngado që kalonte, shihte grumbuj njerëzish që shëtisnin, ndonëse tetori kishte sjellë, veç të ftohtit, edhe një tyl të hollë mjegulle.*

*Pjesë nga:* ***"Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës.***

*Në këtë tekst janë përdorur disa lidhëza:* ***sikur, siç, par, as...as, dhe, andaj, kur, megjithëse, që, ashtu siç, edhe pse, sa herë që, derisa, mirëpo, ngado që, ndonëse, me qëllim që.*** *Disa prej tyre shkruhen bashkë dhe disa të tjera ndaras.*
*Cilat shkruhen bashkë dhe cilat ndaras?*

109

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lidhëzat (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan njohuritë për lidhëzat;
- Shkruan lidhëzat në tekste të ndryshme;
- Nënvizon lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Matematikë, Artet.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit i rikujtojnë njohuritë për lidhëzat dhe llojet e tyre.
Pyeten: "Për çfarë na shërbejnë lidhëzat?"
Një përgjigje e mundshme:
Lidhëzat na shërbejnë për të lidhur dy fjalë ose dy fjali mes vete.
Vazhdohet me pjesën e tekstit.



*Shkruhen bashkë të gjitha lidhëzat që sipas strukturës morfologjike janë fjalë:*

| ***të thjeshta:*** | ***të përngjitura:*** |
|---|---|
| *dhe, e, edhe, o, ose, a, apo, por, po, pa, që, sa, se, si, ku, kur, tek, nga, në, veç, vetëm, daç, qoftë etj.* | *derisa, domethënë, gjersa, gjithsaherë, kudo, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, megjithëqë, megjithëse, meqenëse, meqë, mirëpo, ndërsa, ndonëse, nëse, ngado, ngaqë, ngase, pasi, përderisa, përveçqë, përveçse, poqë, porsa, parse, porsi, posa, prejse, qëkurse, saku, sapo, saqë, sepse, sesa, siç, sikundërse, sikur, sikurse, tekdo, tekqë, teksa, veçse etj.* |

*Shkruhen **ndaras** të gjitha lidhëzat që sipas strukturës morfologjike janë:*

***shprehje lidhëzore:***
*aq sa, ashtu si(ç), deri ku, deri kur, duke qenë se, edhe në, edhe po, edhe pse, edhe sikur, gjer ku, gjer kur, kaq sa, kështu që, kudo që, kurdo që, kurdoherë që, kushdo që, me kusht që, me qëllim që, mjaft që, në është se, në mënyrë që, në qoftë se, në rast se, në vend që, nga frika se, nga ku, nga shkaku që, ngado që, para se, për arsye se, për shkak se, po qe se, po të jetë se, posa që, që ku, që kur, qysh se, sa herë që, sa kohë që, sado që, sapo që, si edhe, sido që, tekdo që, vetëm se; as...as, daç...daç, dhe...dhe, edhe...edhe, ja...ja,jo që...por (edhe), jo veç (që)...por (edhe), jo vetëm (që)...por (edhe), jo vetëm që...por as, le që...por as, le që...por edhe, ndo...ndo, o...o, ose...ose, qoftë...qoftë, si...ashtu edhe, si...si etj.*

*Dallohen në shkrim lidhëzat **nëse, ngase, sesa, sepse, porsa, porsi** nga përdorimet e pjesëve përbërëse të tyre si fjalë të veçanta. Krahaso.*

| ***Lidhëza:*** | ***Fjalë të veçanta:*** |
|---|---|
| ***Nëse** nuk vjen, më shkruaj.*<br>*Nuk shkoi **ngase** kishte frikë.*<br>*Më mirë të lexosh, **sesa** të rrish kot.*<br>*Ai u vonua, **sepse** i iku autobusi.*<br>***Porsa** ta shkruash, na lexo.*<br>*Punonte **porsi** bletë.* | ***Në se** e mbështet ti këtë mendim?*<br>***Nga se** bëhet letra?*<br>*Më thuaj **se sa** ka vlerë ky punim.*<br>*As unë nuk e di se **pse** ai nuk erdhi.*<br>***Por sa** kushton kjo, askush nuk na tha.*<br>***Por si** e bëri, nuk na tregoi.* |

*Në Kosovë, në fjali shkakore e kohore, në vend të lidhëzës së përngjitur **pasi**, po përdoret gjithnjë e më shpesh shprehja lidhëzore **pasi që**. Ky përdorim është sipas modelit të lidhëzave: **kështu që, kushdo që, kurdo që, kudo që, sado që, sapo që, sido që** etj. Megjithatë, forma **pasi që** nuk është normative. Khs.*

| | | |
|---|---|---|
| *Kohore:* | **Ai iku, **pasi që** hëngri drekë.* | *për: Ai iku, **pasi** hëngri drekë.* |
| *Shkakore:* | **Ai nuk erdhi, **pasi që** kishte punë.* | *për: Ai nuk erdhi, **pasi** kishte punë.* |

110

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Diskuto-Plotëso*

Nxënësit udhëzohen që pjesën e lexuar në libër ta analizojnë dhe t'i nënvizojnë lidhëzat.
Disa lidhëza shkruhen bashkë, disa ndaras, disa janë shprehje lidhëzore.
Lidhëza të thjeshta: dhe, e, edhe, ose etj.
Lidhëza të përngjitura: derisa, domethënë, kudo, sepse etj.
Shprehje lidhëzore: aq sa, ashtu si, deri ku, deri kur, edhe po, edhe në, nga shkaku që etj.

*Nëse nuk vjen, më shkruaj!*
*Nuk shkoi, ngase kishte frikë.*
*Më mirë të lexosh, sesa të rrish kot.*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit udhëzohen që librat e tyre t'i shikojnë me shokun e bankës.
Lexojnë nënvizimet e njëri-tjetrit dhe korrigjojnë aty ku shohin gabime. Tregojnë mes vete se përse përdoren lidhëzat në fjali ose tekste të ndryshme.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të lidhëzave dhe përdorimit të tyre.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 104

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Lidhëzat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon lidhëzat bashkërenditëse.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2, 3; II. 1; III. 2, 7.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3; 2. 5, 6; 3. 2, 6.


*Merrni nga një parafjalë prej secilit katror të tabelës lart dhe ndërtoni katër fjali.*

*Dona i ka shkruar një mesazh në telefon shoqes së saj, Rinës.*

*Rina, unë po dal n'park. Do të luaj deri n'orën katër. Nëse kalon ka parku, hajde edhe ti. Dona.*

*Shikoni si i ka përdorur Dona parafjalët. Përmirësojini sipas rregullave të drejtshkrimit.*

njësia 26
LIDHËZAT

***Detyrë***

*Gjejini lidhëzat në tregimin "Luli i vocërr". Tregoni cilat janë nënrenditëse dhe cilat janë bashkërenditëse.*

*Plotësojeni tabelën me lidhëzat përkatëse:* ***dhe, edhe, as, ose, apo, kurse, megjithatë, mirëpo, ndërsa, teksa, por, vetëm, prandaj, andaj, pra, se, që, në, nëse, ku, derisa, sapo, sepse, meqenëse, meqë, ngase, me qëllim që, sa, si, sikur, në qoftë se, saqë, ndonëse, megjithëse, në vend që*** *etj.*

| | |
|---|---|
| *Lidhëza bashkërenditëse* | |
| *Lidhëza nënrenditëse* | |

59

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lidhëzat (ora III)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen lidhëzat në fjali dhe tekste të ndryshme;
- Diferencon ato në llojet e veta;
- Zbaton në shkrime dhe paragrafë të ndryshëm.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Matematikë, Artet.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Rikujtim i njohurive paraprake*

Nxënësve u kërkohet t'i rikujtojnë njohuritë nga orët paraprake për lidhëzat dhe pjesën e tekstit "Luli i vocërr". Llojet e lidhëzave i kanë gjetur në orën e parë, tani duhet të plotësojnë në rubrikat e fletore punës.

| | |
|---|---|
| Lidhëzat bashkërenditëse | |
| Lidhëzat nënrenditëse | |



◇ *Tregoni çfarë raporti shpreh lidhëza në fjalinë e dytë:* ***Unë të gjitha i kundërshtoja, por ju jeni i palëkundur dhe çdoherë arritët ta thyeni këmbënguljen time.***

*a. përmbyllës*
*b. kundërshtues*
*c. veçues*

◇ *Mbushni hapësirat me lidhëzat që përshtaten me tekstin:* ***dhe, saqë, se si, pastaj.***

*Plaku e kishte pritur goditjen................e kishte kthyer. E kishte kthyer aq të tmerrshme,...................sulmuesi dhe i sulmuari i kishin këmbyer rolet vetëtimthi. Gavroshi bëri me mendje planin......................do të hidhej, ......................u ndal menjëherë.*

◇ *Formoni fjali me lidhëzën* ***që****:*

*Si lidhëz shkakore:* ______________________

*Si lidhëz qëllimore:* ______________________

◇ *Shkruani në tabelë lidhëzat e mëposhtme sipas strukturës së tyre morfologjike.*

*Në këngë e sipër Adilit iu duk sikur yjet e largëta u afruan, siç afrohen në verë përmbi majat e maleve të Kosovës. Por, as yjet s'kishin luajtur nga vendi, as gjethet që po kalbëzoheshin. Përsëri, u dëgjua çiftelia dhe Adili që këndonte. Ishte kënga e vet kjo, andaj druhej të ngrinte zërin lart. Kur kërciti një ashkë nën këmbët e Vitës, djaloshi ngriti kokën. Megjithëse ishte e treta herë që takonte këtë vajzë, ai i vuri re bukurinë, që buronte nga të gjitha tiparet e grizarakes e mblidhej me një hijeshi të përgjithshme, ashtu siç buron ujët nga të katër anët e dheut. Edhe pse e ftohta të përpinte, kuajt lëviznin nëpër rrugën e ngrirë. Sa herë që fshikullonte kamxhikun, hapi i tyre bëhej më i shpejtë. Karroca u anua, u lëkund, derisa qëndroi, mirëpo njeri s'po dilte prej saj. Ngado që kalonte, shihte grumbuj njerëzish që shëtisnin, ndonëse tetori kishte sjellë, veç të ftohtit, edhe një tyl të hollë mjegulle.*

60

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-plotëso*

Nxënësit udhëzohen t'i lexojnë tekstet e dhëna në libër dhe të bëjnë diferencimin dhe nënvizimin e lidhëzave dhe llojeve të tyre.
Në rubrikën e tekstit me hapësira në mes tekstit nxënësit duhet t'i përdorin lidhëzat që janë dhënë në libër, cila është gjegjëse për hapësirën e duhur.
Gjithashtu, edhe në ushtrimin tjetër duhet të dallojnë se cilat lidhëza janë shkruar drejt e cilat jo.
Në rubrikën formoni fjali me lidhëzën që:

Si lidhëz shkakore:____________________

Si lidhëz qëllimore:___________________

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Përmblidh-thuaja shokut*

Nxënësit i përmbledhin përgjigjet e tyre që kanë shkruar në libër dhe librat i shkëmbejnë me njëri-tjetrin. Ndonjëri nga nxënësit ia lexon tjetrit përgjigjet dhe shkëmbejnë mendime mes vete për përgjigjet e dhëna.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të lidhëzave dhe përdorimit të tyre.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________

______________________

# Mësimi 105

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përbërësit e fjalës

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon përbërësit e fjalës: rrënjën, temën, parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjat. Identifikon fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 17

FJALA DHE KUPTIMET E SAJ

Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë
kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti
gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt
pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk
heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët: **i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon **sende** e **dukuri.** Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë **kuptimi gramatikor** dhe **kuptimi leksikor.***

63

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit e fjalës

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon rrënjën, temën dhe ndajshtesat;
- Dallon përbërësit e fjalës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Nxënësve u prezantohet njësia e re. Nga ta kërkohet të punojnë në tabelë me teknikën *Di.*

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël e kuptimshme në leksikologji. | | |



***Kuptimi gramatikor*** *i përfshin të gjitha fjalëformat e fjalës në një fjali të dhënë, për shembull, në fjalinë më poshtë, trajta e gjinores (e nënvizuar) e shpreh kuptimin e përkatësisë së shtëpisë.*

*Atje është shtëpia* ***e vajzës****.*

***Kuptimi leksikor*** *është vetë kuptimi i morfemës apo fjalës bazë që shpreh diçka dhe përbën anën më thelbësore të fjalës, si shembull, më poshtë po e japim kuptimin leksikor të fjalës* ***shtëpi****:*

| *fjala* | *Shtëpi* |
|---|---|
| kuptimi leksikor | Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje); banesë; apartament ku banon një familje. |

*Kuptimi leksikor ndahet tutje në kuptim parësor (të drejtpërdrejtë) dhe në kuptim dytësor (të figurshëm).*

- *Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor apo i drejtpërdrejtë që ajo shpreh. Për shembull, në fjalinë: E dëgjova me* ***veshët*** *e mi - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin denotativ (parësor), pasi u referohet drejtpërdrejt organeve të dëgjimit.*
- *Kuptimi i figurshëm është kuptimi dytësor i fjalës që sugjerohet ose nënkuptohet. Për shembull, në fjalinë: I vari (i uli) veshët - fjala* ***veshët*** *është dhënë në kuptimin e figurshëm (dytësor), pasi në këtë kontekst nënkupton dikë që nuk mburret më, nuk shet mend më.*
- *Disa fjalë kanë më shumë kuptime dhe kjo quhet polisemi.*
- *Për shembull, fjala* ***bisht*** *ka dy e më shumë kuptime leksikore, pra është fjalë polisemike (shumëkuptimëshe). Në fjalor, fjala* ***bisht*** *del me 13 kuptime, por këtu po i japim 3 prej tyre:*

| | |
|---|---|
| 1 | Pjesa e zgjatur në fund të kurrizit të kafshëve, që është e lëvizshme dhe zakonisht e mbuluar me qime të gjata te kafshët e mëdha; ana e prapme e trupit të shpendëve e mbuluar me një tufë puplash; copa e mishit që pritet nga kjo pjesë e kafshëve ose e shpendëve. Bisht dhelpre. |
| 2 | Pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me degën a me kërcellin e një bime. Bishti i dardhës. |
| 3 | Pjesë e një vegle a e një mjeti, shkop i ngulur në pjesën tjetër a i mbërthyer me të ose pjesë e zgjatur si shkop, që shërben si dorezë. Bishti i lopatës. |

Shih fletoren e punës



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë dhe të mbajnë shënime te rubrika *Dua të di.*

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël e kuptimshme në leksikologji. | Cili është kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës? | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova më shumë*

Në fund ora përmbyllet me rubrikën *Mësova më shumë.*

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Fjala është njësia më e vogël e kuptimshme në leksikologji. | Cili është kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës? | Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor që e shpreh ajo. |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të përbërësve të fjalës dhe identifikimit të llojeve të fjalëve.

**Detyrë:**
(Detyrë në *Fletore pune,* faqe 62)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 106

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përbërësit e fjalës


njësia 27

PËRBËRËSIT E FJALËS

**Pyetje**

1. Çka është fjala?
2. Nga se përbëhet fjala?
3. Cila pjesë e fjalës e bart kuptimin themelor të saj?
4. Si ndahen ndajshtesat?
5. Si e gjejmë temën e fjalës?

**Detyrë**

◇ Gjeni rrënjët dhe ndajshtesat e këtyre fjalëve: përjetoj, përshpejtoj, mosbesim, stërgjysh, mbivlerësoj, veproj, punoj, pagjumësi, e papërfunduar, i qeshur.

| | |
|---|---|
| Rrënja e fjalës | |
| Ndajshtesat e fjalës | |

◇ Si janë ndërtuar këto fjalë: **mendoj, mendim, krejtësisht, aftësi, punëtor, drejtor.**

a. Me parashtesa
b. Me prapashtesa
c. Me nyja

62

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon përbërësit e fjalës: rrënjën, temën, parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjat. Identifikon fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 2, II: 2. 4, III: 1. 3
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit e fjalës

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon rrënjën, temën dhe ndajshtesat;
- Dallon përbërësit e fjalës;
- Lexon qartë e pa gabime.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohurit paraprake*

Nxënësit do t'i lexojnë pyetjet që janë parashtruar në librin *Fletore pune.* Secili nga ta do të përfshihet në dhënien e përgjigjeve.

*1. Çka është fjala?*
*2. Nga çka përbëhet fjala?*
*3. Cila pjesë e fjalës e bart kuptimin e saj themelor?*
*4. Si e gjejmë temën e fjalës?*



◇ *Formoni fjalët e kundërta me anë të parashtesave:* ***sh-, ç-, mbi-, mos-, pa-, zh-.***

*qep....................* *besim....................* *i ditur....................*

*lodhem....................* *nënvlerësoj....................* *vesh....................*

◇ *Ndani fjalët në rrënjë, prapashtesë dhe mbaresë: punofsha, detarët, madhërive.*

| | **Rrënja** | **prapashtesa** | **mbaresa** |
|---|---|---|---|
| Punëtore | Punë | tor | e |
| Punofsha | ................ | ................ | ................ |
| Detarët | ................ | ................ | ................ |
| Madhërive | ................ | ................ | ................ |

◇ *Shënoni pesë fjalë të prejardhura me parashtesim.*
◇ *Shënoni pesë fjalë të prejardhura me prapashtesim.*
◇ *Shënoni pesë fjalë të prejardhura me parashtesim dhe prapashtesim.*
◇ *Shënoni tri fjalë të përbëra.*
◇ *Shënoni tri fjalë të përngjitura.*

◇ *Shembulli* ***i hutuar*** *është fjalë e formuar:*

*a. Me nyjëzim*
*b. Me parashtesim*
*c. E përngjitur*

◇ ***Degëgjerë*** *është fjalë:*

*a. Me nyjëzim*
*b. Me parashtesim*
*c. E përbërë*

◇ *Shikoni në Fjalorin e Gjuhës Shqipe dhe kërkoni 5 fjalë të reja të prejardhura dhe po aq të përbëra që fillojnë me* ***o, r*** *dhe* ***rr****.*

63



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Mësimdhënësi i shpjegon konceptet rrënjë (punë), temë (punë, punoj) dhe ndajshtesë (-o, -im, për-), duke dhënë shembuj në tabelë.

*Punë-tor*
*Punë-sim*
*Punë-tori*

Në librin *Fletore pune* plotësohen detyrat e dhëna në faqe 62 dhe 63.



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Në fund të orës diskutohet se si duhet t'i identifikojmë dhe analizojmë elementet e fjalës: *parashtesat, prapashtesat, mbaresat* dhe *nyjat* me shembuj konkretë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të përbërësve të fjalës dhe identifikimit të llojeve të fjalëve.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 107

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përbërësit e fjalës

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon përbërësit e fjalës: rrënjën, temën, parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjat. Identifikon fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2


njësia 17
FJALA DHE KUPTIMET E SAJ
Agron Tufa

Të ngasësh fjalët e para, thjesht, për t'i dhënë
kohë mendimit
të ndrydhë trajektoren e lirë në hark vullneti
gotik.
Të çlirosh hapësirën brenda vrundujsh të amullt
pështjellimi
dhe kordat e Frymës të dridhen me pathos e rreshk
heraldik.

*Kërko në fjalor fjalët:* ***i amullt, kordë, trajektore, gotik, rreshk, pështjellim, vrundull.***

*Nuk i gjen në fjalor fjalët: heraldik, pathos Heraldik, -e mb. 1. që lidhet me person a diçka që i paraprin një veprimi a ngjarjeje.*
*2. që lidhet me ndonjë shpallje apo njoftim. Pathos-i (emër)-aftësi e nxitjes së një ndjenjeje, nga një person apo vepër.*

*Pathos, -i em. aftësi e nxitjes së një ndjenjeje të zjarrtë a me frymëzim të lartë nga një person apo vepër.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Ju mund të vëreni se ngjyrat tregojnë fillimin dhe mbarimin e çdo fjale. Po ashtu, mund të vëreni se shumë nga këto fjalë janë shfrytëzuar në kuptimet e tyre figurative. Pra, jo të drejtpërdrejta.*
- *Fjala është si njësia më e vogël, e pavarur dhe kuptimplote e gjuhës që mund të qëndrojë e vetme. Ajo pasqyron dhe shënon* ***sende*** *e* ***dukuri.*** *Fjala ka përmbajtje dhe formë.*
- *Kuptimi që bart fjala është pjesa më e rëndësishme e saj dhe mund të përshkruhet si një komponent i fjalës përmes të cilit komunikohet një koncept.*
- *Dy llojet kryesore të kuptimit janë* ***kuptimi gramatikor*** *dhe* ***kuptimi leksikor.***

63

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit e fjalës

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon rrënjën, temën dhe ndajshtesat;
- Dallon përbërësit e fjalës;
- Krijon fjalë të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Bisedohet me nxënësit për formimin e fjalëve të reja, duke punuar me teknikën *Stuhi mendimesh.*





*Kuptimi gramatikor* i përfshin të gjitha fjalëformat e fjalës në një fjali të dhënë, për shembull, në fjalinë më poshtë, trajta e gjinores (e nënvizuar) e shpreh kuptimin e përkatësisë së shtëpisë.

*Atje është shtëpia **e vajzës**.*

***Kuptimi leksikor*** *është vetë kuptimi i morfemës apo fjalës bazë që shpreh diçka dhe përbën anën më thelbësore të fjalës, si shembull, më poshtë po e japim kuptimin leksikor të fjalës* ***shtëpi****:*

| fjala | Shtëpi |
|---|---|
| kuptimi leksikor | Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje); banesë; apartament ku banon një familje. |

*Kuptimi leksikor ndahet tutje në kuptim parësor (të drejtpërdrejtë) dhe në kuptim dytësor (të figurshëm).*

- *Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës është kuptimi parësor apo i drejtpërdrejtë që ajo shpreh. Për shembull, në fjalinë: E dëgjova me **veshët** e mi - fjala **veshët** është dhënë në kuptimin denotativ (parësor), pasi u referohet drejtpërdrejt organeve të dëgjimit.*
- *Kuptimi i figurshëm është kuptimi dytësor i fjalës që sugjerohet ose nënkuptohet. Për shembull, në fjalinë: I vari (i uli) veshët - fjala **veshët** është dhënë në kuptimin e figurshëm (dytësor), pasi në këtë kontekst nënkupton dikë që nuk mburret më, nuk shet mend më.*
- *Disa fjalë kanë më shumë kuptime dhe kjo quhet polisemi.*
- *Për shembull, fjala **bisht** ka dy e më shumë kuptime leksikore, pra është fjalë polisemike (shumëkuptimëshe). Në fjalor, fjala **bisht** del me 13 kuptime, por këtu po i japim 3 prej tyre:*

| | |
|---|---|
| 1 | Pjesa e zgjatur në fund të kurrizit të kafshëve, që është e lëvizshme dhe zakonisht e mbuluar me qime të gjata te kafshët e mëdha; ana e prapme e trupit të shpendëve e mbuluar me një tufë puplash; copa e mishit që pritet nga kjo pjesë e kafshëve ose e shpendëve. Bisht dhelpre. |
| 2 | Pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me degën a me kërcellin e një bime. Bishti i dardhës. |
| 3 | Pjesë e një vegle a e një mjeti, shkop i ngulur në pjesën tjetër a i mbërthyer me të ose pjesë e zgjatur si shkop, që shërben si dorezë. Bishti i lopatës. |

Shih fletoren e punës

64

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Të nxënët në grupe*

Nxënësit ndahen në grupe.
Grupi i parë do të formojë fjalë të reja me *prejardhje*.
Grupi i dytë me *kompozim*.
Grupi i tretë me *përngjitje*.
Grupi i katërt me *forma të përziera*.

Grupi I – fjalë të reja me prejardhje.
- Emri *punë*, prapashtesa *im* – ***punim***

Grupi II – me kompozim.
- *Udhë + kryq* - ***udhëkryq***

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Mësimdhënësi jep informata shtesë për fjalën dhe përbërësit e saj.

*Prapashtesa trajtëformuese ose mbaresa janë ato ndajshtesa me anë të të cilave formohen treguesit gramatikorë, si numri, gjinia, rasa.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të përbërësve të fjalës, identifikimit të llojeve të fjalëve dhe krijimit të fjalëve të reja.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 108

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Subjekti, kompozicioni, tema, komentimi i teksteve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Kupton tiparet e subjektit, kompozicionit dhe temës;

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



njësia 15
SUBJEKTI DHE TEMA

Brajan Morz
**PATA E SHËMTUAR**

Një patë po rrinte ulur mbi vezë, prapa shkurreve. Kur dëgjoi krismat e para të vezëve, prej nga do të dilnin zogjtë, ajo u gëzua shumë.
I numëroi të gjithë zogjtë, por pa se njëra vezë nuk kishte çelur fare.
"Qenka një vezë e madhe", i tha një patë tjetër. "Ndoshta nuk është jotja. Mos është e ndonjë qure".
"Jo, jo, është imja", ia ktheu pata nënë. Ajo u ul mbi vezën, duke pritur të çelte zogu edhe prej saj.
Nuk kaloi shumë dhe veza e mbetur kërciti. Nga ajo doli zogu i fundit. Ishte më i madh se të tjerët dhe shumë i shëmtuar. Nënës patë i vinte turp nga zogu i saj. Mirëpo, i kishte të tjerët, të bukur si hëna dhe u ngut të shkonte sa më parë në fermë. Hyri në ujë dhe zogjtë vajtën pas saj.
- "Të paktën po notuaka mirë", mendoi nëna patë për zogun e shëmtuar. "E dija unë se nuk është qurë. Qurat nuk dinë të notojnë. Nejse, tash është e shëmtuar, por ndoshta zbukurohet, kur të rritet. E ndoshta edhe nuk rritet së tepërmi". Mirëpo, ngjau e kundërta. Pata e shëmtuar rritej shumë e më shumë. Zogjtë e tjerë e vërenin se ajo ishte më ndryshe se ata. E tallnin dhe e ngacmonin.
- "Si nuk po të ha macja", i thoshin.
As pulat nuk e linin rehat. Ndonjëherë edhe e shtynin me krahë.
Pata e shëmtuar duroi sa duroi dhe një ditë nuk mundi më. Vendosi të ikte. Ec e ec e arriti te një vend ku jetonin patat e egra. Edhe patat e egra e përqeshën për shëmtinë e saj dhe e përzunë. Pata mbeti vetëm. Askush nuk dëshironte të luante me të. "Nuk më duan se jam kaq e shëmtuar", mendoi vetëmevete.
Një ditë u shoqërua me dy rosa, por ato fluturuan tutje, kur dëgjuan zërat e gjuetarëve. Një ditë tjetër, një plakë e mori në shtëpi, por kanakarët e saj, një pulë dhe një mace laroshe, e përqeshnin, se nuk dinte të mjaullinte dhe se nuk dinte të bënte vezë.

54

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Subjekti dhe tema

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon subjektin nga tema;
- Identifikon subjektin dhe temën në një tekst letrar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqitet përrallëza "Breshka dhe lepuri"
Pyetjet:
Cili është mesazhi i kësaj përrallëze?
Çka simbolizon breshka?
Çka simbolizon lepuri?
Pse lepuri e humb garën?
Përgjigjet e mundshme:
I duruari, i fituari!

Breshka simbolizon ngadalësinë.
Lepuri simbolizon shpejtësinë.
Lepuri e humb garën nga mendjemadhësia.



Lepuri dhe Breshka - Përralla Shqip për Fëmijë - Përralla Shqiptare
https://www.youtube.com/watch?v=4pWkpI7Jo3Y



njësia 15
SUBJEKTI DHE TEMA

Brajan Morz
## PATA E SHËMTUAR

Një patë po rrinte ulur mbi vezë, prapa shkurreve. Kur dëgjoi krismat e para të vezëve, prej nga do të dilnin zogjtë, ajo u gëzua shumë.
I numëroi të gjithë zogjtë, por pa se njëra vezë nuk kishte çelur fare.
"Qenka një vezë e madhe", i tha një patë tjetër. "Ndoshta nuk është jotja. Mos është e ndonjë qure".
"Jo, jo, është imja", ia ktheu pata nënë. Ajo u ul mbi vezën, duke pritur të çelte zogu edhe prej saj.
Nuk kaloi shumë dhe veza e mbetur kërciti. Nga ajo doli zogu i fundit. Ishte më i madh se të tjerët dhe shumë i shëmtuar. Nënës patë i vinte turp nga zogu i saj. Mirëpo, i kishte të tjerët, të bukur si hëna dhe u ngut të shkonte sa më parë në fermë. Hyri në ujë dhe zogjtë vajtën pas saj.
- "Të paktën po notuaka mirë", mendoi nëna patë për zogun e shëmtuar. "E dija unë se nuk është qurë. Qurat nuk dinë të notojnë. Nejse, tash është e shëmtuar, por ndoshta zbukurohet, kur të rritet. E ndoshta edhe nuk rritet së tepërmi". Mirëpo, ngjau e kundërta. Pata e shëmtuar rritej shumë e më shumë. Zogjtë e tjerë e vërenin se ajo ishte më ndryshe se ata. E tallnin dhe e ngacmonin.
- "Si nuk po të ha macja", i thoshin.
As pulat nuk e linin rehat. Ndonjëherë edhe e shtynin me krahë.
Pata e shëmtuar duroi sa duroi dhe një ditë nuk mundi më. Vendosi të ikte. Ec e ec e arriti te një vend ku jetonin patat e egra. Edhe patat e egra e përqeshën për shëmtinë e saj dhe e përzunë. Pata mbeti vetëm. Askush nuk dëshironte të luante me të. "Nuk më duan se jam kaq e shëmtuar", mendoi vetëmevete.
Një ditë u shoqërua me dy rosa, por ato fluturuan tutje, kur dëgjuan zërat e gjuetarëve. Një ditë tjetër, një plakë e mori në shtëpi, por kanakarët e saj, një pulë dhe një mace laroshe, e përqeshnin, se nuk dinte të mjaullinte dhe se nuk dinte të bënte vezë.

54

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ditari i të nxënit*

Kërkesa:
Ndahet fleta në mes me një vizë, në dy kolona, të cilat do të plotësohen gjatë leximit të tekstit.
Kolona e djathtë plotësohet me citatet që u pëlqejnë nga teksti, ndërsa kolona e majtë me komentet pse u ka pëlqyer ai citat.

| Citati | Komenti |
| --- | --- |
| | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ruaje fjalën e fundit për mua*

Kërkesa:
Disa nga nxënësit do ta lexojnë njërin nga citatet që u ka pëlqyer më shumë nga teksti, por nuk do ta lexojnë komentin pse, sepse komenti lexohet pasi të dëgjohen komentet e të tjerëve për citatin e zgjedhur nga ta.
Bashkëbisedojmë.
Bashkëbisedojmë për subjektin dhe temën, ku dallon subjekti nga tema dhe si mund të dallohen subjekti dhe tema nga teksti i lexuar.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të subjektit nga tema dhe në vërtetësinë e identifikimit të subjektit dhe temës në një tekst letrar.

**Detyrë:**
Kërko në Fjalorin e Gjuhës Shqipe kuptimin e fjalëve: kanakar, larosh, sipërfaqe

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 109

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


*Fjalë të reja:*

*Kërko në Fjalorin e Gjuhës Shqipe fjalët:*

***kanakar, larosh, sipërfaqe** dhe shkruaji kuptimet e tyre.*

***Bashkëbisedojmë:***

*Letërsia e mirë ta ofron një botë më vete. Janë disa strategji që ndihmojnë për të nxjerrë kuptimet kryesore nga një vepër letrare.*

- *Përvoja personate. Kur lexojmë e pyesim veten nëse kemi pasur përvoja të ngjashme apo si do të ndiheshim a vepronim në situata të tilla.*
- *Përfytyrojmë. I lexojmë përshkrimet e personazheve dhe të vendeve dhe përpiqemi të përfytyrojmë ambientin ku zhvillohen ngjarjet.*
- *Parashikojmë ngjarjen. Duke e lexuar rrëfimin përpiqemi të gjejmë se çfarë do të ndodhë më tutje. Pas secilës intrigë mbani shënim se çfarë keni parashikuar.*
- *Dallojmë episodet. Secili roman ka një ngjarje që përfshin edhe episode të ndryshme brenda vetes. Këto episode së bashku e trajtojnë një temë të përbashkët. I shënojmë në fletore këto episode për të parë lidhjen mes tyre.*

***Detyrë:***

*Rreshtoji sipas kohës kur kanë ndodhur episodet e përrallës "Pata e shëmtuar"*

- *Pata e shëmtuar e kalon dimrin me vështirësi.*
- *Çelin zogjtë nga vezët dhe nëna patë vëren se njëri nga zogjtë është më ndryshe nga të tjerët.*
- *Pata e shëmtuar e sheh një tufë zogjsh të bardhë duke fluturuar në formë të shkronjës V.*
- *Patën e shëmtuar e tallin zogjtë e tjerë dhe pulat.*
- *Pata e shëmtuar kupton se është mjellmë.*
- *Pata e shëmtuar rri te një plakë.*
- *Pata e shëmtuar kupton se mund të fluturojë.*

56

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Subjekti, kompozicioni, tema, komentimi i teksteve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Kupton tiparet e subjektit, kompozicionit dhe temës;

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Subjekti dhe tema

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Nxjerr kuptimet kryesore nga një tekst letrar;
- Rendit ngjarjet sipas kronologjisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Pyetjet:
Ku dallon subjekti nga tema?
Çka përfaqëson subjekti në një tekst letrar?
Çka përfaqëson tema në një tekst letrar?
Përgjigjet e mundshme:
Subjekti është kuptimi, ndërsa tema është mesazhi i tekstit.
Subjekti përfaqëson atë për çka bëhet fjalë në atë tekst letrar.

Tema përfaqëson porosinë që e jep autori përmes tekstit letrar.

Bashkëbisedohet rreth strategjive të nxjerrjes së kuptimeve në një vepër letrare.



**Fjalë të reja:**
*Kërko në Fjalorin e Gjuhës Shqipe fjalët:*
***kanakar, larosh, sipërfaqe** dhe shkruaji kuptimet e tyre.*

**Bashkëbisedojmë:**

***Letërsia e mirë ta ofron një botë më vete. Janë disa strategji që ndihmojnë për të nxjerrë kuptimet kryesore nga një vepër letrare.***

- *Përvoja personate. Kur lexojmë e pyesim veten nëse kemi pasur përvoja të ngjashme apo si do të ndiheshim a vepronim në situata të tilla.*
- *Përfytyrojmë. I lexojmë përshkrimet e personazheve dhe të vendeve dhe përpiqemi të përfytyrojmë ambientin ku zhvillohen ngjarjet.*
- *Parashikojmë ngjarjen. Duke e lexuar rrëfimin përpiqemi të gjejmë se çfarë do të ndodhë më tutje. Pas secilës intrigë mbani shënim se çfarë keni parashikuar.*
- *Dallojmë episodet. Secili roman ka një ngjarje që përfshin edhe episode të ndryshme brenda vetes. Këto episode së bashku e trajtojnë një temë të përbashkët. I shënojmë në fletore këto episode për të parë lidhjen mes tyre.*

**Detyrë:**

***Rreshtoji sipas kohës kur kanë ndodhur episodet e përrallës "Pata e shëmtuar"***

- *Pata e shëmtuar e kalon dimrin me vështirësi.*
- *Çelin zogjtë nga vezët dhe nëna patë vëren se njëri nga zogjtë është më ndryshe nga të tjerët.*
- *Pata e shëmtuar e sheh një tufë zogjsh të bardhë duke fluturuar në formë të shkronjës V.*
- *Patën e shëmtuar e tallin zogjtë e tjerë dhe pulat.*
- *Pata e shëmtuar kupton se është mjellmë.*
- *Pata e shëmtuar rri te një plakë.*
- *Pata e shëmtuar kupton se mund të fluturojë.*

56

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di, dua të di, mësova*

Paraqitet tabela para nxënësve.
Kërkesa:
Plotësoni kolonën e parë dhe të dytë me atë që dini dhe pyetjet që i keni rreth temës, ndërsa kolonën e tretë e plotësoni pas leximit të tekstit.

| Strategjitë e nxjerres së kuptimeve në një tekst letrar | | |
|---|---|---|
| Di | Dua të di | Mësova |
| | | |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rendit, grupo dhe shëno*

Kërkesa:
Renditni sipas kohës kur kanë ndodhur ngjarjet e përrallës "Pata e shëmtuar".

Lexohen disa nga punimet e nxënësve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e nxjerrjes së kuptimve kryesore të një teksti letrar si dhe renditjen e saktë të ngjarjeve sipas kronologjisë.

**Detyrë:**
Nxirrni subjektin dhe temën te një tekst letrar sipas dëshirës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 110

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Subjekti, kompozicioni, tema, komentimi i teksteve

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Kupton tiparet e subjektit, kompozicionit dhe temës;

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



STRUKTURA E TEKSTIT

Ali Mehmetaj

**NUSJA ULKONJË**

Një mbret kishte dalë njëherë tebdil, veshur si një fshatar fill i vetëm nëpër mbretërinë e tij. Donte të shihte me sytë e tij se si jetonte populli dhe çfarë hallesh e mundonin. Kur e zuri nata, trokiti në derën e shtëpisë që u gjet atypari.

- A pranon mysafir, o i zoti i shtëpisë? - tha mbreti.
- Mirë se vjen! - e futi i zoti i shtëpisë brenda mbretin.

Pasi u përshëndetën, filluan një bisedë të përzemërt. Ndërkohë, të zotin e shtëpisë e thirrën në dhomën tjetër për ta gëzuar se e shoqja i kishte lindur djalë. Kur u kthye, i zoti i shtëpisë deshi ta nderonte mysafirin dhe i tha: "Gruaja më ka lindur djalë. Dëshiroj që, sipas dëshirës sate, të gjesh një emër për të."

Nxënësit i përsëritin ato që mësuan orët paraprake dhe mësimdhënësja pyet për poezitë e lexuara.
Si i kanë shprehur ndjenjat autorët në poezi?
Cilat janë llojet e strofave, rimës, vargjeve?
Vazhdohet me përgjigjet ku mësimdhënësja i shkruan në formë të pemës.




**Detyrë:**

- 1. Nxënësit ndahen në dy grupe.
  Grupi i parë - secili nxënës provon të shkruajë një poezi pa strofa dhe me varg të lirë.
  Grupi i dytë - secili nxënës provon të shkruajë një poezi me dy strofa katërshe sipas rimës ABAB.
- 2. Lexoni vjershat në klasë.
- 3. Tregoni lidhur me përvojën dhe vështirësitë që keni pasur për shkrimin e vjershave.

**Projekt:**

- Kërko në internet për poetin tënd të dashur dhe poezitë e tij. Prezanto në klasë për të.
  Ftoni në klasë ndonjë poet të njohur që t'i lexoni së bashku poezitë e tij. Diskutoni me të për përvojën e tij krijuese dhe për idetë e poezive të tij.

62

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Punë në grupe*

Nxënësit ndahen në dy grupe.
Grupi i parë - secili nxënës provon të shkruajë një poezi pa strofa dhe me varg të lirë.
Grupi dytë - secili nxënës provon të shkruajë një poezi me dy strofa katërshe sipas rimës ABAB.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Stilolapsat në mes*

Nxënësit i kanë shkruar poezitë që u është dhënë si detyrë.
Për ta treguar punën e tyre para të tjerëve nxënësit i vendosin lapsat në mes të tavolinës, lapsat e atyre nxënësve që merren i lexojnë poezitë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të saktësisë së përgjigjeve, përmbledhjes dhe krijimit të poezisë.

**Detyrë:**
(Hulumto në internet për shkrimtarin tënd të preferuar)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 121

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare: poezi, prozë, tekst dramatik.

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon zhanret kryesore letrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; II. 3; III. 3, 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 3, 7; 2. 5, 6; 3. 6.


Detyrë

**Në munç**

*Përkthyer nga Fan S. Noli (Namik Namazi)*

*Në munç të mbash në kokë terezinë*
*Kur shokët çmendër dhe fajtor të nxijnë;*
*Në munç të kesh besim, kur të dyshon*
*Kushdo, dhe s'ka njeri që të beson;*
*Në munç të preç, dhe pritjen s'e kursen,*
*Në të gënjefshin, ti nuk i gënjen,*
*Në të urrefshin, ti s'i çan me brirë,*
*Dhe s'hiqesh as m'i mënçim as m'i mirë.*
*Në munç të çndërrosh e të mejtosh,*
*Dhe nga këto në mos u robërofsh;*
*Në munç të preç Triumfin dhe Hatanë,*
*Dhe t'i shkelmosh të dysi kallpazanë;*
*Në munç të mbahesh, kur një dreq ta dreth*
*Të drejtën dhe në lak syleshin heth,*

*Kur sheh kalan' e jetës të rëzuar*
*Dhe prap e ngre me veglën e çkallmuar;*
*Në munç të vësh m'i grumbull çdo thesar,*
*Edhe t'i loç të gjitha me një zar,*
*T'i humpç edhe të nisësh përsëri*
*Pa thën' asgjë për këtë batërdi;*
*Në munç të kesh një zemër, trup e kokë*
*Që të shërbejnë sa të bëhen trokë,*
*Dhe të vazhdosh i djegur shkrump në furrë,*
*Dhe të thërret vullneti: "Mbahu, or burrël";*
*Në munç të zbreç në turm' e të mbash nderin,*
***Të hash me mbretin, të pish me neferin;***
*Në mos të ngaftë dot as mik as hasmë,*
*N'i daç të gjithë, po asnjë për dasmë;*
*Në munç për çdo minutë të përpjetë*
*Të rënç tamam sekunda gjashtëdhjetë;*
*Zaptove dhenë me çdo mall dhe hir,*
*Dhe ca më mirë, qënke trim, or bir!*

*Teksti i mësipërm është:*

*a. Prozë*
*b. Poezi*

*c. Tekst letrar*
*d. Tekst joletrar*

*a. Në gjuhën standarde*
*b. Në dialektin toskë*
*c. Në dialektin gegë*

31

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Poezia (ora IV)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Vlerëson poezinë për përmbajtjen që ka;
- Zgjeron njohuritë për poezinë;
- Përmbledh atë që lexon në poezi.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuteri, mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Artet, Histori, Matematikë.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Nxënësve u shtrohet pyetja: Keni dëgjuar për shkrimtarin FAN S. NOLIN?
Për poezinë "Në munç".
Një përgjigje e mundshme: Fan S. Noli shkrimtar që ka shkruar për gjendjen ekonomike të një periudhe të caktuar kohore.
Kurse poezia "Në munç" është një poezi ku Noli e ka përkthyer dhe autori ia ka kushtuar birit të vet.
Nxënësit udhëzohen të hapin fletore pune.

*Në munç*
*Në munç të mbash në kokë terezinë*
*Kur shokët çmendër dhe fajtor të nxijnë;*
*Në munç të kesh besim, kur të dyshon...*



- *Shëno disa shembuj që të tregojnë se në cilin dialekt apo gjuhë standarde është ky tekst.*

***Detyrë***

- *Shiko fjalët e panjohura të poezisë "Në munç". Kërkoji në fjalor dhe shiko format standarde që gjenden në fjalor. P.sh. Në munç = Në mundsh.*
- *Kërko në fjalor nga një fjalë të re që fillon me shkronjën: **f, g, gj,** dhe **h.***

***Detyrë***

- *Shëno lektyrat që i keni pasur deri tash dhe trego se çfarë zhanri janë ato.*

***Detyrë***

- *Shkruani poezi në dialektin gegë. Pastaj, provoni t'i ktheni në shqipen standarde dhe vëreni ndryshimet. Në cilin variant ju duket se tingëllojnë më mirë (shprehni mendimet tuaja). Po ashtu, poezitë mund t'i interpretoni në klasë. Mund ta ndërlidhni edhe me një orë muzikore, ku t'i shoqëroni ato me instrumente të ndryshme.*

32

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar-punë në grupe*

Nxënësve u lexohet poezia dhe analizohet secila pjesë. U përgjigjen pyetjeve:

| Teksti i mësipërm është: | | |
|---|---|---|
| Prozë | Tekst letrar | Gjuhë standarde |
| Poezi | Tekst joletrar | Në dialektin toskë |
| | | Në dialektin gegë |

Klasa ndahet në katër grupe.
Grupi A - do të hulumtojë fjalët e panjohura në poezi.
Grupi B - do të gjejë nga një fjalë në fjalor me shkronjat: f, g, gj dhe h.
Grupi C - do të shkruajë lektyrat që kanë lexuar dhe do të tregojë zhanrin e tyre.
Grupi D - shkruani poezi në dialektin gegë dhe mundohuni të ktheni në gjuhë standarde.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Thuaja shokut-Diskuto*

Nxënësit detyrat e dhëna ia lexojnë njëri-tjetrit dhe i shkëmbejnë librat mes vete.
Përgjigjet e tyre i korrigjojnë aty ku është nevoja dhe mësimdhënësja plotëson aty ku ka nevojë.
Nxënësit mund të shtrojnë edhe pyetje.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësimi i nxënësve bëhet në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë përmbledhur dhe shkruar dhe zgjerimit të njohurive të tyre.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 122

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1; II. 1.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 4.


KALLËZUESI

***Bashkëbisedojmë:***

***Kallëzuesi***
***Kryefjala së bashku me kallëzuesin janë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë.***

***Ai notoi.***
*kryefjala* — *kallëzuesi*

***Si ta dimë kallëzuesin?***
***Kallëzuesi, në sintaksë, e tregon:***

- *Veprimin që e kryen ose e pëson kryefjala, për shembull: Ai* ***noton.***

  *Për ta gjetur kallëzuesin bëjmë pyetje të tilla, si:* ***ç'bën?, ç'bëri?, ç'ka bërë?, si është?*** *etj., për shembull:*

  *Ai notoi. - bëjmë pyetjen: ç'bëri ai? -* ***Notoi.***

***Kallëzuesi në gjuhën shqipe shprehet me:***

- *Një folje: Ai* ***notoi.***
- *Një folje gjysmëndihmëse këpujore (jam, kam etj.) dhe një emër a mbiemër, përemër a numëror: Qielli* ***është i kaltër.***

117

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kallëzuesi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kallëzuesin si njësi sintaksore;
- Përdor kallëzuesin në fjali dhe tekste.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri Gjuha shqipe 6, fletore pune, tabela.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Artet, Gjuha angleze.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*

Bashkëbisedohet me nxënësit për veprimet e gjendjet e tyre gjatë fundjavës së kaluar. Disa nga përgjigjet e mundshme, janë: lexova, mësova, pushova, flija, rrija, dola, vizitova etj. Pastaj, pyeten se çfarë janë këto fjalë në gjuhë, në aspektin gramatikor. Shumë nxënës përgjigjen se këto janë folje, natyrisht, përgjigjja e tyre merret e saktë. Mirëpo, për të kaluar te njësia mësimore e planifikuar u sqarojmë se folje janë në morfologji, por në sintaksë janë kallëzues.



**Llojet e kallëzuesit:**

- *Kallëzuesi i thjeshtë foljor që shprehet me një formë foljore:*

  *Ai **notoi.***
  ***Jam lodhur** nga Deti i Veriut.*

- *Kallëzuesi i përbërë foljor që shprehet me dy folje (e dyta tregon veprim të plotë):*

  ***Duhet të shpëtojmë** Armitaxhin.*
  *Berti **nisi të ngjiste** ngadalë shkallën prej litari.*

- *Kallëzuesi emëror që përbëhet nga një folje gjysmëndihmëse këpujore (jam, kam etj.) dhe një emër a mbiemër, një përemër a numëror:*

  *Qielli **është i kaltër.***
  *Sepse **je një kokërr dembeli.***

- *Kallëzuesi mund të shprehet edhe me shprehje të figurshme:*

  *a. Djali ia **nxori bishtin** këtë herë.*
  *b. Ai nuk **vuri re** asgjë.*
  *c. Askush nuk **kishte marrë vesh** për ngjarjen.*

- *Vendi i kallëzuesit në fjali:*
  *Pas kryefjalës: Para kryefjalës:*
  - *Ai **notoi**.* ◇ ***Ra** një heshtje paksa e gjatë.*

- *Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën:*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në vetë:*
  - ***Ti je** vajzë e mirë.*
    ***Ai është** djalë i mirë.*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në numër:*
  - *Ai **notoi** drejt jugut*
    *Ata **notuan** drejt jugut.*

***Pyetje***

- *Çka është kallëzuesi?*
- *Pse kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë?*
- *Me çka shprehet kallëzuesi në fjali?*
- *Si e gjejmë kallëzuesin në fjali?*

Shih fletoren e punës

118

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Mbajtja e strukuruar e shënimeve*

U kërkohet nxënësve të mbajnë shënime gjatë leximit të informacioneve, duke i shkruar pyetjet, të cilat do t`u ndihmojnë atyre.

- Çka shpreh kallëzuesi?
- Pse kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë?
- Me çka shprehet kallëzuesi në fjali?
- Si e gjejmë kallëzuesin në fjali?
- Cilat janë llojet e kallëzuesit sipas ndërtimit?

Pyetjeve të lartshënuara u japim përgjigje, duke sqaruar secilën prej tyre edhe me shembuj, në mënyrë që ta kenë më të qartë dhe më të lehtë për ta kuptuar kallëzuesin.

Shembuj: Fëmijët e lagjes sonë janë të kujdesshëm (kallëzues i thjeshtë).
Ky qytet mund të jetë më i miri në vendin tonë (kallëzues i përbërë).

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shënime mbi shënime*

Nga shënimet e marra gjatë fazës së parë dhe të dytë të orës mësimore, kërkohet nga nxënësit t`i klasifikojnë informacionet që kanë marrë për kallëzuesin; pyetjet me të cilat e gjejmë, format me të cilat shprehet dhe llojet e kallëzuesit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njohurive për kallëzuesin; përcaktimin e kallëzuesit dhe mosngatërrimin me gjymtyrët e tjera, si dhe për përdorimin e kallëzuesit në fjali e tekste.

**Detyrë:**
(Të plotësohet fletore pune, faqe 65-66)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 123

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorët.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; 2. 1; II. 1. 2; IV. 4. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3; II. 3, 4; IV. 3, 4, 8



njësia 31
KURIOZITETE PËR ILIRËT

– **Agroni**

Mbreti i ardianëve, Agroni, ka vdekur në një mënyrë të pazakonshme. Pas betejës me etolët, ai ka pirë aq shumë prej gëzimit dhe është dehur pa masë, saqë ka vdekur pak orë më pas.

– **Tatuazhet**

Tek ilirët ka qenë në modë tatuazhi, thonë historianët. Sidomos për këtë është shquar fisi i japodëve që ka jetuar përafërsisht në Bosnjën e sotme.

– **Birra dhe ujëmjalti**

Pijet më të përdorura të ilirëve kanë qenë birra dhe ujëmjalti, pije kjo e ngjashme me verën e ëmbël.

– **Tadenusi**

Tadenusi ka qenë perëndi ilire e bukurisë dhe e dashurisë.

– **Armët**

Një prej armëve më të preferuara të luftëtarëve ilirë ka qenë arma që romakët e paraqitnin me emrin Sika. Kjo ka qenë një armë pak më e gjatë se thika e sotme dhe e ka pasur pakëz të lakuar majën. Prej saj vjen fjala e sotme: thikë.

**Pyetje:**
— Fjalitë e mësipërme janë tekste letrare apo joletrare?

**Detyrë:**
— Shikoni cilat janë foljet e tekstit të mësipërm,

**Bashkëbisedojmë (bisedoni në klasë):**

- Çfarë dini për ilirët?
- Ku kanë jetuar ata?
- Çfarë thotë teksti per vdekjen e Agronit?
- Cilat ishin pijet e preferuara të ilirëve?
- Cila ishte perëndia e bukurisë dhe e dashurisë e ilirëve?
- Cila ishte arma e preferuar e ilirëve?

116

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kallëzuesi (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon foljet në tekst;
- Analizon foljet në tekst;
- Shkruan duke përdorur kallëzues të përbërë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Lexo-dallo*

*Nxënësit e lexojnë me kujdes tekstin "Kuriozitete për ilirët".*
*Në tekst udhëzohen t'i dallojnë të gjitha foljet.*
*I nënvizojnë ato dhe u përgjigjen pyetjes:*
*Cilat folje tregojnë veprim e cilat gjendje?*



***Llojet e kallëzuesit:***

- *Kallëzuesi i thjeshtë foljor që shprehet me një formë foljore:*

  *Ai **notoi.***
  ***Jam lodhur** nga Deti i Veriut.*

- *Kallëzuesi i përbërë foljor që shprehet me dy folje (e dyta tregon veprim të plotë):*

  ***Duhet të shpëtojmë** Armitaxhin.*
  *Berti **nisi të ngjiste** ngadalë shkallën prej litari.*

- *Kallëzuesi emëror që përbëhet nga një folje gjysmëndihmëse këpujore (jam, kam etj.) dhe një emër a mbiemër, një përemër a numëror:*

  *Qielli **është i kaltër.***
  *Sepse **je një kokërr dembeli.***

- *Kallëzuesi mund të shprehet edhe me shprehje të figurshme:*

  a. *Djali ia **nxori bishtin** këtë herë.*
  b. *Ai nuk **vuri re** asgjë.*
  c. *Askush nuk **kishte marrë vesh** për ngjarjen.*

- *Vendi i kallëzuesit në fjali:*
  *Pas kryefjalës:* *Para kryefjalës:*
  - *Ai **notoi**.* - ***Ra** një heshtje paksa e gjatë.*

- *Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën:*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në vetë:*
  - ***Ti je** vajzë e mirë.*
    ***Ai është** djalë i mirë.*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në numër:*
  - *Ai **notoi** drejt jugut*
    *Ata **notuan** drejt jugut.*

***Pyetje***

- *Çka është kallëzuesi?*
- *Pse kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë?*
- *Me çka shprehet kallëzuesi në fjali?*
- *Si e gjejmë kallëzuesin në fjali?*

Shih fletoren e punës

118

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analizo-shkruaj*

*Nxënësit i analizojnë foljet në fjalitë e dhëna:*
*Tek ilirët ka qenë në modë tatuazi.*

______________________________________________

*Kjo ka qenë armë pak më e gjatë.*

______________________________________________

*Aty nisnin t'i mbanin armët.*

______________________________________________

*Prej saj vjen fjala e sotme: thikë.*

______________________________________________

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një tekst të shkurtër, duke përdorur vetë kallëzues të përbërë foljor

______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________

Më pas, i lexojnë shkrimet e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për dallimin e foljeve në tekst, saktësinë e përgjigjeve të dhëna si dhe për shkrimin e tekstit me kallëzues të përbërë.

**Detyrë:**

______________________________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:* ______________________________________________

______________________________________________

# Mësimi 124

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorët.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2; 2. 1; II. 1. 2; IV. 4. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3; II. 3, 4; IV. 3, 4, 8


KALLËZUESI

**Bashkëbisedojmë:**

**Kallëzuesi**
**Kryefjala së bashku me kallëzuesin janë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë.**

**Ai notoi.**

*kryefjala* — *kallëzuesi*

**Si ta dimë kallëzuesin?**
**Kallëzuesi, në sintaksë, e tregon:**

- *Veprimin që e kryen ose e pëson kryefjala, për shembull: Ai* ***noton.***

  *Për ta gjetur kallëzuesin bëjmë pyetje të tilla, si:* ***ç'bën?, ç'bëri?, ç'ka bërë?, si është?*** *etj., për shembull:*

  *Ai notoi. - bëjmë pyetjen: ç'bëri ai? -* ***Notoi.***

**Kallëzuesi në gjuhën shqipe shprehet me:**

- *Një folje: Ai* ***notoi.***
- *Një folje gjysmëndihmëse këpujore (jam, kam etj.) dhe një emër a mbiemër, përemër a numëror: Qielli* ***është i kaltër.***

117

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kallëzuesi (ora e tretë)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan rreth temës;
- Dallon foljet në tekst;
- Përshtat kallëzuesin me kryefjalën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4, Gjuha shqipe 6

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*

*Nxënësit udhëzohen të shkruajnë rreth temës "Kush jam unë", duke i përdorur foljet "kam" dhe "jam".*



***Llojet e kallëzuesit:***

- *Kallëzuesi i thjeshtë foljor që shprehet me një formë foljore:*

  *Ai* ***notoi.***
  ***Jam lodhur*** *nga Deti i Veriut.*

- *Kallëzuesi i përbërë foljor që shprehet me dy folje (e dyta tregon veprim të plotë):*

  ***Duhet të shpëtojmë*** *Armitaxhin.*
  *Berti* ***nisi të ngjiste*** *ngadalë shkallën prej litari.*

- *Kallëzuesi emëror që përbëhet nga një folje gjysmëndihmëse këpujore (jam, kam etj.) dhe një emër a mbiemër, një përemër a numëror:*

  *Qielli* ***është i kaltër.***
  *Sepse* ***je një kokërr dembeli.***

- *Kallëzuesi mund të shprehet edhe me shprehje të figurshme:*

  a. *Djali ia* ***nxori bishtin*** *këtë herë.*
  b. *Ai nuk* ***vuri re*** *asgjë.*
  c. *Askush nuk* ***kishte marrë vesh*** *për ngjarjen.*

- *Vendi i kallëzuesit në fjali:*
  *Pas kryefjalës:* *Para kryefjalës:*
  - *Ai* ***notoi****.* ◆ ***Ra*** *një heshtje paksa e gjatë.*

- *Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën:*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në vetë:*
  - ***Ti je*** *vajzë e mirë.*
    ***Ai është*** *djalë i mirë.*

  *Kallëzuesi me kryefjalën përshtaten në numër:*
  - *Ai* ***notoi*** *drejt jugut*
    *Ata* ***notuan*** *drejt jugut.*

***Pyetje***

- *Çka është kallëzuesi?*
- *Pse kallëzuesi është gjymtyra kryesore e fjalisë?*
- *Me çka shprehet kallëzuesi në fjali?*
- *Si e gjejmë kallëzuesin në fjali?*

Shih fletoren e punës



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-analizo*

Nxënësve u shpërndahen fletët me tekstin e shkruar. Çdo ditë nisi të binte shi. I imët dhe i ëmbël ishte. Dalëngadalë fillova të përgatitesha që të dilja. Të merrja ajrin e freskët. Këmbët më ecnin avash-avash. Nisa të lodhesha nga ecja.

Nxënësit i analizojnë foljet e tekstit duke e treguar llojin e kallëzuesit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexo-plotëso*

Nxënësit udhëzohen ta përshtatin kallëzuesin me kryefjalën në fjalitë e dhëna:
Djali ia __________ (nxora) bishtin.
Ai ________ (notova) drejt detit.
Ai _______ (jam) djalë i mirë.
Ajo ______ (isha) vajzë e kulturuar.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e kallëzuesit, llojin e kallëzuesit dhe për përshtatjen e tij.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 125

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ (kuptimin e parë dhe atë të figurshëm). Dallon dhe përdor figurat kryesore stilistike në të folur dhe në të shkruar. Identifikon tipare letrare dhe joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ;
- Identifikon tipare letrare dhe joletrare.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Kulturë, Teatër, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Imagjinata e drejtuar*

Mësimdhënësi bashkë me nxënësit i analizojnë situatat e dhëna përmes stripave nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6. Pas leximit nxënësit shprehin idetë e tyre lidhur me paraqitjen e secilit strip.



***Bashkëbisedojmë:***

— *Fjalët kanë kuptimet e tyre të figurshme.*

— *Ndonjëherë kuptimin e figurshëm të fjalës e bëjmë për shkak se duam të shprehim ose të nxisim te tjetri një ndjenjë. Ndonjëherë kuptimi i figurshëm është bërë aq i zakonshëm, sa nuk e dallojmë se është i figurshëm. P.sh. pak kush e dallon se kur thua: **marr vesh**, ti je duke përdorur një kuptim të figurshëm, sepse **marr vesh = kuptoj** e jo në kuptimin e parë, e marr veshin nga një vend në tjetrin.*

— *Kuptimet e tilla të fjalëve i quajmë figura.*

***Krahasimi:***
*Paraqet ngjashmërinë në mes të dy gjërave të ndryshme. Realizohet me përdorimin e fjalës **"si"** ose **"sa".***
***Shembuj:***
*I shpejtë si lepuri; I fortë si guri; E lehtë si era; E madhe sa pema; E drejtë si vizore; Punëtore si bleta.*

***Metafora:***
*Paraqet ngjashmërinë mes dy gjërave të ndryshme pa përdorur mjetin e krahasimit "sa" ose "si" Një diçka e quan me diçka tjetër.*
***Shembuj:***
*Mesi është një **makinë golash**. Ti je **ylli** i gjyshes. Skënderbeu ishte një **dragua** për turqit. Ku po fshihesh, o **lepur**? (me ç'rast lepur i themi ndonjë personi që e konsiderojmë frikacak).*

***Hiperbola:***
*Paraqet një krahasim të tepruar të dy gjërave si sasi apo si përmasë.*
***Shembuj:***
*U vonove **5 orë.** Ku po ngutesh kështu **500 km në orë.***

***Onomatopeja:***
*Figurë që imiton tingujt e krijuar nga një objekt a qenie.*
***Shembuj:***
*Ai erdhi duke ecur **tap e tup**. Bilbili këndonte **ciu-ciu**. E goditi topin **bam.***

***Frazeologjitë:***
*Ndonjëherë shprehjet e ndryshme të figurshme janë bërë të zakonshme në gjuhë. Ato kanë kuptim tjetër nga kuptimi i parë i fjalëve që e përbëjnë atë shprehje.*
***Shembull:***
*Ia nxori bishtin = e teproi; marr vesh = kuptoj; luaj vendit = lëviz; hoqa të zinjtë e ullirit = pata vështirësi (për të kryer një punë).*

66

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Diskutim*

Mësimdhënësi e nis shpjegimin duke treguar kuptimin e figurshëm të fjalëve, si dhe figurat stilistike që përdoren. Nxënësit pyeten për figurat kryesore stilistike, metaforën dhe krahasimin, si dhe për rolin e tyre.

Nxënësve u kërkohet që të dallojnë cilin lloj të figurës stilistike e kanë përdorur në strip.
Analizohen për çdo rast kuptimet e figurshme që shprehin shembujt.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Plotësimi i njohurive*

Në pjesën e fundit nxënësit në librin bazë, faqe 66, lexojnë për figurat stilistike që përdoren në krijimtaritë letrare dhe ngjyrimin e bukur që ato e bëjnë në tekste.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të kuptimit figurativ nga ai jofigurativ dhe identifikimit të tipareve letrare e joletrare në tekst.

**Detyrë:**
(Nxënësit përsëri do ta lexojnë tekstin në shtëpi dhe do ta plotësojnë faqen 67 në librin bazë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 126

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ (kuptimin e parë dhe atë të figurshëm). Dallon dhe përdor figurat kryesore stilistike në të folur dhe në të shkruar. Identifikon tipare letrare dhe joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2



**Detyrë:**

*Shiko ilustrimet në fillim të njësisë. Trego cilat nga figurat janë shfrytëzuor te secila prej tyre:*

1 ______
2 ______
3 ______
4 ______
5 ______
6 ______



**Detyrë:**

— *Taun-tërt imiton cilin veprim?*

***Diskutoni stripin:***

— *Çfarë po ndodh në këtë strip?*
— *A është për të qeshur? Pse?*

Shih fletoren e punës

67

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Identifikon figurat stilistike në fjali;
- Shpjegon përmbajtjen frazeologjike;
- Përshkruan situata nga përditshmëria, duke e përdorur metaforën, krahasimin, hiperbolën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit do t'i lexojnë detyrat e bëra në faqen 67 në librin bazë.

Shiko ilustrimet në fillim të njësisë. Trego cilat nga figurat janë shfrytëzuar te secila prej tyre:

| | |
|---|---|
| 1. | *Krahasimi* |
| 2. | *Metafora* |
| 3. | *Hiperbola* |
| 4. | *Onomatopeja* |


◇ Tregoni si e dalloni kuptimin parësor dhe dytësor të fjalës **kockë**.

a. I thernin **kockat** e këmbëve.

b. Fitoi ca **kocka** për tërë punën që bëri.

◇ Shikoni në Fjalorin e Gjuhës Shqipe dhe gjeni dy fjalë që kanë më shumë se një kuptim.

◇ Shikoni në fjalorin e Gjuhës Shqipe dhe gjeni nga një fjalë të re që fillon me i dhe j.

mësimi 17
SHPREHJET E FIGURSHME DHE FRAZEOLOGJIKE

**Detyrë**

◇ Tregoni kuptimin e këtyre shprehjeve frazeologjike:

**1. Nuk më zihet vendi vend**
a. Nuk jam i qetë
b. E kam mendjen e madhe
c. Nuk e di ku jam

**2. Ia hodha një sy**
a. E shikova
b. E mbylla syrin
c. E lëndova syrin

**3. S'ia kapi radakja**
a. Nuk i bëri detyrat e shtëpisë
b. Nuk kuptoi
c. Nuk u mashtrua, sepse është shumë i zgjuar

**4. Ia nxori bishtin**
a. E quajti qen
b. Bëri mirë
c. E teproi

**5. Jepu këmbëve**
a. Ha (më shumë)
b. Pi (më pak)
c. Ec (më shpejt)

36

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Shpjegim i përparuar*

Në pjesën e dytë do të shpjegohen dhe përforcohen njohuritë për shprehjet frazeologjike, duke e bërë punimin e detyrave të dhëna në Fletore pune, faqe 36. Tregoni kuptimin e këtyre shprehjeve frazeologjike:

1. Nuk më zihet vendi vend.

a. Nuk jam e qetë
b. E kam mendjen e madhe
c. Nuk e di ku jam

2. Ia hodha një sy.

a. E shikova
b. E mbylla syrin
c. E lëndova syrin

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Plotësimi i njohurive*

Kur tregoni një ngjarje, përpiquni të bëni një paraqitje të saktë e të plotë të saj. Tregoni ngjarjet sipas radhës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të figurave stilistike në fjali, komentimit të shprehjeve frazeologjike dhe përdorimit të figurave stilistike në tekst apo në të folur.

**Detyrë:**
(Të plotësohen pyetjet në *Fletore pune*, faqe 37)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 127

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ (kuptimin e parë dhe atë të figurshëm). Dallon dhe përdor figurat kryesore stilistike në të folur dhe në të shkruar. Identifikon tipare letrare dhe joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2


Detyrë

Shikoji këto shprehje dhe trego se ç'figura janë:

1. O Bajram, **bajrak** i gjallë (nga vjersha Shpellë e Dragobisë):
a. Metaforë
b. Krahasim
c. Onomatope

2. **Peshkaqenët me dy këmbë...janë shumë të dëmshëm** (Nga Shpella e piratëve):
a. Krahasim
b. Metaforë
c. Hiperbolë

3. "**Tu, tu, tu,** mblidhni armët" (Nga Princesha Argjiro):
a. Metaforë
b. Hiperbolë
c. Onomatope

4. **Qeshi si peshk** (Nga Shpella e piratëve):
a. Metaforë
b. Krahasim
c. Hiperbolë

5. **"Ata që po i sheh atje... Ata me duar të gjata, disa prej të cilëve edhe disa kilometra të gjatë"**:
a. Onomatope
b. Krahasim
c. Hiperbolë

37

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Interpreton tekste të ndryshme letrare;
- Shkruan krijime letrare duke përdorur figura stilistike;
- Emërton llojin e tekstit letrar dhe joletrar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Art, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit në fillim të orës do ta lexojnë detyrën e shtëpisë.
Detyrë: Shikoji këto shprehje dhe trego se ç'figura janë:
1. "O Bajram, bajrak i gjallë" (nga vjersha "Shpellë e Dragobisë")
a. Metaforë
b. Krahasim
c. Onomatope


Detyrë

◇ Shikoji këto shprehje dhe trego se ç'figura janë:

1. O Bajram, **bajrak** i gjallë (nga vjersha Shpellë e Dragobisë):

a. Metaforë
b. Krahasim
c. Onomatope

2. **Peshkaqenët me dy këmbë...janë shumë të dëmshëm** (Nga Shpella e piratëve):

a. Krahasim
b. Metaforë
c. Hiperbolë

3. "**Tu, tu, tu,** mblidhni armët" (Nga Princesha Argjiro):

a. Metaforë
b. Hiperbolë
c. Onomatope

4. **Qeshi si peshk** (Nga Shpella e piratëve):

a. Metaforë
b. Krahasim
c. Hiperbolë

5. **"Ata që po i sheh atje... Ata me duar të gjata, disa prej të cilëve edhe disa kilometra të gjatë"**:

a. Onomatope
b. Krahasim
c. Hiperbolë

37

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Di – Dua të di – Mësova më shumë*

Nxënësit do të ndahen në grupe, varësisht sa nxënës janë në klasë, aq grupe do të formohen. Ata do të shpalosin të gjitha ato që dinin dhe ato që i mësuan gjatë zhvillimit të njësisë, me teknikën *Di-Dua të di-Mësova më shumë.*

| Di | Dua të di | Mësova më shumë |
|---|---|---|
| Figurat stilistike e bëjnë tekstin më atraktiv. | Çfarë lloj figurash stilistike kemi? | Metafora, krahasimi, hiperbola, onomatopeja etj. |

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Paragraf përmbledhës*

Nxënësit do të shkruajnë një tekst të shkurtër për gjërat që pëlqejnë, duke i përshkruar ato me fjalët më të mira.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të figurave stilistike në fjali, komentimit të shprehjeve frazeologjike dhe përdorimit të figurave stilistike në tekst apo në të folur.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 128

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kuptimin figurativ nga ai jofigurativ (kuptimin e parë dhe atë të figurshëm). Dallon dhe përdor figurat kryesore stilistike në të folur dhe në të shkruar. Identifikon tipare letrare dhe joletrare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 3, II: 2. 3, III: 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 2, 2: 1. 4, 3: 2



Detyrë

Gjeji në lektyrat që i ke lexuar deri tash:

Tre shembuj të metaforës:

Tre shembuj të krahasimit:

Dy shembuj të hiperbolës:

Dy shembuj të onomatopesë:

38

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shprehjet e figurshme dhe frazeologjike

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kuptimin figurativ dhe jofigurativ;
- Analizon tekste të zhanreve e të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare;
- Shkruan tekste të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletore pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Art, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do të bëjnë një përsëritje të njësisë. Pastaj mësimdhënësi do të shtrojë disa pyetje.
1. *Cila është karakteristika e figurave stilistike?*
2. *Si dallohet një tekst në të cilin janë përdorur figurat stilistike nga llojet e tjera të teksteve?*

Një nga përgjigjet mund të jetë:
1. *Karakteristika e figurave stilistike është për ta përforcuar shprehjen dhe fjalët artistike.*



**Detyrë**

◇ Kërko në lektyrë shprehje frazeologjike dhe shëno kuptimet e tyre.

1 ____________________________

2 ____________________________

◇ Lexo tekstin:

*Plazhi shtrihej sa nuk ta zinte syri. Mbi sipërfaqen e detit të qetë, hidhej një avull i dendur, kurse krerët e njerëzve në të dukeshin si shalqinj të rritur në ndonjë arë të paanshme. Në një skaj po rrinin dy djem e këmbët i kishin futur në ujë.*
*Këqyrnin detin dhe kuvendonin.*

*- Deri ku mund të shkosh me not?*
*- Deriiii... atje tek ajo barka.*
*Barka ishte nja njëqind metra larg bregut.*
*- Unë edhe një herë më larg - ia priti tjetri.*
*- Eh, unë kisha mundur edhe dhjetë herë më shumë, por nuk guxoj.*
*- Pse?*
*- Prej peshkaqenit.*
*- Peshkaqenit? Iiii, sa frikacak je ti. Unë edhe sikur të më dalë, notoj shpejt fap e fap-fap-fap e në rërë.*
*- Hajt njëherë ta shohim.*
*Ai u çua në këmbë dhe e këqyri detin ashtu të kaltër dhe që dukej si ta thërriste me dorë notarin e vogël. Djali u përmblodh dhe u zhyt në ujë. Humbi për një grimë dhe mandej doli prapë përmbi. Shoku në breg e shihte me vëmendje. Kur doli në sipërfaqe, u shtrua dhe çau përpara.*
*Duke notuar u largua mjaft. Lëshoi sytë në hapësirën e detit, por kudo kaltër e kaltër. I uli prapë dhe, i mbushur frymë, u shty edhe më tej. Dikur i çoi sytë përsëri, kur njëherë iu bë terr, mandej prapë qartë. Një hije si shpatë e zezë po çante ujin si vetëtimë e po vinte drejt nga ai... U dëgjua një britmë e tmerrshme:*
*- Ndihmë, ndihmë...*
*Shoku që rrinte në breg u çua në këmbë dhe ngriti veshët. Njerëzit u ndalën të mbajnë vesh nga po vinte bërtima. Duke shikuar, vunë re se pranë djalit që bërtiti u çua edhe koka e një djali tjetër dhe të dy nisën të notonin këndej.*
*Çka ndodhi?*
*Mu kur djaloshi ra me not, prej barkës atje larg kishte kërcyer në ujë një djalosh tjetër.*

39

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Leximi në heshtje*

Nxënësit nxiten të lexojnë në heshtje tekstin e dhënë në *Fletore pune*. Sipas kërkesës i gjejnë figurat letrare dhe shprehjet frazeologjike në tekst, duke mbajtur shënime që të diskutohet për to pas leximit.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Paragraf përmbledhës*

Nxënësit bëjnë një përmbledhje të shkurtër me shkrim lidhur me figurat letrare të mësuara tashmë dhe lidhur me shprehjet frazeologjike.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të kuptimit figurativ nga ai jofigurativ dhe përdorimit të figurave stilistike në tekst apo në të folur.

**Detyrë:**

____________________________

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

____________________________

# Mësimi 129

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Kundrinori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2. 3; II. 4; III. 2. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2, 4


*Detyrë:*

*Te fjalitë e mësipërme, trego cilat janë kryefjala dhe kallëzuesi.*

*Fjalia 1:*
*Kryefjala __________ kallëzuesi __________*

*Fjalia 2:*
*Kryefjala __________ kallëzuesi __________*

*Fjalia 3:*
*Kryefjala __________ kallëzuesi __________*

*Mund të vëreni se te këto fjali kanë mbetur disa fjalë që nuk janë as kryefjalë e as kallëzues.* ***Cilat janë ato fjalë?***

*Fjalia 1: __________*
*Fjalia 2: __________*
*Fjalia 3: __________*

*Eh, këto fjalë janë kundrinorë në fjalitë e tyre.*

**Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë**

Kundrinori (kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, kundrinori i zhdrejtë me parafjalë), ndryshe nga gjymtyrët kryesore: kryefjala dhe kallëzuesi, trajtohet si gjymtyrë e dytë, sepse funksioni i tij në fjali varet nga gjymtyra kryesore, kallëzuesi, ose nga gjymtyrët e tjera të fjalisë. Kundrinori i plotëson gjymtyrët e tjera të fjalisë në strukturë dhe kuptim (semantikë). Prandaj, llogaritet si plotës kryesor në fjali dhe shpesh nuk mund të hiqet nga fjalia, sepse nga ana kuptimore fjalia del e paqartë. P.sh.

120

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kundrinori i drejtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kundrinorin e drejtë në fjali;
- Tregon me se shprehet kundrinori i drejtë;
- Shkruan fjali me kundrinorin e drejtë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazike

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Mësimdhënësi drejton pyetjet:
- Ç’janë kundrinorët?
- Cilat janë llojet e tyre?
- Kë plotësojnë kundrinorët?
Disa nga përgjigjet që mund të jenë:
Kundrinorët plotësojnë foljet.
Janë gjymtyrë plotësuese të foljes.
Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit ta lexojnë njësinë faqe 120 dhe 121.



Djali e takoi shokun

kryefjalë kallëzues kundrinor i drejtë

***Si ta dimë kundrinorin?***

— *Kundrinori, në sintaksë, përbën:*

- *Objektin që e merr veprimin e drejtpërdrejtë të foljes (kallëzuesit të fjalisë), për shembull:*
  *Djali e takoi **shokun.** (kundrinor i drejtë).*
- *Objektin që është përfituesi i veprimit që shprehet prej foljes (kallëzuesit), për shembull:*

*Ia dhamë dhuratën **djalit.** (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë)*
*Diskutuam deri vonë **për mësimet.** (kundrinor i zhdrejtë me parafjalë)*

*a) Për ta gjetur kundrinorin e drejtë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës **kë?, cilin? cilën? cilat?, cilët?** P.sh.*

*Djali e takoi **shokun** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kë:** Kë e takoi djali? - **Shokun.***

*b) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës **kujt? cilit? cilës? cilave?, cilëve?** P.sh.*

*Ia dhamë dhuratën **djalit** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kujt:** Kujt ia dhamë dhuratën? - **Djalit.***

*c) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, bëjmë pyetje sipas modelit: parafjalë + përemër pyetës, si: **me kë? prej kujt? për kë? nga kush?** etj. P.sh.*

*Diskutuam **për mësimet** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kë me parafjalë:** Për kë diskutuam? - **Për mësimet.***

121

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pema e mendimeve*

Derisa nxënësit e lexojnë njësinë në faqe 121 dhe 122 me theks te kundrinori i drejtë, mësimdhënësi shënon në tabelë disa pyetje rreth kundrinorit.
Si e gjejmë në fjali?
Cili është roli i tij?
Cili është vendi i tij në fjali?
Me çka shprehet?
Mësimdhënësi bashkë me nxënësit e plotësojnë pemën e mendimeve duke iu përgjigjur pyetjeve, por edhe duke shtuar të dhëna të tjera nga nxënësit dhe duke i marrë shpjegimet e nevojshme nga mësimdhënësi.




**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Shkruajnë fjali duke i përdorur kundrinorët e drejtë. Mësimdhënësi i vëzhgon.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të funksionit të kundrinorit nga funksionet e tjera dhe të përdorimit të tij.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 130

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Kundrinori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2. 3; II. 4; III. 2. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2, 4


**Detyrë:**

*Te fjalitë e mësipërme, trego cilat janë kryefjala dhe kallëzuesi.*

*Fjalia 1:*
*Kryefjala ________ kallëzuesi ________*

*Fjalia 2:*
*Kryefjala ________ kallëzuesi ________*

*Fjalia 3:*
*Kryefjala ________ kallëzuesi ________*

*Mund të vëreni se te këto fjali kanë mbetur disa fjalë që nuk janë as kryefjalë e as kallëzues.* ***Cilat janë ato fjalë?***

*Fjalia 1: ________*
*Fjalia 2: ________*
*Fjalia 3: ________*

*Eh, këto fjalë janë kundrinorë në fjalitë e tyre.*

**Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë**

Kundrinori (kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, kundrinori i zhdrejtë me parafjalë), ndryshe nga gjymtyrët kryesore: kryefjala dhe kallëzuesi, trajtohet si gjymtyrë e dytë, sepse funksioni i tij në fjali varet nga gjymtyra kryesore, kallëzuesi, ose nga gjymtyrët e tjera të fjalisë. Kundrinori i plotëson gjymtyrët e tjera të fjalisë në strukturë dhe kuptim (semantikë). Prandaj, llogaritet si plotës kryesor në fjali dhe shpesh nuk mund të hiqet nga fjalia, sepse nga ana kuptimore fjalia del e paqartë. P.sh.

120

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kundrinori i drejtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen kundrinorin e drejtë në fjali;
- Tregon me se shprehet kundrinori i drejtë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësit i përsëritin pyetjet e kundrinorit të drejtë në formë të lojës. Një nxënës e përmend njërin nga përemrat pyetës, tjetri në vazhdim e krijon një pyetje me atë përemër, kurse i fundit i përgjigjet pyetjes së shokut.
Shembull.
Nxënësi A: Kë?
Nxënësi B: Kë takove?
Nxënësi C: Takova mikun.
Kështu vazhdon derisa secili nxënës merr pjesë në aktivitet.



Djali e takoi shokun

kryefjalë kallëzues kundrinor i drejtë

**Si ta dimë kundrinorin?**

— Kundrinori, në sintaksë, përbën:

- Objektin që e merr veprimin e drejtpërdrejtë të foljes (kallëzuesit të fjalisë), për shembull:
  Djali e takoi **shokun.** (kundrinor i drejtë).
- Objektin që është përfituesi i veprimit që shprehet prej foljes (kallëzuesit), për shembull:

Ia dhamë dhuratën **djalit.** (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë)
Diskutuam deri vonë **për mësimet.** (kundrinor i zhdrejtë me parafjalë)

a) Për ta gjetur kundrinorin e drejtë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës **kë?, cilin? cilën? cilat?, cilët?** P.sh.

Djali e takoi **shokun** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kë:** Kë e takoi djali? - **Shokun.**

b) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës **kujt? cilit? cilës? cilave?, cilëve?** P.sh.

Ia dhamë dhuratën **djalit** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kujt:** Kujt ia dhamë dhuratën? - **Djalit.**

c) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, bëjmë pyetje sipas modelit: parafjalë + përemër pyetës, si: **me kë? prej kujt? për kë? nga kush?** etj. P.sh.

Diskutuam **për mësimet** - bëjmë pyetje me përemrin pyetës **kë me parafjalë:** Për kë diskutuam? - **Për mësimet.**

121

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Të nxënët në grupe*

Nxënësit ndahen në grupe dhe zgjedhin një fragment leximi brenda librit të gjuhës shqipe, ku brenda atij fragmenti ata i gjejnë kundrinorët e drejtë dhe tregojnë me çfarë janë shprehur.

Pasi të përfundojnë grupet, i shkëmbejnë detyrat me njëri-tjetrin.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë në grupe*

Grupet i lexojnë tekstet e tyre duke i dalluar kundrinorët.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të kundrinorit.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 131

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Kundrinori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2. 3; II. 4; III. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2, 4


*Djali e takoi shokun*

kryefjalë — kallëzues — kundrinor i drejtë

***Si ta dimë kundrinorin?***

— *Kundrinori, në sintaksë, përbën:*

- *Objektin që e merr veprimin e drejtpërdrejtë të foljes (kallëzuesit të fjalisë), për shembull:*
  *Djali e takoi* ***shokun.*** *(kundrinor i drejtë).*
- *Objektin që është përfituesi i veprimit që shprehet prej foljes (kallëzuesit), për shembull:*

*Ia dhamë dhuratën* ***djalit.*** *(kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë)*
*Diskutuam deri vonë* ***për mësimet.*** *(kundrinor i zhdrejtë me parafjalë)*

*a) Për ta gjetur kundrinorin e drejtë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës* ***kë?, cilin? cilën? cilat?, cilët?*** *P.sh.*

*Djali e takoi* ***shokun*** *- bëjmë pyetje me përemrin pyetës* ***kë:*** *Kë e takoi djali? -* ***Shokun.***

*b) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, bëjmë pyetje me përemrat pyetës* ***kujt? cilit? cilës? cilave?, cilëve?*** *P.sh.*

*Ia dhamë dhuratën* ***djalit*** *- bëjmë pyetje me përemrin pyetës* ***kujt:*** *Kujt ia dhamë dhuratën? -* ***Djalit.***

*c) Për ta gjetur kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, bëjmë pyetje sipas modelit: parafjalë + përemër pyetës, si:* ***me kë? prej kujt? për kë? nga kush?*** *etj. P.sh.*

*Diskutuam* ***për mësimet*** *- bëjmë pyetje me përemrin pyetës* ***kë me parafjalë:*** *Për kë diskutuam? -* ***Për mësimet.***

121

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kundrinori i zhdrejtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kundrinorin e zhdrejtë në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompjuter, projektor

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*
Mësimdhënësi i drejton pyetjet:
Me cilën pyetje e gjejmë kundrinorin e zhdrejtë?
Pse e përdorim?
Cilat janë llojet e tij?
Disa nga përgjigjet:
Kundrinorin e zhdrejtë e gjejmë me pyetjet, si: kujt, cilës, cilit etj.
E përdorim për t'i plotësuar gjymtyrët kryesore.
Me parafjalë dhe paparafjalë.
Mësimdhënësi ua shpjegon rëndësinë e kundrinorit të zhdrejtë, përdorimin dhe me çka shprehet ai.



Me cilat pjesë të ligjëratës shprehet kundrinori në fjali? (Shih tabelën e mëposhtme.)

| *Kundrinori i drejtë në gjuhën shqipe shprehet me:* | *Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe shprehet me:* | *Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe shprehet me:* |
|---|---|---|
| • Një emër në trajtën e shquar në rasën kallëzore pa parafjalë:<br>Djali e takoi **shokun**. | • Një emër në trajtën e shquar në rasën dhanore:<br>I dhamë dhuratën **djalit**. | • Një emër në trajtën e shquar në rasën kallëzore me parafjalë:<br>Djali u takua **me shokun**. |
| • Një emër në trajtën e pashquar në rasën kallëzore pa parafjalë:<br>E kënduam **një këngë**. | • Një emër në trajtën e pashquar në rasën dhanore:<br>I dhamë dhuratën një **djali**. | • Një emër në trajtën e pashquar në rasën kallëzore me parafjalë:<br>Djali u takua **me një shok**. |
| • Një përemër në rasën kallëzore:<br>**Cilin** do ta takojmë? | • Një përemër në rasën dhanore:<br>**Cilit** do t'ia japim dhuratën? | • Një përemër në rasën kallëzore me parafjalë:<br>**Për cilën** do të flasim? |
| • Një pjesë të emërzuar të ligjëratës në rasën kallëzore:<br>I uruam **mirëseardhjen**. | • Një pjesë të emërzuar të ligjëratës në rasën dhanore:<br>**Pse-ve** të tij iu përgjigjëm me argumente. | • Një pjesë të emërzuar të ligjëratës në rasën kallëzore:<br>I treguam **për pesat** që kishin marrë. |
| • Me një grup emëror të pandashëm:<br>E njoftuam **ministren e Punëve të Brendshme**. | • Me një grup emëror të pandashëm:<br>I telefonuam **ministres së Punëve të Brendshme**. | |

***Ku vendoset kundrinori në fjali?***

Të gjitha llojet e kundrinorit (kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë, kundrinori i zhdrejtë me parafjalë) mund të vendosen para ose pas kallëzuesit të fjalisë, për shembull:

- *Djali e takoi **shokun.** (pas kallëzuesit)*
- ***Cilin** do ta takojmë? (para kallëzuesit)*

***Pyetje:***

- *Çka është kundrinori?*
- *Si e gjejmë kundrinorin në fjali?*
- *Me çka shprehet kundrinori i drejtë?*
- *Me çka kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë?*
- *Dhe me çka kundrinori i zhdrejtë me parafjalë?*

Shih fletoren e punës

122

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari në dyshe*

Nxënësit e rilexojnë njësinë në faqe 121 dhe 122 ku vëmendje i kushtojnë kundrinorit të zhdrejtë.

Pas leximit i shkruajnë dallimet në mes të kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë dhe me parafjalë si dhe kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit i lexojnë dallimet që kanë hasur në mes të kundrinorëve dhe mësimdhënësi i shkruan në tabelë. Gjatë kësaj kohe, mësimdhënësi dhe nxënësit diskutojnë nëse kanë paqartësi.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të funksionit të kundrinorit të zhdrejtë në fjali.

**Detyrë:**
(Pyetje faqe 122)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 132

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Kundrinori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon kryefjalën, kallëzuesorin e kryefjalës, kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2. 3; II. 4; III. 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2, 4


njësia 30
KUNDRINORI

**Pyetje**

1. Pse kundrinori trajtohet si gjymtyrë e dytë?
2. Cilën gjymtyrë të fjalisë e plotëson kundrinori?
3. Në cilën rasë duhet të jetë emri për të funksionuar si kundrinor i drejtë?
4. Në cilën rasë duhet të jetë emri për të funksionuar si kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë?
5. Me cilin përemër pyetës mund të gjendet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në fjali?

**Detyrë**

◇ Gjeni kundrinorët në fjalitë më poshtë dhe thoni llojin e tyre:

a. Arta e ftoi Artanin për të vallëzuar.
b. Atë natë biseduan për poezinë.
c. Vajzës i pëlqen të bëhet pilote.
d. Cilën lojë do ta luajmë?

◇ Kryefjalën e fjalisë më poshtë kthejeni në kundrinor të drejtë:

Arta e ftoi Artanin për të vallëzuar.

◇ Ktheni në trajtën e duhur fjalët në kllapa dhe tregoni funksionin e tyre:

a. I binte (fyelli)...............
b. E lexonte (gazetë)...............
c. Nuk e njohu (asaj)...............
d. Më fliste (për plane)...............

67

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kundrinori i zhdrejtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kundrinorin e zhdrejtë nga kundrinori i drejtë;
- Shkruan fjali me kundrinorët.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazike

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë individuale*

Nxënësit plotësojnë fletore pune faqe 67 dhe 68.



◇ Tregoni në cilën rasë janë fjalët e nënvizuara:

**Asaj** i erdhi keq.

**Këtë** nuk e kuptova kurrë.

Kishte harruar **librin.**

◇ Shikoni në fjalor nga tri fjalë të reja që fillojnë me shkronjat **s, sh, t, th**. Tregojuani kuptimet e atyre fjalëve shokëve e shoqeve në klasë.

njësia 31

RRETHANORI

**Pyetje**

1. A është rrethanori plotës kryesor në fjali? Pse trajtohet si gjymtyrë e dytë?
2. Çka tregon rrethanori i vendit dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?
3. Çka tregon rrethanori i kohës dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?
4. Çka tregon rrethanori i shkakut dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?

**Detyrë**

◇ Thoni llojin e rrethanorëve të nënvizuar në fjalitë më poshtë:

a. Sot, në kinemanë e qytetit do të shfaqet një film i ri.
b. U rrëzua nga moskujdesi, para shkollës së tij.
c. Në orën e parë të mësimit u dëgjua një britmë nga jashtë.
d. Përse nuk i flet asaj, sot?
e. Paradite do të shkojmë në Gërmi.
f. Ushtronte përskaj lumit çdo mëngjes.

68



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit i lexojnë detyrat e plotësuara. Përmirësohen gabimet që mund të kenë ndodhur.



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë në grupe*

Nxënësit të ndarë në grupe krijojnë fjali me dy llojet e kundrinorëve. Mësimdhënësi vendos një kohë të caktuar për përfundimin e detyrës. Grupi që ka krijuar më së shumti fjali e fiton garën. Nxënësit fitues i lexojnë fjalitë e krijuara.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të funksionit të kundrinorit të zhdrejtë nga ai i drejtë dhe të përdorimit të tij.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 133

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Zhanret dhe kategoritë letrare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.



## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lektyrë shkollore "Luli i vocërr" nga Migjeni (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për jetën dhe veprën e Migjenit;
- Dallon skicën nga llojet e tjera letrare;
- Bën përmbledhjen e tregimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Shtrohen pyetjet:
- Çfarë dimë për tregimin dhe novelën? (njohuri të marra disa orë më parë)
- Për skicën i jep shpjegimet mësuesi.
- Plotësohet skema.



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-diskuto*

Një nxënës flet për jetën dhe veprën e Migjenit.
Dikush e lexon përmbledhjen e tregimeve sipas pikave të planit.
Nxënësve u drejtohen pyetjet:

- Cili e ka bërë ndryshe këtë pikë të punës me shkrim?
- Çfarë nuk ka trajtuar mirë shoku (shoqja) në përmbajtjen e tregimeve?

Përfshihen në diskutim sa më shumë nxënës të niveleve të ndryshme. Pjesëmarrja e sa më shumë nxënësve të niveleve të ndryshme në diskutim, tregon edhe nivelin e leximit të veprës nga nxënësit, i cili relativisht mund të jetë "Dobët", "Mirë" dhe "Shumë mirë".
Pas përmbledhjes bëhet analiza e strukturës së tregimeve, duke pyetur për: hyrjen, zhvillimin, pikën kulminante, zgjidhjen dhe mbylljen. Analiza e personazheve mund të tregohet nga mësuesi, cilësitë fizike dhe morale të një personazhi dhe, nxënësit duhet të përcaktojnë se për cilin personazh bëhet fjalë. Pyeten nxënësit:

- A keni në klasën tuaj persona të tillë?
- Cili personazh ju ka pëlqyer më shumë?
- Merren sa më shumë përgjigje nga nxënësit. Bëhet diskutimi i përgjigjeve.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim*

A ju pëlqeu vepra?
Pse?
Cili tregim ishte më i pëlqyeri?

**Vlerësimi i nxënësve:**

Bëhet në orën tjetër.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 134

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Proza

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3, 4, 5; II. 1, 2, 3; III. 3, 5, 7, 8
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 3, 4; 2. 1, 2, 4; 3. 1, 2, 4.



## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lektyra "Luli i vocërr" (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Analizon personazhet, cilësitë fizike e morale;
- Zbulon problematikat që trajtohen në vepër;
- Shpreh mesazhet e veprës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pyetja e ditës*

Cili problem i shoqërisë duhet të trajtohet sot?
Nxënësit japin përgjigje. Disa prej tyre shkruhen në tabelë.



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dëgjo-analizo*

Kërkohet nga nxënësit që duke u mbështetur te fletorja e punës t'i shprehin me shkrim problematikat që janë trajtuar në këtë vepër.
Disa problematika shkruhen në tabelë.

Shprehje dhe thënie që ju kanë bërë më shumë përshtypje - lexojnë nxënësit nga fletorja.
Mesazhet që transmeton vepra.
Ua drejtoj nxënësve pyetjen:
- Cilat janë mesazhet që përcjell vepra?
Merren sa më shumë përgjigje nga ta.
Pas diskutimit, disa mesazhe shkruhen në tabelë:

Çfarë do të donit të ishte ndryshe në tregime dhe pse?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Turi i galerisë*

Udhëzohen nxënësit ta paraqesin me vizatim njërin nga tregimet e veprës në një fletë A4.
Punimet e tyre vendosen në muret e klasës.

**Vlerësimi i nxënësve:**

A - Notë për përgjigjet me gojë të nxënësve gjatë aktivizimit të dy orëve mësimore, të cilat mbahen të shënuara në fletore për çdo nxënës. B - Nota për vlerësimin e punës me shkrim në fletoren e çdo nxënësi, të cilën mësuesi e mbledh në fund të orës së dytë për korrigjimin dhe vlerësimin e tyre me notë. Nota përfundimtare (mesatarja e notës me gojë dhe punës me shkrim) vendoset në regjistër.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 135

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 33

RRETHANORI

PREMTIMET E PAPËRMBUSHURA TË BART SIMPSONIT

Shoku im i klasës, Barti, është trazovaç i madh. Ai gjithnjë bën sherre. Sa herë që e bën një sherr, mësuesja e detyron ta shkruajë në tabelë premtimin se nuk do ta bëjë më atë sherr. Deri tash është mbushur një listë e tërë me premtimet e Bartit.

Ja lista

1. Nuk do të gogësij më në orë të mësimit, përveç nëse vërtet nuk mund të përmbahem.
2. Në mbledhje të prindërve do ta thërras babanë, e jo xhaxhanë tim shurdhan.
3. Nuk do të luaj kot në kabinetin e fizikës.
4. Nuk do t'i shes dy ari, në anën e majtë të oborrit të shkollës.
5. Nuk do të gënjej se nuk do të mbahet mësimi nesër.
6. Nuk do të sjell merimanga në klasë.
7. Nuk do t'ia fsheh fshesën nën shkallë pastruesit Halim.
8. Nuk do të jap në klasë premtime që nuk mund t'i përmbush.
9. Këtë herë njëmend do ta përmbush premtimin e dhënë.
10. Vërtet, vërtet, tash e tutje nuk do ta thyej fjalën e dhënë.

123

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon rrethanorin e vendit, të kohës, të shkakut si dhe përcaktorin dhe ndajshtimin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 4, 7; III. 1, 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 8; 2. 2, 7; 3. 1, 3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon rrethanorët në fjali, duke përdorur pyetje përkatëse;
- Identifikon llojin e rrethanorëve se me çka janë shprehur në fjali.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Teknika e pyetjeve*

Parashtrohen pyetjet për nxënësit:
- Çka janë rrethanorët?
- Me cilat pyetje gjenden?
- Cilat janë llojet e rrethanorëve?
- Çfarë roli luajnë në fjali?

Nga përgjigjet e nxënësve krijohen organizuesit grafikë për rrethanorët.



**Diskutojmë:**

- Si ju duket sjellja e Bartit?
- Si duhet të sillen nxënëset dhe nxënësit në shkollë?

**Detyrë:**

- Lexojini edhe një herë të gjitha premtimet e Bartit. Kërkoni brenda tyre nëse ka fjalë ose grupe fjalësh që u përgjigjen pyetjeve **ku**, **kur** dhe **përse**.
- Shënojini fjalët që janë përgjigje të këtyre pyetjeve.

***Bashkëbisedojmë:***

*Rrethanori i vendit, i kohës, i shkakut*

*Rrethanori është një fjalë ose një grup fjalësh që përcjell informacion shtesë në fjali për të treguar: **ku, kur** dhe **pse** ndodh diçka. Rrethanori si gjymtyrë e dytë në fjali varet nga folja dhe mbiemri, pra shton informacion në lidhje me fjalët, si mbiemri e folja. Prandaj, është element jo i detyrueshëm, pasi mund të hiqet nga struktura e fjalisë pa e prishur kuptimin. P.sh.*

- ***Dje** u takuam me Lumin. (rrethanor i kohës) / U takuam me Lumin.*
- *U takuam me Lumin **pranë shtëpisë së tij**. (rrethanor i vendit) / U takuam me Lumin.*
- *Rruga nuk shihej nga **mjegulla.** (rrethanor i shkakut) / Rruga nuk shihej.*

*Rrethanori i kohës, në fjali, **tregon**:*

- ***Kohën** e shfaqjes së veprimit të caktuar dhe gjendet në fjali me pyetjen **kur**? P.sh.*
  *Fëmijët shkuan **në mëngjes**-bëjmë pyetje me ndajfoljen pyetëse **kur**: Kur shkuan fëmijët? - Në mëngjes.*

124

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexo-diskuto*

Mësimdhënësja ua lexon nxënësve pjesën e tekstit “Premtimet e papërmbushura” të Bart Simsonit dhe listën e gabimeve që bën Barti në shkollë, ku mësuesja e detyron ta shkruajë gabimin në tabelë sa herë e bën.
Ja që lista ishte mbushur.
Nxënësit pyeten:
Si ju duket sjellja e Bartit?
Si duhet të sillen nxënësit në shkollë?
Nxënësve u kërkohet ta shikojnë listën e gabimeve dhe të gjejnë brenda tyre fjalë ose grupe fjalësh që u përgjigjen pyetjeve ku, kur dhe përse.
Duhet të shënohen fjalët që janë përgjigje të këtyre pyetjeve.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Nxënësit i lexojnë fjalitë dhe duke lexuar i nënvizojnë fjalët me viza që u përgjigjen pyetjeve për rrethanorët.
Nxënësit vazhdojnë me fjali që mund t’i krijojnë edhe vetë.
Diskutojnë për zgjidhjet që kanë bërë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për dallimin e rrethanorëve dhe identifikimin e llojeve të tyre në fjali.

**Detyrë:**
(Shkruaj pesë fjali dhe dallo rrethanorët)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 136

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon rrethanorin e vendit, të kohës, të shkakut si dhe përcaktorin dhe ndajshtimin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 4; III. 1, 4.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 8; 2. 7; 3. 1, 3.


*Diskutojmë:*

- Si ju duket sjellja e Bartit?
- Si duhet të sillen nxënëset dhe nxënësit në shkollë?

*Detyrë:*

- Lexojini edhe një herë të gjitha premtimet e Bartit. Kërkoni brenda tyre nëse ka fjalë ose grupe fjalësh që u përgjigjen pyetjeve **ku**, **kur** dhe **përse**.
- Shënojini fjalët që janë përgjigje të këtyre pyetjeve.

***Bashkëbisedojmë:***

*Rrethanori i vendit, i kohës, i shkakut*

*Rrethanori është një fjalë ose një grup fjalësh që përcjell informacion shtesë në fjali për të treguar: **ku, kur** dhe **pse** ndodh diçka. Rrethanori si gjymtyrë e dytë në fjali varet nga folja dhe mbiemri, pra shton informacion në lidhje me fjalët, si mbiemri e folja. Prandaj, është element jo i detyrueshëm, pasi mund të hiqet nga struktura e fjalisë pa e prishur kuptimin. P.sh.*

- ***Dje** u takuam me Lumin. (rrethanor i kohës) / U takuam me Lumin.*
- *U takuam me Lumin **pranë shtëpisë së tij**. (rrethanor i vendit) / U takuam me Lumin.*
- *Rruga nuk shihej nga **mjegulla.** (rrethanor i shkakut) / Rruga nuk shihej.*

*Rrethanori i kohës, në fjali, **tregon**:*

- ***Kohën** e shfaqjes së veprimit të caktuar dhe gjendet në fjali me pyetjen **kur**? P.sh.*
  *Fëmijët shkuan **në mëngjes**-bëjmë pyetje me ndajfoljen pyetëse **kur**: Kur shkuan fëmijët? - Në mëngjes.*

124

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon rrethanorët në fjali të ndryshme;
- Ndan llojet e tyre sipas rregullave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë qytetare, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Pema e mendjes*

Nxënësit i lexojnë përgjigjet e dhëna nga detyra e shtëpisë dhe ndërkohë ato lidhen me vazhdimin e rrethanorëve. Rethanori si gjymtyrë e dytë e fjalisë që është element jo i detyrueshën në fjali mund të hiqet dhe nuk e prish kuptimin e fjalisë.
*Dje* u takuam me Lumin.
U takuam me Lumin *pranë shtëpisë së tij.*
Rruga nuk shihej *nga mjegulla.*
Nxënësit i japin përgjigjet e duhura dhe mësimdhënësja i shkruan ato në formë të pemës.



***Rrethanori i kohës në gjuhën shqipe shprehet me:***

– *Ndajfolje ose lokucion ndajfoljor kohe:*

- ***Sot*** *na lajmëruan.* ***Nesër*** *do të mbahet ceremonia.*
- ***Natë për natë*** *ëndërronte syhapur.*

– *Emër ose grup emëror me ose pa parafjalë:*

- ***Në verë*** *shkojmë në pishinë.*
- *U nisën* ***natën.***

– *Forma të pashtjelluara të foljes:*
- *Do të shkojmë* ***pa gdhirë.***

***Rrethanori i vendit,*** *në fjali, tregon:*

– ***Vendin*** *ku ndodh një veprim i caktuar dhe gjendet me pyetjen* ***ku****? Për shembull:*
*Fëmijët shkuan* ***në shkollë*** *- bëjmë pyetje me ndajfoljen pyetëse* ***ku****: Ku shkuan fëmijët? - Në shkollë.*

***Rrethanori i vendit në gjuhën shqipe shprehet me:***

– *Ndajfolje ose lokucion ndajfoljor vendi:*
*Eja* ***këtu****! Ku po shkon?*
***Aty-këtu*** *kishin mbetur ca copëza të saj.*

– *Emër me ose pa parafjalë:*
***Pranë shtëpisë*** *është një lumë.*
***Maleve*** *bie borë.*

– *Përemër me parafjalë:*
*Macja fshihet* ***pas tij****.*

– *Grup emëror me parafjalë:*
***Në dhomën e saj*** *ishte pianoja.*

***Rrethanori i shkakut, në fjali, tregon:***

– ***Shkakun*** *ose motivin e veprimit që ndodh dhe gjendet me pyetjen* ***pse****? Për shembull:*

*Rruga nuk shihej* ***nga mjegulla*** *- bëjmë pyetje me ndajfoljen pyetëse* ***pse****:*
*Pse nuk shihej rruga? - Sepse ishte mjegull.*

***Rrethanori i shkakut në gjuhën shqipe shprehet me:***

– *Ndajfolje:*
- ***Përse*** *pushoi kënga?*

– *Emër ose grup emëror me parafjalë ose lokucione parafjalore:*
- *U gëzova* ***për suksesin tënd****.*

– *Grup fjalësh:*
- *Ai u prek* ***nga këto fjalë****.*

Shih fletoren e punës

125

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Të nxënët në grupe*

Nxënësit ndahen në tri grupe.
Grupi A - lexon rrethanorin e vendit, karakteristikat kryesore dhe shembujt e ndryshëm.
Grupi B - lexon rrethanorin e kohës, karakteristikat kryesore dhe shembujt e ndryshëm.
Grupi C - lexon rrethanorin e shkakut, karakteristikat kryesore dhe shembujt e ndryshëm.
Pas punimit të detyrës, nxënësit diskutojnë dhe i kompletojnë përgjigjet e tyre.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Stilolapsat në mes*

Nxënësit përgjigjen pasi e kanë përfunduar pjesën e leximit, të diskutimit dhe të nxjerrjes së karakteristikave kryesore të tri llojeve të rrethanorëve.
Stilolapsat vendosen në mes të tavolinës dhe, stilolapsin e ndonjërit që e merr mësuesja, ai nxënës përgjigjet.
Të tjerët mund të shtrojnë pyetje për informacionet që u interesojnë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të rrethanorëve dhe dallimit të tyre nga njëri-tjetri.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 137

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon rrethanorin e vendit, të kohës, të shkakut si dhe përcaktorin dhe ndajshtimin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 3; II. 4, 7; III. 1, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1, 8; 2. 2, 7; 3. 1, 3.



*Tregoni në cilën rasë janë fjalët e nënvizuara:*

***Asaj*** *i erdhi keq.*

***Këtë*** *nuk e kuptova kurrë.*

*Kishte harruar* ***librin.***

*Shikoni në fjalor nga tri fjalë të reja që fillojnë me shkronjat* ***s, sh, t, th****. Tregojuani kuptimet e atyre fjalëve shokëve e shoqeve në klasë.*

njësia 31
RRETHANORI

***Pyetje***

1. *A është rrethanori plotës kryesor në fjali? Pse trajtohet si gjymtyrë e dytë?*
2. *Çka tregon rrethanori i vendit dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?*
3. *Çka tregon rrethanori i kohës dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?*
4. *Çka tregon rrethanori i shkakut dhe me cilën pjesë të ligjëratës shprehet?*

***Detyrë***

*Thoni llojin e rrethanorëve të nënvizuar në fjalitë më poshtë:*

*a. Sot, në kinemanë e qytetit do të shfaqet një film i ri.*
*b. U rrëzua nga moskujdesi, para shkollës së tij.*
*c. Në orën e parë të mësimit u dëgjua një britmë nga jashtë.*
*d. Përse nuk i flet asaj, sot?*
*e. Paradite do të shkojmë në Gërmi.*
*f. Ushtronte përskaj lumit çdo mëngjes.*

68

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Rrethanori i vendit, i kohës dhe i shkakut (ora III)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon rrethanorët në fjali;
- Zbaton llojet e rrethanorëve në fjali të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** mjetet e shkrimit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Nxënësve u shtrohet pyetja: Me cilën pjesë të ligjëratës shprehen rrethanorët?
Nxënësit nxiten për përgjigje të sakta.
Disa prej tyre japin edhe shembuj në tabelë.



◇ Hiqni të gjithë rrethanorët në fjalitë më poshtë dhe tregoni nëse u ndërrohet kuptimi fjalive:

Dje, në mëngjes, u rrëzova.
Nuk kishte guxim të më ndiqte, nga frika.
Nën libër është lapsi.

◇ Ndërtoni nga dy fjali që përmbajnë rrethanorë kohe, vendi dhe shkaku.

njësia 32
PËRCAKTORI

Pyetje

1. Me cilën gjymtyrë të fjalisë lidhet përcaktori?
2. Pse përcaktorët trajtohen si gjymtyrë të dyta?
3. Si gjendet përcaktori në fjali?
4. Sa lloje të përcaktorëve kemi?
5. Çka është ndajshtimi?

Ushtrime

◇ Gjeni përcaktorët në fjalitë më poshtë:

a. E Bukura e Dheut doli nga liqeni.
b. E di vlerën time. E shfrytëzoj fuqinë time.
c. Duhen vite për ta gjetur zërin tënd dhe vlerën tënde.
d. Ka dy lloje të fuqive në botë, njëra është shpata dhe tjetra është lapsi.

69

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Analizo-plotëso*

Nxënësit përgjigjen për pyetjet rreth rrethanorit ku përmes këtyre pyetjeve i shpalosin njohuritë bazë për rrethanorin.
Pyetjen e bën mësimdhënësi dhe merr dy përgjigje nga dy nxënës. Cili e ka përgjigjen e saktë duartrokitet nga shokët.
Kështu, vazhdohet me katër pyetjet.
Nxënësit udhëzohen që ushtrimin e radhës ta plotësojnë duke e dalluar llojin e rrethanorit.
Psh.: *Paradite* do të shkojmë *në Gërmi.*
Vazhdohet edhe me ushtrimin e fundit ku kërkohet të hiqen të gjithë rrethanorët dhe të tregohet nëse i ndërron kuptimi fjalisë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim në dyshe*

Nxënësit udhëzohen që punën e tyre ta prezantojnë te njëri-tjetri dhe të diskutojnë për zgjidhjet e tyre.
Ata mund edhe ta pyesin shokun apo shoqen si ka ardhur deri te zgjidhja e ushtrimit të fundit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të rrethanorëve të kohës, të vendit dhe të shkakut, dhe identifikimit të tyre në fjali.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 138

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Përcaktori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon përcaktorin nga gjymtyrët e tjera të fjalisë. Mëson që është gjymtyrë e dytë e fjalisë dhe e plotëson një gjymtyrë emërore të fjalisë. Identifikon mjetet gjuhësore me të cilat shprehet përcaktori në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2, III: 5. 6
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



njësia 34
PËRCAKTORI

*Jetoj brenda syve **të tu**,*
*në sytë **e mi** ti ke*
*shtëpinë.*

*Fjalët e **hijezuara** funksionojnë si përcaktorë të emrave të nënvizuar. Ato e saktësojnë, e sqarojnë dhe e përcaktojnë emrin **sy**, në këtë rast. Pra, varen drejtpërdrejt prej tij, duke u përshtatur me rasën në të cilën shfaqet emri. Dhe po të hiqet ky emër nga struktura, përcaktorët nuk kanë kuptim si të vetëm pa emrin që e përcaktojnë, prandaj bëjnë pjesë në gjymtyrët e dyta.*

*Përcaktori shprehet me: emër, mbiemër dhe përemër. Emri në rasën gjinore është gjithmonë në funksionin e përcaktorit.*

*Përcaktori në fjali e përcakton një emër ose një gjymtyrë emërore, duke treguar cilësi të gjymtyrës që përcakton. Në fjali u përgjigjet pyetjeve: **ç'?, i/e kujt?, sa?** Varësisht nga lidhja sintaksore me të cilën lidhet përcaktori me emrin, kemi disa lloje të përcaktorëve: përcaktori **me përshtatje** përcaktori **me drejtim**, përcaktori **me bashkim** dhe **ndajshtimi**.*

***Përcaktori me përshtatje***

*Përcaktori me përshtatje shprehet me mbiemër, me përemër dhe me numërorët tre/tri, të dy, të tre etj. Për shembull:*

- *Papritur dëgjova një zhurmë **të pazakontë** te shkëmbi. (me mbiemër)*
- *Përroi malor oshëtinte mbi kokat **tona**. (me përemër)*
- *Ne **të tre** u nisëm sërish nëpër labirintet e galerisë. (me numëror)*

***Përcaktori me drejtim***

*Përcaktori me drejtim shprehet me emër në rasat gjinore, rrjedhore e kallëzore pa parafjalë dhe në rasat emërore, kallëzore e rrjedhore me parafjalë. P.sh.*

- *Vetëm gurgullima **e ujit** më freskoi.*
- *Dora qe nxirë me pluhur **qymyrguri**.*
- *Lufta **kundër krimit** s'duhet ndalur asnjë çast.*

126

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përcaktori

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon përcaktorin nga llojet e tjera;
- Dallon llojet e përcaktorit;
- Gjen përcaktorin në tekst.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Loja në grupe*

Nxënësit do të ndahen në grup, në bazë të numrit të nxënësve aq grupe do të bëhen.
Fillimisht, nuk do të njoftohen me njësinë e re, por përmes lojës në grupe do ta kuptojnë për çfarë njësie do të flitet sot.

Nxënësit do të bëjnë pyetje për njëri-tjetrin me format pyetëse *i/e kujt.*
Nëpërmes kësaj loje nxënësi e kupton më lehtë funksionin e përcaktorit.



***Përcaktori me bashkim***

- *Përcaktori me bashkim shprehet me përemra të palakueshëm, me numërorë, me forma foljore të pashtjellueshme dhe me ndajfolje. P.sh.*

◇ ***Çfarë*** *njeriu ishte!*
◇ ***Katër*** *vajza ndodheshin në veturë.*
◇ *Ideja* ***për t'u kthyer*** *si më parë ishte e rrezikshme.*
◇ *Kënga* ***kushtuar*** *Nënë Terezës është e mahnitshme.*

***Ndajshtimi***

- *Ndajshtimi përcakton një emër a përemër vetor duke u përshtatur me të vetëm në numër. P.sh.*

◇ *Vinte nga shteti* ***mik.***
◇ *Vinin nga shtetet* ***mike****.*

- *Ndajshtimi shprehet me një emër të pashquar në formën e rasës emërore - kallëzore. P.sh.*

◇ *Lumi* ***Drin*** *vizitohet nga shumë turistë.*

*Ky tipar i ndajshtimit e dallon atë si një lloj i veçantë i përcaktorit.*

- *Ndajshtimi qëndron pas gjymtyrës që e përcakton:*

◇ *U kthye te dhoma e tij* ***shpellë*** *(ndajshtim i shprehur me emër të përgjithshëm që tregon cilësi).*
◇ *Mali* ***Korab*** *shtrihet përgjatë kufirit të Shqipërisë (ndajshtim i shprehur me emër të përveçëm pas emrave të përgjithshëm që emërtojnë vende gjeografike).*
◇ *Fjalën "****largohu****" e mori përzemër (ndajshtim i shprehur me çdo pjesë të ligjëratës të emërzuar pas emrave të përgjithshëm).*
◇ *Ne* ***nxënësit*** *duhet të kërkojmë më shumë dijen (ky është rasti kur ndajshtimi e përcakton një përemër vetor të vetës së parë ose të dytë dhe shprehet me emër të shquar).*

***Pyetje:***

- *Çka është përcaktori?*
- *Me se shprehet përcaktori?*
- *Sa lloje të përcaktorëve kemi varësisht nga lidhja sintaktore?*
- *Çka përcakton ndajshtimi dhe me çka shprehet ai?*

Shih fletoren e punës

127

*Nga zëri ai kuptoi se kishte ndodhur diçka* ***më e madhe.***
*Jehona e* **këtyre** *ngjarjeve u përhap në të katër anët.*
*More, si u bë puna* ***e atij*** *shkrimit tim?*

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit e lexojnë tekstin në librin bazë, faqe 126 dhe 127.

Mësimdhënësi i jep shpjegimet për përcaktorin.

- Përcaktori shprehet me emër, mbiemër dhe përemër. Emri në rasën gjinore është gjithmonë në funksionin e përcaktorit.
- Përcaktorët shërbejnë për ta përcaktuar emrin bërthamë të një grupi emëror.

*Kemi katër lloje të përcaktorëve:*

1. *Përcaktorë me përshtatje*
2. *Përcaktorë me drejtim*
3. *Përcaktorë me bashkim*
4. *Përcaktorë me ndajshtim*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit në dyshe duke i ndihmuar njëri-tjetrit do të bëjnë shembuj me përcaktorë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të përcaktorëve nga llojet e tjera dhe përdorimit të drejtë të tij.

**Detyrë:**
(Pyetjet e shtruara në librin bazë)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 139

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Përcaktori

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon përcaktorin nga gjymtyrët e tjera të fjalisë. Mëson që është gjymtyrë e dytë e fjalisë dhe e plotëson një gjymtyrë emërore të fjalisë. Identifikon mjetet gjuhësore me të cilat shprehet përcaktori në fjali.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1, II: 2. 5, III: 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2



◇ Hiqni të gjithë rrethanorët në fjalitë më poshtë dhe tregoni nëse u ndërrohet kuptimi fjalive:

Dje, në mëngjes, u rrëzova.
Nuk kishte guxim të më ndiqte, nga frika.
Nën libër është lapsi.

◇ Ndërtoni nga dy fjali që përmbajnë rrethanorë kohe, vendi dhe shkaku.

njësia 32
PËRCAKTORI

Pyetje

1. Me cilën gjymtyrë të fjalisë lidhet përcaktori?
2. Pse përcaktorët trajtohen si gjymtyrë të dyta?
3. Si gjendet përcaktori në fjali?
4. Sa lloje të përcaktorëve kemi?
5. Çka është ndajshtimi?

Ushtrime

◇ Gjeni përcaktorët në fjalitë më poshtë:

a. E Bukura e Dheut doli nga liqeni.
b. E di vlerën time. E shfrytëzoj fuqinë time.
c. Duhen vite për ta gjetur zërin tënd dhe vlerën tënde.
d. Ka dy lloje të fuqive në botë, njëra është shpata dhe tjetra është lapsi.

69

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përcaktori

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon llojet e përcaktorit;
- Gjen përcaktorin në tekst.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të siguruara nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Harta e konceptit*

Nxënësit në fillim të orës me ndihmën e mësimdhënësit do ta punojnë *Hartën e konceptit.*





◇ *Gjeni cilën gjymtyrë po e përcakton përcaktori i nënvizuar në fjalitë më poshtë:*

*a. Vrapova për tek ato mbetje shekullore.*
*b. Nuk di si ta shpjegojë ekzistencën e katërkëmbëshave.*
*c. S'ka kënaqësi më të madhe!*
*d. Nga buzët e thara më dilnin ca tinguj të ngjirur.*

◇ *Tregoni llojin e përcaktorëve të nënvizuar në fjalitë më poshtë, duke u bazuar në llojin e lidhjes sintaksore me emrin:*

*a. Ku po më çonte marrëzia ime?*
*b. Bëra një gjumë të rëndë.*
*c. Ai hëngri me ne sillën modeste.*
*d. Lumi Shkumbin ndan gjeografikisht dy dialektet e shqipes.*

◇ *Fjalët e nënvizuara më poshtë, përcaktoni me nga një përcaktor:*

*a. Unë kam ca miq ................*
*b. Ata janë................ fëmijë*
*c. Ai ka ca shoqe ................*
*d. Shkolla................ është e bukur*

***Detyrë***

◇ *Përzgjidhni një film për ta shikuar së bashku. Mbani shënime për aktorët/aktoret. Pastaj, do t'i vlerësoni ata/ato dhe performancat e tyre, duke përdorur përcaktorët. Diskutoni në klasë.*

70

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Në pjesën e dytë do të lexohen pyetjet me përgjigje nga libri bazë.

Pas leximit të detyrave të shtëpisë, do të punohet në librin *Fletore pune*, faqe 69 dhe 70.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Ditari dypjesësh*

| *Citim* | *Koment* |
|---|---|
| *Përcaktori shprehet* | *Përcaktori shprehet me emër, mbiemër dhe përemër.* |
| *Kemi katër lloje të përcaktorëve* | *Me përshtatje, me drejtim, me bashkim, me ndajshtim.* |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të përcaktorëve nga llojet e tjera dhe përdorimit të drejtë të tij.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 140

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksa

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë; -Dallon llojet kryesore të fjalive (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore), format e tyre (pohore, mohore); - Dallon fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.


njësia 35
FJALIA

MERKURI DHE DRUVARI

Një druvar i varfër kishte dalë për të copëtuar dru në pyll, skaj një liqeni. Druvari ishte lodhur. Kishte punuar gjithë ditën. Kishte humbur kujdesin për sëpatën. Sëpata rrëshqiti dhe ra drejt e në ujë.
Druvari u pikëllua. Me atë sëpatë e nxirrte bukën e gojës. Nuk kishte para për ta blerë një të re. Nisi të qante. Përnjëherë, nga uji doli Merkuri. E pyeti druvarin për hallin. Druvari i tregoi fije e për pe. Sakaq, Merkuri u zhyt në ujë. Doli pas disa sekondash. Në dorë po e mbante një sëpatë të artë.

- A është kjo sëpata jote, - e pyeti druvarin.
- Kjo nuk është sëpata ime, - ishte i sinqertë druvari.

***Merkuri e la sëpatën e artë në breg dhe u zhyt përsëri në ujë. Pas pak doli nga uji me një sëpatë të argjendtë që po e mbante në dorë. E pyeti druvarin nëse kjo ishte sëpata e tij, par druvari ishte i sinqertë.***

***Merkuri u zhyt edhe një herë në ujë dhe, këtë herë, doli me sëpatën e ndryshkur të druvarit. Druvari i ngratë u gëzua shumë që i ishte gjetur sëpata. Mirëpo, edhe Mërkuri ishte i gëzuar, për shkak të sinqeritetit të druvarit. Prandaj, vendosi dhe ia fali sëpatën e artë dhe sëpatën e argjendtë si shpërblim druvarit, i cili nuk kishte gënjyer.***

Druvari u kthye i gëzuar në fshat. I takoi bashkëfshatarët dhe u tregoi se çfarë kishte ngjarë. Disa nga bashkëfshatarët ia patën zili druvarit dhe u nisën të shkonin te liqeni, për t'i hedhur sëpatat e veta. Filluan të shtireshin se sëpatat u kanë rënë rastësisht në ujë dhe po bënin se po qanin në breg, duke pritur Merkurin. Merkuri doli vërtet dhe i pyeti se përse po qanin. Këta i thanë se u kishin humbur sëpatat.

***Merkuri u zhyt në ujë dhe doli me disa sëpata të arta. Fshatarët u gëzuan, kur i panë sëpatat dhe thanë se këto ishin sëpatat e tyre.***

Merkuri u vrenjt. I shikoi shtrembër. Ua dha nga një shuplakë pas qafe. U tha të iknin menjëherë në shtëpi. Pastaj, u zhyt në ujë. Bashkëfshatarët ikën të frikësuar. Erdhën të nesërmen. Po i kërkonin në ujë sëpatat që i kishin hedhur vetë. Mirëpo, nuk i gjetën dot.

128

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjalia

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon fjalitë me një kallëzues;
- Dallon fjalitë me dy kallëzues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqiten tri fjali:
1. Po, e dua detin.
2. Deti është si një nënë zemërgjerë.
3. Mallkimi i nënës të zë.

Kërkesë:
Gjeni kryefjalën dhe kallëzuesin në këto fjali.


njësia 35
FJALIA

MERKURI DHE DRUVARI

Një druvar i varfër kishte dalë për të copëtuar dru në pyll, skaj një liqeni. Druvari ishte lodhur. Kishte punuar gjithë ditën. Kishte humbur kujdesin për sëpatën. Sëpata rrëshqiti dhe ra drejt e në ujë.
Druvari u pikëllua. Me atë sëpatë e nxirrte bukën e gojës. Nuk kishte para për ta blerë një të re. Nisi të qante. Përnjëherë, nga uji doli Merkuri. E pyeti druvarin për hallin. Druvari i tregoi fije e për pe. Sakaq, Merkuri u zhyt në ujë. Doli pas disa sekondash. Në dorë po e mbante një sëpatë të artë.

- A është kjo sëpata jote, - e pyeti druvarin.
- Kjo nuk është sëpata ime, - ishte i sinqertë druvari.

***Merkuri e la sëpatën e artë në breg dhe u zhyt përsëri në ujë. Pas pak doli nga uji me një sëpatë të argjendtë që po e mbante në dorë. E pyeti druvarin nëse kjo ishte sëpata e tij, par druvari ishte i sinqertë.***

***Merkuri u zhyt edhe një herë në ujë dhe, këtë herë, doli me sëpatën e ndryshkur të druvarit. Druvari i ngratë u gëzua shumë që i ishte gjetur sëpata. Mirëpo, edhe Mërkuri ishte i gëzuar, për shkak të sinqeritetit të druvarit. Prandaj, vendosi dhe ia fali sëpatën e artë dhe sëpatën e argjendtë si shpërblim druvarit, i cili nuk kishte gënjyer.***

Druvari u kthye i gëzuar në fshat. I takoi bashkëfshatarët dhe u tregoi se çfarë kishte ngjarë. Disa nga bashkëfshatarët ia patën zili druvarit dhe u nisën të shkonin te liqeni, për t'i hedhur sëpatat e veta. Filluan të shtireshin se sëpatat u kanë rënë rastësisht në ujë dhe po bënin se po qanin në breg, duke pritur Merkurin. Merkuri doli vërtet dhe i pyeti se përse po qanin. Këta i thanë se u kishin humbur sëpatat.

***Merkuri u zhyt në ujë dhe doli me disa sëpata të arta. Fshatarët u gëzuan, kur i panë sëpatat dhe thanë se këto ishin sëpatat e tyre.***

Merkuri u vrenjt. I shikoi shtrembër. Ua dha nga një shuplakë pas qafe. U tha të iknin menjëherë në shtëpi. Pastaj, u zhyt në ujë. Bashkëfshatarët ikën të frikësuar. Erdhën të nesërmen. Po i kërkonin në ujë sëpatat që i kishin hedhur vetë. Mirëpo, nuk i gjetën dot.

128

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Teknika e pyetjeve të një tregimi*

Teksti në libër lexohet me dy ndalesa. Pas çdo ndalese bëhen pyetje.
Pyetjet pas ndalesës së parë:
Pse druvari e pranon vetëm sëpatën e vet?
Me çka e shpërblen Merkuri?
Pyetjet pas ndalesës së dytë:
Pyetjet pas ndalesës së fundit:
Cili është shpërblimi i Merkurit për druvarët?
Cili është mesazhi i këtij teksti?

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rrjeti i diskutimit*

Kërkesë:
Identifikoni në tekst fjalitë me një kallëzues dhe ato me dy kallëzues.

Diskutohen fjalitë e identifikuara në tekst.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të fjalive me një kallëzues dhe dy kallëzues.

**Detyrë:**
(Shkruani nga një fjali me një kallëzues dhe një fjali me dy kallëzues)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 141

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksa

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë; -Dallon llojet kryesore të fjalive (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore), format e tyre (pohore, mohore); - Dallon fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



njësia 33
FJALIA

**Detyrë**

◇ *Ndaji të gjitha fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra nga përrallëza "Zoti i ujit dhe druvari".*

**Detyrë**

◇ *Analizoje fjalinë:* ***Një druvar i varfër kishte dalë për të copëtuar dru në pyll, skaj një liqeni.***

*Kryefjala:* ____________
*Kallëzuesi:* ____________

*Trego cilat janë gjymtyrët e tjera:*

____________ : ____________
____________ : ____________

◇ *Analizoje fjalinë:* ***Merkuri e la sëpatën e artë aty.*** *Trego se ç'gjymtyrë janë këto njësi:*

*Merkuri -* ____________.
*La -* ____________.
*Sëpatën e artë -* ____________.
*E artë -* ____________.
*Aty -* ____________.

**Pyetje**

1. *Çka është fjalia e thjeshtë dhe cila është njësia bazë e saj?*
2. *Sipas qëllimit të thënies, si ndahen fjalitë e thjeshta?*
3. *Sipas modalitetit, si ndahen fjalitë?*
4. *Çka është fjalia e përbërë dhe si dallohet nga fjalia e thjeshtë?*
5. *Si i kuptoni fjalinë kryesore, fjalinë e pavarur dhe të varur?*

71

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjalia - ushtrime

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali;
- Harton fjali me një kallëzues.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diagrami i Venit*

Kërkesë:
Plotësoni tabelën sipas të dhënave.




njësia 33
FJALIA

**Detyrë**

◇ *Ndaji të gjitha fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra nga përrallëza "Zoti i ujit dhe druvari".*

**Detyrë**

◇ *Analizoje fjalinë: **Një druvar i varfër kishte dalë për të copëtuar dru në pyll, skaj një liqeni.***

*Kryefjala:* ______
*Kallëzuesi:* ______

*Trego cilat janë gjymtyrët e tjera:*

______ : ______
______ : ______

◇ *Analizoje fjalinë: **Merkuri e la sëpatën e artë aty.** Trego se ç'gjymtyrë janë këto njësi:*

*Merkuri -* ______.
*La -* ______.
*Sëpatën e artë -* ______.
*E artë -* ______.
*Aty -* ______.

**Pyetje**

1. *Çka është fjalia e thjeshtë dhe cila është njësia bazë e saj?*
2. *Sipas qëllimit të thënies, si ndahen fjalitë e thjeshta?*
3. *Sipas modalitetit, si ndahen fjalitë?*
4. *Çka është fjalia e përbërë dhe si dallohet nga fjalia e thjeshtë?*
5. *Si i kuptoni fjalinë kryesore, fjalinë e pavarur dhe të varur?*

71

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rrjeti i diskutimit*

Kërkesë:
Analizoni këto fjali.
1. Një druvar i varfër kishte dalë për të copëtuar dru në pyll, skaj një liqeni.
2. Merkuri e la sëpatën e artë aty.
3. Druvari u kthye i gëzuar në fshat.

Diskutohen punimet e nxënësve.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Kërkesë:
Shkruani nga dy fjali që kanë kryefjalë dhe kallëzues.

Lexohen disa nga punimet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e identifikimit të kallëzuesit dhe përdorimin e drejtë të tij në fjali.

**Detyrë:**
(Analizo tri fjali me një kallëzues)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 142

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III  **Klasa:** VI
**Tema:** Sintaksa

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Dallon fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë; - Dallon llojet kryesore të fjalive (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore), format e tyre (pohore, mohore); - Dallon fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4, 5, 6; II- 2, 7, 8; III- 3, 6; IV- 1, VI- 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** I: 2,4; II:1.2.3.4; III: 1,2,3,4.



**Pyetje:**

— Cili është subjekti i kësaj përrallëze?
— Cila është tema e kësaj përrallëze?
— Përmblidhe shkurtimisht përmbajtjen e kësaj përrallëze.

**Detyrë:**

— Në tekstin e mësipërm, disa fjali janë të shënuara me shkronja më të nxira. Mund të vëreni se ato fjali kanë më shumë se një kallëzues. Fjalitë që e kanë një kallëzues janë fjali të thjeshta. Ato që kanë më shumë se një janë fjali të përbëra.

**Bashkëbisedojmë:**

– Tregoni ndonjë shembull, kur e keni thënë të vërtetën dhe për këtë jeni shpërblyer.
– Tregoni domethënien e fjalës së urtë: Gënjeshtra i ka këmbët të shkurtra.

**Detyrë:**

Gjeni një tekst joletrar që flet për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Pastaj, krijoni një tabelë në fletore dhe klasifikoni fjalitë e thjeshta nga të përbërat.

**Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë**

a) Profesori mbante kronometrin. (fjali e thjeshtë)
b) Unë e afrova fitilin te flaka dhe vrapova për në breg. (fjali e përbërë)

129

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fjalia e thjeshtë dhe llojet e saj

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë;
- Dallon llojet e fjalive të thjeshta.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektori, laptopi, interneti

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Historia, Gjeografia, Gjuha angleze, Edukimi mjedisor, Edukimi shoqëror, Edukimi për medie

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutimi i ideve*

Paraqiten dy fjali:
1. Profesori e mbante kronometrin.
2. Unë e afrova fitilin te flaka dhe vrapova në breg.
Kërkesë:
Analizoni fjalitë.



*a. Një fjali është një grup fjalësh që shprehin një mendim. Fjalia e thjeshtë njësi bazë e ka një folje (kallëzues) dhe prania e gjymtyrëve të tjera në fjali, si kryefjala, kundrinori e rrethanori varen nga tiparet e foljes (kallëzuesit).*
*Shqipja ka disa lloje të fjalive të thjeshta në bazë të qëllimit të thënies dhe të intonacionit, si: fjalia dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore dhe thirrmore.*

***Fjalia dëftore***

- *Fjalia dëftore kumton zakonisht fakte të realitetit. Me të konstatohet diçka, jepet mendimi, gjykimi i folësit për një gjë. Për shembull:*
  - *Korriku ishte i nxehtë.*
  - *Bën vapë.*
  - *Sot është e premte.*
  - *Ajo noton shumë.*

***Fjalia pyetëse***

- *Fjalia pyetëse përdoret për të formuluar pyetje. Për shembull:*
  - *Sa është ora?*
  - *Çfarë dite është sot?*
  - *Kur do ta lexosh librin?*
  - *A të pëlqen noti?*

***Fjalia nxitëse***

*E takoi ujkun dhe e pyeti: Ku i ke bonbonet? Mirëpo, dhelpra e kishte dëgjuar ariun dhe i kishte treguar ujkut që do t'i kërkonte bonbone, kështu që ujku kishte marrë me vete bonbone plot.*

- *Ja ku i kam, tha ujku.*

*Ariu i zënë keq tha: Po ku i ke bonbonet e kuqe?*
*Ujku ia tregoi.*

- *Ku i ke bonbonet e gjelbra?*

*Ujku i kishte edhe ato.*

- *Ku i ke bonbonet e verdha?*

*Ujku i kishte edhe ato.*
*Ariu e pa se arsyetimi me bonbonet nuk po pinte ujë, prandaj iu kthye ujkut:*
*Ku e ke kapuçin?*
*Ujku s'e kishte.*
*Bap e bup.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Barcoletat janë tekste që synojnë ta bëjnë dikë të qeshë. Janë tekste letrare.*
- *Përbëhen nga dy pjesë: përgatitja dhe goditja. Përgatitja është pjesa në të cilën tregohet ngjarja si çdo ngjarje tjetër. Mund të ketë orientimin, komplikimin. Goditja është pjesa në të cilën bëhet shmangia nga ajo që pritet të ndodhë dhe kështu krijohet elementi humoristik.*
- *Qeshja është një nga emocionet e njeriut. Ndjenjat (emocionet) nxiten edhe përmes veprave të ndryshme letrare. Kur e lexojmë një tekst, mund të ndiejmë neveri, pikëllim, të qeshim a të qajmë, të ndiejmë frymëzim apo keqardhje.*
- *Ndjenjat zakonisht i shprehim dhe i nxisim te të tjerët, duke përdorur mbiemra dhe ndajfolje subjektive, por edhe folje me përdorim figurativ.*

***Shembuj:***

*M'u **dridh** zëri nga frika; Ajo ishte shumë e **gëzuar**.*

- *Kur shkruajmë për një libër, për një vepër, për një dukuri që nuk është letrare përpiqemi që të mos i përfshijmë ndjenjat tona.*
- *Kur shkruajmë përshtypje tonat ose vepra letrare i shprehim ndjenjat tona dhe përpiqemi të nxisim ndjenjat e të tjerëve.*

Shih fletoren e punës

77

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Disa nxënës caktohen për t'i lexuar barcoletat e dhëna në libër.
Ora do të jetë mjaft argëtuese dhe me të qeshura nga leximi i barcoletave.
Nxënësit do ta kenë mundësinë t'i tregojnë barcoletat që dinë.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Marrëdhënie pyetje-përgjigje*

Nxënësit i plotësojnë pyetjet në *Fletore pune,* faqe 45.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e rrëfimit dhe komentimit të barcoletave të lexuara.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë disa barcoleta)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 153

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Lexon dhe krahason artikuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me aktualitete nga shkenca, shëndetësia, barazia gjinore, të drejtat e njeriut.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2, II: 2. 3, III: 1. 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3



*E takoi ujkun dhe e pyeti: Ku i ke bonbonet? Mirëpo, dhelpra e kishte dëgjuar ariun dhe i kishte treguar ujkut që do t'i kërkonte bonbone, kështu që ujku kishte marrë me vete bonbone plot.*
*- Ja ku i kam, tha ujku.*
*Ariu i zënë keq tha: Po ku i ke bonbonet e kuqe?*
*Ujku ia tregoi.*
*- Ku i ke bonbonet e gjelbra?*
*Ujku i kishte edhe ato.*
*- Ku i ke bonbonet e verdha?*
*Ujku i kishte edhe ato.*
*Ariu e pa se arsyetimi me bonbonet nuk po pinte ujë, prandaj iu kthye ujkut:*
*Ku e ke kapuçin?*
*Ujku s'e kishte.*
*Bap e bup.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Barcoletat janë tekste që synojnë ta bëjnë dikë të qeshë. Janë tekste letrare.*
- *Përbëhen nga dy pjesë: përgatitja dhe goditja. Përgatitja është pjesa në të cilën tregohet ngjarja si çdo ngjarje tjetër. Mund të ketë orientimin, komplikimin. Goditja është pjesa në të cilën bëhet shmangia nga ajo që pritet të ndodhë dhe kështu krijohet elementi humoristik.*
- *Qeshja është një nga emocionet e njeriut. Ndjenjat (emocionet) nxiten edhe përmes veprave të ndryshme letrare. Kur e lexojmë një tekst, mund të ndiejmë neveri, pikëllim, të qeshim a të qajmë, të ndiejmë frymëzim apo keqardhje.*
- *Ndjenjat zakonisht i shprehim dhe i nxisim te të tjerët, duke përdorur mbiemra dhe ndajfolje subjektive, por edhe folje me përdorim figurativ.*

***Shembuj:***

*M'u **dridh** zëri nga frika; Ajo ishte shumë e **gëzuar**.*

- *Kur shkruajmë për një libër, për një vepër, për një dukuri që nuk është letrare përpiqemi që të mos i përfshijmë ndjenjat tona.*
- *Kur shkruajmë përshtypje tonat ose vepra letrare i shprehim ndjenjat tona dhe përpiqemi të nxisim ndjenjat e të tjerëve.*

Shih fletoren e punës

77

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon dhe rrëfen barcoleta;
- Shfaq kreativitet për krijimin e barcoletave;
- Nxjerr mesazhin nga barcoletat.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Film, Teatër.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Orën niset duke i lexuar detyrat e shtëpisë. Nxënësit duhej të shkruanin disa barcoleta. Një shembull që mund të jetë:

*Një ditë mësuesja duke i përfunduar notat, i erdhi rendi Agimit.*
*Mësuesja: "Sa bëjnë 2+2?"*
*Agimi u përgjigj: "4 bëjnë."*



*E takoi ujkun dhe e pyeti: Ku i ke bonbonet? Mirëpo, dhelpra e kishte dëgjuar ariun dhe i kishte treguar ujkut që do t'i kërkonte bonbone, kështu që ujku kishte marrë me vete bonbone plot.*
*- Ja ku i kam, tha ujku.*
*Ariu i zënë keq tha: Po ku i ke bonbonet e kuqe?*
*Ujku ia tregoi.*
*- Ku i ke bonbonet e gjelbra?*
*Ujku i kishte edhe ato.*
*- Ku i ke bonbonet e verdha?*
*Ujku i kishte edhe ato.*
*Ariu e pa se arsyetimi me bonbonet nuk po pinte ujë, prandaj iu kthye ujkut:*
*Ku e ke kapuçin?*
*Ujku s'e kishte.*
*Bap e bup.*

***Bashkëbisedojmë:***

- *Barcoletat janë tekste që synojnë ta bëjnë dikë të qeshë. Janë tekste letrare.*
- *Përbëhen nga dy pjesë: përgatitja dhe goditja. Përgatitja është pjesa në të cilën tregohet ngjarja si çdo ngjarje tjetër. Mund të ketë orientimin, komplikimin. Goditja është pjesa në të cilën bëhet shmangia nga ajo që pritet të ndodhë dhe kështu krijohet elementi humoristik.*
- *Qeshja është një nga emocionet e njeriut. Ndjenjat (emocionet) nxiten edhe përmes veprave të ndryshme letrare. Kur e lexojmë një tekst, mund të ndiejmë neveri, pikëllim, të qeshim a të qajmë, të ndiejmë frymëzim apo keqardhje.*
- *Ndjenjat zakonisht i shprehim dhe i nxisim te të tjerët, duke përdorur mbiemra dhe ndajfolje subjektive, por edhe folje me përdorim figurativ.*

***Shembuj:***

*M'u **dridh** zëri nga frika; Ajo ishte shumë e **gëzuar**.*

- *Kur shkruajmë për një libër, për një vepër, për një dukuri që nuk është letrare përpiqemi që të mos i përfshijmë ndjenjat tona.*
- *Kur shkruajmë përshtypje tonat ose vepra letrare i shprehim ndjenjat tona dhe përpiqemi të nxisim ndjenjat e të tjerëve.*

Shih fletoren e punës

77

*Mësuesja: "Ulu, Agim! 5."*
*Agimi: "E dita që bëjnë 5, por u habita."*

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Lexim i drejtuar*

Në këtë fazë mësimdhënësi jep informata për barcoletën si tekst letrar.

Barcoletat janë tekste që synojnë ta bëjnë dikë të qeshë. Janë tekste letrare.
Përbëhen nga dy pjesë: përgatitja dhe goditja.
Përgatitja është pjesa në të cilën tregohet ngjarja si çdo ngjarje tjetër. Mund të ketë orientimin, komplikimin. Goditja është pjesa në të cilën bëhet shmangia nga ajo që pritet të ndodhë dhe kështu krijohet elementi humoristik.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Diskutim i përbashkët*

Lexohen barcoletat në librin bazë dhe komentohen së bashku.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e rrëfimit dhe komentimit të barcoletave të lexuara si dhe kreativitetin e krijimit të tyre.
**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 154

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Lexon dhe krahason artikuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me aktualitete nga shkenca, shëndetësia, barazia gjinore, të drejtat e njeriut.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2, II: 2. 3, III: 1. 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3


SERGEJ JESENJIN
KËNGA E QENUSHES

- **Pyetje:** *Cilët janë subjekti dhe tema të kësaj vjershe?*
- **Pyetje dhe diskutim:** *Çfarë ndjenje ju sjell kjo vjershë?*
- **Detyrë:** *Përmblidhe këtë vjershë në mënyrë objektive në më pak se 50 fjalë.*
- *Shkruaji ndjenjat e tua për këtë vjershë në më pak se 50 fjalë.*

Kur mbi kosherë agmia dritë solli
Mbi cohat e lidhura si ngaberë
Shtatë këlyshë qenushja polli
Polli shtatë këlyshë leshverdhë

Deri në muzg i mbante ngat vetes
Ua lëpinte qimet në dritë hëne
Me qumësht ajo i ushqente
Nga ai gjoks i ngrohtë nëne

Në mbrëmje, të gjithë të heshtur
Dhe shpezëria mbyllur në kotec
Doli atëherë i zoti i vrenjtur
Të gjithë këlyshët i hodhi në thes

E qenushja gjurmët ia ndiqte
Skaj lumit nëpër errësirë
Sa gjatë e sa shumë që po dridhte
Sipërfaqja e ujit pa ngrirë

Tek po kthehej zvarrë nëpër terr
Dhe po lëpinte djersët si vaj
Hëna përtej iu duk njëherë
Si njëri nga këlyshët e saj

Shikoi lart me një dënesë
Në qiellin që nxinte prej së larti
Hëna e verdhë që si pa përtesë
U tret e ra diku pas një shpati

Heshti, si njëherë kur të tallur e lanë
Një asht duke e endur nga dora në dorë
Sytë e saj të qenushes ranë
Si rreze dielli mbi dëborë

78

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon dhe komenton poezi;
- Shfaq kreativitet për krijimin e poezisë;
- Nxjerr mesazhin nga poezia.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Film, Teatër.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do ta bëjnë një përsëritje të shkurtër për barcoletën si tekst letrar. Pas përsëritjes, do të fillojnë ta lexojnë vjershën "Kënga e qenushes".



SERGEJ JESENJIN
KËNGA E QENUSHES

– **Pyetje:** Cilët janë subjekti dhe tema të kësaj vjershe?

– **Pyetje dhe diskutim:** Çfarë ndjenje ju sjell kjo vjershë?

– **Detyrë:** Përmblidhe këtë vjershë në mënyrë objektive në më pak se 50 fjalë.

– Shkruaji ndjenjat e tua për këtë vjershë në më pak se 50 fjalë.

Kur mbi kosherë agmia dritë solli
Mbi cohat e lidhura si ngaberë
Shtatë këlyshë qenushja polli
Polli shtatë këlyshë leshverdhë

Deri në muzg i mbante ngat vetes
Ua lëpinte qimet në dritë hëne
Me qumësht ajo i ushqente
Nga ai gjoks i ngrohtë nëne

Në mbrëmje, të gjithë të heshtur
Dhe shpezëria mbyllur në kotec
Doli atëherë i zoti i vrenjtur
Të gjithë këlyshët i hodhi në thes

E qenushja gjurmët ia ndiqte
Skaj lumit nëpër errësirë
Sa gjatë e sa shumë që po dridhte
Sipërfaqja e ujit pa ngrirë

Tek po kthehej zvarrë nëpër terr
Dhe po lëpinte djersët si vaj
Hëna përtej iu duk njëherë
Si njëri nga këlyshët e saj

Shikoi lart me një dënesë
Në qiellin që nxinte prej së larti
Hëna e verdhë që si pa përtesë
U tret e ra diku pas një shpati

Heshti, si njëherë kur të tallur e lanë
Një asht duke e endur nga dora në dorë
Sytë e saj të qenushes ranë
Si rreze dielli mbi dëborë

78



**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pyetja sjell pyetjen*

Mësimdhënësi shtron pyetje rreth vjershës së lexuar.
*Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?*
*Çfarë ndjenje ju sjell kjo vjershë?*

Nga nxënësit kërkohet të identifikohen edhe fjalët e reja që i hasën gjatë leximit.

*Agmia - dritë e butë*
*Cohat - stof leshi i butë*
*Polli - lindi*



**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrimi përmbledhës*

Duke u bazuar në detyrat e dhëna në tekstin mësimor, nxënësve u kërkohet ta përmbledhin vjershën në mënyrë objektive me 50 fjalë, por edhe të shkruajnë për ndjenjat e tyre po ashtu me 50 fjalë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e komentimit dhe krijimit të poezive.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 155

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Lexon dhe krahason artikuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me aktualitete nga shkenca, shëndetësia, barazia gjinore, të drejtat e njeriut.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2, II: 2. 3, III: 1. 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpreh mendimin rreth poezisë si krijimtari letrare;
- Analizon poezinë;
- Nxjerr mesazhin nga poezia.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Film, Teatër.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Lexim i drejtuar*

Dy ose tre nxënës e lexojnë vjershën "I pamposhturi". Nga të tjerët kërkohet që me vëmendje të dëgjojnë derisa shokët/ shoqet e lexojnë vjershën, sepse më pas do të bëhet analiza për të.



Uiliam Ernest Henlej
**I PAMPOSHTURI**

Tek nata më mbulon anembanë,
E zezë si skëterra pambarim,
I falënderoj zotat kudo janë,
Për të pamposhtshmin shpirtin tim.

Kur rrethanat më shtynë me hov të rreptë
As kam dënesur, as qarë me lot
Tek më kaploi një fat i sertë
Koken ma thyen, por s'ma ulën dot

Diku përtej vajit dhe mërisë
Ku tmerri i ferrit mori të sundojë
Kërcënimi i viteve që vijnë
Nuk më zë kurrë në drojë

S'ka gjë që porta s'më zë dot
As sa i ashpër secili ndëshkim
Për fatin tim unë dal zot
Jam komandant i shpirtit tim

**Pyetje dhe diskutim:**

- *Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?*
- *Çfarë ndjenje keni kur e lexoni këtë vjershë?*

***Fjalë të reja:***
*Agmi, cohë, koshare, skëterrë, i sertë, dënes, kërcënim, mëri.*

***Detyrë:***
*Shkruani poezi në shtëpi. Pastaj, analizoni temën dhe subjektin e poezive tuaja. Prezantojini ato në klasë dhe diskutoni.*

79

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Pyetja sjell pyetjen*

Mësimdhënësi shtron pyetje rreth vjershës së lexuar.
*Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?*
*Çfarë ndjenje ju sjell kjo vjershë?*

Nxënësit identifikojnë fjalët e reja:

*Skëterrë – errësirë e madhe*
*I sertë – i vrazhdë*
*Dënes – qaj me ngashërim*
*Kërcënim – rrezik që i kanoset dikujt*
*Mëri – inat*

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Marrëdhënie pyetje-përgjigje*

Pyetjet 7, 8 dhe 9 në *Fletore pune.*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e komentimit dhe krijimit të poezive.

**Detyrë:**
(Të shkruajnë poezi për kafshët që i duan)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 156

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Lexon dhe krahason artikuj të ndryshëm që kanë të bëjnë me aktualitete nga shkenca, shëndetësia, barazia gjinore, të drejtat e njeriut.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I: 1. 2, II: 2. 3, III: 1. 3. 5
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1. 2, 2: 1. 4, 3: 2. 3


Uiliam Ernest Henlej
I PAMPOSHTURI

Tek nata më mbulon anembanë,
E zezë si skëterra pambarim,
I falënderoj zotat kudo janë,
Për të pamposhtshmin shpirtin tim.

Kur rrethanat më shtynë me hov të rreptë
As kam dënesur, as qarë me lot
Tek më kaploi një fat i sertë
Koken ma thyen, por s'ma ulën dot

Diku përtej vajit dhe mërisë
Ku tmerri i ferrit mori të sundojë
Kërcënimi i viteve që vjjnë
Nuk më zë kurrë në drojë

S'ka gjë që porta s'më zë dot
As sa i ashpër secili ndëshkim
Për fatin tim unë dal zot
Jam komandant i shpirtit tim

Pyetje dhe diskutim:
– Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?
– Çfarë ndjenje keni kur e lexoni këtë vjershë?

Fjalë të reja:
Agmi, cohë, koshare, skëterrë, i sertë, dënes, kërcënim, mëri.

Detyrë:
Shkruani poezi në shtëpi. Pastaj, analizoni temën dhe subjektin e poezive tuaja. Prezantojini ato në klasë dhe diskutoni.

79

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndjenjat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Diskuton për artikuj të ndryshëm;
- Shkruan ese kreative;
- Analizon shkrimet letrare dhe joletrare.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekste të ndryshme plotësuese.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Biologjia, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë paraprake*

Në fillim të orës nxënësit do të diskutojnë bashkë me mësimdhënësin për kafshët që i duan.
*Cilat kafshë shtëpiake do të donit t'i mbanit në shtëpi?*
*A do të kujdeseshit shumë për to?*
Një nga përgjigjet do të ishte:
*Do të doja një mace, sepse ajo është shumë e dashur.*
*Unë do të kujdesesha shumë për të.*



Uiliam Ernest Henlej

**I PAMPOSHTURI**

Tek nata më mbulon anembanë,
E zezë si skëterra pambarim,
I falënderoj zotat kudo janë,
Për të pamposhtshmin shpirtin tim.

Kur rrethanat më shtynë me hov të rreptë
As kam dënesur, as qarë me lot
Tek më kaploi një fat i sertë
Koken ma thyen, por s'ma ulën dot

Diku përtej vajit dhe mërisë
Ku tmerri i ferrit mori të sundojë
Kërcënimi i viteve që vjjnë
Nuk më zë kurrë në drojë

S'ka gjë që porta s'më zë dot
As sa i ashpër secili ndëshkim
Për fatin tim unë dal zot
Jam komandant i shpirtit tim

***Pyetje dhe diskutim:***

- *Cilët janë subjekti dhe tema e kësaj vjershe?*
- *Çfarë ndjenje keni kur e lexoni këtë vjershë?*

***Fjalë të reja:***
*Agmi, cohë, koshare, skëterrë, i sertë, dënes, kërcënim, mëri.*

***Detyrë:***

*Shkruani poezi në shtëpi. Pastaj, analizoni temën dhe subjektin e poezive tuaja. Prezantojini ato në klasë dhe diskutoni.*

79

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Ese "Kafshët që unë dua"*

Nxënësit do të shkruajnë një ese me temën "Kafshët që unë dua".
Mësimdhënësi do të shkruajë në tabelë fjalët kyçe:
*Kafshë shtëpiake, e bukur, e dashur, besnike.*

Po ashtu, mësimdhënësi tregon që eseja duhet të ketë hyrje, zhvillim dhe përfundim, drejtshkrim dhe bukurshkrim.

Nxënësit duhet t'u përmbahen këtyre rregullave.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Lexim i drejtuar*

Nxënësit i lexojnë esetë e tyre. Ata komentojnë dhe i vlerësojnë shkrimet e njëri-tjetrit, ndjenjat e tyre dhe dashurinë që kanë për kafshët.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e komentimit dhe krijimit të eseve.

**Detyrë:**

---

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 157

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Drejtshkrimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Në të shkruar përdor drejt shenjat e pikësimit, pikën, presjen dhe pikëçuditjen.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2; II. 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2



njësia 38

PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

– ***Nënvizoni rastet e përdorimit të shkronjës së madhe. Argumentoni përdorimin e saj për çdo rast.***

Ishte përhapur lajmi se Fogu ishte zotëria që kishte vjedhur Bankën e Anglisë. Ishte njëfarë detektivi Fiks, ai që zbuloi identitetin e vërtetë të Fogut. Shefi i policisë së Londrës e dërgoi atë në Suez për të kërkuar hajdutin dhe i premtoi t'i dërgonte edhe një fletë arresti. Në atë kohë, Egjipti ishte pjesë e Perandorisë Britanike dhe Kanali i Suezit ishte ndërtuar për t'ua shkurtuar rrugën anijeve që udhëtonin nga Anglia në Indi.

Lufta e Dytë Botërore ishte koha më e rëndësishme në jetën e babagjyshit. Atëkohë, pilotët trima të Forcave Ajrore Mbretërore e donin, sepse ai luftonte për vendin e tyre në Betejën e Britanisë. Nazistët planifikonin pushtimin, kishin bërë një plan që e quanin operacioni Luani i Detit. Ditë për ditë dhe natë për natë, pilotët e FAM-it, si babagjyshi, rrezikonin jetën për lirinë e britanikëve.

*Me shkronjë të madhe fillon:*

- *një tekst;*
- *një paragraf;*
- *një fjali.*

*Emrat në fragmentet e mësipërme: Fiks, Londër, Indi, Kanali i Suezit, Banka e Anglisë, Lufta e Dytë Botërore, FAM, si dhe emra të tjerë: Vesë, Lekë, Prizren, Kosovë, Evropë, Hënë, Drin, Adriatik janë* ***emra të përveçëm*** *dhe shkruhen me* ***shkronjë të madhe.*** *Kurse emrat: lis, top, lajm, shef, polic, kompjuter, nënë, qiell, pilot, shi, ujë, fushë, liri janë* ***emra të përgjithshëm*** *dhe shkruhen me* ***shkronjë të vogël.***

137

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përdorimi i shkronjës së madhe

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon rastet e përdorimit të shkronjës së madhe;
- Identifikon fjalët me shkronjë të madhe.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Di*

Nxënësit i tregojnë rastet se kur përdoret shkronja e madhe.

| | | |
|---|---|---|
| Di | | |
| Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe. | | |



*Pra, në gjuhën shqipe, shkronja e madhe shërben për të dalluar emrat e përveçëm të njerëzve, të kafshëve, të planetëve, të sendeve, të vendeve, të festave etj., nga emrat e përgjithshëm.*

***Me shkronjë të madhe shkruhen:***

- *Emrat dhe mbiemrat e njerëzve (Gjergj Kastrioti, Majlinda Kelmendi), epitetet (Leka i Madh, Akil Këmbështpejti), nofkat dhe pseudonimet (Pleshti, Çajupi, Migjeni);*
- *Emrat e botës mitologjike e fetare (Eva, Ademi, Apoloni, Diana), si edhe ata të figurave e të tregimeve popullore (Borëbardha, e Bukura e Dheut);*
- *Emrat e kafshëve: Baloja, Lola, Kiti, Akela;*
- *Emërtimet e planetëve, të yjeve e të trupave qiellorë: Arusha e Madhe, Jupiteri, Dielli, Hëna, Toka;*
- *Emrat e vendeve: Kosova, Evropa, Alpet, Drini, Prizreni, Amerika Veriore, Deti i Zi, Britania e Madhe, Qafa e Thanës, Rrafshi i Dukagjinit, Sheshi i Flamurit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;*
- *Emërtimet e ngjarjeve dhe të dokumenteve historike: Rilindja Kombëtare Shqiptare, Lufta e Dytë Botërore; Pakoja e Ahtisarit; Kalaja e Prizrenit; Monumenti i Shpalljes së Pavarësisë;*
- *Emërtimet zyrtare të institucioneve: Republika e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Universiteti i Prishtinës;*
- *Emërtimet e festave: 28 Nëntori, 17 Shkurti, Tetë Marsi, Dita e Mësuesit;*
- *Titujt e botimeve, që vihen edhe ndërmjet thonjëzash, ku shkruhet me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë e titullit dhe emrat e përveçëm që janë pjesë e tij: "Historia e Skënderbeut", "Komedia hyjnore", "Jeta arbëreshe";*
- *Shkurtimet: ShBA, OKB, FIFA, RTK*

Shih fletoren e punës

138

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Dua të di*

Nxënësit tregojnë atë që duan të dinë rreth përdorimit të shkronjës së madhe.

| Di | Dua të di | |
|---|---|---|
| Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe. | Pse te shkurtesa OBSh shkronja H është e vogël? | |

Pas plotësimit të kësaj rubrike, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit ta lexojnë njësinë faqe 137 dhe 138.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Mësova*

Nxënësit përmes rubrikës Mësova i shprehin njohuritë e marra.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe. | Pse te OBSh-ja shkronja H është e vogël? | Shkronja e dytë te shkronjat dyshe në shkurtesa të emërtimeve gjithnjë shkruhet me të vogël. |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të rregullave për shkrimin e fjalëve me shkonjë të madhe.

**Detyrë:**
(Shkruaj fjalë ku përdoret shkronja e madhe)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 158

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Drejtshkrimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Në të shkruar përdor drejt shenjat e pikësimit, pikën, presjen dhe pikëçuditjen.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2; II. 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2


◇ Diskutoni për përgjigjet e mundshme të këtyre pyetjeve:

A) Ç'farë është kjo? Ç'ka që po qan?

B) Çfarë është kjo? Çka ka që po qan?

◇ Vendosni apostrofin te pjesëza mohuese **s'** dhe pastaj zëvendësoni pjesëzën **s'** me pjesëzën **nuk**.

Ai tha se se pa filmin në kinema. - ________________

Si doli ashtu si e kishte menduar. - ________________

Su skuq qielli, kur sdoli dielli. - ________________

njësia 36
PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

◇ Vendosni shkronjat e mëdha aty ku duhet dhe shpjegoni përdorimin e tyre.

fileas fogu fiton edhe një bashkudhëtar të ri
paspartuja ishte shumë i kënaqur nga suksesi që arriti duke shpëtuar audën. zoti frensis paralajmëroi se, në qoftë se auda nuk do të largohej nga india, do ta rikapnin dhe herët a vonë do ta vrisnin.
në orën 10 udhëtarët arritën në stacionin hekurudhor të alahabatit. auda mezi u zgjua nga efektet e barnave. sa e bukur ishte dhe sa mirë e fliste anglishten!
fileas fogu i la lamtumirën djaloshit, duke i dhënë jo vetëm paratë e premtuara për shërbimet e tij, por edhe elefantin. fogu, paspartuja, auda dhe sër frensisi u nisën për në kalkutë me tren. kur u zgjua, auda pa se ishte veshur me rroba të stilit evropian dhe se po udhëtonte në tren me njerëz të huaj, po të mirë. fogu i propozoi asaj të kalonte indinë, në mënyrë që brahminët të mos kishin mundësi ta rikapnin. ai e ftoi audën që të shkonte me të në koloninë e hong-kongut, e cila shtrihej në breg të kinës dhe qeverisej nga anglezët. auda tha se do të kërkonte kushëririn e vet xhixhih, i cili jetonte në hong-kong. zoti frensis zbriti nga treni në benares. të nesërmen në mëngjes treni mbërriti në kalkutë. fileas fogu kishte fituar dy ditë kohë ndërmjet londrës dhe bombeit dhe humbi dy ditë duke u endur nëpër indi, kështu që ishte tamam në afat.

(Zhyl Vern "Rreth botës për 80 ditë", 2004)

76

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përdorimi i shkronjës së madhe

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon fjalët me shkronjë të madhe;
- Argumenton rastet e përdorimit të fjalëve me shkronjë të madhe;
- Shkruan fjalë duke e përdorur shkronjën e madhe.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim për njohuritë e parapara*

Nxënësit i lexojnë detyrat e shtëpisë, lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe. Gjatë leximit mësimdhënësi dhe nxënësit diskutojnë rreth fjalëve që janë përdorur nga ta.



◇ *Vendosni shenjën ✓ ose ✗ varësisht nga përdorimi korrekt ose jokorrekt i shkronjës së madhe.*

- ☐ *Arushi balu është shok i mirë i moglit.*
- ☐ *Nga të gjitha emërtimet e planetëve më i veçantë më duket emri Jupiter.*
- ☐ *Biblioteka Kombëtare ka arkitekturë interesante.*
- ☐ *Në fundjavë do ta vizitojmë kalanë e Prizrenit.*
- ☐ *Festa e 17 shkurtit është afër.*
- ☐ *Dita e Mësuesit është një festë e veçantë për ne.*
- ☐ *Në veprën "Libri i xhunglës" kafshët janë personazhe të dashura.*
- ☐ *Në RTK u shfaq filmi i ri "Avatar".*
- ☐ *Organizata UNICEF merret me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve.*

◇ *Shkruani nga 5 emra të përveçëm:*

*njerëzish:* ____________________

*kafshësh:* ____________________

*vendesh:* ____________________

*planetësh:* ____________________

*personazhesh:* ____________________

*ngjarjesh historike:* ____________________

*festash:* ____________________

*institucionesh:* ____________________

*veprash:* ____________________

*shkurtime:* ____________________

77

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari zbatuese*

Nxënësit i plotësojnë detyrat në fletore punë faqe 76 dhe 77.
Mësimdhënësi vëzhgon.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit e lexojnë punën e tyre. Përmirësohen gabimet e mundshme.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e dallimit të rregullave për shkrimin e fjalëve me shkonjë të madhe dhe përdorimit të drejtë të tyre.

**Detyrë:**

___

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

___

# Mësimi 159

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Drejtshkrimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Në të shkruar përdor drejt shenjat e pikësimit, pikën, presjen dhe pikëçuditjen.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1. 2; II. 3.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1: 1, 2


USHTRIM PËRMBLEDHËS PËR DREJTSHKRIMIN

◇ ***Hapi I.*** *Lexoni tekstin ashtu siç është dhënë. Diskutoni për vështirësitë e të kuptuarit të tekstit kur shenjat e pikësimit mungojnë.*

◇ ***Hapi II.*** *Vini shenjat e pikësimit, apostrofin dhe shkronjën e madhe aty ku duhet. Arsyetoni përdorimin e tyre në secilin rast.*

◇ ***Hapi III.*** *Rilexoni tekstin pasi keni vendosur shenjat e pikësimit.*

*djali ra mbi barin e gjatë dritat që vinin nga kullat e Muzgut nisën të kontrollonin vendin xheku ndenji shtrirë pa lëvizur për ca kohë edhe pse ishte vrarë keq kur ra me cep të syrit pa rrethin e dritës që po i afrohej një pjesë të djalit e kishte mbërthyer frika dhe donte tia mbathte por kujtoi se çi kishte mësuar gjyshi pra se çduhej të bënte në raste të tilla mos lëviz asnjë muskul kur dritat u larguan djali ngriti kokën ngadalë mes tij dhe ndërtesës ishte një pjesë toke e zbuluar si të shkonte atje pa u parë në atë çast sdinte çtë bënte një tjetër mësim i gjyshit ishte që në terren të zbuluar të rrëshqiste si gjarpër as në ëndërr nuk e kishte menduar se do të vinte një ditë që do ti përdorte këto teknika në një aventurë të vërtetë në jetë*

*(David Walliams "Superarratisja e babagjyshit", 2015)*

78

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përmbledhje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon rastet e përdorimit të apostrofit;
- Identifikon fjalët me shkronjë të madhe;
- Shkruan fjali duke i përdorur shenjat e pikësimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tekstet bazë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Punë individuale*

Nxënësit plotësojnë fletore punë faqe 78.



USHTRIM PËRMBLEDHËS PËR DREJTSHKRIMIN

- ◇ ***Hapi I.*** *Lexoni tekstin ashtu siç është dhënë. Diskutoni për vështirësitë e të kuptuarit të tekstit kur shenjat e pikësimit mungojnë.*
- ◇ ***Hapi II.*** *Vini shenjat e pikësimit, apostrofin dhe shkronjën e madhe aty ku duhet. Arsyetoni përdorimin e tyre në secilin rast.*
- ◇ ***Hapi III.*** *Rilexoni tekstin pasi keni vendosur shenjat e pikësimit.*

*djali ra mbi barin e gjatë dritat që vinin nga kullat e Muzgut nisën të kontrollonin vendin xheku ndenji shtrirë pa lëvizur për ca kohë edhe pse ishte vrarë keq kur ra me cep të syrit pa rrethin e dritës që po i afrohej një pjesë të djalit e kishte mbërthyer frika dhe donte tia mbathte por kujtoi se çi kishte mësuar gjyshi pra se çduhej të bënte në raste të tilla mos lëviz asnjë muskul kur dritat u larguan djali ngriti kokën ngadalë mes tij dhe ndërtesës ishte një pjesë toke e zbuluar si të shkonte atje pa u parë në atë çast sdinte çtë bënte një tjetër mësim i gjyshit ishte që në terren të zbuluar të rrëshqiste si gjarpër as në ëndërr nuk e kishte menduar se do të vinte një ditë që do ti përdorte këto teknika në një aventurë të vërtetë në jetë*

*(David Walliams "Superarratisja e babagjyshit", 2015)*

78

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Rishikim në grup*

Nxënësit i lexojnë detyrat e bëra. Përmirësohen gabimet e lëshuara.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Punë individuale*

Nxënësit shkruajnë një ese ku i përdorin të gjitha shenjat e pikësimit: përdorimin e apostrofit, përdorimin e shkronjës së madhe.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në saktësinë e përdorimit të apostrofit, shkronjës së madhe dhe shenjave të pikësimit.
**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 160

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 39

DREJTSHKRIMI I SHKRONJËS Ë

Përdorimi i shkronjës **ë** është problematik në gjuhën shqipe. Prandaj, nxënësit/nxënëset bëjnë shpesh gabime gjatë përdorimit të kësaj shkronje. Kjo ndodh se në disa raste ë-ja nuk është thjesht zanore, por shërben për të shënuar gjatësinë e zanores paraprake. Për shembull: ***plak-plakë (plaak), lum - lumë (luum),*** (unë) ***të dëgjoj*** - (ai/ajo) ***të dëgjojë (dëgjooj)***. Shërben edhe për të treguar shumësin e disa emrave. Për shembull: ***një mekanik - dy mekanikë; një punëtor - dy punëtorë.*** Ja disa nga rregullat e përdorimit të kësaj shkronje:

***Zanorja ë e theksuar***

Shkruhen dhe shqiptohen me **ë** të theksuar të gjitha fjalët që në gegërishte dalin me ***a*** të theksuar (hundore). Khs.

| *Shqipe standarde:* | *Gegërishte:* |
|---|---|
| — bëj | — baj |
| — nënë | — nanë |
| — (kam) dhënë | — (kam) dhanë |
| — (i, e) ëmbël | — (i, e) amël |
| — ëndërr | — andërr |
| — mbrëmje | — mbramje |
| — më (pak) | — ma (pak) |
| — nëntë | — nantë |
| — (kam) ngrënë | — (kam) ngranë |
| — një | — nja |

139

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Drejtshkrimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt shkronjën *ë*.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Drejtshkrimi i shkronjës *ë* (ora I)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon drejtshkrimin e shkronjës *ë;*
- Identifikon përdorimin e drejtë dhe të gabuar të shkronjës *ë;*
- Dallon kur *ë*-ja është e theksuar e kur e patheksuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** dokumenti "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe"

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Stuhi mendimesh*

Shkruhen në tabelë fjalët me theks fundor, parafundor e tejfundor, si: popujtë, miqët, meshkujtë, letërësin. Nxënësit duhet të gjejnë se ku është vendosur shkronja *ë* gabim e ku duhet të vendoset. Për këtë çështje kanë mësuar te theksi i fjalës.
Nxënësit i përmirësojnë gabimet duke e argumentuar mendimin. Shembull fjala *letërsinë* duhet të shkruhet me ë në fund, sepse theksi bie në rrokjen e fundit.



*Me **ë** shkruhen dhe shqiptohen edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit, si:* ***dëmtoj (damtoj), dhënie (dhanie), frëngjisht (frangjisht), gojëdhënë (gojëdhanë)*** *etj.*
*Por këto fjalë shkruhen me* ***a: bamirësi, dhanore, (i, e) mangët, ranishte, shmang, zanë, zanore.***

- *Zanorja **ë** e patheksuar*

**a)** *fjalët që kanë **ë** në rrokjen e parë dhe fjalët e prejardhura prej tyre:* ***bërryl, gërryej, këlysh, këmishë, kënaq, kënetë, këput, të këqij, kërcej, këshill, të mëdhenj, dëlir, kësaj, lëkund, mësyj*** *etj.*

b) *fjalët e formuara nga një temë më **-ë** dhe ndiqen nga një prapashtesë a temë tjetër që nis me bashkëtingëllore:* ***anëtar*** *(anë),* ***atëror*** *(atë),* ***bardhësi*** *(i bardhë),* ***botëror*** *(botë),* ***burrëri, burrëror*** *(burrë),* ***copëtoj, copëzoj*** *(copë),* ***drejtësi*** *(i drejtë),* ***anëshkrim*** *(anë),* ***atëherë*** *(atë),* ***bashkëpunoj*** *(bashkë),* ***dhjetëfishoj*** *(dhjetë),* ***i jashtëzakonshëm*** *(jashtë),* ***mirëdita*** *(mirë) etj.*

c) *fjalët e prejardhura nga tema që mbarojnë me bashkëtingëllore, ku zanorja **ë** është si zanore mbështetëse, si:* ***armiqësi*** *(armiq),* ***besnikëri*** *(besnik),* ***bujqësi*** *(bujq),* ***djallëzi*** *(djall),* ***harkëtar*** *(hark),* ***kombësi, kombëtar*** *(komb),* ***lajmëtar, lajmëroj*** *(lajm),* ***mjekësi, mjekësor*** *(mjek) etj.*

- ***Nuk** shkruhen me **ë** të patheksuar:*

**a)** *fjalët:* ***amtar, besnik, fillestar, furrtar, kishtar, lojtar, meshtar, nevojtar, ngatërrestar, pishtar, rojtar, zyrtar, atdhe*** *etj.*

**b)** *përemrat, ndajfoljet dhe lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalët **gjithë** ose **kurrë: gjithçka, gjithçmos, gjithfarë, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithkush, gjithmonë, gjithnjë, gjithsaherë, gjithsecili, gjithsekush, kurrfarë, kurrgjë, kurrkund, kurrkush kurrsesi** etj.*

c) *fjalët e përbëra, kur tema e dytë fillon me zanore:* ***bashkautor, bashkudhëtar*** *(bashkë),* ***gojëmbël*** *(gojë),* ***kokulur*** *(kokë),* ***i shumanshëm*** *(shumë) etj. Por shkruhen:* ***i njëanshëm, zëëmbël,*** *sepse **ë**-ja fundore te tema e parë është e theksuar.*

Shih fletoren e punës

140

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Veprimtari e të lexuarit dhe të menduarit të drejtuar (DRTA)*

Mësuesi së pari ua tregon librin "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" dhe ua shpjegon atë.
Më pas udhëzohen ta lexojnë tekstin.
Teksti ndahet në paragrafë.

Pyetjet për pjesën e parë:
- Roli i shkronjës *ë* në shembullin plakë?
- Po te fjala shqiptarë?
- Gjej fjalë të tjera me këtë rol.

Pyetjet për pjesën e dytë:
- Si shkruhen në standard fjalët: baj, kanga?
- Çfarë thotë kjo rregull?
- Merr shembuj të tjerë!
- A është kjo *ë* e theksuar?

Pyetjet për pjesën e tretë:
- A duhet të shkruhet me *ë* fjala bërryl? Pse?
- Po fjalët botëror, lajmëtar?

A është e theksuar *ë*-ja në këta shembuj?
Kështu vazhdohet edhe me pjesën e fundit.
Shpjegohet se fjalët: pishtar, kishtar, atdhe, besnik e të gjitha fjalët e këtij rreshti janë historikisht pa *ë*.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Rishikim në dyshe*

Nxënësit udhëzohen ta punojnë ushtrimin e parë në fletore pune, ku kanë për t'i korrigjuar fjalët e shkruara gabimisht.
Pas plotësimit, i shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin, i korrigjojnë gabimet dhe diskutojnë për detyrën.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në pyetje, për korrigjimin e përdorimit të *ë*-së në shembujt e dhënë.
**Detyrë:**
(Në fletore pune, ushtrimi 2)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 161

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


njësia 37

DREJTSHKRIMI I SHKRONJËS Ë

◇ *Vendosni ✓ ose x varësisht se si është shkruar fjala, korrekt ose jo.*

| | | | |
|---|---|---|---|
| ☐ *gja* | ☐ *tanë njerëzit* | ☐ *landë* | ☐ *kam zanë* |
| ☐ *hënë* | ☐ *shtëpinë tënde* | ☐ *zani* | ☐ *gojëdhënë* |
| ☐ *këngë* | ☐ *kam thanë* | ☐ *lang* | ☐ *dhanore* |

◇ *Gjeni fjalët që nuk janë shkruar në mënyrë korrekte dhe shkruani si duhet. Më pas, ndajini në dy grupe: fjalët që shkruhen me **ë** dhe fjalët që nuk shkruhen me **ë**.*

*brryl, grryej, këlysh, këmishë, knaq, kënetë, këput, të kqij, kërcej, kshill, të mdhenj, këtu, kshtu, kësaj, ktë, lëkund, msyj, antar, atëror, bardhësi, botror, burrëri, pjestoj, drejtsi, antar, atherë, bashkpunim, pesëfishoj, jashtëzakonisht, mirmbrëma, armiqësi, besnikëri, bujqsi, harktar, kombtar, lajmroj, mjeksi, amtar, besnik, lojëtar, zyrtar, atëdhe, gjithëçka, kurrfarë, bashkëpunëtor, bashkëautor, gojëëmbël, i shumanshëm, zëëmbël.*

| *Fjalët që shkruhen me ë* | *Fjalët që nuk shkruhen me ë* |
|---|---|
| | |

79

**Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim
**Lënda:** Gjuhë shqipe
**Shkalla e kurrikulës:** III **Klasa:** VI
**Tema:** Drejtshkrimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përdor drejt shkronjën *ë*.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 1, 2, 4; II. 4; III. 3, 5.
**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 1; 2. 1, 3; 3. 2, 4, 5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Drejtshkrimi i shkronjës *ë* (ora II)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Vendos *ë*-në në fjalë sipas rregullave gramatikore;
- Argumenton mendimin për vendosjen e *ë*-së;
- Shkruan një tekst, duke e vendosur *ë*-në sipas rregullave gramatikore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Historia.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**
**Përgatitja për të nxënët**
*Diskutim me tërë klasën*

Disa nxënës i lexojnë detyrat e shtëpisë.
Diskutojnë nëse i kanë gjetur dhe përmirësuar përdorimet e gabuara të shkronjës *ë*.
Duke i kontrolluar detyrat e shtëpisë bëhet edhe përsëritja e njësisë së fundit.


◇ Vendosni prapashtesën **-tar, -tor**, pas temave të dhëna. Shkruani me ose pa **ë** fjalët e dhëna.

| | | |
|---|---|---|
| arkë ______ | armë ______ | arsim ______ |
| gjyq ______ | nismë ______ | komb ______ |
| flamur ______ | faj ______ | pagë ______ |
| kalim ______ | shkrim ______ | shkak ______ |
| amë ______ | treg ______ | kishë ______ |
| punë ______ | shqip ______ | tym ______ |
| këngë ______ | lojë ______ | ski ______ |
| pishë ______ | lajm ______ | meshë ______ |

◇ Formoni fjalë të përbëra dhe të përngjitura me temat e dhëna dhe shkruani me ose pa **ë** fjalët e formuara.

| | |
|---|---|
| këpucë+bërës ______ | bojë+argjendi ______ |
| punë+dashës ______ | kurrë+gjë ______ |
| gjithë+andej ______ | gjithë+farë ______ |
| kurrë+kund ______ | zë+ëmbël ______ |
| gjithë+sesi ______ | farë+e fis ______ |
| vetë+vete ______ | vetë+vetiu ______ |

***Detyrë***

◇ Përzgjidhni një temë dhe shkruani për të. Pastaj, analizoni se si e keni përdorur shkronjën "ë" në raste të ndryshme.

80

**Ndërtimi i njohurive:**
**Përpunimi i përmbajtjes**
*Vëzhgo, analizo, plotëso*

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë ushtrimin 3 në fletore pune dhe ta plotësojnë sipas kërkesës.
Mësuesi, meqë nuk është në libër, shpjegon se fjalët që lidhen me prapashtesën -ti, -to, -tar, kur fjala e ka *ë*-në e vet, e ruan, shembull *këngëtar*.
Kur fjala mbaron me një bashkëtingëllore nuk merr ë, shembull fjalët: gjyqtar, kalimtar, tregtar; kur fjala mbaron me dy bashkëtingëllore merr -*ë*, shembull: lajmëtar, kombëtar dhe fjalët që historikisht kanë mbetur pa ë, janë: pishtar, meshtar, kishtar, lojtar, amtar. (Nëse ndonjë nxënës nuk e kupton kërkesën, udhëzohet ta lexojë edhe disa herë me kujdes udhëzimin e më pas mund t'i ndihmohet).

Njëjtë vazhdohet me ushtrimin 4.
Ndihmohen nxënësit ku kanë nevojë, por pas përpjekjeve që bëjnë vetë për zgjidhjen e detyrave.

**Përforcimi:**
**Konsolidimi i të nxënit:**
*Shkrim i lirë*

Nxënësit shkruajnë për një temë sipas dëshirës. Përdorin shkronjën ë sipas rregullave drejtshkrimore, e argumentojnë përdorimin ose mospërdorimin e *ë*-së.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për plotësimin e saktë të fjalëve me ose pa *ë*, për krijimin dhe për argumentimin e mendimit për drejtshkrimin e *ë*-së.
**Detyrë:**
(Shkruajnë për bukurinë e gjuhës shqipe)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*